AGJENCIA SHTETËRORE
PËR SHPRONËSIMIN
Nr. 274/3 Prot.
Datë.më 30.3.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 277/33 Prot.

Tiranë, më 27.03.2026

Lënda: *Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë dhe Rekomandimet*

Drejtuar: **AGJENCISË SHTETËRORE PËR SHPRONËSIM**

TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim (ASHSH), sipas programit të auditimit nr. 277/2 prot, datë 12.03.2025, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 10.03.2025 deri më datën 31.10.2025, në subjektin Agjencia Shtetërore për Shpronësim u krye "Auditimi i Përputhshmërisë për periudhën nga fillimi i institutcionit deri me datë 31.12.2024, rezultuan veprime apo mosveprime në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi, të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit, mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve mbi shpronësimin e pronave për interes publik, rezultuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", si dhe **Vendimin nr. 60 datë 17.03.2026, të Kryetarit të KLSH-së,** për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme, si dhe japim opinionin e auditimit:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit ASHSH për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i aktivitetit deri më 31.12.2024, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, në përdorimin e fondeve/burimeve të ASHSH.

Pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në përfundim rezultuan devijime të vogla nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, efektet e të cilave janë *materiale por jo të përhapura*, të cilave justifikojnë dhënien e një "***opinioni të kualifikuar***".

*"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e ASHSH janë evidentuar devijime të vogla nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur **janë materiale por jo të përhapura** dhe justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar** e shprehur kjo në bazën për opinion.*

Baza për opinionin:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpronësimin e pronave për interes publik të realizuara në Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve (ASHSH), rezultoi se:

- Në procedurën e shpronësimit me objekt: "*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër*", sipërfaqet e miratuar për shpronësim, nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit në dwg, e cila ndikon në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit;
- Në procedurën e shpronësimit me objekt: "*Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë*", sipërfaqet e miratuara për shpronësim nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit të miratuar e dokumentuar në dosje, veprime të cilat ndikojnë në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit prej 32,295,977.20 lekë, me efekt në buxhetin e shtetit;
- Në procedurën e shpronësimit me objekt: "*Studim projektim i mbikalimit të Fllakës*", në listën e pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private që shpronësohen për interes publik është përfshirë e gjithë sipërfaqja e truallit dhe objektet e pasurisë 14/59, pavarësisht faktit se në këtë pasuri është prekur vetëm një pjesë e truallit, por jo objektet, ku dhe pse janë shpronësuar ato nuk janë prishur. Llogaritja e sipërfaqes së truallit e cila nuk preket nga projekti i realizuar, si dhe llogaritja me vlerën e preventivit të objekteve të cilat nuk janë prekur nga shpronësimi, ndikon në rritjen e vlerës totale të shpronësimit dhe likuidimin e saj në mungesë të ndërhyrjeve të përshkruara në kërkesën për shpronësim;
- Nuk është vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit për marrjen e masave për të parandaluar dëmin ekonomik për buxhetin e shtetit si rezultat i llogaritjes së gabuar të vlerës së shpronësimeve konstatuar nga gjykata në proceset gjyqësore të iniciuara nga të shpronësuarit, në masën 560,230,000 lekë;
- Mungesa të rregullave të hollësishme për mënyrën e negocimit të ASHSH me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët;
- Vonesa të pajustifikuara në procesin e plotësimit të dokumentacionit për shpronësim nga ana e subjektit kërkues;
- Në dosjen e projekteve nuk përmbahet asnjë dokument ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH për likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar, duke mos pasur dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, dhe detyrimin për të krijuar bazën e të dhënave të likuidimeve, gjë që mund të çojë në pavlefshmëri shpronësimesh;
- Nga ASHSH, në relacionet shpjeguese adresuar subjekteve kërkuese për shpronësim dhe akt-marrëveshjet e lidhura, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit dhe punimeve;
- Nuk është respektuar afati 10 ditor nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit, për njoftimin zyrtarë të subjekteve, për mungesë adrese;
- Në asnjë nga praktikat e shpronësimit nuk dokumentohet që ASHSH të ketë përcjellë në adresë të ASHK vendimet e Këshillit të Ministrave për shpronësim, për të bërë të mundur ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale;
- Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në *të gjitha rastet*, Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACION NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Në procesin e zbatimit të kuadrit ligjor që rregullon fushën e shpronësimit për interes publik, gjatë auditimit është konstatuar se ekziston një mospërputhje dhe kontradiktë midis disa ligjeve e akteve nënligjore në fuqi. Fenomeni që në jurisprudence njihet si "*ndotje legjislative*" dhe sjell konfuzion në aplikimin e legjislacionit për shkak të rregullimeve me disa norma ligjore të një fushe të caktuar, është i dukshëm në Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve. Këtij konstatimi i shtohet dhe fakti se në këtë institucion pavarësisht insistimit nga strukturat e brendshme nuk janë miratuar nga organet eprore (MIE) aktet nënligjore të relatuara e propozuara nga struktura e audituar. Vlen të theksohet se miratimi i tyre nuk do të zgjidhte problemin tërësisht, por do të shmangte përplasjen e zbatimit në legjislacion për të njëjtin proces nga institucionet në të ardhmen. Konkretisht ndërhyrjet që propozohen: Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë

pronë private për interes publik", i ndryshuar; Ligji nr. 7980, datë 27.5.1995, "Për shitblerjen e tokave në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Ligjin Nr. 10018, Datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" ndryshuar me ligjin nr. 86/2018 Nenin 7.

Këto ligje materiale trajtojnë situata të ngjashme, por me qasje dhe zgjidhje ligjore të ndryshme, duke krijuar pasiguri juridike, zvarritje në procedura dhe mungesë efikasiteti në realizimin e projekteve me interes publik.

Ligji për avokaturën e Shtetit ka një rregullim për rolin e Avokatit të Shtetit në proceset e shpronësimit shumë në përgjithësi, duke mos konsideruar faktin se bëhet fjalë për realizim të projekteve strategjike me rëndësi kombëtare dhe me impakt të lartë si në financat shtetërore (Kontratat e Huasë dhe Koncesionare) por dhe të drejtën private.

Nisur nga ky impakt pjesëmarrja e Avokatit të Shtetit vlerësojmë se duhet të parashikohet që në fazën e fillimit të procesit të shpronësimit me qëllim vlerësimin sa më profesional të procedurës dhe marrjen përsipër të hetimit administrativ nga ana e tij për të gjitha efektet krahas përfaqësuesit të ASHSH.

Përfitimet ligjore do të ishin disa dimensionale por më të rëndësishmet do të parandalonin një dëm efektiv të mundshëm nga arbitrazhet ose Gjykatat Ndërkombëtare në buxhetin e shtetit për dëmshpërblime të të shpronësuarave jo me vlerën e tregut për pronat e tyre. Aktualisht është në fazat fillestare procesi, gjykatat vendase kanë dhënë vendimet e para duke treguar probabilitetin se shpërblimi i pronarëve privatë do të duhet të konsiderohet me vlerën e tregut për pronat e shpronësuara si në rastet e zbatimit të projekteve të huaja. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqet 81-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministrinë e Drejtësisë, Avokaturën e Shtetit, Ministrinë e Financave, si dhe me Agjencinë Shtetërore të Planifikimit e Zhvillimit të Territorit, të marrë masat për përgatitjen e projekt-studimit përkatës sipas problematikave të konstatuara gjatë aplikimit të ligjit ekzistues me qëllim: *Sigurimin e një qasje të unifikuar dhe të konsoliduar për çështjet që lidhen me shpronësimet*;

Parandalimin e konflikteve ligjore dhe përfaqësimin profesional ligjor në proceset gjyqësore që mund të iniciohen.

Përshpejtimin dhe rritjen e efikasitetit në zbatimin e projekteve të zhvillimit me interes publik.

Implementimin e harmonizuar të planeve të zhvillimit urban të qyteteve që miratohen në bazë të studimeve afatgjata dhe reflektimin e ndryshimit në regjistrat kadastrale të pasojave që prodhojnë në zërat kadastrale të pasurive të paluajtshme.

Brenda 30.09.2026

C. MASAT ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpronësimin e pronave për interes publik të realizuara në Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve (ASHSH), në objektet: - *"Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6"*; - *"Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër"*; - *"Ndërtim kopshti dhe çerdhe integruar nr. 42, Bashkia Tiranë"*; - *"Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi, Bashkia Pogradec"*; - *"Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë"*, rezultoi se:

- Në të gjitha projektet e shpronësimit të audituara rezultojnë mungesa të rregullave të hollësishme për mënyrën e negocimit të ASHSH me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët, në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 11, pika 5, germa d.

- Në relacionin e përpiluar nga ASHSH drejtuar subjekteve kërkuese për shpronësim (*MEI dhe Bashkitë Shkodër, Vlorë dhe Pogradec*), nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve, gjë e cila nuk rezulton të jetë parashikuar dhe në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues dhe ASHSH, veprim i cili vjen në kundërshtim me

Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 20, pika 1, shkronja (a);

- Vendimmarrja sipas procesverbalit të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), pasi kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten te plotësuar ne afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur;
- Akt-marrëveshja e lidhur nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar;
- Në dosjen e projektit procesverbalet e mbledhjeve të KPSH, në të gjitha rastet, janë pa numër protokolli, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18 i cili parashikon se: "*Procesverbale te mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshëm. Ato protokollohen.*"
- ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të subjektit privat që shpronësohet dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar në realizimin e "*Njoftim për shpronësim publik*", është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" i ndryshua, pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM nr.127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi, pasi ky njoftim është kryer përtej afatit 10 ditor nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit;
- Në dosjen e shpronësimit, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHSH) për regjistrimin e pronës së shpronësuar, në kundërshtim të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur, të nenit 11, pika 5/c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit të sipërcituar, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqen 18-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëveprim me subjektet kërkuese të projekteve që shpronësohen për interes publik, të marrë masat për:

- Standardizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor;
- Të siguruar që çdo vendimmarrje për pranimin e kërkesave për shpronësim të merret vetëm pasi dokumentacioni shoqërues të jetë i plotë, i saktë dhe i verifikuar, dhe në rastet kur ky dokumentacion paraqitet i paplotë ose jashtë afatit të përcaktuar, duhet të zbatojë detyrimisht procedurën e refuzimit të kërkesës dhe njoftimit të menjëhershëm të subjektit kërkues, në përputhje me përcaktimet ligjore;
- Të siguruar që çdo aktmarrëveshje e lidhur me subjektet kërkuese të jetë e shoqëruar detyrimisht me të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, në momentin e nënshkrimit të saj;
- Të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen;
- Të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale;
- Të hartuar dhe miratuar një akt normativ që përcakton rregullat e detajuara për procesin e negocimit;
- Të hartuar dhe miratuar një akt normativ që përcakton afate të qarta dhe konkrete për plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesit, si dhe të sigurohet zbatimi rigoroz i detyrimeve ligjore për kthimin ose refuzimin e kërkesave në rast të mos përmbushjes së afateve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i objektit: "*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës*

dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendodhje në Bashkinë Shkodër", dhe "*Studim projektim i mbikalimit të Fllakës*", u konstatua që në dokumentacionin e pronësisë disa kartela pasurie dhe harta treguese nuk ishin të përditësuara, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018 datë 7.2.2019, për "Kadastrën", neni 17, pika 4 dhe neni 12 dhe 13, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH".

(Më hollësisht trajtuar në faqen 21-34; 63-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH), përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të verifikojë të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara dhe të marrë miratimet/ konfirmimet nga institucionet përkatëse për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i objektit: "*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendodhje në Bashkinë Shkodër*", u konstatua se sipërfaqet e miratuara për shpronësim, nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit në dŵg. Ndryshimi dhe rritja e sipërfaqes së pasurive që marrin pjesë në shpronësim, ndikon edhe në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit. Gjithashtu ndikon në cenimin e pasurive kufizuese, ndër të cilat disa prej tyre janë edhe pasuri shtet. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimit të listës përfundimtare për shpronësim, në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH", veprime të cilat kanë çuar në efekte negative në buxhetin e shtetit për vlerën 16,528,362 lekë, kjo si rezultat i shpronësimit të një sipërfaqe më të madhe se sa duhej të shpronësohej nga matjet në dŵg, pasurinë e llojit "truall", me nr. 18/71, volumi 14, faqe 194, në ZK.8591, me sipërfaqe totale 11.200 m^2, në pronësi të Fatmir Muça, sipërfaqja e përcaktuar për shpronësim nuk përputhet me sipërfaqen e verifikuar nga projektit në dŵg.

(Më hollësisht trajtuar faqet 155-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH) pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim (ASHSH), përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryhej të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues. Gjithashtu të verifikohen të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara, të konfirmohen të gjitha sipërfaqet që preken nga shpronësimi nga projekti i miratuar (*edhe në version elektronik dŵg*) dhe nga verifikimi në terren, duke shmangur efektet negative në buxhetin.

Të merren masa për verifikimin e të gjitha pasurive që marrin pjesë në shpronësim dhe përputhshmërinë e tyre me projektin përfundimtar, rishikimin e sipërfaqeve që preket nga projekti (referuar DŴG-së), sipas konstatimeve të diferencës së sipërfaqeve të evidentuara nga grupi i auditimit. Pas rivlerësimit të situatës, KPSH, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

Menjëherë

3.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, në lidhje me nismën ligjore për ndryshimin e VKM-së, të vijojë me procesin për rishikimin dhe ndryshimin e sipërfaqes së

shpronësuar në mënyrën e gabuar, deri në miratimin e VKM-së të ndryshuar, në të cilën të reflektohet ndryshimi i sipërfaqes së shpronësimit sipas rekomandimit të grupit të auditimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: "*Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë*", u konstatua që sipërfaqet që janë miratuar për shpronësim, nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit të miratuar të dokumentuar në dosje, por bazohen në rishikimet e projektit, në të cilin sipërfaqet e disa pasurive të konstatuara nuk përkojnë me dokumentacionin e pronësisë. Ndryshimi dhe rritja e sipërfaqes së pasurive që marrin pjesë në shpronësim, ndikon edhe në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit, veprime të cilat kanë çuar në efekte negative në buxhetin e shtetit për vlerën 32,295,977.20 lekë.

Gjithashtu ndikon në cenimin e pasurive kufizuese, ndërtime të cilat disa prej tyre janë edhe pasuri shtet. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimit të listës për shpronësim. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", i ndryshuar, si dhe me nenin 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH". *(Më hollësisht trajtuar në faqen 48-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimit nëpërmjet Komisionit të Posaçëm për Shpronësim, të marrë masa si vijon:

- Përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryhen të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues, duke shmangur efektet negative në buxhetin.
- Të verifikojë të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara, të konfirmohen të gjitha sipërfaqet që preken nga shpronësimi nga projekti i miratuar dhe nga verifikimi në terren.
- Të gjitha pasurive që marrin pjesë në shpronësim dhe përputhshmërinë e tyre me projektin përfundimtar, duke rishikuar të gjitha sipërfaqet që preken nga projekti, në bazë të sipërfaqes të verifikuar nga dokumentacioni i pronësisë.

Menjëherë

4.2. Rekomandimi: Pas rivlerësimit të situatës, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

Menjëherë

5- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: "*Studim projektim i mbikalimit të Fllakës*", u konstatua që në listën e pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit është përfshirë e gjithë sipërfaqja e truallit dhe objektet e pasurisë 14/59, ndonëse është prekur vetëm një pjesë e truallit dhe objektet nuk janë prishur, duke mos cënuar funksionalitetin e njësisë ekonomike. Llogaritja e sipërfaqes së truallit e cila nuk preket nga projekti i realizuar, si dhe llogaritja me vlerën e preventivit të objekteve të cilat nuk janë prekur nga shpronësimi, ndikon në rritjen e vlerës totale të shpronësimit dhe likuidimin e saj në mungesë të ndërhyrjeve të përshkruara në kërkesën për shpronësim. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës dhe miratimit të listës për shpronësim. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për

interes publik", i ndryshuar, si dhe në bazë të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH". *(Më hollësisht trajtuar në faqen 63-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1- Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH), përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimin e listës përfundimtare të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryejë të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues. Nga KPSH, të merren masa për rishikimin e sipërfaqeve që preken nga projekti i realizuar dhe përjashtimin e objekteve të cilat nuk preken nga shpronësimi, referuar projektit dhe verifikimit në terren, sipas konstatimit të lënë nga grupi i auditimit. Pas rivlerësimit të situatës, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

Menjëherë

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dosjeve fizike të shpronësimit në **7 (shtatë) raste**, për akësisht për praktikat:

- "*Shpronësimi për realizimin e projektit të rishikuar për Lotet 4, 5, 6 Unaza Lindore*" Tiranë,
- "*Shpronësimi për realizimin e projektit Ndërtimi i Unazës Lindore Loti II*" Tiranë,
- "Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë-Vorë-Kashar".
- "Shpronësim për realizimin e projektit "Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik "Teda Tiranë"",
- "Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore,
- "Ndërtimi i Rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll",
- "Ndërtimi i nënstacionit 400 Kv Elbasan 3",

rezultoi se, nga KPSH, janë miratuar kërkesa për shpronësim në të cilat nuk përcaktohej afati i fillimit e përfundimit të punimeve, dhe/ose nuk vërtetohej me dokumentacion ligjor qëllimi shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar. Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, është shkak që prodhon me probabilitet absolut pasojën që rrjedh prej zbatimit të pikës 1 të nenit 26 "*Pavlefshmëri e shpronësimit*". Në raste të tjera mungon projekti i miratuar sipas ligjit, dhe/ ose aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, në kundërshtim me pikën b dhe pikën dh të nenit 10 të ligjit cituar.

Në disa prej praktikave, të trajtuara rast pas rasti më sipër, mungojnë njoftimi për pranimin e kërkesës drejtuar subjektit kërkues/ akt-marrëveshja për pranimin e kërkesës së subjektit, njoftimi i pronarëve/ bashkëpronarëve, publikimi i kërkesës për shpronësim të pronave, marrjen e Vendimit të shpronësimit përpara afatit njëmujor, të gjitha këto parregullësi vijnë në kundërshtim me nenet 13, 14, 15, 16, pika 1, 18 ,të Ligjit sipërcituar.

-KPSH në përfundim të shqyrtimit administrativ të kërkesës së subjektit për shpronësim me procesverbal ka pranuar kërkesën, duke vijuar me procedurat e tjera, në kundërshtim me nenin 13.1 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 sipër cituar. Dokumenti administrativ që sipas ligjit duhet të hartojë KPSH dhe që prodhon pasojë ligjore është "vendimi për pranimin e kërkesës për shpronësim". Ky vendim është akti bazë që prodhon Aktmarrëveshjen ligjore me pasoja juridike për subjektin kërkues dhe ASHSH.

-Janë lidhur Aktmarrëveshjen në mungesë të dokumentacionit ligjor shoqërues të saj. Ky devijim ligjor është me pasojë pavlefshmërinë juridike të shpronësimit. Në këtë kontekst të gjitha procedurat e shpronësimit të realizuara në këtë mënyrë janë të ekspozuara ligjërisht përballë goditjeve për pavlefshmëri në të ardhmen, si pasojë e neglizhencës dhe moskorrektesës nga ana e KPSH. Situata është me rrezikshmëri të theksuar kur subjekti kërkues është privat dhe Aktmarrëveshja duhet lidhet para noterit, por dhe pasojat e goditjes për pavlefshmëri janë më të rënda hipotetikisht. Institucioni ka detyrim të parashikojë dëmin në të ardhmen dhe pasojën në të ardhmen për çdo veprimtari në zbatim të ligjit. Veprim në kundërshtim me nenin 13, pika 4 e Ligjit 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe

marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqet 81-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësim Institucionit të marrë masat e domosdoshme që në përbërjen e KPSH të ketë specialistëve të trajnuar në fushën e përgjegjësisë dhe zbatimit të procedurave të shpronësimit me qëllim krijimin e standardeve të njëjta dhe aplikimin e tyre në çdo procedurë shpronësimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, në vazhdimësi të marrë masa për të vënë në funksion strukturën e Auditit të Brendshëm e cila nën monitorimin e tij të realizojë kontrollin e brendshëm për gjithë kohën e funksionimit të KPSH si mjetin efektiv për vetëkorrigjimin e punës së strukturës dhe vënien në efiçensë të sistemit të kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.3. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në varësi të marrë masa që të organizohen trajnime për stafin përgjegjës në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim lidhur me kërkesat ligjore dhe procedurale të shpronësimeve, implementimin e azhurnimeve e përmirësimeve ligjore si dhe praktikës gjyqësore të brendshme e ndërkombëtare në fushën e shpronësimeve. Në vëmendje të posaçme implementimin e praktikës ndërkombëtare në hartimin e akteve dhe zbatimin e standardeve për vlerësimin e pasurive objekt shpronësimi në të gjitha rastet që merren në shqyrtim nga Agjencia.

Në vijimësi

6.4. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të organizojë punën për evidentimin në çdo praktikë shpronësimi të realizuar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim që ka përfunduar procedurën përkatëse dhe të urdhërojë aty ku është e mundur plotësimin për ngritjen profesionale të punonjësve lidhur për procedurat e shpronësimit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **6 raste** u konstatua se:

- Nga KPSH nuk është përcaktuar afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar. Mungesa e përcaktimit të këtij afati, sjell ndër të tjera, pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*". Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit përkatësisht:

1- "*Unaza lindore Loti 3, Tiranë*".
2- "*Projektimi i Shkollës së Biçikletave për grupmoshat 7-10 vjeç Tiranë*".
3- "*Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare "Qazim Turdiu" Tiranë*".
4- "*Ndërtimi i qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço" Bashkia Lushnjë*".
5- "*Rikualifikim i akseve rrugore "Unaza Lindore Loti 2" Bashkia Tiranë.*
6- "*Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë*".

Sa më sipër është, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar,

-Procesverbalet e KPSH (KPSH) nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat teknike-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse, veprim në kundërshtim me nenin 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të

Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, "Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore".
-ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues realizimin e njoftimit të shpronësimit, veprim në kundërshtim me nenin 14, pika 1, nenit 24, pika 1, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- Nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë ku Agjencia Shtetërore për Shpronësim i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, për të bërë të mundur ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, veprime në kundërshtim me nenin 25, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe subjektit kërkues.
- Në të gjitha projektet e shpronësimit të audituara rezultojnë mungesa të rregullave të hollësishme për mënyrën e negocimit të ASHSH me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 11, pika 5, germa d). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 103-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të sigurohet që në propozimin për shpronësim paraqitur ministrit përgjegjës për zhvillimin urban të jetë i përcaktuar afati i fillimit dhe mbarimit të shpronësimit si dhe afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve ose i realizimit të qëllimit të shpronësimit.

Menjëherë

7.2. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësim, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, të merren masa për standardizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor.

Menjëherë

7.3. Rekomandimi: Nga ana e ASHSH, të merren masa për të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen. Në mungesë të adresës zyrtare, Agjencia duhet të zbatojë format alternative të njoftimit të parashikuara në legjislacion, dhe jo ti delegojë këtë detyrim subjektit kërkues.

Menjëherë

7.4. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të merren masa për të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale.

7.5. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me ministrinë e linjës Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të hartojë dhe miratojë urgjentisht një akt normativ që përcakton rregullat e detajuara për procesin e negocimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **3 raste**, përkatësisht për praktikat e shpronësimit: (*"Rikualifikimi i akseve rrugore Unaza Lindore, Lôti II dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit", "Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së plazhit të Durrësit, nga ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës", "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe-Tiranë", Bashkia Tiranë*"), Komisioni i Posaçëm të

Shpronësimit (KPSH) ka vendosur pranimin me kusht të kërkesës për shpronësim në mungesë të kompetencave dhe pa parashikuar në aktet ligjore e nënligjore, në kundërshtim me përcaktimet e pikës "2" të nenit 12, dhe neni 13, të Ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të VKM nr. 127, datë 23.03.2000 dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe [88], [166-165], [165-189] të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësimin në bashkëpunim me Komisionin e Posaçëm për Shpronësimin, duhet të ndalojë zbatimin e praktikës së pranimit me kusht të kërkesave dhe të zbatojë me rigorozitet procedurat për kthimin pa veprim dhe refuzimi i kërkesës si dhe pranimin e kërkesës për shpronësim, duke u siguruar që çdo kërkesë të jetë ose e pranuar ose e refuzuar siç parashikohet në kuadrin rregullator të shpronësimeve.

Menjëherë e në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në **2** projekte shpronësimi të audituara përkatësisht:
-Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore Tirana Agrikulturë (status i finalizuar).
-Projekt Ndërtim i Objektit 6 kate+1 kat parkim nën tokë në truallin në pronësi të Entit të Banesave (status i refuzuar), rezultoi se, ASHSH ka aplikuar afate të zgjatura dhe ka toleruar vonesa të pajustifikuara në procesin e plotësimit të dokumentacionit për shpronësim nga ana e subjektit kërkues, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 12, pika 3, i cili kërkon veprim të shpejtë (kthim ose refuzim) të kërkesave jo të plota brenda afatit të caktuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 156-175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të hartojë dhe miratojë një akt normativ që përcakton afate të qarta dhe konkrete për plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesit privat për shpronësim, si dhe të sigurohet zbatimi rigoroz i detyrimeve ligjore për kthimin ose refuzimin e kërkesave në rast të mos përmbushjes së afateve.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në **5 raste,** projektet e shpronësimit të audituara përkatësisht:

- "Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore Tirana Agrikulturë (status i finalizuar)",
- "Projekt Ndërtim i Objektit 6 kate+1 kat parkim nën tokë në truallin në pronësi të Entit të Banesave (status i refuzuar)",
- "Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së plazhit të Durrësit, nga ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës",
- "Projekt zgjerimi i Varrezave Publike, qyteti Përmet",
- "Projekt Ndërtimi i kopshtit nr. 37, Tiranë",

rezultoi se ASHSH nuk ka përcaktuar afate të qarta për fillimin dhe përfundimin e shpronësimit, si dhe të punimeve, në relacionet dhe akt-marrëveshjet e lidhura, në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 10, pika 1, germa "dh" si dhe nenin 20, pika 1, germa "a".
- ASHSH nuk ka të dhëna apo dijeni për statusin e likuidimit të pronarëve të shpronësuar dhe nuk monitoron pagesat, në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 1, neni 23, nemi 26.
- Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka protokolluar procesverbalet e mbajtura, veprim në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, në kundërshtim me nenin 18 Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar.

- ASHSH nuk siguron që adresat e fundit të njohura të subjekteve të shpronësuara të dorëzohen me kërkesën fillestare, duke çuar në delegimin e njoftimit te subjekti kërkues, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8561/1999, neni 10 dhe VKM nr. 127/2000.
- ASHSH nuk ka dokumentuar dërgimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin te ASHK, duke shkelur akt-marrëveshjen dhe penguar regjistrimin e pronave brenda afatit ligjor, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8561/1999, neni 25.
- Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurat e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime janë në kundërshtim me nenin 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, "*Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 156-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: ASHSH të sigurojë përcaktimin dhe dokumentimin e qartë të afateve të fillimit dhe përfundimit të shpronësimit dhe punimeve në të gjitha shkresat dhe akt-marrëveshjet përkatëse, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor të për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik.

Menjëherë

10.2. Rekomandimi: ASHSH duhet të dokumentojë dhe monitorojë në mënyrë të detajuar statusin e likuidimit të pronarëve të shpronësuar, duke krijuar dhe mbajtur një bazë të dhënash të plotë, si dhe të sigurojë që pagesat të kryhen brenda afateve ligjore për të shmangur pavlefshmërinë e shpronësimeve.

Menjëherë

10.3. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm të sigurojë që të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të protokollohen rregullisht, në përputhje me standardet arkivore.

Menjëherë

10.4. Rekomandimi: ASHSH duhet të zbatojë në mënyrë rigoroze kërkesat ligjore për sigurimin e adresave të fundit të njohura të subjekteve të shpronësuara që në fazën e kërkesës fillestare, për të shmangur delegimin e njoftimit dhe për të garantuar procesin e duhur.

Menjëherë

10.5. Rekomandimi: ASHSH duhet të sigurojë dhe dokumentojë dërgimin e rregullt të vendimeve të Këshillit të Ministrave për shpronësimin te ASHK, për të respektuar akt-marrëveshjet dhe për të garantuar regjistrimin e pronave brenda afatit ligjor.

Menjëherë

10.6. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësim, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, të merren masa për standartizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) procedura prokurimi përkatësisht për "*Blerje letër A4, A3 dhe materialesh kancelarike*" dhe "*Blerje tonerash për fotokopje*", u konstatuan vonesa në afatin e lëvrimit të mallit, nga momenti i shpalljes fitues të OE deri në momentin e marrjes nga grupi i marrjes në dorëzim, veprim në kundërshtim me *shkresën nr. 738/4 prot., datë 03.10.2023 të ASHSH Fiesa për Ofertë për "Blerje letër A4, A3 dhe materialesh kancelarike" dhe me Kontratën nr. 1208/12 prot., datë 31.10.2024 për "Blerje tonerash për fotokopje". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 189-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: ASHSH të vendosë një sistem të përforcuar monitorimi për të siguruar ndjekjen në kohë të afateve të lëvrimit në të gjitha procedurat e prokurimit, të dokumentojë çdo devijim dhe të

aplikojë penalitete të parashikuara për vonesat e pajustifikuara si dhe vlera e penalitetit të përcaktohet në kontratat e lidhura ndërmjet Autoritetit Kontraktor (ASHSH) dhe operatorëve ekonomike të shpallur fitues të kontratave për të reduktuar rreziqet e tejkalimit të afateve dhe për të garantuar furnizime në përputhje me nevojat operacionale të institucionit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit për "*Blerje pjesësh këmbimi për materiale profilaktike*", mungon leja mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, si një nga dokumentacionet që duhen paraqitur nga ana e OE fitues, veprim në kundërshtim me shkresën nr. 489/7 prot., datë 21.11.2023 Ftesa për Ofertë si dhe me *Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 të APP "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 18. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 189-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve me vlerë të vogla, të shqyrtojë me vëmendje dokumentacionet e dërguara nga OE fitues, në mënyrë që mos të kualifikojë operatorë të cilët nuk plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në ftesat për ofertë.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në **2** (dy) procedura prokurimi përkatësisht për "*Blerje pjesësh këmbimi, materiale profilaktike 2023*" dhe "*Blerje pjesësh këmbimi, materiale profilaktike 2024*", në procesverbalet e marrjes në dorëzim nuk shprehet nëse këto shërbime janë kryer sipas standardeve të përcaktuara në ftesën për ofertë, veprimet vijnë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në njësinë e sektorit publik" pika 45, si dhe me Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 të APP "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 18. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 189-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Komisioni i marrjes në dorëzim në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, të dokumentojë realizimin e kryerjes së shërbimeve të procedurave të llojit "Mallra dhe shërbime" sipas kërkesave të dokumenteve standardeve të procedurës së prokurimit.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **2 raste**, përkatësisht për praktikat:

- "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)",
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 122, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)", vendimmarrja për pranimin e kërkesës është miratuar në mungesë të dokumentacionit shoqërues dhe atë të kërkuar në përputhje me kuadrin ligjor. Në **1 rast**, përkatësisht për praktikën, "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)", KPSH ka lejuar dorëzimin e përsëritur të dokumentacionit plotësues nga subjekti, megjithëse dispozitat ligjore parashikojnë refuzimin e menjëhershëm të kërkesës nëse dokumentacioni nuk paraqitet i plotë brenda afatit të caktuar. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime janë në kundërshtim me nenin 12, pika, 2, 3, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1 Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të sigurohet që çdo vendimmarrje për pranimin e kërkesave për shpronësim të merret vetëm pasi dokumentacioni shoqërues të jetë i plotë, i

saktë dhe i verifikuar. Në rastet kur, pas kërkesës për plotësim dokumentacioni, dokumentet paraqiten të paplota ose jashtë afatit të përcaktuar, Agjencia duhet të zbatojë detyrimisht procedurën e refuzimit të kërkesës dhe njoftimit të menjëhershëm të subjektit kërkues, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **3 raste,** përkatësisht për praktikat:

- "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)",
- "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 122, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)",
- "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)",

vendimmarrja për pranimin e kërkesës është miratuar në mungesë të dokumentacionit që shoqëron kërkesën për shpronësim. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime në kundërshtim me nenin 13, pika 4, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar.

- ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues realizimin e njoftimit të shpronësimit. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime në kundërshtim me nenin 14, pika 1, nenit 24, pika 1, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- ASHSH nuk ka përcjell ASHK vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, për të bërë të mundur ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime në kundërshtim me nenin 25, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe subjektit kërkues.
- Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurat e shpronësimit finalizuar me: Procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM-në me Nr. 181, datë 27.03.2024; Procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM-në me Nr. 620, datë 10.10.2024; Procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM me Nr. 221 datë 13.04.2022; Procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM me Nr.758, datë 13.12.2024.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, "*Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin të sigurohet që çdo aktmarrëveshje e lidhur me subjektet kërkuese të jetë e shoqëruar detyrimisht me të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, në momentin e nënshkrimit të saj.

Në vijimësi

15.2. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të merren masa për të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen. Në mungesë të adresës zyrtare, Agjencia duhet të zbatojë format alternative të njoftimit të parashikuara në legjislacion, dhe jo t'ia delegojë këtë funksion subjektit kërkues.

Në vijimësi

15.3. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të merren masa për të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale.

Në vijimësi

15.4. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësim, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, të merren masa për standartizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **4 raste**, përkatësisht: ("Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Arbanë", Bashkia Tiranë", "Rishkimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe-Tiranë, Bashkia Tiranë", "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në me Nr. 795, datë 22.09.2015, Unaza Lindore, Tiranë Loti 2, Viti 2023", Bashkia Tiranë, Përmirësimi i shtresave rrugore, rruga "Andrea Stathi", Bashkia Korçë) u konstatua se:

- Vendimmarrja nga KPSH, për pranimin e kërkesës është miratuar në mungesë të dokumentacionit që shoqëron kërkesën për shpronësim, veprime në kundërshtim me nenin 13, pika 4, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar.
- Agjencia Shtetërore për Shpronësim, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues realizimin e njoftimit të shpronësimit, veprime në kundërshtim me nenin 14, pika 1, nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "*Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet*", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM nr.127, datë 23.03.2000, "*Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- Nuk është dokumentuar asnjë shkresë, ku Agjencia Shtetërore për Shpronësim, i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, për të bërë të mundur ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, veprime në kundërshtim me nenin 25, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe subjektit kërkues.
- Mungesa të rregullave të hollësishme, për mënyrën e negocimit të ASHSH, me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", neni 11, pika 5, germa d.
- ASHSH nuk ka të dhëna apo dijeni për statusin e likuidimit të pronarëve të shpronësuar dhe nuk monitoron pagesat, duke shkelur nenet 1, 23 dhe 26 të ligjit nr. 8561/1999 dhe detyrimin, për të krijuar bazën e të dhënave të likuidimeve, gjë që mund të çojë në pavlefshmëri shpronësimesh. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të

përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 1, neni 23, neni 26. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 187-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, të merren masa për:
- Të siguruar që çdo aktmarrëveshje e lidhur me subjektet kërkuese të jetë e shoqëruar, detyrimisht me të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, në momentin e nënshkrimit të saj;
- Të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen. Në mungesë të adresës zyrtare, Agjencia duhet të zbatojë format alternative të njoftimit të parashikuara në legjislacion, dhe jo t'ia delegojë këtë funksion subjektit kërkues;
- Të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale.

Në vijimësi

16.2 Rekomandimi: ASHSH në bashkëpunim me ministrinë e linjës MIE, të hartojë dhe miratojë urgjentisht një akt normativ që përcakton rregullat e detajuara për procesin e negocimit.

Në vijimësi

16.3. Rekomandimi: ASHSH duhet të dokumentojë dhe monitorojë në mënyrë të detajuar statusin e likuidimit të pronarëve të shpronësuar, duke krijuar dhe mbajtur një bazë të dhënash të plotë, si dhe të sigurojë që pagesat të kryhen brenda afateve ligjore për të shmangur pavlefshmërinë e shpronësimeve.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në **2** projekte shpronësimi të audituara rezultoi se ASHSH ka aplikuar afate të zgjatura dhe ka toleruar vonesa të pajustifikuara në procesin e plotësimit të dokumentacionit për shpronësim nga ana e subjektit kërkues, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 12, pika 3, i cili kërkon veprim të shpejtë (kthim ose refuzim) të kërkesave jo të plota brenda afatit të caktuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 185-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të hartojë dhe miratojë sa më shpejt një akt normativ, që përcakton afate të qarta dhe konkrete për plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesit, si dhe të sigurohet zbatimi rigoroz i detyrimeve ligjore për kthimin ose refuzimin e kërkesave në rast të mos përmbushjes së afateve.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave me vlerë të vogël u konstatua se në 7 procedura të audituara, u konstatuan parregullsi në 3 procedura me vlerë të fondit limit 1,571,000 lekë pa TVSH, si më poshtë:
- Në 1 rast, procedura me vlerë të vogël "Blerje letër A4 dhe A3 dhe materiale kancelarie, mungon numri i protokollit, në dokumentacionin e marrjes në dorëzim.
- Në 1 rast procedura me vlerë të vogël "Blerje programi financiar", komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka specialistë të fushës, *në kundërshtim me pikën 43 të UMF-së me Nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*
- Në 1 rast, procedura me vlerë të vogël "Blerje pajisje për programin software-ik "Auto-Cad" dhe Civil 3D 2022, është konstatuar se komisioni nuk ka specialistë të fushës;
- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që artikujt/ shërbimi të jetë marrë në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të MF-së nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, dhe me përcaktimet e VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimin Nr.5, datë 25.06.2021 *"Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". (Më hollësisht trajtuar në faqet 189-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim, të marrë masa, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë, që në të ardhmen, për çdo procedurë prokurimi "blerje me vlerë të vogël", të zbatojë me përpikmëri Legjislacionin e prokurimit publik, përpos ligjit dhe VKM-së. Kuadri ligjor përbëhet edhe

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



RAPORT
PËRFUNDIMTAR AUDITIMI 2026

AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE USHTRUAR NË "AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIM (ASHSH) TIRANË"

www.klsh.org.al

nga akte nënligjore të Agjencisë së Prokurimit Publik, si: Udhëzime, Rekomandime, etj., që synojnë mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik. "*Rregulloret e aplikueshme*" janë të gjitha aktet nënligjore që rregullojnë prokurimin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga Auditimi: Gjatë Auditimit ka rezultuar se nuk është vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit duke mos marrë masa për të parandaluar ardhjen e dëmit ekonomik për buxhetin e shtetit ose efektin financiar negativ si rezultat i llogaritjes së gabuar të vlerës së shpronësimeve konstatuar nga gjykata në proceset gjyqësore të iniciuara nga të shpronësuarit, në masën 560,230,000 lekë. Kjo diferencë (*midis asaj që është llogaritur në fakt dhe asaj që Gjykata ka pranuar për të shpronësuarit*) vjen si shkak i mos aplikimit të vlerës së pronës së shpronësuar sipas standardit të vendosur nga Gjykata në zbatim të efekteve të vendimit të K.RR.T.SH nr.3 datë 16.12.2004 për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit Tiranë.

Ky vendim ka ndryshuar statusin juridik të pasurive sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.7980 datë 27.5.1995''Për shitblerjen e trojeve në RSH'', konkretisht nenit 1 të këtij ligji; "truall quhet e gjithë toka që ndodhet brenda vijave kufizuese të qyteteve (Bashkive) pavarësisht nëse përdoret për ndërtim, kopësht, arë etj....". Vendimi i KRRTSH nuk është reflektuar në zërat kadastrale të pasurive me qëllim saktësimin e statusit juridik të secilës pasuri për të cilën është kërkuar shpronësimi. Siç dhe Bashkia si institucioni kompetent për menaxhimin e territorit të saj nuk ka reflektuar në kërkesat për ASHK dhe për ASHSH pasojat ligjore të vendimit të KRRTSH nr.3, datë 16.12.2004. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqet 80-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, të marrë masat në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit që të kërkojë procedurialisht pranë Gjykatës së Lartë, unifikimin e praktikës gjyqësore, me qëllim implementimin e saj në procedurat e shpronësimeve në praktikën e punës dhe shmangien e konflikteve gjyqësore, pa cenuar të drejtat e pronarëve dhe lirinë e pronës.

Menjëherë

1.2. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimit të kërkojë në Gjykatën e Lartë pezullimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për të shmangur ekzekutimin detyrimeve financiare në dëm të buxhetit të shtetit deri sa të unifikojë kjo Gjykatë praktikën Gjyqësore dhe çështja të marrë një zgjidhje përfundimtare ligjore.

Menjëherë

E. MASA DISIPINORE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15 germa c); Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 37 "*Masa disiplinore*" dhe Kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve (ASHSH)** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe pronës Publike.

Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit ***brenda 20 ditëve*** nga marrja e kësaj kërkese.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit ***brenda 6 muajve*** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

KRYETAR

Arben Shehu

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËRPUTHSHMËRIE

NË

SUBJEKTIN "AGJENCIA SHTETËRORE E SHPRONËSIMIT"

Tiranë, mars 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	12
II.	**HYRJA**	13
1.	Objektivat dhe qëllimi	13
2.	Identifikimi i çështjes	14
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	15
4.	Përgjegjësitë e audituesve	15
5.	Kriteret e vlerësimit	16
6.	Standardet e auditimit	16
7.	Metodat e auditimit	17
8.	Dokumentimi i auditimit	17
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	18
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	18
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit Auditim mbi kryerjen e verifikimeve të dokumentacionit, kryerjen e verifikimeve në terren, si dhe mbikëqyrjen e procedurave të shpronësimit. Auditim mbi vlerësimin e pasurive pronë private që shpronësohen, zhvlerësohen apo shpërblehen. Auditim mbi respektimin e afateve të shqyrtimit, deri në regjistrimin e ri të pasurive të shpronësuara. Auditim mbi llogaritjen e masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen për interes publik. Auditim mbi shpalljen e pavlefshmërisë së shpronësimit, kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara nga ana e përfituesit të shpronësimit.	18-189
2.6	Të ndryshme, që do të dalin gjatë auditimit. (Prokurimet)	189-224
IV.	**GJETJE DHE REKOMANDIME**	224-239
V.	**ANEKSE**	239-262

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës
MF	Ministria e Financave
ASHSH	Asgjësia Shtetërore për Shpronësim
KPSH	Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit
KM	Këshilli i Ministrave
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
KPV	Komisioni Paraprak i Vlerësimit
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
AK	Autoriteti Kontraktor
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
NjP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2024, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 277/2 prot, datë 12.03.2025, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka realizuar procesin e auditimit në subjektin "Agjencia Shtetërore e Shpronësimit" *(këtu e vijim ASHSH)*, për periudhën e aktivitetit nga fillimi i institucionit deri me datë 31.12.2024 me objekt: "*Auditim Përputhshmërie*".

Auditimi referuar pikave të programit kishte në fokus verifikimin e dokumentacionit në procesin e shpronësimit të pasurive pronë private që shpronësohet për interes publik, nëpërmjet kryerjes së verifikimeve në terren, respektimin e afateve të shpronësimit, deri në regjistrimin e ri të pasurive të shpronësuara, mbi llogaritjen e masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen për interes publik, dhe shpalljen e pavlefshmërisë së shpronësimit, kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara nga ana e përfituesit të shpronësimit.

Grupi i auditimit të KLSH-së shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzionin mbi secilin prej drejtimeve të auditimit, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë procesit të auditimit janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e Procedurave të Auditimit, Kodi Etik, si dhe praktikave më të mira audituese të fushës.

Bazuar në rezultatet e auditimit të kryer në ASHSH, për periudhën objekt auditimi (nga fillimi i aktivitetit të institucionit deri me datë 31.12.2024), grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të kualifikuar të përputhshmërisë.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Projekt raport Auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon akteve të mbajtura.

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

ASHSH është krijuar si institucion shtetëror me qëllim përqendrimin dhe menaxhimin më të mirë të procedurave të shpronësimit të pronës private për interes publik në Shqipëri. Ajo vepron si person juridik publik, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjish. Krijim i saj është pjesë e reformave në kuadër te Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, me fokus të garantojë që procedurat e shpronësimit ose të marrjes në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të personave fizikë ose juridikë private, të realizohen në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.

Funksionimi i rregullt i ASHSH, për ndjekjen dhe përfundimin e procedurave të shpronësimit, për realizimin e projekteve organizohet në formën e Komisioneve të Posaçme të Shpronësimit.

Si organizim, ASHSH për realizimin sa më të plotë të detyrave të përcaktuara aktet ligjore në fuqi, është e ndarë në tre drejtori, si më poshtë vijon:

- Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Drejtoria e Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit;
- Drejtoria e Negocimit dhe Asistencës Ligjore

Misioni, të zbatojë procesin e shpronësimit për interes publik në mënyrë të ligjshme, të drejtë, transparente dhe efikase, duke garantuar respektimin e të drejtave të pronarëve dhe sigurimin e kompensimit të drejtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet më të mira administrative.

Vizioni, të jetë një institucion profesional, i besueshëm dhe modern, që garanton balancën mes interesit publik dhe mbrojtjes së drejtës së pronësisë private, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit.
Për periudhën objekti auditimi nga ASHSH janë realizuar gjithsej 7,144,695,577.15 lekë. Nga grupi i auditimit janë audituar 34 procedura shpronësimit prej 3,933,171,461 lekë ose 55% e vlerës së projekteve të shpronësuara për periudhën nga fillimi deri me datën 31.12.2024.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit është i një rëndësie të veçantë, pasi siguron ligjshmëri dhe standarde etike, rrit besueshmërinë dhe transparencën, mbron të drejtën e pronarëve dhe interesin publik, përmirëson efikasitetin dhe menaxhimin financiar dhe ndihmon në parandalimin e abuzimeve.
Auditimi i Agjencisë së Shpronësimit merr rëndësi të veçantë për shkak se veprimtaria e saj lidhet drejtpërdrejt me **ndërhyrjen e shtetit në të drejtën kushtetuese të pronës private** dhe me administrimin e **fondeve të konsiderueshme publike**. Procesi i shpronësimit për interes publik kërkon respektim rigoroz të ligjshmërisë, transparencës dhe barazisë në trajtimin e subjekteve të prekura.
Në këtë kontekst, auditimi shërben si një mekanizëm thelbësor për të garantuar se vendimmarrja administrative dhe financiare e Agjencisë është e **arsyetuar, e dokumentuar dhe e mbështetur në kritere objektive**, duke minimizuar rrezikun e abuzimeve, konfliktit të interesit dhe keqmenaxhimit të fondeve publike. Për më tepër, duke qenë se pasojat e shpronësimeve janë shpesh **afatgjata dhe të pakthyeshme**, çdo mangësi në proces mund të sjellë pasoja financiare, ligjore dhe sociale për shtetin.
Auditimi kontribuon gjithashtu në **rritjen e besimit të publikut** ndaj institucioneve shtetërore, në uljen e konflikteve dhe proceseve gjyqësore, si dhe në përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të shtetit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronës. Për këto arsye, auditimi i Agjencisë së Shpronësimit konsiderohet një proces me **rrezik të lartë dhe rëndësi strategjike**, i domosdoshëm për garantimin e interesit publik dhe sundimit të ligjit.

c. *Qëllimi i auditimit.*

Auditimi i ASHSH përfshin aktivitetin nga fillimi i aktivitetit deri me 31.12.2024 dhe ka për objektiv dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.
Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.
Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Mbi kryerjen e verifikimeve të dokumentacionit, kryerjen e verifikimeve në terren, si deh mbikëqyrjen e procedurave të shpronësimit;*
- *Mbi vlerësimin e pasurive pronë private që shpronësohet, zhvlerësohet apo shpërblehet;*
- *Mbi respektimin e afateve të shqyrtimit, deri në regjistrimin e ri të pasurive të shpronësuara;*
- *Mbi llogaritjen e masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen për interes publik;*
- *Mbi shpalljen e pavlefshmërisë së shpronësimit, kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara nga ana e përfituesit të shpronësimit.*

Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse ASHSH, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.
Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes

së parimeve të ligjshmërisë, është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje të periudhave. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, është bërë përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim e objekteve të shpronësuara.
Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat si: verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe në terren etj.
Siguria e arsyeshme e auditimit ka ardhur kryesisht si rezultat i testeve thelbësore (punës mbi dokumentacion dhe verifikimit në terren).

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në fazën e realizimit të procesit të shpronësimit të pronës private për interes publik, si dhe shpenzimeve për blerje me vlerë të vogël, për të cilat Grupi i auditimit ka evidentuar 36 gjetje dhe ka dhënë **1 rekomandim për Përmirësim Ligjor, 18 masa organizative dhe 1 masë për Eliminimin e efekteve financiare negative** 3-E.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpronësimin e pronave për interes publik të realizuara në Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve (ASHSH), në objektet: - *"Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6"*; - *"Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër"*; - *"Ndërtim kopshti dhe çerdhe integruar nr. 42, Bashkia Tiranë"*; - *"Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi, Bashkia Pogradec"*; - *"Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë"*, rezultoi se:
- Në të gjitha projektet e shpronësimit të audituara rezultojnë mungesa të rregullave të hollësishme për mënyrën e negocimit të ASHSH me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët, në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 11, pika 5, germa d.
- Në relacionin e përpiluar nga ASHSH drejtuar subjekteve kërkuese për shpronësim (*MEI dhe Bashkitë Shkodër, Vlorë dhe Pogradec*), nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve, gjë e cila nuk rezulton të jetë parashikuar dhe në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues dhe ASHSH, veprim i cili vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 20, pika 1, shkronja (a);
- Vendimmarrja sipas procesverbalit të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), pasi kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten te plotësuar ne afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur;

- Akt-marrëveshja e lidhur nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar;
- Në dosjen e projektit procesverbalet e mbledhjeve të KPSH, në të gjitha rastet, janë pa numër protokolli, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18 i cili parashikon se: "*Procesverbale te mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshëm. Ato protokollohen.*"
- ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të subjektit privat që shpronësohet dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar në realizimin e "*Njoftim për shpronësim publik*", është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" i ndryshua, pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM nr.127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi, pasi ky njoftim është kryer përtej afatit 10 ditor nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit;
- Në dosjen e shpronësimit, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHSH) për regjistrimin e pronës së shpronësuar, në kundërshtim të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur, të nenit 11, pika 5/c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit të sipërcituar, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i objektit: "*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër*", dhe "*Studim projektim i mbikalimit të Fllakës*", u konstatua që në dokumentacionin e pronësisë disa kartela pasurie dhe harta treguese nuk ishin të përditësuara, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018 datë 7.2.2019, për "Kadastrën", neni 17, pika 4 dhe neni 12 dhe 13, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH".

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i objektit: "*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër*", u konstatua se sipërfaqet e miratuara për shpronësim, nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit në dwg. Ndryshimi dhe rritja e sipërfaqes së pasurive që marrin pjesë në shpronësim, ndikon edhe në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit. Gjithashtu ndikon në cenimin e pasurive kufizuese, ndër të cilat disa prej tyre janë edhe pasuri shtet. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimit të listës përfundimtare për shpronësim, në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë

pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të

funksionimit të ASHSH", veprime të cilat kanë çuar në efekte negative në buxhetin e shtetit për vlerën 16,528,362 lekë, kjo si rezultat i shpronësimit të një sipërfaqe më të madhe se sa duhej të shpronësohej nga matjet në dŵg, pasurinë e llojit "truall", me nr. 18/71, volumi 14, faqe 194, në ZK.8591, me sipërfaqe totale 11.200 m^2, në pronësi të Fatmir Muça, sipërfaqja e përcaktuar për shpronësim nuk përputhet me sipërfaqen e verifikuar nga projektit në dŵg.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: "*Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë*", u konstatua që sipërfaqet që janë miratuar për shpronësim, nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit të miratuar të dokumentuar në dosje, por bazohen në rishikimet e projektit, në të cilin sipërfaqet e disa pasurive të konstatuara nuk përkojnë me dokumentacionin e pronësisë. Ndryshimi dhe rritja e sipërfaqes së pasurive që marrin pjesë në shpronësim, ndikon edhe në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit, veprime të cilat kanë çuar në efekte negative në buxhetin e shtetit për vlerën 32,295,977.20 lekë.

Gjithashtu ndikon në cenimin e pasurive kufizuese, ndërtime të cilat disa prej tyre janë edhe pasuri shtet. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimit të listës për shpronësim. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", i ndryshuar, si dhe me nenin 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH".

5- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: "*Studim projektim i mbikalimit të Fllakës*", u konstatua që në listën e pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit është përfshirë e gjithë sipërfaqja e truallit dhe objektet e pasurisë 14/59, ndonëse është prekur vetëm një pjesë e truallit dhe objektet nuk janë prishur, duke mos cënuar funksionalitetin e njësisë ekonomike. Llogaritja e sipërfaqes së truallit e cila nuk preket nga projekti i realizuar, si dhe llogaritja me vlerën e preventivit të objekteve të cilat nuk janë prekur nga shpronësimi, ndikon në rritjen e vlerës totale të shpronësimit dhe likuidimin e saj në mungesë të ndërhyrjeve të përshkruara në kërkesën për shpronësim. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës dhe miratimit të listës për shpronësim. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe në bazë të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH".

6. Gjetje nga Auditimi: Gjatë Auditimit ka rezultuar se nuk është vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit duke mos marrë masa për të parandaluar ardhjen e dëmit ekonomik për buxhetin e shtetit ose efektin financiar negativ si rezultat i llogaritjes së gabuar të vlerës së shpronësimeve konstatuar nga gjykata në proceset gjyqësore të iniciuara nga të shpronësuarit, në masën 560,230,000 lekë. Kjo vlerë vjen si shkak i mosaplikimit të çmimit të pronës sipas standardit të vendosur nga Gjykata që rrjedh si pasojë ligjore e vendimit të K.RR.T.SH nr.3 datë 16.12.2004 për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit Tiranë.

Ky vendim ka ndryshuar statusin juridik të pasurive sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.7980 datë 27.5.1995''Për shitblerjen e trojeve në RSH'', konkretisht nenit 1 të këtij ligji, 'truall quhet e gjithë toka që ndodhet brenda vijave kufizuese të qyteteve (Bashkive) pavarësisht nëse përdoret për ndërtim, kopësht, arë etj....''Vendimi i KRRTSH nuk është reflektuar në zërat kadastralë të pasurive me qëllim saktësimin e statusit juridik të secilës pasuri për të cilën është kërkuar shpronësimi. Siç dhe Bashkia si institucioni kompetent për menaxhimin e territorit të saj nuk ka reflektuar në kërkesat për ASHK dhe për ASHSH pasojat ligjore të vendimit të KRRTSH nr.3 datë 16.12.2004.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

1. Rekomandimi: Titullari i ASHSH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministrinë e Drejtësisë, Avokaturën e Shtetit, Ministrinë e Financave, si dhe me Agjencinë Shtetërore të Planifikimit e Zhvillimit të Territorit, të marrë masat për përgatitjen e projekt-studimit përkatës sipas problematikave të konstatuara gjatë aplikimit të ligjit ekzistues me qëllim: *Sigurimin e një qasje të unifikuar dhe të konsoliduar për çështjet që lidhen me shpronësimet*;

Parandalimin e konflikteve ligjore dhe përfaqësimin profesional ligjor në proceset gjyqësore që mund të iniciohen.

Përshpejtimin dhe rritjen e efikasitetit në zbatimin e projekteve të zhvillimit me interes publik.

Implementimin e harmonizuar të planeve të zhvillimit urban të qyteteve që miratohen në bazë të studimeve afatgjata dhe reflektimin e ndryshimit në regjistrat kadastrale të pasojave që prodhojnë në zërat kadastrale të pasurive të paluajtshme.

2. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëveprim me subjektet kërkuese të projekteve që shpronësohen për interes publik, të marrë të gjitha masat si vijon:

- Standardizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor;
- Të siguruar që çdo vendimmarrje për pranimin e kërkesave për shpronësim të merret vetëm pasi dokumentacioni shoqërues të jetë i plotë, i saktë dhe i verifikuar, dhe në rastet kur ky dokumentacion paraqitet i paplotë ose jashtë afatit të përcaktuar, duhet të zbatojë detyrimisht procedurën e refuzimit të kërkesës dhe njoftimit të menjëhershëm të subjektit kërkues, në përputhje me përcaktimet ligjore;
- Të siguruar që çdo aktmarrëveshje e lidhur me subjektet kërkuese të jetë e shoqëruar detyrimisht me të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, në momentin e nënshkrimit të saj;
- Të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen;
- Të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale;
- Të hartuar dhe miratuar një akt normativ që përcakton rregullat e detajuara për procesin e negocimit;
- Të hartuar dhe miratuar një akt normativ që përcakton afate të qarta dhe konkrete për plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesit, si dhe të sigurohet zbatimi rigoroz i detyrimeve ligjore për kthimin ose refuzimin e kërkesave në rast të mos përmbushjes së afateve.

3. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH), përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të verifikojë të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara dhe të marrë miratimet/ konfirmimet nga institucionet përkatëse për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

4. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH) pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim (ASHSH), përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për

interes publik nga realizimi i projektit, të kryhej të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues. Gjithashtu të verifikohen të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara, të konfirmohen të gjitha sipërfaqet që preken nga shpronësimi nga projekti i miratuar (*edhe në version elektronik dwg*) dhe nga verifikimi në terren, duke shmangur efektet negative në buxhetin.
Të merren masa për verifikimin e të gjitha pasurive që marrin pjesë në shpronësim dhe përputhshmërinë e tyre me projektin përfundimtar, rishikimin e sipërfaqeve që preket nga projekti (referuar DWG-së), sipas konstatimeve të diferencës së sipërfaqeve të evidentuara nga grupi i auditimit. Pas rivlerësimit të situatës, KPSH, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë
nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

5. Rekomandimi: Drejtoria Juridike pranë ASHSH, në lidhje me nismën ligjore për ndryshimin e VKM-së, të vijojë me procesin për rishikimin dhe ndryshimin e sipërfaqes së shpronësuar në mënyrën e gabuar, deri në miratimin e VKM-së të ndryshuar, në të cilën të reflektohet ndryshimi i sipërfaqes së shpronësimit sipas rekomandimit të grupit të auditimit.

6. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimit nëpërmjet Komisionit të Posaçëm për Shpronësim, të marrë masa si vijon:
- Përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryhen të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues, duke shmangur efektet negative në buxhetin.
- Të verifikojë të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara, të konfirmohen të gjitha sipërfaqet që preken nga shpronësimi nga projekti i miratuar dhe nga verifikimi në terren.
- Të gjitha pasurive që marrin pjesë në shpronësim dhe përputhshmërinë e tyre me projektin përfundimtar, duke rishikuar të gjitha sipërfaqet që preken nga projekti, në bazë të sipërfaqes të verifikuar nga dokumentacioni i pronësisë.

7. Rekomandimi: Pas rivlerësimit të situatës, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

8. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimin e listës përfundimtare të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryhen të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues. Për sa më sipër trajtuar, të merren masa për rishikimin e sipërfaqeve që preken nga projekti i realizuar dhe përjashtimin e objekteve të cilat nuk preken nga shpronësimi, referuar projektit dhe verifikimit në terren, sipas konstatimit të lënë nga grupi i auditimit.
Pas rivlerësimit të situatës, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen
ndryshimet e mundshme.

9. Rekomandimi: Pas rivlerësimit të situatës, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

10- Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimin e listës përfundimtare të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryhen të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues. Për sa më sipër trajtuar, të merren masa për rishikimin e sipërfaqeve që preken nga projekti i realizuar dhe

përjashtimin e objekteve të cilat nuk preken nga shpronësimi, referuar projektit dhe verifikimit në terren, sipas konstatimit të lënë nga grupi i auditimit.
Pas rivlerësimit të situatës, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

11. Rekomandimi: Drejtoria Juridike, të marrë masat e domosdoshme për të parandaluar rritjen efektive të demit në buxhetin e shtetit. Për këtë qëllim të bëjë prezent para Bashkisë Tiranë urdhërimin e Gjykatës në vendimet e saj, si dhe të kërkojë në çdo proces gjyqësor përfshirjen e Bashkisë Tiranë me cilësinë e ndërhyrësit kryesor (pale e tretë) me qëllim që të bëhet solidare në detyrim. Kjo për shkak se ka detyrimin kryesor për përcaktimin e vijës kufizuese të qytetit Tiranë. Gjithashtu është Bashkia Tiranë ajo që ka detyrimin që çdo vendim për ndryshimin e vijës kufizuese të qytetit Tiranë ta bëjë të ditur për ASHK. Në këtë kuptim Drejtoria Juridike në bashkëpunim dhe me Avokaturën e Shtetit duhet të vërë në lëvizje mekanizmat ligjorë e procedurale për të parandaluar dëmin financiar të ardhshëm në buxhetin e shtetit si rezultat I shkeljes së ligjit nga ana e institucioneve të tjera. Por këtë shkelje evidentohen dhe japin pasojën në punën e ASHSH.

12. Rekomandimi: Drejtoria Juridike, të marrë masat në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit që të kërkojë proceduralisht pranë Gjykatës së Lartë, unifikimin e praktikës gjyqësore, me qëllim implementimin e saj në procedurat e shpronësimeve në praktikën e punës dhe shmangien e konflikteve gjyqësore, pa cenuar të drejtat e pronarëve dhe lirinë e pronës. Një vendim unifikues do të shërbente si udhërrëfyes i pakontestueshëm për institucionin, pronarët dhe subjektin kërkues, gjithashtu do të shmangte në çdo rast zbatimin e standardeve të ndryshme.

10. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimit të kërkojë në Gjykatën e Lartë pezullimin e vendimit të Gjykatës së Apelit deri sa të Unifikojë kjo Gjykatë praktikën Gjyqësore dhe çështja të marrë një zgjidhje përfundimtare ligjore.

2. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.

Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë.
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit ASHSH për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i aktivitetit deri më 31.12.2024, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, në përdorimin e fondeve/burimeve të ASHSH.
Pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në përfundim rezultuan devijime të vogla nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, efektet e të cilave janë *materiale por jo të përhapura*, të cilave justifikojnë dhënien e një ***"opinioni të kualifikuar"***.
*"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e ASHSH janë evidentuar devijime të vogla nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur **janë materiale por jo të përhapura** dhe justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar** e shprehur kjo në bazën për opinion.*
Baza për opinionin:
Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpronësimin e pronave për interes publik të realizuara në Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve (ASHSH), rezultoi se:
- Në procedurën e shpronësimit me objekt: *"Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër"*, sipërfaqet e

miratuar për shpronësim, nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit në dwg, e cila ndikon në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit;
- Në procedurën e shpronësimit me objekt: "*Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë*", sipërfaqet e miratuara për shpronësim nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit të miratuar e dokumentuar në dosje, veprime të cilat ndikojnë në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit prej 32,295,977.20 lekë, me efekt në buxhetin e shtetit;
- Në procedurën e shpronësimit me objekt: "*Studim projektim i mbikalimit të Fllakës*", në listën e pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private që shpronësohen për interes publik është përfshirë e gjithë sipërfaqja e truallit dhe objektet e pasurisë 14/59, pavarësisht faktit se në këtë pasuri është prekur vetëm një pjesë e truallit, por jo objektet, ku dhe pse janë shpronësuar ato nuk janë prishur. Llogaritja e sipërfaqes së truallit e cila nuk preket nga projekti i realizuar, si dhe llogaritja me vlerën e preventivit të objekteve të cilat nuk janë prekur nga shpronësimi, ndikon në rritjen e vlerës totale të shpronësimit dhe likuidimin e saj në mungesë të ndërhyrjeve të përshkruara në kërkesën për shpronësim;
- Nuk është vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit për marrjen e masave për të parandaluar dëmin ekonomik për buxhetin e shtetit si rezultat i llogaritjes së gabuar të vlerës së shpronësimeve konstatuar nga gjykata në proceset gjyqësore të iniciuara nga të shpronësuarit, në masën 560,230,000 lekë;
- Mungesa të rregullave të hollësishme për mënyrën e negocimit të ASHSH me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët;
- Vonesa të pajustifikuara në procesin e plotësimit të dokumentacionit për shpronësim nga ana e subjektit kërkues;
- Në dosjen e projekteve nuk përmbahet asnjë dokument ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH për likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar, duke mos pasur dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, dhe detyrimin për të krijuar bazën e të dhënave të likuidimeve, gjë që mund të çojë në pavlefshmëri shpronësimesh;
- Nga ASHSH, në relacionet shpjeguese adresuar subjekteve kërkues për shpronësim dhe akt-marrëveshjet e lidhura, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit dhe punimeve;
- Nuk është respektuar afati 10 ditor nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit, për njoftimin zyrtarë të subjekteve, për mungesë adrese;
- Në asnjë nga praktikat e shpronësimit nuk dokumentohet që ASHSH të ketë përcjellë në adresë të ASHK vendimet e Këshillit të Ministrave për shpronësim, për të bërë të mundur ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale;
- Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në *të gjitha rastet*, Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 277/2 prot., datë 12.03.2025, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.03.2025 deri në datë 31.10.2025, në subjektin Agjencia Shtetërore e Shpronësimit, për periudhën nga data fillimi i krijimit të ASHSH deri në datë 31.12.2024 u krye "*Auditim Përputhshmërie e veprimtarisë ekonomike-financiare*" nga Grupi i Auditimit, me përbërje:

1. Skënder Muçaj, Përgjegjës Grupi

2. Kristaq Gjurgjaj, anëtar
3. Erion Saliu, anëtar
4. Blerti Shehu, anëtar
5. Rita Gjati, anëtare
6. Juljan Hysomema, anëtar
7. Henri Axhushi, anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse **Agjencia Shtetërore për Shpronësim**, në të gjithë aspektet materiale, aktivitet ekonomike dhe financiare, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizën ligjore të prokurimit publik, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së ASHSH. Auditimi ka për qëllim promovimin e transparencës, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar ASHSH. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik, duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18)*.
Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

2. Identifikimi i çështjes.

ASHSH duhet të ketë organizimin e duhur për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit të shpronësimeve ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet. Raporti përfundimtar i auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të ASHSH për periudhën e audituar, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:
- Zbatimi i ligjshmërinë për kontrollin dhe vlerësimin e dokumentacionit për shpronësim, për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, për tre drejtoritë (Drejtoria e Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit; Drejtoria e Financë dhe Shërbimeve Mbështetëse; Drejtoria e Negocimit dhe Asistencë Ligjore) dhe vendimeve të marra dhe zbatimi i tyre, dhe konkretisht:

1. Kontrollon dokumentacionin e paraqitur nga subjektet kërkues të shpronësimit;
2. Shqyrton dokumentacionin në përmbushje të kritereve ligjore, teknike, financiare sipas legjislacionit në fuqi për shpronësimin në interes publik;
3. Vë në dispozicion të eprorëve dhe/ose të KPSH dokumentet në kuadër të procesit të shpronësimit;
4. Merr pjesë në trajtimin e ankesave lidhur me dokumentacionin e shpronësimit;
5. Kontrollon dhe rakordon vlerën ekonomike në listën e shpronësimit të pronarëve që shpronësohen për interes publik;
6. Përgatit praktika shkresore, relacione, informacione, database, sipas rastit, brenda fushës së përgjegjësisë së Sektorit;

7. Kontrollon listat e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, listat e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe listat e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave.
8. Shqyrton përllogaritjen e masës së shpërblimit apo kompensimit për objektet që shpronësohen, sipas rastit, për çdo pronë të prekur nga projektet e shpronësimit, për interes publik, si dhe identifikimin e vlerësimit përfundimtar të shpronësimit.
9. Vë në dispozicion të eprorëve dhe/ose të KPSH, në rast se kërkohet, dokumentet e kontrolluara për identifikimin e vlerave financiare, në kuadër të procesit të shpronësimit, sipas legjislacionit në fuqi për shpronësimin në interes publik.
10. Trajton ankesat e subjekteve kërkues të shpronësimit apo pronarët e pronave të shpronësuara apo personat e tretë të prekur lidhur me vlerat financiare në kuadër të shpronësimit publik.
11. Rakordon vlerat ekonomike në listën e shpronësimit të pronarëve që shpronësohen, për interes publik, si dhe kryen veprime për identifikimin e vlerësimit përfundimtare të shpronësimit, sipas legjislacionit në fuqi për shpronësimin në interes publik.
12. Merr pjesë në krijimin e database-ve për pasqyrimin e mënyrës së përllogaritjes së masës së shpërblimit apo kompensimit për objektet që shpronësohen dhe çdo pronë të prekur nga projektet e shpronësimit, për interes publik.
13. Angazhohet dhe/ose asiston në grupet e punës të ngritura me urdhër të Drejtorit të përgjithshëm, sipas rastit.
14. Mban kontakte dhe bashkëpunon me subjektet kërkuese, sipas rastit.
15. Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave; etj.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Një ndër përgjegjësitë kryesore të strukturave drejtuese është ngritja e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive të punonjësve. Hartimi i rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së ASHSH, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo drejtuesi dhe punonjësi në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore që veprojnë dhe në fuqi për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre.

ASHSH brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Në zbatim të dispozitave ligjore, merr masa për:

-Krijimin e kushteve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së punonjësve.
-Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbarëvajtjen në punë.
-Zbatimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri.
-Zbatimin e dispozitave të vendosura në Kontratën e Punës.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është që të shprehim një opinion të saktë objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen ose jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomiko financiare, në bazë të auditimit të KLSh-së. Ne mbajmë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute dhe, auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.
Procedurat e shpronësimit të zgjedhura për auditim varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

5. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë dhe dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar; Ligji nr. 44/2025, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligji nr. 90/2012, datë 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 "*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*", i ndryshuar; Ligji nr.35/2023, datë 24.03.2023 "*Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve*"; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 "*Për arkivat*"; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", ndryshuar; Ligji nr. 7980, datë 27.05.1995 "Për shitblerjen e trojeve në RSH", Ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në R.SH.", Ligji nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 86/2018.
VKM nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të ASHSH"; VKM-së 138, datë 23.02.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik"; VKM-së 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", VKM nr. 126, datë 23.03.2000 "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", VKM nr. 127, datë 23.03.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", Udhëzim nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

6. Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti përfundimtar i auditimit

është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:
-Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
-ISSAI 100 – (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik).
-ISSAI 400 – (Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë).
-Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";
-ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
-Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

7. Metodat e auditimit.

Është përdorur metoda me auditim me zgjedhje sipas vlerësimit të audituesit dhe çështjes së audituar. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale sasiore dhe cilësore dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zëra të ndryshëm të aktivitetit ekonomik dhe financiar të subjektit.
Për arritjen e konkluzionit dhe opinionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:
- *Kontrolli aritmetik.* u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e procesit të shpronësimit të pronës private për interes publik, përfundojnë në regjistrimin e pronës në interes shtetërorë dhe që nuk përmbajnë gabime. Gjithashtu, kjo teknikë u përdor dhe në rastet e tjera të çështjeve të auditimit ku ka lindur e nevojshme;
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*, konstaton na faktin nëse procesi i shpronësimit ka mjaftueshëm dokumentacion referuar Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar;
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e proceseve të shpronësimit, duke siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales"*, që përbëjnë tregues të parregullsive të ndryshme. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

8. Dokumentimi i auditimit.

Dokumentimi i auditimit është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Raporti përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në 5 kapituj. Në kapitullin e parë të përmbledhjes ekzekutive janë trajtuar çështjet e rezultateve të auditimit, gjetjet rekomandimet kryesore dhe konkluzioni e opinioni i auditimit, në kapitullin e dytë janë trajtuar objektivat dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve, metodat, etj. Në vijim në kapitullin e tretë është përshkrimi i auditimit, në të cilin trajtohet një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 3 drejtimeve të auditimit. Në kapitullin e katërt jepen rekomandimet, bazuar në rezultatet e auditimit gjetjet dhe rekomandimet të strukturuara sipas llojit të tyre, janë vendosur në kapitullin e pestë anekset dhe kapitulli gjashtë lista e dokumenteve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Agjencia Shtetërore e Shpronësimit (ASHSH) është një institucion publik në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i ngarkuar me zbatimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private. Veprimtaria e saj lidhet drejtpërdrejt me ndërhyrjen e shtetit në të drejtën e pronësisë, si dhe me administrimin e fondeve publike të destinuara për kompensimin e subjekteve të shpronësuara.

Agjencia ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për shpronësimet për interes publik, aktet nënligjore përkatëse dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për projekte konkrete. Funksioni kryesor i ASHSH është administrimi i procesit të shpronësimit, që nga shpallja e kërkesës për shpronësim, vlerësimi i pasurive, përcaktimi i masës së kompensimit, deri në likuidimin e fondeve për subjektet përfituese.

Struktura organizative e Agjencisë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe përfshin njësi përgjegjëse për procedurat juridike, vlerësimin teknik të pasurive, menaxhimin financiar dhe likuidimin e kompensimeve, si dhe funksione mbështetëse administrative. Këto struktura bashkëpunojnë me institucionet kërkuese të projekteve publike dhe me autoritete të tjera shtetërore.

Duke qenë se veprimtaria e ASHSH përfshin procese me **rrezik të lartë ligjor, financiar dhe reputacional**, si dhe pasoja afatgjata dhe shpesh të pakthyeshme për subjektet e prekura dhe për buxhetin e shtetit, Agjencia përbën një subjekt me rëndësi të veçantë për auditim. Auditimi i saj synon vlerësimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator, efektivitetin e procedurave të ndjekura, si dhe ligjshmërinë dhe korrektësinë e përdorimit të fondeve publike.

Si organizim, ASHSH për realizimin sa më të plotë të detyrave të përcaktuara aktet ligjore në fuqi, është e ndarë në tre drejtori, si më poshtë vijon:

- Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Drejtoria e Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit;
- Drejtoria e Negocimit dhe Asistencës Ligjore

Sipas legjislacionit në fuqi, konkretisht Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, në pika 1), të Nenit 18, përcaktohet që: "*Jepet kompensim për vlerën e zhvlerësimit të pronës në rastet kur shpronësimi për interes publik shoqërohet me zhvlerësimin e pjesës së pronës që*

nuk është shpronësuar ose të pronës që ndodhet pranë asaj që shpronësohet. Rastet, mënyrat dhe llogaritjet e shumës së kompensimit caktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave".
Nga auditimi u konstatua se, në zbatim të kësaj pike, *ende nuk ka një akt normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e vlerësimit për objektet/truall/arë që zhvlerësohen.*

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Mbi shqyrtimin e kërkesave për shpronësim dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik.

Grupi i auditimi mbi bazën e materialitetit, bërë përzgjedhjen e praktikave të shpronësimit për interes publik të pronës private, ku në përfundim arrin në konkluzionin se nga punonjësit e ASHSH, janë konstatuar veprime të cilat bien ndesh me aktet ligjore e nënligjorë të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar.
Kështu nga 175 praktika të finalizuara në shumën 7,144,695,577.15 lekë dosje (praktika) shpronësimi të realizuara nga ASHSH për periudhë objekt auditimi (nga fillimi deri me 31.12.2024), grupi vlerësojë për auditim 34 praktika shpronësimi në vlerën 5,964,885,316 lekë, ose 83.48 % të vlerës, rezultatet e të cilave paraqiten si më poshtë vijon:

I. Dosja e procedurës së shpronësimit që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: *"Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6".*

Autoriteti Rrugorë Shqiptar (*këtu e vijim ARRSH*), me shkresën nr. 1694 *prot*, datë 14.2.2022 ka paraqitur kërkesë për shpronësim me objekt: *"Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6"*, në Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve (*këtu e vijim ASHSH*), me nr. 254 *prot*, datë 15.2.2022.
Me shkresën nr. 254/24 *prot*, datë 20.4.2022, ASHSH njofton ARRSH për pranimin e kërkesës për shpronësim, ku në paragrafin 2 thuhet se: *"Personi i autorizuar nga ana Juaj, duhet të paraqitet në ASHSH brenda 10 ditëve nga marrja e këtij njoftimi për nënshkrimin e akt-marrëveshjes për të drejtat dhe detyrimet që lidhen me realizimin e procesit të shpronësimit të pasurive që përfshihen në këtë projekt".*
Akt-marrëveshja ndërmjet ASHSH nr. 254/25, datë 20.4.2022 me përfaqësues *z. Erlis Hereni* për ASHSH dhe ARRSH me nr. 4974/1prot, datë 20.4.2022 me përfaqësues *z. Evis Berberi*, e lidhur në zbatim të pikës 2 e nenit 13, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik".
Me shkresën nr. 254/26 *prot*, datë 21.4.2022 nga ASHSH është bërë publikimi i kërkesës për shpronësim në Qendrën së Publikimeve Zyrtare (QPZ), në referencë të nenin 15, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik", në zbatim të shkresë nr. 1694 *prot*, datë 14.2.2022 të ARRSH.
Me shkresën nr. 254/28 *prot*, datë 28.4.2022 është bërë njoftimi i të gjithë personave që preken nga projekti i ndërtimit të segmentit *"Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe Tiranë, nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6"*, në zbatim të nenit 14 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për

shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe pikën 3 të VKM nr. 126, datë 23.3.2000 "Për përbërjen dhe procedurat e punës së KPSH".
Me shkresën nr. 254/27 *prot*, datë 21.4.2022 (plotësim dokumentacioni), ASHSH i drejtohet ARRSH, që lidhur me kërkesën nr. 1694 *prot*, datë 14.2.2022.
Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve në ASHSH *(këtu e vijim KPSH)*, ngritur me urdhër nr. 40, datë 16.2.2022, në mbledhjen e datës 20.4.2022 ka pranuar kërkesën për shpronësim. Në këtë shkresë kërkohet që brenda 15 ditëve nga shpallja në QPZ, duhet të paraqisni konfirmimet mbi statusin juridik të pasurive e pasqyruara në tabelën paraprake bashkëlidhur kërkesës për shpronësim, ku në kolonën shënime rezultojnë me shënimin *"në proces konfirmimi"*.
Projekti është finalizuar me VKM nr. 662, datë 13.10.2022 *"Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë "Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6"*.
Projektit i segmentit rrugorë *"Studim-projektim rikualifikim i Unazës Lindore Tiranë për lotët 4,5,6"*, është hartuar nga B/OE "Klodioda & Altea Geostudio 2000" ShPK, ndërsa projekti i segmentit rrugorë *"Studim-projektim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të unazës së Madhe Tiranë nga Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri"*, është hartuar nga B/OE "Seed Consulting & ATELIER 4".
Me Vendim nr. 26 (*prot, 5745/3*), datë 15.7.2021, me objekt: *Mbi projektin e zbatimit të kontratës "Studim-projektim, rikualifikim i Unazës Lindore Tiranë, lotët 4,5,6"* , si dhe në zbatim të VKM nr. 276, datë 16.5.2018 "Për miratimin e mënyrës së organizimit të strukturës, organikës dhe statusit të ARRSH", nga ARRSH është marrë në shqyrtim projekti i zbatimit me objekt: *"Studim projektim rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4,5,6"*, sipas kontratës nr. 62357/7 prot, datë 7.12.2020 të lidhur midis ARRSH dhe B/OE "Klodiola & Altea Geostudio 2000" ShPK.
Sipas relacionit të hartuar nga ARRSH në adresë të ASHSH, shpronësimi i pasurive do realizohet në këto forma.
Për sipërfaqe e shpronësuar "truall, arë, pemëtore, ullishte" etj., vlera e shpronësuar përllogaritet sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH", i ndryshuar.
Ndërsa për objektet të tipit ndërtesë e kemi në dy forma:
Për objektet social-ekonomik dhe ndërtesa që në kartelë është banim, por që nuk ka funksion banimi sipas terrenit, do realizohet sipas vlerës së preventivit;
Për objektet me funksion banimi vlerësimi është për m^2, sipas mesatares së kontratave të shitblerjes për 3 mujorin e fundit të ardhur nga ASHK Tiranë.
Me shkresën nr. 11084 *prot*, datë 7.12.2021 (kërkesë për bashkëpunim), ARRSH i kërkon Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë Tiranë, që për dorëzimin e dokumentacionit ligjorë të pronësisë të pasurive private që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe të Tiranës, kërkohet bashkëpunimi për vënien në dispozicion të adresave të banimit të pronarëve.
Nëpërmjet shkresës nr. 1884/1 prot, datë 23.9.2021, Enti i Banesave në adresë të ARRSH, i përcjell listën e çmimeve sipas zërave dhe volumeve të punës, kjo në zbatim të Udhëzimit të KM nr. 3, datë 28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave për vitin 2016". (me ndryshime). Ky projekt sipas shkresës nr. 11290 prot, datë 13.12.2021, të Sektorit të Mjedisit dhe Impaktit Social në adresë të Drejtorit të Planifikimit Strategjik dhe Operacional, është pajisur me leje zhvillimi nr. 3, datë 13.7.2021 të lëshuar nga KKT.
Nga ASHK me shkresa respektive dhe në afate të ndryshme kohore ka përcjellë pranë ASHSH çmimet mesatare të 3 mujorit të fundit, konkretisht disa nga këto shkresa janë:

Me shkresën nr. 8884/2 prot, datë 10.11.2021, është përcjellë çmimi (vlera mesatare) e shitjeve të ZK 8170 për 3 muajt e fundit Vmes = 79,505.3471 lekë/m2;
Me shkresën nr. 6762/1 prot, datë 10.11.2021, është përcjellë çmimi (vlera mesatare) e shitjeve të ZK 1066 dhe 2884 për 3 muajt e fundit Vmes = 52,000 lekë/m^2;
Me shkresën nr. 6899/1 prot, datë 10.11.2021, është përcjellë çmimi (vlera mesatare) e shitjeve të ZK 3976- NjA Farkë prej 66,500 lekë/m^2, por pa çmimin e truallit. Çmimi i truallit është 2,560 lekë/m^2. Ndërsa për pasurinë ZK 2460 për NjA Dajt çmimi është 53,500 lekë/m2 pa truall. Ndërsa çmimi truallit është 2,080 lekë/m2;
Me shkresën nr. 6750/1 prot, datë 10.11.2021, është përcjellë çmimi (vlera mesatare) e shitjeve të ZK 3976- NjA Farkë është 66,500 lekë/m^2, por pa çmimin e truallit. Çmimi i truallit është 2,560 lekë/m^2. Ndërsa për pasurinë ZK 1604 për NjA Farkë çmimi është 66,500 lekë/m2 pa truall. Ndërsa çmimi truallit është 5,140 lekë/m2;
Me shkresën nr. 10069/2 prot, datë 23.11.2021, ASHK informon ASHSH se lidhur me çmimin mesatar sipas kontratave të shitblerjes 3 mujorin e fundit, nuk janë evidentuar transaksione. Çmim i referencës së ZK 8110 është 60,000 – 70,000 lekë/m2;
Me shkresën nr. 10069/1 prot, datë 12.11.2021, për ZK 8120, ku çmimi referencë është 60,000 – 70,000 lekë/m2.

Nga ana e KPSH, me shkresën datë 17.6.2022 është mbajtur procesverbali mbi shqyrtimin e dokumentacionit plotësues të dërguar nga ARRSH me shkresën nr. 6832 prot, datë 17.6.2022 *(prot ASHSH nr. 552/2, dt. 17.6.2022)*, në të cilën është vendosur:

*Miratimi i propozimit për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme pronë private me vlerë **3,158,206,249 lekë**;*
Hartimin e draft-projektvendimit për shpronësimin për interes publik;
Ti paraqes ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, propozimi për shpronësim të shoqëruar me dokumentacion përkatës ligjorë, në referim të nenit 20 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.199 "për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik", i ndryshuar.

Me shkresën nr. 552/3 *prot*, datë 17.6.2022 ASHSH i përcjell MIE projekt vendimi për shpronësim të objektit: *"Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe Tiranë nga sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri dhe Rikualifikimi i Unazës Lindore për lotët 4,5,6"*, i cili është miratuar VKM nr. 662, datë 13.10.2022, ku ndër të tjera thuhet se vlera e shpronësimit kap shumën 3,158,206,249 lekë për 197 pasuri, nga e cila:

Vlera 3,035,497,750 lekë do shpronësohen nga llogaria "Fondi i shpronësimeve" në Bankën e Shqipërisë;
Vlera 122,708,499 lekë, nga buxheti i ARRSH;
Vlera e shpenzimeve procedurale në masën 70,000 lekë do përballohen nga ARRSH.

Sipas të dhënave të financës, rezultoi se me fondet e shpronësimit sipas shkronjës (a), të pikës 4 të VKM nr. 662, ku është përcaktuar likuidimi i 203 pasurive, gjithsej kanë përfunduar procedurat e likuidimi 133 pasuri me vlerë 2,609,770,872 lekë dhe janë akoma pa likuiduar 38 pasuri me vlerë 517,964,322 lekë. Janë në proces gjyqësore për këtë projekt 15 kërkesëpadi, me objekt kundërshtimin e VKM nr. 662, datë 13.10.2022, në lidhje me vlerën e shpronësimit, nga të cilat:

Për *3 procese gjyqësore* është marrë vendim rrëzim kërkesëpadie nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;
Për *5 procese gjyqësore* është marrë vendim, pranimi i pjesshëm i kërkesëpadisë, vendime të cilat janë ankimuar pranë Gjykatës së Apelit;
Për *5 procese gjyqësore*, vijojnë procedurat e gjykimit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
Për *2 kërkesëpadi* është marrë vendim për mospranim kërkesëpadi dhe pezullim gjykimi.

Me urdhër nr. 90 (prot 254/1), datë 16.2.2022 të ish- Drejtorit të Përgjithshëm *z. Erlis Hereni* është krijuar komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të shpronësimit ..., i përbërë nga: *Erlis Hereni*, Kryetar, *Besnik Hysaj* me profil inxhinier, *Besmira Nuredini* me profil ekonomiste, *Albian Nuredini* me profil arkitekt, *Denada Dosti* me profil jurist, *Entela Bytyci* me profil inxhinier, *Sidorela Qato* me profil ekonomiste, në pozicionin e anëtarit. Ndërsa funksioni i Sekretarit Teknik do kryhet nga *z. Martin Beqiraj dhe Areda Koci.*
Me shkresën nr. 254/1 *prot*, datë 17.2.2022, ASHSH i është drejtuar ASHK dhe degëve rajonale ku projekti preket për shpronësim, për dijeni dhe ARRSH, që në kuadër të shpronësimit të zbatimit të projektit për interes publik të segmentit rrugorë *"Rishikim i projektit segmenti rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4,5,6"*, të paraqitur nga ARRSH me shkresën nr. 1694, datë 14.2.2022, *prot* ASHSH nr. 254, datë 15.2.2022, është kërkuar çmimi mesatar i kontratave të shitblerjes për 3 mujorin e fundit, nga ku është përcaktuar se:
Nga DVASHK Kamëz-Vorë, sipas shkresës nr. 6762/1 prot, datë 10.11.2021, informon se çmimi mesatar për ZK 1066; ZK 2884 është 52,000 lekë/m², pa vlerën e truallit;
Nga DVASHK Tirana – Veri, sipas shkresave nr. 10069/1prot, datë 12.11.2021 dhe nr. 10069/3 prot, datë 10.12.2021, informon se çmimi mesatar për ZK 8120 është 86,748 lekë/m² dhe për ZK 8310 është 93,086.78 lekë/m²;
Nga DVASHK Tirana – Jug, sipas shkresës nr. 8884/2prot, datë 10.11.2021, informon se çmimi mesatar për ZK 8170 është 79,505.3471 lekë/m².
Nga DVASHK Tirana –Rurale 1, sipas shkresave nr. 899/1prot, datë 11.10.2021 dhe nr. 6750/1 prot, datë 11.10.2021, informon se çmimi mesatar për ZK 3976 është 66,500 lekë/m2 dhe për ZK 2460 është 53,500 lekë/m2 dhe ZK nr. 1604 çmimi është 66,500 lekë. Në këto çmime nuk përfshihet çmimi i truallit.
Me shkresën *"kërkesë"* nr. 254/2 *prot*, datë 17.2.2022, Drejtori ASHSH i kërkon ASHK qendër dhe Drejtorive Rajonale Tirana Rurale-1, Tirana-Veri, Tirana-Jug dhe Kamës Vorë, për dijeni dhe ARRSH, në vijim të shkresës nr. 254/1 *prot*, datë 17.2.2022, ku ndër të tjera kërkohet që: *"Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit në ASHSH, konstaton se çmimet mestarë sipas kontratave të shitjes blerjes për 3 mujorin e fundit për objektet e banimit në ZK 3976/ 8310/ 8110/ 8120/ 8170/ 1066/ 2884/ 2460, rezulton më i largët se 3 mujorit paraardhës, duke filluar nga data e kërkesës së bërë nga ASHSH (1694, dt. 14.2.2022)*, kjo në respektim të pikave 1 dhe 2 të VKM nr. 138, datë 23.3.2020 *"Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive të zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik"*, i ndryshuar.
Në përgjigjen e dhënë nga ASHK në adresë të ASHSH mbi çmimet e referencës, konstatohet se për pasuritë e ZK 1066 dhe ZK 2884, nuk është respektuar afati kohorë prej 5 ditëve për kthim përgjigje nga ASHK, pasi shkresa e nisur nga ASHSH mban datën 6.10.2021 me nr. 8932 *prot* dhe përgjigje e kthyer nga ASHK mban datën 10.11.2021 me nr. 6762/1 *prot*, në kundërshtim me pikën 1 të VKM nr. 138, datë 23.3.2020, ku thuhet se: *"ZRPP (sot ASHK), detyrohet që deklarimi i mesatares së shitblerjes të realizojë brenda 5 ditëve nga paraqitja zyrtare e kërkesës, prej subjekteve të interesuara për shpronësim për interes publik"*.
Nga ASHK me shkresën nr. 1013/1prot, datë 21.2.2022 (*prot ASHSH nr. 254/4, dt. 23.2.2022*), informon se çmimi mesatar në ZK 2884 është 52,000 lekë/ m²;
Me shkresën nr. 1772/2 prot, datë 28.2.2022 (*prot ASHSH nr. 254/7, dt. 2.3.2022), DVASHK Tirana –Rurale 1*, informon se çmimi mesatar për ZK 8120 është 81,666.61 lekë/m² dhe për ZK 8310 është 96,753.41 lekë/ m².
Me shkresën nr. 1772/3 prot, datë 01.3.2022 *(prot ASHSH nr. 254/8, dt. 2.3.2022)*, çmimi mestar për ZK 8110 është vetëm për një kontratë, në këto kushte është referuar çmimit të shitjes në nivel më të aftër, konkretisht të ZK 8120, ku rezulton çmimi 78,710.48 lekë/ m².

Me shkresën nr. 1287/1 *prot*, datë 22.2.2022 *(prot ASHSH nr. 254/5prot, datë 24.2.2022), DVASHK Tirana –Rurale 1*, informon se çmimi mesatar për ZK 3976/2460/1604, ka vënë në dispozicion kontratat e shitjes. Ndërsa mbi konfirmimin e statusit juridik të pasurive është shprehur se:

Për disa zona të pasurive ZK 1066 dhe ZK 2884, është shprehur me shkresën nr. 1012/1prot, datë 22.2.2022 (prot ASHSH nr. 254/6, dt. 24.2.2022), kjo nga Drejtoria vendore Tirana Jug;
Me shkresën nr. 3999/3 prot, datë 25.2.2022 (prot ASHSH nr. 254/10, dt. 3.3.2022), ka vendosur në dispozicion listën e pasurive të cilat nuk ka ndryshim të gjendjes juridike;
Me shkresën nr. 1303/1 prot, datë 3.3.2022 (prot ASHSH nr. 254/13, dt. 7.3.2022), ka dërguar konfirmim mbi statusin juridik për ZK 8170

Me shkresën nr. 1772/4 *prot*, datë 7.3.2022, ASHK informon ASHSH lidhur me kërkesën sipas shkresës nr. 254/3 *prot*, datë 17.2.2022, mbi gjendjen e statusit juridik të pronave private të cilat kërkohen të shpronësohen, ku thuhet se vijon i njëjti status juridik të dërguar nga ARRSH, referuar konfirmimeve tona të mëparshme, kjo për ZK 8310.

Me shkresën nr. 1013/2 *prot*, datë 18.3.2022 ASHK drejtuar ASHSH (Komisionit të Posaçëm të shpronësimeve), mbi çmimin mesatarë të shitjes së pasurive referuar kontratave të shitjes për ZK 2884 është 53,748 lekë/m^2 dhe për ZK 1066 është 50,566 lekë/m^2. Ndërsa referuar çmimit të aplikuar në VKM nr. 622, datë 13.10.2022 *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të 'unazës së madhe' tiranë nga 'sheshi Shqiponja'– 'Bulevardi i Ri' dhe 'Rikualifikimi i 'Unazës Lindore' për lotet 4, 5, 6"*, konstatohet se për ZK 2884 çmimi mesatar i aplikuar është 52,000 lekë/m^2 *me një diferencë në minus për vlerën 1,748 lekë/m^2, e konvertuar në vlerë kap shumën – 8,169,051 lekë në dëm të personave përfitues të shpronësuar*, ndërsa për ZK 1066 çmimi i aplikuar është prej 52,000 lekë/m^2, *me një diferencë në minus për vlerën 1,434 lekë/m2, e konvertuar në vlerë kap shumën + 3,875,528 lekë në dëm të buxhetit të shtetit.*

<u>*Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e shpronësimit, veças sa mësipërm konstatohet se:*</u>

- Çmimi mesatar për ZK 3976; 8310; 8110; 8120; 8170; 1066;2884; 2460, është më i largët se 3 mujori paraardhës, duke filluar nga data që është bërë kërkesa për shpronësim në ASHSH, në kundërshtim me pikën 1 dhe 2 të VKM nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive të shpronësuara, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar;
- Në planimetrinë e përgjithshme të shpronësimeve nuk pasqyrohet sipërfaqja dhe plan vendosja, për disa pasuri, sipas konfirmimit të HRT të lëshuar nga ASHK;
- Sipërfaqen e *"ballkonit", "shkallëve", "bodrumit"*, janë vlerësuar sipas çmimit mesatar për 3-mujorin e fundit për objektet e banimit, gjë për të cilën nuk është marrë konfirmim nga ASHK përkatëse, pasi jo në çdo rast bodrumi është në funksion të banimit;
- Planimetritë e shpronësimit duhet të jetë në zbatim të VKT nr. 25, datë 15.7.2021 dhe VKM nr. 26, datë 15.7.2021;
- Nuk përcaktohet funksioni i objektit në kartelën e pasurisë nr. 10/280-BD dhe nr. 11/640 në ZK 8310, në pasurinë nr. 985/8 në ZK 1066, në pasurinë 5/409 në ZK 8120.
- Në relacionin e përpiluar nga ASHSH drejtuar MIE, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve, gjë e cila nuk rezulton të jetë bërë dhe akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues ARRSH dhe ASHSH, ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 20, pika 1, shkronja (a) e cila parashikohet se: *"Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, ASHSH i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*

Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilën citohen dhe dokumentet që kërkohen nga shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 10 të këtij ligji."

Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se: *"Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit".*

- Vendimmarrja sipas procesverbalit të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *"Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten te plotësuar ne afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur, për mungesë te shkakut ose te kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga ASHSH dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të shpronësimit".*
- Aktmarrëveshja e lidhur nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar.
- Në dosjen e projektit procesverbalet e mbledhjeve të KPSH, në të gjitha rastet, janë pa numër protokolli, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18 i cili parashikon se: *"Procesverbale te mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshëm. Ato protokollohen."*
- Vendimmarrja sipas procesverbalit KPSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse,* pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet";
- ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar se: *Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e ARRSH marrjen e masave për njoftimin e tij,* realizimin e *"Njoftim për shpronësim publik"*, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM nr.127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi. Ky njoftim është kryer përtej afatit 10 ditor nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit;

Praktika është punuar nga: ish- Drejtori i ASHSH ***zj. Erlis Hereni*** në cilësinë e Kryetarit, ***z. Besnik Hysaj*** me profil inxhinier, ***zj. Besmira Nuredini*** me profil ekonomiste, ***z. Albian Nuredini*** me profil arkitekt, ***zj. Denada Dosti*** me profil jurist, ***zj. Entela Bytyci*** me profil inxhinier, ***zj. Sidorela Qato*** me profil ekonomiste, *në pozicionin e anëtarit.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Në lidhje me kartelën e pasurisë nr. 2/725 në ZK 8310 të pasurisë së llojit "truall", ka sipërfaqe të regjistruar 478 m². Në përshkrimin e veçantë ajo ndahet në disa njësi banimi (apartamente), të reflektuara në volumin nr. 68, faqe 24 deri 72, respektivisht me sipërfaqe 19.8 m² për pasurinë 2/72+1-1, me sipërfaqe 160.2 m², nga e cila sip banimi 68.5 m², verandë 60 m2 dhe shkallë 8.5 m² në pasurinë 2/72+1-2, me sipërfaqe 145.5 m² për pasurinë 2/72+1-3, me sipërfaqe 145.5 m² për pasurinë 2/72+1-7 .*
Qëndrim i grupit të auditimit: Për sa sqarohet nga subjekti me posedues të pronës *Prel Dedë Kolprecaj* , shpjegimet **nuk argumentojnë konstatimin** e grupit të auditimit, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve. Nga grupi është konstatuar (siç dhe është paraqitur në pjesën narrative), që referuar sipërfaqes së shpronësuar dhe sipërfaqes sipas kartelave të pronësisë, shihet qartazi se totali i tyre nuk vjen me sipërfaqen e shpronësuar, duke lënë jashtë sipërfaqen e verandë + shkallë.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Pavarësisht se, në dosjen përkatëse të shpronësimit, përveç disponimit të çdo kartele pasurie dhe harte treguese për pasuritë objekt shpronësimi, janë të depozituara të gjitha komunikimet zyrtare të zhvilluara ndërmjet ASHSH dhe ASHK. Konkretisht, ASHSH i është drejtuar zyrtarisht ASHK-së Qendrore dhe Drejtorive të saj Vendore me shkresën nr. 254/3 Prot., datë 17.02.2022, për vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës. Në vijim, janë marrë përgjigjet dhe konfirmimet zyrtare si: (Shkresa e ASHK-së, Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë, nr. 1012/1 Prot., datë 22.02.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 254/6 Prot., datë 24.02.2022; - Shkresa e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tiranë-Jug, nr. 1303/1 Prot., datë 03.03.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 254/23 Prot., datë 07.03.2022; - Shkresa e DVASHK Tiranë-Veri, nr. 1772/4 Prot., datë 07.03.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 254/14 Prot., datë 08.03.2022; - Shkresa e ASHK-së, Drejtoria Qendrore, nr. 3999/3 Prot., datë 25.02.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 254/10 Prot., datë 03.03.2022). Në përfundim, sqarojmë se, dhe pse kartelat dhe HTR të depozituara nga ana e subjektit kërkues konsiderohen jashtë afatit KPSH ka mbajtur komunikimet e nevojshme me institucionin kompetent ASHK dhe ka kërkuar vendosjen në dispozicion të dokumentacionit pronësor i cili është konfirmuar dhe vendosur dhe njëherë në dispozicion sipas datave të të sipërcituara në shkresat përkatëse të cilat e rifreskojnë informacionin e të dhënave pronësore i cili është brenda afatit 3 mujor të kërkesës për shpronësim të paraqitur nga ana e subjekti kërkues.*
Qëndrim i grupit të auditimit: Për sa është argumentuar në lidhje me mos zbatimin e afatit mbi 3 muaj të kartelave të pasurive, referuar shkresave të paraqitura nga subjekti është bindës dhe merret në konsideratë grupin e auditimit, duke mos gjetur pasqyrim në këtë fazë të RPA.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Me shkresën Nr. 254/1 Prot., datë 17.02.2022, ASHSH i është drejtuar ASHK-së Qendrore dhe Drejtorive Vendore për përcaktimin e çmimeve mesatare, të cilat më pas janë bërë të disponueshme nëpërmjet shkresave si: (- Shkresa Nr. 1287/2 Prot., datë 11.03.2022, nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, protokolluar në ASHSH me Nr. 254/17 Prot., datë 15.03.2022, për çmimet mesatare të ZK-ve 3976, 2460 dhe 1604; - Shkresa Nr. 8884/5 Prot., datë 07.03.2022, nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug, protokolluar në ASHSH me Nr. 254/12 Prot., datë 07.03.2022, për çmimin mesatar të ZK 8170; - Shkresa Nr. 1772/2 Prot., datë 28.02.2022, nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, protokolluar në ASHSH me Nr. 254/7, datë 02.03.2022, për çmimet mesatare të ZK-ve 8310 dhe 8120; - Shkresa Nr. 1013/1 Prot., datë 21.02.2022, nga ASHK Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë, protokolluar në ASHSH me Nr. 254/4 Prot., datë 23.02.2022, për çmimet mesatare të*

ZK-ve 1066 dhe 2884; - Shkresa Nr. 1772/3 Prot., datë 01.03.2022, nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, për konfirmimin e çmimit mesatar të ZK 8110), sqarohet se në zbatim të pikës 2, të VKM nr. 138, datë 23.3.2000, përcaktohet se: "2. Vlerësimi për objektet e banimit të përcaktohet si mesatare e shitblerjeve, përcaktuar nga ZRPP-ja, sipas procedurës për rastin e truallit. Në rastet kur mungojnë treguesit e shitblerjeve, vlerësimi të përcaktohet me metodën e kostos së ndërtimit, duke përdorur si bazë çmimet e Entit Kombëtar të Banesave".
Ndërsa në pikën 1 të VKM së sipërcituara përcaktohet se: "1. Vlerësimi për truallin përcaktohet sipas çmimeve te miratuara, me vendim te Këshillit te Ministrave për trojet urbane, Brenda vijës se verdhe, trojet ne qytete dhe komuna, ne zbatim te ligjit nr.9235, date 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", te ndryshuar. Ne rastet kur mungojnë çmimet e miratuara ne zonat përkatëse, vlerësimi për truallin përcaktohet si mesatare e shitblerjeve qe ka zyra e regjistrimit te pasurive te paluajtshme (ZRPP). Mesatarja e shitblerjeve të përcaktohet bazuar në rajonin e interesuar ku realizohet shpronësimi për interes publik.
Periudha kohore e llogaritjes së mesatares të mos rezultojë më e largët se 3 mujori paraardhës, duke filluar nga data që bëhet kërkesa. ZRPP-ja detyrohet që deklarimin e mesatares së shitblerjes ta realizojë brenda 5 ditëve nga paraqitja zyrtare e kërkesës, prej subjekteve të interesuar për shpronësim për interes publik. Dokumenti që lëshohet nga ZRPP-ja përbën akt zyrtar, i cili formulohet me shkrim dhe firmoset nga përgjegjësi i ZRPP-së. Kopja e tij ruhet pranë ZRPP-së".
Në interpretim të dispozitës së sipërcituar, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, bazohet tek çmimi mesatar i shitblerjeve të konfirmuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe e merr të mirëqenë përllogaritjen e vlerës mbi çmimin mesatar, dhe përsa i përket kontratave në të cilat bazohet ASHK, është përgjegjësi e saj, dhe këto kontrata janë pjesë e praktikës që mbahet në ASHK, të cilat shërbejnë dhe si gjurmë auditimi mbi aktin zyrtar të nxjerrë nga ky institucion.
Qëndrim i grupit të auditimit: Për sa është argumentuar në lidhje me konstatimin se çmimi mestar për ZK 3976; 8310; 8110; 8120; 8170; 1066;2884; 2460, është më i largët se 3 mujori paraardhës, sqarohet se nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element shtesë nga ato të paraqitura në fazën e kateve, për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative dhe në kundërshtim ne observacioneve të subjektit shpjegon se nga ana juaj nuk janë paraqitur dokumentacion bashkëshoqërues, por vetëm janë përmendur shkresat të cilat ne si grup jemi në dijeni por që nuk ka përgjigje nga ASHK të shoqëruar me dokumentacion referuar përgjigjes së ASHK dhe dokumentacionit bashkëlidhur (*kontratat e shitblerës*), janë përtej këtij afati. **Argumenti nuk qëndron.**

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020, Kreu III pika 5, germa e), ku thuhet se" ASHSH mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësim". Në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrjen apo miratimin e akteve normative.*
Qëndrim i grupit të auditimit: Sqarojmë se argumenti juaj nuk paraqet asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve, ku të argumentojë mos parashikimin e afateve për fillimin dhe mbarimin e punimeve. **Argumenti nuk qëndron.**

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Sqarojmë për KLSH se korrespondencat vijuese midis ASHSH dhe subjektit kërkues në çdo rast janë mbështetur në pikën 2 të nenit 12 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar. Arsyetimi i KLSH se, nuk jemi në kushtet e pikës 2 të nenit 12, por në kushtet e pikës 3 të këtij neni, komisioni e kundërshton për arsye se vetë pika 2 e nenit 12 nuk ka të përcaktuar detyrim mbi numrin apo sasinë e korrespondencave që duhet të mbajmë me subjektin kërkues apo të jetë specifikuar që domosdoshmërish vetëm një korrespondencë shkresore të mbahet me subjektin kërkues. Gjithashtu sqarojmë se, pika 3 e*

nenit 12 përcakton rastet e refuzimit kur mungon shkaku apo kushti i shpronësimit ose kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar. Ndërkohë në rastin konkret, kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues është paraqitur brenda afatit të caktuar, si dhe kërkesa për shpronësim i plotëson kushtet dhe shkakun ligjor për realizimin e shpronësimit për interes publik..

Qëndrim i grupit të auditimit: Për sa observoni, argumenti juaj qëndron dhe gjen bazueshmëri ligjore, duke mos gjetur pasqyrim në RPA.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën nr. 1134/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH, ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe*
verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve. Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumenti juaj nuk qëndron, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element i ri, nga ato të paraqitura në fazën e akteve, për të cilat grupi i auditimit si në pjesën narrative (si më sipër), po ashtu dhe në kundërpërgjigje të kundërshtive tuaja në fazën e akteve është shprehur se dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivin tuaj. Aktmarrëveshja është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për palët. Ligji kërkon në mënyrë të shprehur qartë domosdoshmërinë e bashkëlidhjes së dokumentacionit që ka shoqëruar kërkesën për shpronësim. **Për sa më sipër, argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Sqarojmë për KLSH se, referuar listëpagesës për shpronësimet bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 7, datë 7.5.2007 "Për përdorimin e fondit të shpronësimeve", të ndryshuar, ku specifikohet se: "për ndjekjen e procedurave të likuidimit ngarkohen personat e autorizuar për likuidim". Në rastin konkret grupi i punës së likuidimit (i cili është i ndryshëm nga komisioni i posaçëm i shpronësimit) ngrihet me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe procedurat përkatëse të likuidimit ndiqen nga ky grup i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është i njëjti grup me të njëjtët anëtarë gjatë gjithë vitit dhe ndjek dhe realizon procedurat përkatëse referuar vitit përkatës. Gjithashtu sqarojmë për KLSH se nuk është përcaktuar asnjë bazë ligjore që hapat e ndjekur për likuidimin të jenë pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa kundërshtohet nga subjekti sqarimet qërojnë dhe **merren në konsideratë**, duke mos gjetur pasqyrim në këtë fazë të RPA.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër, argumentimi juaj merret në konsideratë, nisur nga fakti se është vijuar me protokollimin e shkresave.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".*

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa observoi, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si më sipër), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. Argumentimi juaj nuk merret në konsideratë". **Argumenti nuk merret në konsideratë.**

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *KPSH e kundërshton duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit, pasi ky komision është "ad hoc" dhe tagrat e tij përfundojnë me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022.*

Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më

sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa observoi, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si më sipër), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve. Sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara, dhe se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja. Argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.

II. Mbi zbatimin e procedurës për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: *"Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër".*

Në bazë të urdhrit nr. 179, me nr. 1215/1 prot., datë 25.10.2024, si dhe kërkesës për shpronësim nga Bashkia Shkodër me shkresën me nr. 24881 prot., datë 23.10.2024, u krijua Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH) për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit *"Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër"*, i përbërë nga Kryetari dhe 8 anëtar, si më poshtë: Z. Kastriot Gurra, *Kryetari* i komisionit me pozicion Drejtor i Përgjithshëm; Z. Albian Marku me profesion arkitekt; Z. Ilirjana Hasanllari me profesion jurist; Zj. Entela Bytyci me profesion inxhinier; Zj. Selmina Varfi me profesion jurist; Zj. Blerina Gjonaj me profesion jurist; Z. Nurion Sula me profesion jurist; Z. Spartak Kodra me profesion ekonomist; Zj. Mirela Omeri me profesion ekonomist (*Anëtar*).

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *KPSH sqaron se, sipas shkresës së ASHK Drejtoria Vendore Shkodër nr. 4001/1 Prot., datë 09.09.2024, është konfirmuar statusi i pasurisë Nr. 10/123, ZK 8591, duke ju bashkëlidhur edhe dokumentacionin e pronësisë (kartelën e pasurisë dhe hartën treguese).*

Megjithatë, në vijim të qëndrimit të auditimit lidhur me pranimin pjesërisht të pretendimeve tona lidhur me këtë observacion, ASHSH me qëllim ezaurimin e plotë të kërkesës së sipërcituar, nëpërmjet shkresës Nr. 400/1 Prot., datë 18.02.2026, i është drejtuar Bashkisë Shkodër, në cilësinë e subjektit kërkues për vendosjen në dispozicion edhe njëherë të dokumentacionit të pronësisë për pasurinë Nr. 10/123, ZK 8591, të përditësuar, e të konfirmuar nga ASHK, me qëllim kryerjen edhe njëherë të verifikimeve për sa I përket sipërfaqes që preket nga shpronësimi. Bashkia Shkodër, nëpërmjet shkresës nr. 4430 Prot., datë 25.02.2026, protokolluar në ASHSH me Nr. 400/2 Prot., datë 26.02.2026, ka përcjellë dokumentacionin e pronësisë të konfirmuar nga ASHK me shkresën Nr. 1506/1, datë 25.02.2026, kartelë pasurie +HTR për pasurinë Nr. 10/123, ZK 8591 Shkodër.

Sa më sipër, KPSH pas verifikimit të HTR të përcjellë bashkëlidhur kartelës së pasurisë të konfirmuar nga ASHK, rezulton që sipërfaqja e pasurisë Nr. 10/123, ZK 8591, që preket nga shpronësimi është sipërfaqja totale prej 10500 m², e njëjtë me sipërfaqen e miratuar për shpronësim sipas VKM 117, datë 26.02.2025 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës".

Dokumentacion mbështetës (1. Shkresa Nr. 400/1 Prot., datë 18.02.2026;2. nr. 4430 Prot., datë 25.02.2026).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacionit Tuaj, bashkëshoqërua me dokumentacion mbështetës (shkresa bashkëpunimi), qëndron dhe **merret në konsideratë** duke mos gjetur pasqyrim në këtë fazë të RPA.

Nga verifikimi i projektit në dŵg dhe pasurive që preken nga ndërhyrjet e propozuara për realizimin e projektit "*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës*", të evidentuara në plan (*me kontur të kuq e vijëzim të verdhë*), u konstatua që në pasurinë me nr.10/123, vol.37, fq. 127, në ZK.3852, sipërfaqja e cila preket sipas përcaktimit në plan nuk është 10.500 m^2, por është 8310 m^2.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: *KPSH sqaron se, në ndjekjen dhe realizimin e procedurave për shpronësim, KPSH, është bazuar në dokumentacionin për shpronësim të dërguar nga subjekti kërkues, në zbatim të nenit 10 e vijues të Ligjit 8561/1999, i ndryshuar, konkretisht Vendimit nr. 3 datë 02.04.2024 të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit..., konfirmimit të statusit juridik të pasurive nga institucioni kompetent ASHK, si dhe procesverbalit të mbajtur në terren më datë 30.12.2024 nga Bashkia Shkodër, ku konfirmon se pasuria me Nr. 10/123, ZK 8591, preket nga shpronësimi për sipërfaqen totale të saj prej 10500 m^2. Gjithashtu, sqarojmë se, në relacionin shpjegues të përcjellë nga Bashkia Shkodër nëpërmjet shkresës Nr. 282 Prot., datë 08.01.2025, ka sqaruar se, "Komisioni i vlerësimit paraprak ka kryer vlerësimin e pasurive pronë private që shpronësohen për interes investimi publik, bëri vlerësimin paraprak të pasurive që shpronësohen...", konkretisht sipas listës së shpronësimit të përcjellë bashkëlidhur kësaj shkrese si dhe procesverbalit të mbajtur në terren datë 30.12.2024, në zbatim të Urdhrit Nr. 1306, datë 16.09.2024 "Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit paraprak të pasurive pronë private që shpronësohen për efekt investimi publik..., sipas të cilit është konfirmuar se, "Nga verifikimi paraprak në terren i projektit të miratuar, rezulton se Gjurma e projektit bie mbi pasuritë sipas tabelës bashkëngjitur referuar dhe informacionit zyrtar të marrë nga ASHK Shkodër, Nga përputhja e gjurmës së projektit në hartën treguese të pasurive rezulton se sipas tabelës me të dhënat përkatëse, pjesë e këtij procesverbali të mbajtur nga përfaqësuesit e Komisionit të ngritur nga Bashkia Shkodër, Terezina Gega, preket nga shpronësimi për pasurinë Nr. 10/123, ZK 8561, për sipërfaqen prej 10500 m^2. Komisioni sqaron se, në rastin në fjalë nuk është parë e nevojshme për të kryer verifikime në terren në zbatim të VKM nr. 395, datë 13.05.2020, lidhur me pasuritë objekt shpronësimi, për faktin se, në lidhje me mospërputhjet përkatëse është mbajtur një procesverbal nga ana e Bashkisë Shkodër, në të cilën janë konfirmuar në terren sipërfaqet që preken për çdo pasuri ku pasuria Nr. 10/123, ZK 8561, preket për sipërfaqen prej 10500 m^2. Në përfundim, sqarojmë se, në zbatim të nenit 12 pika 1, të Ligjit 8561, datë 22.11.1999 ...të ndryshuar, VKM-së nr. 395, datë 13.05.2020 ..., si dhe nenit 16.1 & 16.2 pika a) e Rregullores së brendshme të ASHSH specifikohet se ASHSH: a) Kryen verifikimet, nëse është e nevojshme, edhe verifikime në vend, për subjektin kërkues, në favor të të cilit kërkohet shpronësimi, për dokumentacionin e paraqitur, për shkakun e shpronësimit. Në këto kushte, në zbatim të plotë të. dispozitave të mësipërme, duke qenë se dispozita e sipërcituar është e karakterit lejues dhe jo urdhërues, në momentin që subjekti kërkues, në rastin konkret Bashkia Shkodër, për pasuritë e sipërcituara ka kryer verifikimin në terren (procesverbal konstatimi) dhe grupi i punës më datë 30.12.2024, ka konstatuar se këto subjekte shpronësohen në përputhje me gjurmën e projektit të miratuar sipas Vendimit Nr. 03, datë 02.04.2024, të Këshillit Kombëtar të Territorit, si dhe planimetrisë së shpronësimit*

bashkëlidhur, ky dokumentacion plotëson kriteret ligjore të nenit 10 e vijues të Ligjit për shpronësimin, për interes publik:

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, përsa i përket sipërfaqes që preket nga shpronësimi i pasurisë nr.10/123, në ZK 3852, argumentet e paraqitura qëndrojnë dhe merren në konsideratë, ku pasuri që shpronësohet është ajo e përcaktuar dhe në VKM prej 10500 m^2.

Në shqyrtimin e dokumentacionit të pasqyruar nga Bashkia Shkodër për shpronësim, u konstatua që për pasurinë e llojit "truall", me nr. 18/71, volumi 14, faqe 194, në ZK.8591, me sipërfaqe totale 11.200 m^2, në pronësi të Fatmir Muça, sipërfaqja e përcaktuar për shpronësim nuk përputhet me sipërfaqen e verifikuar nga projektit në dwg. Nga verifikimi në dwg sipërfaqja e pasurisë me nr. 18/71, është më e madhe (13.912 m^2), sesa është në dokumentacionin e pronësisë (11.200 m^2). Për arsye të paraqitjes së konturit të pronësisë me një sipërfaqe më të madhe, reduktohen edhe paraqitja e sipërfaqeve me të cilat prona kufizohet, që janë pasuria e llojit "livadh" me nr. 10/122, volumi 37, faqe 126, në ZK.8591, me sipërfaqe totale 64.488 m^2 dhe pasuria e llojit "livadh" me nr.10/121, volumi 37, faqe 125, në ZK.8591, me sipërfaqe totale 88.488 m^2, në pronësi të Bashkisë Shkodër.
Mos paraqitja e saktë e sipërfaqeve takuese të secilës pasuri, në bazë të të dhënave të dokumenteve që vërtetojnë pronësinë, kartela dhe harta treguese, si edhe në bazë të rilevimit topografik të pasurive, ndikon në cenimin e pasurive të tjera kufizuese.
Në rastin konkret, rritja e sipërfaqes së pasurisë private në pronësi të z. Fatmir Muça ndikon në cenimin e pasurive kufizuese, duke zvogëluar me 2712 m^2 sipërfaqen e pasurive me të cilat kufizohet, pronë e Bashkisë Shkodër. Ky konstatim është evidentuar edhe nga vetë z. Fatmir Muça (pronar i pasurisë me nr.18/71), i cili i është i drejtuar me anë të shkresave MIE, ASHSH-së dhe Bashkisë Shkodër, për të informuar dhe kërkuar që të rishikohet sipërfaqja e përcaktuar për shpronësim, pasi vetëm 5828 m^2 është sipërfaqja që preket nga projekti i propozuar dhe jo 7770 m^2. Për të sqaruar situatën e pronës, zotëria ka paraqitur edhe një rilevim topografik të realizuar nga një inxhinier i licencuar, të pasqyruar si më poshtë:



Sipërfaqja e përcaktuar si S-3 në planin e rilevimit është pjesa që preket nga projekti për shpronësimin për interes publik, prej 5828 m^2. Sipërfaqja S-4 prej 2712 m^2 është pjesë e pronës së Bashkisë Shkodër në bazë të verifikimit nga projekti dwg. Ndërsa sipërfaqja S-2 është shpronësuar me VKM-në nr.725, datë 16.09.2020. Rritja e sipërfaqes takuese që duhet të shpronësohet ndikon jo vetëm në cenimin e pasurive kufizuese, por edhe në mbivendosjen e sipërfaqes të shpronësuar më parë në bazë të VKM-së nr. 725, datë 16.09.2020.
Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se z. *Fatmir Muça* ka bërë edhe një deklaratë noteriale në të cilën deklaron që heq dorë nga sipërfaqja që nuk i takon, prej 2712 m^2.
Vlera e shpronësimit për pasurinë me nr.18/71, volumi 14, faqe 194, në ZK 8591, duhet të ishte llogaritur për sipërfaqen që preket nga projekti prej 5828 m^2, jo sipërfaqen prej 7770 m^2, duke shpronësuar më shumë për vlerën 16,528,362 lekë [(5828 m^2 x 8511 lekë/m^2) = 49,602,108 lekë, sipas grupit të KLSH – 66,130,470 lekë përllogaritja e ASHSH-së].

Si përfundim, vlera totale e shpronësimit prej 402,403,347 lekë është miratuar edhe në VKM nr. 117, datë 26.02.2025, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës", duke i kaluar në favor të Bashkisë Shkodër. Diferenca e konstatuar në llogaritjen e vlerës së shpronësimit prej 16,528,362 lekë, efekti financiar negativ në buxhetin e shtetit, dhe vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, për nenet 17, 18 dhe 19.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimet e subjektit: *Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, sqaron se pasi janë finalizuar procedurat për shpronësim me VKM Nr. 117, datë 26.02.2025 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të*
pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës", nëpërmjet shkresës protokolluar në ASHSH nr. 83/43 prot., datë 05.03.2025, është paraqitur ankesa e Z. Fatmir Muça, i cili parashtron pretendimin se, për pasurinë nr. 18/17, ZK 8591, i është drejtuar ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, në cilësinë e institucionit kompetent, për saktësim sipërfaqes të pasurisë sipas planit të rilevimit me sipërfaqe 5828 m^2.
Në këto kushte ASHSH i është drejtuar subjektit kërkues, Bashkisë Shkodër me shkresën nr. 83/56 prot., datë 16.04.2025, me lëndë "Për trajtim dhe kompetencë", ku në vijim të kërkesës së qytetarit është kërkuar kryerja e një verifikimi lidhur me sipërfaqen që preket nga projekti për pasurinë nr. 18/71, ZK 8591. Bashkia Shkodër, nëpërmjet shkresës nr. 8168/1 prot., datë 23.04.2025, protokolluar në ASHSH me nr. 83/59 prot., datë 25.04.2025, sqaron se: "Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ka pasaktësi në sipërfaqen e shpronësuar dhe për sa më sipër po përgatisin dokumentacionin e nevojshëm me qëllim paraqitjen e kërkesës për ndryshimin e VKM nr. 117., datë 26.02.2025.... ". Në vijim, sikurse rezulton nga kërkesat për shpronësim që administrohen pranë ASHSH, nga ana e Bashkisë Shkodër me shkresën nr. 10749 prot, date 29.05.2025, protokolluar në ASHSH nr. 730 Prot., datë 02.06.2025 ka paraqitur, kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 117, datë 26.02.2025 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës", Bashkia Shkodër", në të cilën është evidentuar dhe korrigjimi i sipërfaqes së prekur nga shpronësimi për pasurinë e sipërcituar nga 7770 m^2 në 5828 m^2, sipas planit të rilevimit.
Në përfundim ASHSH sqaron se, KPSH ka marrë masat për ndryshimin e VKM-së përkatëse, lidhur me saktësimin e sipërfaqes së pasurisë Nr. 18/71, ZK 8591 dhe me shkresën Nr. 730/13 Prot, datë 2.12.2025 është dërguar propozimi i projektvendimit për shpronësim pranë MIE. Në këtë projektvendim kërkohet të ndryshohen të dhënat për shpronësim të pasurisë Nr. 18/71, ZK 8591, të pasqyruar sipas numrit rendor 21, të tabelës bashkëlidhur VKM Nr. 117, datë 26.02.2025.
Sqarojmë se, pronari i pasurisë Nr. 18/71 vol.14 fq. 194 Zk. 8591, të shpronësuar sipas VKM nr. 117/2025, nuk është likuiduar për vlerën e shpronësuar, konfirmuar nëpërmjet korrespondencës elektronike datë 07.11.2025, nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë ASHSH.
Dokumentacioni mbështetës(1. Shkresa Nr. 730/13 Prot, datë 2.12.2025 me lëndë "Dërgohet propozimi i projektvendimit për shpronësim").
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, sqarojmë se nuk janë paraqitur elemente të reja nga ato në fazën e akt konstatimeve, për të cilat grupi i

auditimit është shprehur si në pjesën narrative po ashtu dhe në kundërpërgjigjet të observacioneve të paraqitura nga an juaj dhe të reflektuara në Raportin Përfundimtar të Auditimin. Në lidhje me nismën ligjore për ndryshimin e VKM-së, pavarësisht vlerësimit pozitiv që grupi i auditimit ka kundrejt saj, theksojmë se kjo e fundit nuk mund të merret në konsideratë si efektive për ndryshimin e "gjetjes së auditimit" apo rekomandimit përkatës, deri në momentin e miratimit konkret të VKM-së që do të pasqyrojë dhe reflektojë korrigjimin konkret. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Gjithashtu konstatohet se:

- Në relacionin e përpiluar nga ASHSH drejtuar MIE, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve, gjë e cila nuk rezulton të jetë bërë dhe akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues ARRSH dhe ASHSH, ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 20, pika 1, shkronja (a) e cila parashikohet se: "*Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, ASHSH i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*
Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilën citohen dhe dokumentet që kërkohen nga shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 10 të këtij ligji."
Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se: "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit*".
- Akt-marrëveshja e lidhur nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar);
- ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar se: *Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e ARRSH marrjen e masave për njoftimin e tij.* realizimin e "Njoftim për shpronësim publik", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM nr.127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi. Ky njoftim është kryer përtej afatit 10 ditor nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit;
- Nuk është bërë i mundur zbatimi i pikës 10 të VKM nr. 117, datë 26.2.2025, ku thuhet se: "*ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi*", në kundërshtim me nenin 25 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të

pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, ku thuhet se: *"Në rastet kur pasuria pronë private të shpronësuara duhet të regjistrohet sipas ligjit, ky regjistrim duhet të kruhet nga ministria kompetente brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësim*

- Në dosjen e shpronësimit, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës VKM për shpronësim, në kundërshtim të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur, në zbatim të nenit 11, pika 5/c të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se: *Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.*

Praktika është punuar nga: ***Z. Kastriot Gurra***, Kryetari i komisionit me pozicion Drejtor i Përgjithshëm, *Z.* ***Albian Marku*** me profesion arkitekt, ***Z. Ilirjana Hasanllari*** *me profesion jurist,* ***Zj. Entela Bytyci*** me profesion inxhinier, ***Zj. Selmina Varfi*** me profesion jurist, ***Zj. Blerina Gjonaj*** me profesion jurist, ***Z. Nurion Sula*** me profesion jurist, ***Z. Spartak Kodra*** me profesion ekonomist dhe ***Zj. Mirela Omeri*** me profesion ekonomist *(Anëtar).*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1134/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve. Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumenti juaj **nuk qëndron**, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element i ri, nga ato të paraqitura në fazën e akteve, për të cilat grupi i auditimit është shprehur si në pjesën narrative (si më sipër), po ashtu dhe në kundërpërgjigje të observacioneve tuaja në fazën e akteve, si: "është shprehur se dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivin tuaj. Aktmarrëveshja është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për palët. Ligji kërkon në mënyrë të shprehur qartë domosdoshmërinë e bashkëlidhjes së dokumentacionit që ka shoqëruar kërkesën për shpronësim".

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Sqarojmë për KLSH se, referuar listëpagesës për shpronësimet bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 7, datë 7.5.2007 "Për përdorimin e fondit të shpronësimeve", të ndryshuar, ku specifikohet se: "për ndjekjen e procedurave të likuidimit ngarkohen personat e autorizuar për likuidim". Në rastin konkret grupi i punës së likuidimit (i cili është i ndryshëm nga komisioni i posaçëm i shpronësimit) ngrihet me Urdhër të Drejtorit*

të Përgjithshëm dhe procedurat përkatëse të likuidimit ndiqen nga ky grup i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është i njëjti grup me të njëjtët anëtarë gjatë gjithë vitit dhe ndjek dhe realizon procedurat përkatëse referuar vitit përkatës. Gjithashtu sqarojmë për KLSH se nuk është përcaktuar asnjë bazë ligjore që hapat e ndjekur për likuidimin të jenë pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa kundërshtohet nga subjekti sqarimet qërojnë dhe **merren në konsideratë**, duke mos gjetur pasqyrim në këtë fazë të RPA.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *KPSH e kundërshton duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit, pasi ky komision është "ad hoc" dhe tagrat e tij përfundojnë me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022.*

Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa observoi, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si mësipër), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve. Sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara, dhe se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja. **Argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për*

rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar
Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa observoi, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si më sipër), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. Argumentimi juaj nuk merret në konsideratë". **Argumenti nuk merret në konsideratë.**

III. Mbi zbatimin e procedurës për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, me objekt: *"Ndërtim kopshti dhe çerdhe integruar nr. 42, Bashkia Tiranë".*

Dokumentacionet që u shqyrtuan në procesin e auditimit janë të gjithë shkresat, korrespondencat, vendimet, dokumentacionet e pronësisë, projektet, etj. të cilat janë pjesë e dosjes fizike, të paraqitura si më poshtë:
Shkresë *"kërkesë për shpronësim"*, nr. 3043/1 prot, datë 3.8.2021, ku Bashkia Tiranë nëpërmjet Kryetarit të saj z. Erion Veliaj, ka kërkuar shpronësimin e pronës për zhvillimin e projektit *"Ndërtim kopshti dhe çerdhe integruar nr. 42, Bashkia Tiranë"* në adresë të ASHSH;
Shkresë nr. 36312/3 prot, datë 23.12.2021 nga Bashkia Tiranë në adresë të ASHSH, për plotësim dokumentacioni (kthim përgjigje shkresës nr. 355/5 prot, datë 7.12.2021), për vënien në dispozicion të projektit të shpronësimit;
Urdhër nr. 105, datë 10.8.2021 (shkresa nr. 355/1 prot, dt. 10.8.2021), për krijimin e KPSH, me anëtarë: *zj. Erlis Hereni* në cilësinë e Kryetarit me detyrë ish- Drejtor ASHSH, *z. Martin Beqiraj* me detyrë ekonomist, *z. Besnik Hysaj* me profil inxhinier, *zj. Klodiana Elezi* me profil Jurist, *z. Albian Marku* me profil Arkitekt, në cilësinë e anëtarit;
Procesverbal datë 20.9.2021 mbajtur nga KPSH, ku konstaton se:
- planimetria e shpronësimit nuk është miratuar nga titullari i institucionit ose autoriteti përgjegjës të cilit i janë deleguar kompetencat.
– konfirmimi mbi statusin juridik të pasurive që shpronësohen nga ASHK, i shoqëruar me kartelat e pasurive, duhet të jetë i 3 muajve të fundit;
Procesverbal datë 01.12.2021 mbajtur nga KPSH, ku konstaton se planimetria e shpronësimit duhet të jetë sipas ligjit. Bashkia shprehet se planimetria e shpronësimit është sigluar nga peronat përgjegjës për hartimin e saj dhe shoqëruar me vulën e bashkisë Tiranë;
Me shkresën *"plotësim dokumentacioni"* nr. 355/5 prot, datë 7.12.2021, KSHP nëpërmjet kryetarit të saj zj. Erlis Hereni, i kërkoj Bashkisë Tiranë se planimetria e shpronësimit duhet të jetë sipas ligjit. Bashkia shprehet se planimetria e shpronësimit është sigluar nga peronat përgjegjës për hartimin e saj dhe shoqëruar me vulën e bashkisë Tiranë. Dokumentacioni duhet të jetë me vulën e titullarit të bashkisë dhe jo vulë lidhëse;
Me procesverbal datë 28.12.2021 KSHP bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim publikë dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik" (me ndryshime), ka vendosur:

Njoftimin e subjektit Bashkia Tiranë për pranimin e kërkesës për shpronësim, ku referuar pikës 6 të VKM nr. 127, datë 23.3.2000 :Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe njoftimit për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", njoftimi të afishohet në ambientet e Bashkisë Tiranë;
Të hartojë akt-marrëveshjen ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Tiranë, si subjekt kërkues për shpronësimin e pronave që preken nga projekti: "Ndërtim kopshti dhe çerdhe e integruar nr. 42", në referim të pikës 2 të nenit 13 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim publikë dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik" (me ndryshime);
Të bëj publikimin e kërkesës për shpronësim në QBZ, referuar pikës 1 të nenit 15 të Ligjit nr. 8561, datë 22.121.1999 "Për shpronësim publikë dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik" (me ndryshime);
Të bëjë njoftimin e drejtpërdrejtë të secilit pronarë a bashkëpronarë të pasurive private, në referencë të pikës 1 të nenit 14 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim publikë dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik" (me ndryshime);
Sekretaria teknike ti dërgojë shkresë bashkisë Tiranë;
Shkresa "*plotësim dokumentacioni*' nr. 36312/1 prot, datë 20.10.2021 e bashkisë Tiranë, adresuar ASHSH, në lidhje me nënshkrimin nga titullari i planimetrisë së shpronësuar, ku thuhet se: Titullari i Bashkisë referuar rregullores së saj, siglon projektet e miratuara nga Këshilli teknik (KT), ku dh projekti i shpronësimit është rjedhojë e këtyre projekteve. Për këtë fakt projekti i shpronësimit është i sigluar nga personat përgjegjës për hartimin e tij, shoqëruar me vulën e bashkisë, referuar urdhrit te Kryetarit të Bashkisë nr. 30342, datë 2.8.2021.
Në lidhje me konfirmimin e statusit nga ASHK , sqarojmë se Sektori i shpronësimeve pranë bashkisë në referim të VKM nr. 389, datë 13.5.2020 "Për miratimin e listës së tarifave të shërbimit kadastrale", ka bërë aplikimin nr. 55513, datë 27.9.2021 dhe nr. 55531, datë 27.9.2021, në sistemin online të ASHK, ku nga kjo e fundit është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar;
Shkresë "*kërkesë për konfirmim*" nr. 13053/3 prot, datë 4.10.2021, e Bashkisë Tiranë në adresë të ASHK për konfirmim statusi juridik, për vënien në dispozicion të kartelave të pasurisë të 3 muajve të fundit;
Shkresa "*njoftim për pranim e kërkesës për shpronësim*" nr. 355/7 prot, datë 30.12.2021 e AHSH në adresë të Bashkisë Tiranë, ku njofton këtë të fundit për pranimin e kërkesës për shpronësimin për interes publikim të pronarëve që preken nga projekti. Personi i autorizuar brenda 10 ditëve duhet të paraqitet për lidhjen e akt-marrëveshjes për shpronësim;
Akt-marrëveshja e lidhur ndërmjet ASHSH (*nr. 355/8 prot, dt. 30.12.2021)* dhe Bashkisë Tiranë *(nr. 114/1 prot, dt. 6.01.2022).* në nenin 3 të kësaj akt-marrëveshje thuhet se: 1- Brenda 10 ditëve nga data e lidhjes, ASHSH duhet të përmbush procedurat e njoftimit të Bashkisë Tiranë dhe të secilit pronarë që kërkohet shpronësim, kjo referuar nenit 14 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim publikë dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik" (me ndryshime).... 4- Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së përgjigjes nga të njoftuarit por jo më përpara se një muaj nga data e fundit të afatit të publikimit të kërkesës për shpronësim për interes publik, në rastet kur të njoftuarit kanë pranuar kushtet mes palëve, ASHSH kryhen me të njoftuarit veprimet për kalimin e pronësisë në favor të shtetit, kundrejt shpërblimit apo pagesës së masës së kompensimit për zhvlerësimin e pasurisë; ..6- ASHSH brenda 30 ditëve nga data e miratimit me vendim të KM, të shpronësimit për interes publik të pronarëve të pasurisë pronë private që preken nga projekti do kryhej veprimet përkatëse për kalimin e pronësisë nga pronarët në favor të Bashkisë Tiranë;
Shkresa *"kërkesë për publikim për shpronësim"*, nr. 98 prot, datë 18.01.2022, ASHSH i kërkon QPZ publikimin e kërkesës për shpronësim;
Shkresa *"njoftim për shpronësim"* nr. 98/1 prot, datë 20.01.2022, ASHSH njofton poseduesin e pronës *z. David Bashkim Haxhi* dhe *z. Mark Shantoja*, për shpronësimin e pasurisë nr. 2/427 e llojit truall në ZK 8270 për vlerën 22,588,643.70 lekë *(337.3 m^2 x 66,969 lekë.m^2)*, referuar VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH", dhe poseduesin e pronës *z. Jorgo Gaqo Papadhopulli* dhe *z. Petraq Gaqo Papadhopullia*, për shpronësimin e pasurisë nr. 2/899 e llojit truall në ZK 8270 për vlerën 44,032,117.5 lekë *(657.5 m^2 x 66,969 lekë.m^2)*, referuar VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH";
Procesverbal datë 21.2.2022 hartuar nga KSHP, ku është vendosur:

Miratimi i propozimit për shpronësim për interes publik të pronarëve për realizimin e projektit "Ndërtim Kopshti dhe çerdhe e integruar nr. 42", për vlerën e shpronësuar 66,620,761.2 lekë;
Sekretaria teknike të hartojë draft-projekt VKM të shoqëruar me relacion përkatës për shpronësim, si dhe dërgimi në MIE;
Shkresa *"draft projekt-vendim"* nr. 98/3 prot, datë 2.3.2022, ku ndër të tjera thuhet se ....vlera e shpenzimeve të procedurës në masën 50,000 lekë të përballohet nga Bashkia Tiranë;
Vendim nr. 244, datë 20.4.2022 i KM "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurisë të paluajtshme, pronë private që preken nga projekti *Ndërtim Kopshti dhe Çerdhe e integruar nr. 42"*. Vlera prej 66,620,761.2 lekë do përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.
Nga auditimi konstatohet se:
- Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, "Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore", ku parashikohet se: *Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen.*
- Nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 11, pika 5, germa (d) e cila parashikon se: *"ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban".*
Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen.
- Konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, Bashkia Tiranë realizimin e njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, shkronja (e), e cila parashikon se: *"Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohet, se bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës,* si dhe VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: *"Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet standarde, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.";*
Praktika është punuar nga: ***zj. Erlis Hereni*** *në cilësinë e Kryetarit* me detyrë ish- Drejtor ASHSH, ***z. Martin Beqiraj*** me detyrë ekonomist, ***z. Besnik Hysaj*** me profil inxhinier, ***zj. Besnik Hysaj*** me profil Jurist, ***z. Albian Marku*** me profil Arkitekt, *në cilësinë e anëtarit.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *KPSH sqaron se, përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga KPSH, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa keni observuar, pretendimi juaj qëndron në lidhje me faktin se në periudhën në vijimësi keni bërë reflektimet përkatëse, duke protokolluar shkresat, por që bashkëlidhur nuk keni përcjellë urdhrin dhe disa nga shkresat për ilustrim. **Problematike mbetet në RPA.**

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".*
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar
Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa observoi, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si më sipër), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. Argumentimi juaj nuk merret në konsideratë". **Argumenti nuk merret në konsideratë.**

IV. Mbi zbatimin e procedurës për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: *"Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi, Bashkia Pogradec".*

Dokumentacionet që u shqyrtuan si më poshtë:
Urdhri nr. 69, datë 5.5.2023 *(prot nr. 27/8, dt. 5.5.2023)*, për krijimin e KPSH, i përbërë nga: *zj. Egra Ibrahimi*, në cilësinë e Kryetarit dhe ish- Drejtorit të ASHSH, *z. Besnik Hysa*, me profil

Inxhinier, *zj. Blerina Gjonaj* me profil Jurist, *zj. Sidorela Qato* me profil Ekonomiste dhe *z. Spartak Kodra* me profil ekonomist;
Shkresa *"kërkesë për korrigjim"*, nga Bashkia Pogradec në adresë të ASHSH, ku sqarohet se në përgjigje të shkresës së ASHSH nr. 663/30 prot., datë 19.12.2022, lidhur me shpronësimin e pasurisë nr. 1/388 në ZK 8581, ku sipas listës së VKM, rezulton me nr. 1/338, ZK 8581, kërkohet korrigjimi i VKM nr. 300, datë 11.5.2022 në emër të *z. Thoma Leonard Mihallaq Naco, Tefta Kopi Iftica, Dhimitër Kopi Spiro* nga pasuria 1/338 në pasurinë 1/388 në ZK 8581;
Procesverbal datë 22.5.2023, mbajtur nga KPSH, ku kërkohet se:
Njoftimin e subjektit kërkuar (Bashkia Pogradec), për pranimin e kërkesës së shpronësimit, kjo në referencë të nenit 6 të VKM nr. 127, datë 23.3.2000 për "Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm....";
Të hartohet akt-marrëveshja ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Pogradec si subjekt kërkues për shpronësimin e pronave që preken nga projekti, bazuar në pikën 2 të nenit 13 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 për "Shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik", i ndryshuar;
Të bëhet publikimi i kërkesës për shpronësim të pronarëve që preken nga projekti...;
Të bëhet njoftimi i drejtpërdrejtë i secilit pronarë a bashkëpronarë të pasurive, pronë private, referuar pikës 1 të nenit 14 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 për "Shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik", i ndryshuar;
Shkresa *"njoftim për pranim kërkese)*, nr. 27/11 prot, datë 23.5.2023 ku ASHSH pranon kërkesën e Bashkisë Pogradec për korrigjim të pasurisë nga pasuria 1/338 në pasurinë 1/388 në ZK 8581;
Akt-marrëveshja e lidhur ndërmjet ASHSH *(nr. 27/12prot, dt. 23.5.2023)* dhe Bashkisë Pogradec *(nr. 26/16 prot, dt. 26.5.2023)*, ku në nenin 3 të kësaj akt-marrëveshje thuhet se: *1- Brenda 10 ditëve nga data e lidhjes, ASHSH duhet të përmbush procedurat e njoftimit të Bashkisë Pogradec dhe të secilit pronarë që kërkohet shpronësim,* kjo referuar nenit 14 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim publikë dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik" (me ndryshime).... *4- Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së përgjigjes nga të njoftuarit por jo më përpara se një muaj nga data e fundit të afatit të publikimit të kërkesës për shpronësim për interes publik, në rastet kur të njoftuarit kanë pranuar kushtet mes palëve, ASHSH kryhen me të njoftuarit veprimet për kalimin e pronësisë në favor të shtetit, kundrejt shpërblimit apo pagesës së masës së kompensimit për zhvlerësimin e pasurisë; ..6- ASHSH brenda 30 ditëve nga data e miratimit me vendim të KM, të shpronësimit për interes publik të pronarëve të pasurisë pronë private që preken nga projekti do kryhej veprimet përkatëse për kalimin e pronësisë nga pronarët në favor të Bashkisë Pogradec;*
Shkresa *"njoftim për shpronësim"* nr. 27/20 prot, datë 27.6.2023, ASHSH kërkon nga QPZ, se referuar shkresës nr. 26/9 prot, datë 2.5.2023 të Bashkisë Pogradec, është kërkuar që bazuar në nenin 15 Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim publikë dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik" (me ndryshime), të bëhet publikimi i kërkesës për korrigjim të VKM nr. 300, datë 11.5.2022 "Për shpronësimin për interes publik i të pronarëve të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit". me anë të këtij publikimi, është kërkuar vënia në dijeni e personave të prekur nga ky shpronësim, për pasuritë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në R.SH";
Shkresa *"njoftim për shpronësim"*, adresuar poseduesve të pronës *z. Thoma Leonard Mihallaq Naco, Tefta Kopi Iftica, Dhimitër Kopi Spiro,* ku bazuar në nenin 14 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim publikë dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë

private për interes publik" (me ndryshime), si dhe pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.3.2000 "Për përbërjen dhe procedurat e punës së KPSH", njoftohet se:
Bashkia Pogradec me shkresën nr. 26/9 prot, datë 2.5.2023 ka kërkuar korrigjimin e VKM nr. 300, datë 11.5.2022, ku është kërkuar të shpronësohet për pasurinë e paluajtshme pronë private nr. 1/388 e llojit "truall" në ZK 8581;
Vlerësimi i pasurisë në zbatim të VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH", për vlerën 245,384.49 lekë (23.39 m² x 10,491lekë.m²);
Shkresa *"draft projekt-vendim"* nr. 27/27 prot, datë 28.7.2023, ku ndër të tjera thuhet se ....vlera e shpenzimeve të procedurës në masën 50,000 lekë të përballohet nga Bashkia Pogradec;
Vendim nr. 567, datë 4.10.2023 i KM "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurisë të paluajtshme, pronë private që preken nga projekti *"Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi, Bashkia Pogradec".*
Nga auditimi konstatohet se:
- Konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, Bashkia Tiranë realizimin e njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, shkronja (e), si dhe VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit i bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: *"Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet standarde, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.";*
Praktika është punuar nga: ***zj. Egra Ibrahimi***, në cilësinë e Kryetarit dhe ish- Drejtorit të ASHSH, ***z. Besnik Hysa***, me profil Inxhinier, ***zj. Blerina Gjonaj*** me profil Jurist, ***zj. Sidorela Qato*** me profil Ekonomiste dhe *z. Spartak Kodra* me profil ekonomist, në cilësinë e anëtarit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendim i subjektit (i përmbledhur):: *Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër, argumentimi juaj **merret në konsideratë**, nisur nga fakti se është vijuar me protokollimin e shkresave.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure*

shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar
Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa observoi, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si mësipër), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. Argumentimi juaj nuk merret në konsideratë". **Argumenti nuk merret në konsideratë.**

V. Mbi zbatimin e procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: *"Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë".*

Në zbatim të urdhrit nr. 143, datë 10.10.2022 (nr. 735/1 prot), si dhe kërkesës për shpronësim nga Bashkia Vlorë, nga ana e ASHSH me shkresën nr. 11010 prot, datë 30.9.2022, është krijuar KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për realizimin e projektit: *"Rekonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë"*, me përbërje: *zj. Egla Ibrahimi,* në cilësinë e Kryetarit të KSHP, me detyrë ish- Drejtor I ASHSH, *z. Albian Marku,* me profesion arkitekt, *z. Besnik Hysaj,* me profesion inxhinier, *z. Ilirjan Hysaj,* me profesion jurist, .
Nga shqyrtimi i dosjes së procedurës të paraqitur nga Bashkia Vlorë për shpronësimin e pasurive që preken nga ky Projekt, rezultoi se sipërfaqet e prekura nga projekti sipas hartës (DWG), pjesë e projektit të hartuar Bashkia Vlorë (të dhëna të paraqitura nga studio projektuese), nuk përputhen me sipërfaqet e pasqyruara në listën e shpronësimeve të miratuara me VKM nr. 428, datë 19.7.2023, ku në 10 pasuri, sipërfaqja e shpronësuar është më e madhe se sipërfaqja e gjurmës e përcaktuar në projektin përfundimtar të miratuar për shpronësim, konkretisht:
Pasuria nr. 384/4/1 në ZK 3140, sipërfaqja që preket sipas përcaktimit në Project është 717 m^2, ndërsa në listën e miratuar për shpronësim është 1392 m^2, duke shpronësuar më shumë sesa projekti sipërfaqen prej 675 m^2. Vlera e shpronësuar për pasurinë nr. 384/4/1 në ZK 3140, do duhej të ishte llogaritur për vlerën 9,222,240 lekë *(717 m^2 x 12,862 lekë/ m^2)*, ose rënduar më shumë në buxhetin e shtetit për vlerën 8,682,125.92 lekë *(17,904,365.92 – 9,222,240);*
Në pasurinë me nr. 384/2/1 në ZK 3140, sipërfaqja që preket sipas përcaktimit në Project është 148.5 m^2, ndërsa sipas listës së miratuar janë shpronësuar 920 m^2, duke shpronësuar më shumë sipërfaqen 772 m^2, më shumë sesa në Project. Vlera e shpronësuar për pasurinë nr. 384/2/1 në ZK 3140, do duhej të ishte llogaritur për vlerën 1,910,046 lekë *(148.5 m^2 x 12,862 lekë/ m^2)*, ose rënduar më shumë në buxhetin e shtetit për vlerën 9,923,272.88lekë *(11,833,279.88 – 1,910,046);*
Në pasurinë me nr. 410 në ZK 3140, sipërfaqja që preket sipas përcaktimit në Project është 600.5 m^2, ndërsa sipas listës së miratuar janë shpronësuar 1216.4 m^2, duke shpronësuar më

shumë sipërfaqen 616 m^2, më shumë sesa në Project. Vlera e shpronësuar për pasurinë nr. 410 në ZK 3140, do duhej të ishte llogaritur për vlerën 7,723,787 lekë *(148.5 m^2 x 12,862 lekë/ m^2)*, ose rënduar më shumë në buxhetin e shtetit për vlerën 7,921,549.8 lekë *(15,645,336.8- 7,723,787)*;

Në pasurinë me nr. 145 në ZK 3140, sipërfaqja që preket sipas përcaktimit në Project është 1128 m^2, ndërsa sipas listës së miratuar janë shpronësuar 1455 m^2, duke shpronësuar më shumë sipërfaqen 327 m^2, më shumë sesa në Project. Vlera e shpronësuar për pasurinë nr. 145 në ZK 3140, do duhej të ishte llogaritur për vlerën 13,063,516 lekë *(1128.5 m^2 x 11,576 lekë/ m^2)*, ose rënduar më shumë në buxhetin e shtetit për vlerën 3,779,564 lekë *(16,843,080- 13,063,516)*.

Ndërsa për të gjitha pasuritë që janë konstatuar diferenca, paraqitet tabela e mëposhtëm përmbledhëse:

Nr.	Të dhënat e pronarit	të dhënat kadastrale			Të dhënat e shpronësimit			Të dhëna nga projekti teknik i miratuar (m2)			Diferencat në sipërfaqe për disa nga pasuritë e konstatuara		
	Emër/Atësi/ Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale e parcelës (m2)	Sipërfaqe Shpronësim (m2	Çmimi në lekë (m^2)	Vlera Totale	Sipërfaqe e përrakt uar në projekt	Çmimi në lekë (m^2)	Vlera Totale	Diferenca e sipërfaqes	Çmimi në lekë (m2)	Vlera Totale
1	Agim Hodo Begotaraj Anila Halo Begotaraj	3140	384/4/1	3470	1392	12862.26	17,904,269	717	12862.26	9,222,240	675	12862.26	8,682,025
2	Avdi Sefer Bego	3140	390/2/1	3140	920	12862.26	11,833,279	148.5	12862.26	1,910,045	772	12862.26	9,923,233
3	Tare Bego	3140	391/2	6000	451	12862.26	5,800,879	438.15	12862.26	5,635,599	13	12862.26	165,280
4	Roland Begotaraj	3140	391/1/1	3000	640	12862.26	8,231,846	600.5	12862.26	7,723,787	40	12862.26	508,059
5	Azem Selmanaj	3140	410	3000	1216.4	12862.26	15,645,653	600.5	12862.26	7,723,787	616	12862.26	7,921,865
6	Selam Bego	3140	417/2	5410	973.7	12862.26	12,523,982	956.22	12862.26	12,299,150	17	12862.26	224,832
7	Kledian Tragaj	3140	419/10	975	147	12862.26	1,890,752	140.73	12862.26	1,810,105	6	12862.26	80,646
8	Shefqet Havari	3140	419/11	365	161.1281	12862.26	2,072,471	90.2	12862.26	1,160,175	71	12862.26	912,295
9	Avdi Nika	3140	145	5000	1455	11,576.03	16,843,123	1128.27	11576.03	13,060,887	327	11576.03	3,782,236
10	Alim Rokaj Ditian Banush Serjaraj	3140	160/9	2600	580.7	11,576.03	6,722,200	572.45	11576.03	6,626,698	8	11576.03	95,502
Vlera e shpronësuar për pasuritë e mësipërme							99,468,454						
Vlera që duhet të ishte shpronësuar										67,172,477			
Diferenca e vlerës													32,295,977

Vlera e shpronësuar për 10 pasuritë e mësipërme është në vlerën 99,468,454.41 lekë, kur duhej të ishte shpronësuar në vlerën 67,172,477.21 lekë, me një diferencë më shumë prej 32,295,977.20 lekë, me efekt në buxhetin e shtetit.

Nga të dhënat e dosjes së procedurës së shpronësimit, konstatohet se cimet për sipërfaqet e shpronësuar e Ilojit tokë bujqësore/ pyjore dhe truall, nuk janë bërë në referencë të kuadrit ligjor, por janë bërë mbi bazën e çmimit të vlerësuar nga vlerësues me licencë, kjo bazuar në Ligjin nr. 44/2020, datë 23.4.2020 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas (nr. 50123, datë 10.2.2022), ndërmjet R.SH dhe bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri", dhe jo sipas referenca ligjore që përdoren në rastet kur shpronësimet përballohen nga buxheti i shtetit, konkretisht:

VKM nr. 138, datë 23.3.200 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen....", i ndryshuar, VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "për miratimin e hartës së vlerës së tokës në R,SH", etj.

Konkluzion: Është e domosdoshme që praktikat e shpronësimit të unifikohen dhe të mbështeten në vlerësime reale dhe të pavarura të tregut, duke respektuar të drejtën themelore të pronës. Zbatimi selektiv i ligjit dhe vendosja e çmimeve të shpronësimit jo reale , pa konsultim dhe pa reflektim të vlerës reale të pronës, përbën jo vetëm shkelje ligjore, por edhe cenim të rëndë të parimeve themelore të shtetit të së drejtës. Implementimi i legjislacionit në këtë praktikë shpronësimi duhet të unifikohet me qëllim standardizimin nëpërmjet miratimit të legjislacionit përkatës.

Me shkresën (*kthim pa veprim të kërkesës për shpronësim dhe dokumentacion shoqërues*), nr. 735/2 prot, datë 26.10.2022, ASHSH i kërkon Bashkisë Vlorë, plotësimin e dokumentacionit për shpronësim, pasi sipas KSHP nga verifikimi rezultoi se:

Mungojnë lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me mënyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet nga bashkia;

Kartelat e pasurive janë fotokopje dhe të pa njësuara nga ASHK Vlorë. Kartelat e pasurive BYPASS mungojnë;

Planimetria e shpronësimit duhet të jeta e hedhur mbi H.T.R dhe ortofoto ku të evidentohen vija e shpronësimit dhe sipërfaqet e parcelave që do të shpronësohen sipas figurës nr. 1. Ka mospërputhje të konsiderueshme mes ortofotos dhe HRT, gjë e cila ndikon në sipërfaqet e shpronësimit. Marrëveshja e huasë mes R.SH dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim nuk është e nënshkruar nga Titullari, por është fotokopje e përcjellë pranë nesh me shkresën nr. 21953/11 prot, datë 11.2.2020, e firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm.

Lidhur me vlerësimin e pasurisë sqarohet se në asnjë pikë të akt-marrëveshjes së R.SH dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim nuk cilësohet mënyra e vlerësimit. Në këtu kushte, nisur nga fakti që vlerësimi do realizohet nga Buxheti i shtetit, vlerësimi i pasurisë së pronarëve që preken nga shpronësimi duhet të bëhet sipas legjislacionit në fuqi;

Vlerësuesja e pasurisë zj. Manjola Fida me licencë nr. V.P 0472/1 është e licencuar për vlerësimin e pasurisë truall dhe ndërtesë dhe nuk ka të drejtë të bëj vlerësim për tokë arë, lavash, kullotë, pyje, siç janë pasuritë e paluajtshme të cilat preken nga projekti;

Mungojnë adresat e vendbanimit të fundit të pronarëve dhe personave të tretë përkatës;

Planimetria e shpronësimit, listat e shpronësimit, duhet të jetë edhe në formë digjitale, në format AutoCAD (DWG) dhe Excel në dy CD (gjë e cila mungon në dosjen e kësaj praktike);

Këto mangësi janë të evidentuara në procesverbalin e datës 24.10.2022 të ASHSH nga ana e KPSH.

Me shkresën (*rikujtues*) nr. 735/3 prot, datë 9.12.2022, ASHSH i drejtohet Bashkisë Vlorë ku në referencë të nenit 10 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, referuar shkresës nr. 735/2 prot, datë 26.10.2022 është bërë kthimi pa veprim i kërkesës për shpronësim për plotësim dokumentacioni. Nisur nga fakti se nga Bashkia Vlorë nuk është dërguar dokumentacioni i kërkuar, në zbatim të nenit 12 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, dosja përbën shkak për refuzim shpronësimi. në këto kushte është kërkuar që brenda 30 ditëve të bëhet plotësimi i dokumentacionit të munguar, referuar shkresës 735/2 prot, datë 26.10.2022. 735/2 prot, datë 26.10.2022.

Me shkresën nr. 1280 prot, datë 01.2.2023 (*plotësim dokumentacioni sipas shkresës nr. 735/3 prot, datë 9.12.2022 të ASHSH*), është bërë plotësimi i dokumentacionit të munguar.

Me shkresën (*kthim përgjigje*) nr. 230/1 prot, datë 21.2.2023, ASHSH i është drejtuar Bashkisë Vlorë se në referencë të shkresës nr. 1280 prot, datë 01.2.2023 të Bashkisë Vlorë, është shprehur se bashkëlidhur dokumentacionit plotësues, por në fakt ky dokumentacion nuk është bashkëshoqëruar shkresës dhe deri me datë 21.2.2023 në ASHSH nuk është paraqitur asnjë dokumentacion plotësues lidhur me këtë projekt.

Me shkresën (*plotësim dokumentacioni*) nr. 230/4 prot, datë 14.4.2023, ASHSH i është drejtuar Bashkisë Vlorë, që në referencë të shkresës nr. 1280/2 prot, datë 16.3.2023, dokumentacioni plotësues në vijim të kërkesës për shpronësim. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, rezultoi se:

Mungon projekti i miratuar nga organet kompetente të firmosura dhe vulosura nga projektuesi;

Mungon leja dhe miratimet përkatëse në organet kompetente sipas ligjit;

Për dru frutorë vlerësimi duhet të bëhet nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësorë dhe jo me vlerësues privat, pasi nuk ka kompetencë;

Në raportin e vlerësimit janë marrë në konsideratë 6 shitje që nuk janë pjesë e raportit. Duhet të sqarohet nëse janë shitje truall, arë apo ndërtesë;

Për të gjitha pasuritë pa informacion të merret informacion nga ASHK Vlorë (kartelë pasurie + HTR);

Mungojnë kartelat e pasurive HTR me nr. 433, 149/31, 211/2, 160/2, 204/2, 1/101, 1/102, 5/1, 211/8 në ZK 3140 në pronësi shtet dhe ND mungon kartela pasurisë nr. 415/2 në ZK 3140 në pronësi të z. Ader Azem Selmanaj :

Me shkresën (*plotësim dokumentacioni*) nr. 5246 prot, datë 3.5.2022, Bashkia Vlorë informon ASHSH për dokumentacioni e munguar për interes shpronësimi.

Konkluzion: Nga shqyrtimi i dosjes së procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: *"Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë"*, rezultoi se nuk ishin të depozituar dokumentacioni mëposhtëm, me gjithë kërkesën e bërë nga ASHSH për plotësim, konkretisht:
Mungon projekti i miratuar nga organet kompetente të firmosura dhe vulosura nga projektuesi;
Për të gjitha pasuritë pa informacion të merret informacion nga ASHK Vlorë (kartelë pasurie + HTR);
Mungojnë kartelat e pasurive HTR me nr. 433, 149/31, 211/2, 160/2, 204/2, 1/101, 1/102, 5/1, 211/8 në zk 3140 në pronësi shtet dhe ND mungon kartela pasurisë nr. 415/2 në ZK 3140 në pronësi të z. Ader Azem Selmanaj :
Kartelat e pasurive janë fotokopje dhe të pa njësuara nga ASHK Vlorë. Kartelat e pasurive BYPASS mungojnë;
Mungojnë adresat e vendbanimit të fundit të pronarëve dhe personave të tretë përkatës;
Planimetria e shpronësimit, listat e shpronësimit, duhet të jetë edhe në formë digjitale, në format AutoCAD (dwg) dhe Excel në dy CD (gjë e cila mungon në dosjen e kësaj praktike).
Në këto kushte ASHSH nuk duhet të vijonte me procedurën pa plotësimin e akte të dokumentacionit ligjorë të kërkuar, veprime në kundërshtim me nenet 11 dhe 12 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, dhe pikës 1 të VKM nr. 127, datë 23.3.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
Nisur nga ky fakt (mungesa e dokumentacionit), referuar të dhënave të financës vlera e këtij projekti nuk është rimbursuar e gjitha tek personat e prekur, ku nga vlera e përllogaritur për shpronësim prej 202,682,342 lekë deri në datën e këtij akti është mundësuar likuidimi i vlerës 43,041,458 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 159,660,833 lekë ose 78.7% e vlerës se miratuar, kjo me argumentin se nga personat e prekur nuk është paraqitur dokumentacioni i saktë ligjorë për likuidim.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga grupi i auditimit, konkretisht relatuar në faqen 53-55, të PRA si vijon: Në lidhje me observacionin e dërguar nga ana Juaj, për sa i përket sipërfaqeve që preken nga shpronësimet bazohen në verifikimin e të dhënave duke ju referuar projektit përfundimtar të dokumentuar në dosje (I firmosur/vulosur), në të cilin përcaktohen të dhënat e specifikuara të secilës sipërfaqe, duke përcaktuar numrin e pasurisë, pronësinë dhe sipërfaqen që preket për shpronësim me kontur të saktë. Nga verifikimi i materialit dwg të vënë në dispozicion gjatë auditimit u evidentua që te reflektimi i pasurive në planvendosje nuk përkonin me sipërfaqen e pasqyruar në kartelën e pasurisë dhe me konturin e pronës të verifikuara nga harta treguese e pasurisë. Mos reflektimi i saktë i kufirit të secilës pasuri, ndikon në cënimin e pasurive kufizuese dhe në rritjen e sipërfaqeve për shpronësim.*
Më poshtë po ju paraqesim disa raste në të cilat janë evidentuar mospërputhje dhe që vërtetojnë që projekti i miratuar është ai në të cilin gjenden të detajuara të gjitha sipërfaqet që preken nga shpronësimi, pasi kufijtë e pasurisë janë paraqitur duke u bazuar në dokumentacionin e pronësisë.
Pasuria me nr. 384/4/1, në ZK 3140, në bazë të kartelës së pasurisë dhe Hartës Treguese ka një sipërfaqe totale prej 3470 m^2. Sipërfaqja që preket sipas përcaktimit në projekt është 717 m^2, ndërsa në listën e miratuar për shpronësim është 1392 m 2, duke shpronësuar më shumë sesa projekti sipërfaqen prej 675 m^2.
Në pasurinë Nr. 145 në ZK 3140, sipërfaqja që preket sipas përcaktimit në projektin e miratuar të dokumentuar në dosje është 1128 m^2 (të pasqyruar më poshtë), ndërsa sipas listës së miratuar janë shpronësuar 1455 m^2 duke shpronësuar më shumë sipërfaqen 327 m^2. Gjithashtu, nëse verifikojmë projektin e vënë në dispozicion në dwg evidentohet që në sipërfaqen prej 1455 m^2 preken dy pasuri, pasuria nr. 145 në ZK 3140 dhe pasuria nr. 145/1, në ZK 3140. Konturi i sipërfaqes evidentohet edhe në hartën e pasurisë së paraqitur si më poshtë, në të cilën evidentohen mospërputhje.

Nga verifikimi i projektit në dwg dhe shqyrtimi me projektin përfundimtar të miratuar, konstatohet se ka mospërputhje në pasqyrimin e sipërfaqeve të pasurisë që preken nga shpronësimi. Rritja dhe ndryshimi i konturit të pronësisë, ndikon edhe në rritjen e sipërfaqes që shpronësohet, në mospërputhje me dokumentacionin e pronësisë.

Më sipër janë pasqyruar vetëm disa prej rasteve për të paraqitur ndryshimet nga projekti i dokumentuar në dosje. Duke qenë se, nga KPSH u konstatuan mospërputhje në pasqyrimin e hartave kadastrale në projektin paraprak, në projektin që ju paraqisni në dwg si të rishikuar, janë ndryshuar sipërfaqet e pasurive (rritja e sipërfaqeve) referuar dokumentacionit të pronësisë dhe këto ndryshime janë miratuar edhe nga KPSH ne fazat e mëtejshme.

Në përbërjen e KPSH ka 5 anëtarë, pjesë e tyre janë specialist të fushës së arkitekturës dhe inxhinierisë, bazuar në nenin 12 dhe 13, të Ligjit nr. 8561/1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, si dhe të nenit 16.2/a, të rregullores për funksionimit dhe organizimit e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III) të VKM nr. 395, datë 132.05.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH", në të cilën përcaktohet që komisioni bën verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues përpara pranimit të kërkesës për shpronësim, kjo mospërputhshmëri duhet të ishte konstatuar nga komisioni, Për sa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Sqarime dhe argumentim ligjor:

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit sikurse Ju ka sqaruar në observacionet e depozituara pranë institucionit Tuaj me shkresën nr. 1137/1 Prot., datë 7.11.2025, në lidhje me diferencat në sipërfaqet e pasurive objekt shpronësimi, KSHP Shpronësimit, në vlerësimin për shpronësim për pasuritë e miratuara me VKM Nr. 428, datë 19.07.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës ekzistuese Vlorë–Orikum dhe dy by-passeve, në Radhimë, Vlorë", është bazuar në dokumentacionin e pronësisë, të konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, Vendimin Nr. 13, datë 17.03.2021, të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e Lejes së ndërtimit të infrastrukturës "Rehabilitimi i rrugës Uji Ftohtë – Orikum dhe ndërtimi i dy By-Pass-eve, gjurmës së projektit të miratuar si dhe planimetrisë së shpronësimit të miratuar nga subjekti kërkues Bashkia Vlorë, si dhe Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social", ("Studimit të Vlerave të Kompensimit"), të përcjellë nga Bashkia Vlorë me shkresën Nr. 1280/2 Prot., datë 16.03.2023.

Sikurse ju kemi evidentuar sipërfaqet e pasurive të prekura nga gjurma e shpronësimit përputhen plotësisht me ato të pasqyruara në listën e shpronësimit të miratuar me VKM Nr. 428/2023, sipas planimetrisë përfundimtare të saktësuar në përputhje me gjurmën e projektit të miratuar nga KPSH gjatë procedurës për shpronësim.

Konkretisht mospërputhjet janë konstatuar nga KPSH në dokumentacionin fillestar të përcjellë nga Bashkia Vlorë, ku planimetria (paraprake) nuk pasqyronte me saktësi pronat në hartën kadastrale. Për këtë arsye, gjatë zhvillimit të procedurës së shpronësimit, KSHP pranë ASHSH, pasi konstatoi mospërputhje, kërkoi plotësime dhe saktësime të planimetrisë për shpronësim sipas gjurmës së projektit të miratuar, përmes shkresave: (- Nr. 735/2 Prot., datë 26.10.2022, në të cilën, ndër të tjera, në pikat 1 dhe 2 është konstatuar se: Mungon projekti i miratuar nga organet kompetente, i firmosur dhe vulosur nga projektuesi; Mungojnë lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet; si dhe - Shkresa Nr. 230/4 Prot., datë 14.04.2023, në të cilën, sipas pikës 3, është konstatuar se planimetria e shpronësimit duhet të jetë e hedhur mbi HTR dhe ortofoto, ku të evidentohet vija e shpronësimit dhe sipërfaqet e parcelave që do të shpronësohen, sipas figurës Nr. 1 (bashkëlidhur), pasi u konstatua mospërputhje të konsiderueshme midis ortofotos dhe HTR, çka ndikon në përcaktimin e saktë të sipërfaqeve të shpronësimit).

Në vijim të këtyre kërkesave, Bashkia Vlorë, me shkresën Nr. 5246 Prot., datë 03.05.2023, protokolluar në ASHSH me Nr. 230/5 Prot., datë 04.05.2023, ka përcjellë plotësimet e kërkuara, duke përfshirë Vendimin Nr. 13, datë 17.03.2021, "Për miratimin e lejes së ndërtimit të infrastrukturës "Rehabilitimi i rrugës Uji i Ftohtë–Orikum dhe ndërtimi i dy By-Passeve", si dhe

planimetrinë e shpronësimit të miratuar, me saktësimet përkatëse në përputhje me gjurmën e projektit të miratuar.
Për sa më sipër, KSHP sqaron se, sikurse është konstatuar edhe në qëndrimin Tuaj, dokumentacioni fillestar i përcjellë nga Bashkia Vlorë, përfshirë planimetrinë e shpronësimit kanë qenë të pasakta jo në përputhje me gjurmën e projektit të miratuar dhe pasi janë konstatuar mospërputhje nga KPSH, me qëllim saktësimin e tyre nëpërmjet korrespondencave të sipërcituara, i ka kërkuar subjektit kërkues rishikimin dhe
saktësimin e planimetrisë së shpronësimit, si dhe përcjelljen e materialeve përfshirë dhe DVG përfundimtare të miratuar.
Në përfundim, KSHP, konfirmon edhe njëherë se, sipërfaqet e prekura nga shpronësimi në planimetrinë e shpronësimit (DWG përfundimtare), janë në përputhje me gjurmën e projektit të miratuar, që korrespondojnë me të njëjtat sipërfaqe të miratuara për shpronësim sipas VKM Nr. 428, datë 19.07.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës ekzistuese Vlorë–Orikum dhe dy by-passeve, në Radhimë,
Vlorë".
Konstatimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit. (Konkluzion: Në faqen 56).
Konkluzion "Është e domosdoshme që praktikat e shpronësimit të unifikohen dhe të mbështeten në vlerësime reale dhe të pavarura të tregut, duke respektuar të drejtën themelore të pronës. Zbatimi selektiv i ligjit dhe vendosja e çmimeve të shpronësimit jo reale, pa konsultim dhe pa reflektim të vlerës reale të pronës, përbën jo vetëm shkelje ligjore, por edhe cënim të rëndë të parimeve themelorë të shtetit të së drejtës. Implementimi i legjislacionit në këtë praktikë shpronësimi duhet të unifikohet me qëllim standardizimin nëpërmjet miratimit të legjislacionit përkatës"
Sqarime dhe argumentim ligjor:
KPSH sikurse Ju ka sqaruar në observacionet e depozituara pranë institucionit Tuaj me shkresën nr. 1137/1 Prot., datë 7.11.2025, kemi sqaruar se në lidhje me këtë konstatim, e kundërshton si së pabazuar në ligj, pasi për këtë praktikë shpronësimi, vlerësimi për shpronësim është bërë në zbatim të pikës 4, të nenit 17, "Vlerësimi i objekteve që shpronësohen", të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 ..., i ndryshuar,.
Sa më sipër, në zbatim të dispozitës ligjore në fjalë si dhe referuar dispozitave të Marrëveshjes së Huasë datë 10.02.2020, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim "Për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri", të miratuar me Ligjin Nr. 44/2020 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropian për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri", vlerësimi i pasurive objekt shpronësimi bazohet në pikën 5.1, Skeduli 3 "Plani i veprimit mjedisor dhe social", Kërkesa e shpronësimit në Shqipëri, sipas BERZH.
Në zbatim të këtyre dispozitave është përgatitur Raporti i Vlerësimit nga "AOL Studio sh.p.k.", të kontraktuar dhe miratuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bazë të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis kësaj të fundit dhe Bashkisë Vlorë, për realizimin e projektit "Rehabilitimi i Rrugës Uji i Ftohtë – Orikum dhe Ndërtimi i dy By pass-eve".
Sa më sipër sqarojmë se, në përllogaritjen dhe vlerësimin e pasurive objekt shpronësimi për këtë projekt nuk ka një zbatim selektiv të ligjit dhe vendosjes së çmimeve, pasi vlerësimi për këtë rast është bërë në përputhje me pikën 4, të Nenit 17, "Vlerësimi i objekteve që shpronësohen", të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se, "Masa e shpërblimit për pasuritë, pronë private, që shpronësohen për interes publik, për realizimin e projekteve dhe të investimeve në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, llogaritet në përputhje me parashikimet e marrëveshjes, në rastet kur atje përcaktohet edhe mënyra e përllogaritjes së masës së shpërblimit".
Në këtë rast rezulton e miratuar Marrëveshja e Huasë datë 10.02.2020, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim "Për financimin e

konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri", të miratuar me Ligjin Nr. 44/2020 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës EvropianE për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri", ku vlerësimi i pasurive objekt shpronësimi është përcaktuar në pikën 5.1, Skeduli 3 "Plani i veprimit mjedisor dhe social", Kërkesa e shpronësimit në Shqipëri, sipas BERZH.
Konstatimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit (Konkluzion faqe 57).
Konkluzion. Nga shqyrtimi i dosjes së procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rikonstruksion i rrugës ekzistuese Vlorë-Orikum dhe By-pass-eve në Radhimë Vlorë", rezultoi se nuk ishin të depozituar dokumentacioni mëposhtëm, me gjithë kërkesën e bërë nga ASHSH për plotësim konkretisht: {1. Mungon projekti i miratuar nga organet kompetente të firmosura dhe vulosura nga projektuesi; 2. Për të gjitha pasuritë pa informacion të merret informacion nga ASHK Vlorë (kartelë pasurie +HTR); 3. Mungojnë kartelat e pasurive HTR me nr. 433, 149/31, 211/2, 160/2, 204/2, 1/101, 1/102, 5/1, 211/8 në ZK 3140, në pronësi shtet dhe ND mungon kartela e pasurisë nr. 415/2, në ZK 3140, në pronësi të z. Ader Azem Selmanaj; 4. Kartelat e pasurive janë fotokopje dhe të panjësuara nga ASHK Vlorë. Kartelat e pasurive BYPASS mungojnë; 5. Mungojnë adresat dhe vendbanimi i fundit të pronarëve dhe personave të tretë përkatës; 6. Planimetria e shpronësimit, listat e shpronësimit duhet të jetë edhe në formë digjitale, në format AutoCAD (dwg) dhe Excel në dy CD (gjë e cila mungon në dosjen e kësaj praktike)};
Në këto kushte ASHSH nuk duhet të vijonte me procedurën pa plotësimin e akteve të dokumentacionit ligjor të kërkuar, veprim në kundërshtim me nenet 11 dhe 12, të ligjit Nr. 8561/1999 dhe pikës 1, të VKM nr. 127, datë 23.03.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi. Nisur nga ky fakt (mungesa e dokumentacionit), referuar të dhënave të financës vlera e këtij projekti nuk është rimbursuar e gjitha tek personat e prekur, ku nga vlera e përllogaritur për shpronësim prej 202,682,342 lekë deri në datën e këtij akti është mundësuar likuidimi i vlerës 43,041,458 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 159,660,833 lekë ose 78.7 % e vlerës së miratuar, kjo me argumentin se nga personat e prekur nuk është paraqitur dokumentacioni i saktë ligjor për likuidim.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa observoi, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si mësipërm), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, përsa i përket sipërfaqeve që preken nga shpronësimet bazohen në verifikimin e të dhënave duke ju referuar projektit përfundimtar të dokumentuar në dosje (i firmosur /vulosur), në të cilin përcaktohen të dhënat e specifikuara të secilës sipërfaqe, duke përcaktuar numrin e pasurisë, pronësinë dhe sipërfaqen që preket për shpronësim me kontur të saktë. Nga verifikimi i materialit në dwg të vënë në dispozicion gjatë auditimit u evidentua që të reflektimi i pasurive në praneevendosje nuk përkonin me sipërfaqen e pasqyruar në kartelën e pasurisë dhe me konturin e pronës të verifikuar nga harta treguese e pasurisë. Mos reflektimi i saktë i kufirit të secilës pasuri, ndikon në cenimin e pasurive kufizuese dhe në rritjen e sipërfaqeve për shpronësim. Më poshtë po ju paraqesim disa raste në të cilat janë evidentuar mospërputhjet dhe që vërtetojnë që projekti i miratuar është ai në të cilin gjenden të detajuara të gjitha sipërfaqet që preken nga shpronësimi, pasi kufijtë e pasurisë janë paraqitur duke u bazuar në dokumentacionin e pronësisë.
Pasuria me nr. 384/4/1 në ZK 3140, në bazë të kartelës së pasurisë dhe hartës treguese ka një sipërfaqe totale prej 3470 m^2.
Nga verifikimi i projektit të vendosur në dispozicion në DWG, pasuria nr. 384/4/1 në ZK 3140 ka një sipërfaqe totale prej 5446 m^2. Ndryshimi i konturit/ kufirit të pasurisë dhe rritja e sipërfaqes së pronësisë ndikon në rritjen e sipërfaqes për shpronësim dhe ndikon në cenimin e dy pasurive të tjera kufizuese me nr. 384/4/2 dhe pasuria me nr. 384/1/2, e cila është pasuri shtet. Këto sipërfaqe në projektin përfundimtar të dorëzuar janë paraqitur saktë.
Sipërfaqja që preket sipas përcaktimit në projekt është 717 m^2, ndërsa në listën e miratuar për shpronësim është 1392 m^2, duke shpronësuar më shumë sesa projekti sipërfaqen prej 675 m2.

Pasuria me nr. 390/2/1 në ZK 3140, në bazë të kartelës së pasurisë dhe hartës treguese ka një sipërfaqe totale prej 3140 m^2.
Nga verifikimi i projektit të vendosur në dispozicion në DWG, pasuria nr. 390/2/1 në ZK 3140 ka një sipërfaqe totale prej 3545 m^2. Ndryshimi i konturit të pasurisë dhe rritja e sipërfaqes së pronësisë ndikon në rritjen e sipërfaqes për shpronësim dhe ndikon në cenimin e pasurive të tjera kufizuese, të cilat janë pasuri shtet, ndër to edhe pasuria me nr. 390/2/2. Këto sipërfaqe në projektin përfundimtar të dorëzuar janë paraqitur saktë.
Në pasurinë me nr. 145 në ZK 3140, sipërfaqja që preket sipas përcaktimit në projektin e miratuar të dokumentuar në dosje është 1128 m2 (të pasqyruar me poshtë), ndërsa sipas listës së miratuar janë shpronësuar 1455 m2, duke shpronësuar më shumë sipërfaqen 327 m2. Gjithashtu nëse verifikojmë projektin e vënë në dispozicion në dwg evidentohet që në sipërfaqen prej 1455 m2 preken dy pasuri, pasuria nr. 145 në ZK 3140 dhe pasuria nr. 145/1 në ZK 3140. Konturi i sipërfaqes evidentohet edhe në hartën e pasurisë të paraqitur si më poshtë, në të cilin evidentohen mospërputhje. Konturi i sipërfaqes evidentohet edhe në hartën e pasurisë të paraqitur si më poshtë, në të cilin evidentohen mospërputhje me konturin e hartës treguese .
Pasuria me nr. 419/11 në ZK 3140, në bazë të kartelës së pasurisë dhe hartës treguese ka një sipërfaqe totale prej 365 m^2, ndërsa në bazë të projektit në DWG është 408 m^2. Sipas të dhënave të sakta në projekt duhet të ishte shpronësuar 90.2 m^2, por me ndryshimin e sipërfaqes së pasurisë është janë shpronësuar 161 m^2.
Nga verifikimi i projektit në DWG dhe shqyrtimi me projektin përfundimtar të miratuar, konstatohet që ka mospërputhje në pasqyrimin e sipërfaqeve të pasurisë që preken nga shpronësimi. Rritja dhe ndryshimi i konturit të pronësisë, ndikon edhe në rritjen e sipërfaqes që shpronësohet, në mospërputhje me dokumentacionin e pronësisë, kartelën dhe hartën treguese. Më sipër janë pasqyruar vetëm disa prej rasteve për të paraqitur ndryshimet nga projekti i dokumentuar në dosje. Duke qenë që nga KPSH u konstatuan mospërputhje në pasqyrimin e hartave kadastrale në projektin paraprak, në projektin që ju paraqisni në DWG si të rishikuar, janë ndryshuar sipërfaqet e pasurive (rritja e sipërfaqeve), referuar dokumentacioni të pronësisë dhe këto ndryshime janë miratuar edhe nga KPSH në fazat e mëtejshme.
Në përbërjen e KPSH të përbërë nga 5 anëtarë, pjesë e tyre janë specialistë të fushës së arkitekturës dhe inxhinierisë, në bazë të nenit 12 dhe nenit 13, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe në bazë të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH", në të cilin përcaktohet që komisioni bën verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues përpara pranimit të kërkesës për shpronësim, kjo mospërputhshmëri në rishikimin e projektit dhe ndryshimi i sipërfaqeve të pasurive duhet të ishte konstatuar nga komisioni". **Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.**

Gjithashtu konstatohet se:
- Akt-marrëveshja e lidhur nuk ka bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim, në kundërshtim me nenin 13 pika 4 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik", i ndryshuar;
- Në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH për likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar. Vetë ASHSH nuk ka dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, në të cilat ato nuk janë përcaktuar si përgjegjëse për likuidim, në kundërshtim me Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik", i ndryshuar, neni 23, ku thuhet se: *"Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar brenda afatit në shkronjën "c" të nenit 21 të këtij ligji dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës".*
Neni 1 i Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm", i ndryshuar, përcakton se objekti i këtij ligji është jo vetëm rregullimi i së drejtës së shtetit për të

shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, por edhe mbrojtja e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës.
Pika 3 e nenit 26 përcakton se, shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji nuk është kryer pagesa ose vënia në dispozicion të masës së shpërblimit, sipas këtij ligji, për llogari të pronarëve të shpronësuar, si dhe të pronarëve e personave të tretë të dëmtuar për shkak të shpronësimit" , si dhe neni 6, pika 3, shkronja (ç) e cila parashikon se: *" ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"*
Bazuar në këtë nen dhe faktit që dosja nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me shpërblimin e dhënë, grupi i auditimit e ka të pamundur të dalë në përfundimin nëse shpërblimi është dhënë në masën dhe afatet e përcaktuara ligjore;
- Në dosjen e shpronësimit, u konstatua se nga SHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjellë ASHK mbi VKM e shpronësimit, në kundërshtim me pikën 6 e nenit 3 të akt-marrëveshjes së lidhur, në zbatim të nenit 11 pika 5/c të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik", i ndryshuar, e cila ka çuar në moszbatim të nenit 25 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik", i ndryshuar, ku përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHSH brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit.
Sipas akt-marrëveshjes, në pinë 6 të nenit 3- *Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH,* thuhet se: *ASHSH, Brenda 30 ditëve nga data e miratimit me VKM, të shpronësimit, për interes publik, të pronarëve të pasurisë pronë private, që preken nga realizimi I projektit, do të kryejë veprimet përkatëse ligjore, për kalimin e pronës nga pronarët në favor të Bashkisë Vlorë";*
- Kartelat personale të pasurisë së individëve që preken nga shpronësimi ka një afat mbi 3 muaj nga data e kërkesës së ASHSH, dhe se janë të pashoqëruara me harta treguese të regjistrit (HRT).
Praktika është punuar nga: ***zj. Egla Ibrahimi,*** në cilësinë e Kryetarit të KSHP, me detyrë ish- Drejtor i ASHSH, ***z. Albian Marku,*** me profesion arkitekt, ***z. Besnik Hysaj,*** me profesion inxhinier, ***z. Ilirjan Hysaj,*** me profesion jurist.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*) "Mbi Projekt Raportin e Auditimit", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *KPSH sikurse Ju ka sqaruar në observacionet e depozituara pranë institucionit Tuaj me shkresën nr. 1137/1 Prot., datë 7.11.2025, në lidhje me këtë procedurë ASHSH, nëpërmjet korrespondencave të vazhdueshme me subjektin kërkues, Bashkinë Vlorë ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të munguar, në zbatim të neneve 10 dhe 12 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, ..., i ndryshuar. Kjo përmes shkresave Nr. 735/2 Prot., datë 26.10.2022 dhe Nr. 230/4 Prot., datë 14.04.2023... Në vijim të këtyre kërkesave, Bashkia Vlorë, përmes shkresës Nr. 1280 Prot., datë 01.02.2023, prot ASHSH me nr. 230, datë 08.02.2023, si dhe shkresës nr. 5246 Prot., datë 03.05.2023, prot ASHSH me nr. 230/5, datë 04.05.2023, ka përcjellë plotësimet e kërkuara të dokumentacionit, si më poshtë: - Planimetria e shpronësimit (kopje bashkëlidhur); - Projekti i miratuar (Vendimi Nr. 13, datë 17.03.2021 i Këshillit Kombëtar të Territorit); - Kartelat e pasurive të njehsuara dhe të nënshkruara nga ASHK, të konfirmuara nga Drejtoria Vendore e ASHK Vlorë (kopje bashkëlidhur); - Adresat e pronarëve – lidhur me të cilat Bashkia Vlorë, nëpërmjet shkresës Nr. 1280 Prot., datë 01.02.2023, ka deklaruar se identifikimi dhe njoftimi i pronarëve do të realizohet përmes NjA Orikum, në momentin e njoftimit të kërkesës për shpronësim; - Planimetria në format dŵg (bashkëlidhur CD).*
Për sa më sipër, sqarojmë se, vetëm pas depozitimit të dokumentacionit të munguar është vijuar nga KPSH procedurat e mëtejshme të shpronësimit për interes publik, konkretisht, pranimi i kërkesës për shpronësim, me shkresën Nr. 230/7 Prot., datë 04.05.2023, e cila daton pas depozitimit të dokumentacionit të kërkuar ligjor, të përcjellë me shkresat e sipërcituara (një kopje të të cilave ju është dërguar bashkëlidhur observacionit Nr. nr. 1137/1 Prot., datë 7.11.2025).
Gjithashtu, Komisioni sqaron se, në listën e miratuar për shpronësim, janë pasqyruar vetëm ato pasuri pronë private, për të cilat është konfirmuar dokumentacion pronësie nga institucioni kompetent ASHK, dhe pasi janë përmbushur kërkesat ligjore në zbatim të Nenit 10, të Ligjit nr.

8561, datë 22.12.1999 ...i ndryshuar, me qëllim garantimin e transparencës, barazisë së shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa është observuar, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si më sipër), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Në lidhje me vijimin e procedurës dhe kur dokumentacioni nuk është i plotë dhe në lidhje me kartelat e pasurve, argumentet nuk qëndrojnë dhe gjejnë pasqyrim në këtë PRA. Nga ana jonë siç është shprehur dhe në material, është theksuar se megjithëse nga ana juaj janë bërë kërkesa për plotësim, por nga ju është vijuar procesi pa u bërë plotësimi i tyre. Po jashtë dhe në lidhje me mos konfirmimin e statusit juridik, ku ju thoni se janë hequr nga VKM dhe me konfirmim e tyre do kërkohet shtesë VKM, nuk qëndron, pasi sipas VKM ato janë miratuar. Nga ana juaj nuk ka dokumentacion që e mbështet këtë fakt".

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën nr. 1134/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH, ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve.*
Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Argumenti juaj **nuk qëndron**, pasi nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë element i ri, nga ato të paraqitura në fazën e akteve, për të cilat grupi i auditimit si në pjesën narrative (si më sipër), po ashtu dhe në kundërpërgjigje të observacionit tuaja në fazën e akteve është shprehur se: "*Dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivin tuaj. Aktmarrëveshja është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për palët. Ligji kërkon në mënyrë të shprehur qartë domosdoshmërinë e bashkëlidhjes së dokumentacionit që ka shoqëruar kërkesën për shpronësim*".

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *Sqarojmë për KLSH se, referuar listëpagesës për shpronësimet bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 7, datë 7.5.2007 "Për përdorimin e fondit të shpronësimeve", të ndryshuar, ku specifikohet se: "për ndjekjen e procedurave të likuidimit ngarkohen personat e autorizuar për likuidim". Në rastin konkret grupi i punës së likuidimit (i cili është i ndryshëm nga komisioni i posaçëm i shpronësimit) ngrihet me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe procedurat përkatëse të likuidimit ndiqen nga ky grup i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është i njëjti grup me të njëjtët anëtarë gjatë gjithë vitit dhe ndjek dhe realizon procedurat përkatëse referuar vitit përkatës. Gjithashtu sqarojmë për KLSH se nuk është përcaktuar asnjë bazë ligjore që hapat e ndjekur për likuidimin të jenë pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit.*

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa kundërshtohet nga subjekti sqarimet qërojnë dhe **merren në konsideratë**, duke mos gjetur pasqyrim në këtë fazë të RPA.

Pretendim i subjektit (i përmbledhur): *KPSH e kundërshton duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit, pasi ky komision është "ad hoc" dhe tagrat e tij përfundojnë me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv.*

Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022.
Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa observoi, nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazën e akteve për të cilën grupi i auditimit si në pjesën narrative (si mësipërm), po ashtu dhe kur janë dhënë shpjegimet mbi observacionin e akteve, duke sqaruar se: "Referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve. Sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara, dhe se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja. Argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.

VI- Mbi zbatimin e procedurës për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: **"Studim projektim i mbikalimit të Fllakës".**

Në bazë të urdhrit nr.126, datë 10.09.2021, me shkresën nr. 416/1 prot., datë 10.09.2021, u krijua komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit (KSHP) për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor *"Studim projektim i mbikalimit të Fllakës"*, i përbërë nga Kryetari i komisionit *Erlis Hereni* me pozicion Drejtor i Përgjithshëm dhe anëtarët *Martin Beqiraj* me profesion ekonomist, *Ermal Bala* me profesion inxhinier, *Klodiana Elezi* me profesion jurist, *Albian Marku* me profesion arkitekt.
Në kërkesën e Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) për shpronësim të pasurive pronë private që preken nga projekti për segmentin rrugor *"Studim projektim mbikalimi i Fllakës"*, drejtuar ASHSH-së me nr. 7989 prot., datë 07.09.2021, në dokumentacionin e paraqitur për shpronësim, **kartelat e pasurisë nuk janë të përditësuara në 3 muajt e fundit dhe mungojnë hartat treguese për secilën pasuri**.
Mbi zbatimin e procedurës për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë:" *"Studim projektim i mbikalimit të Fllakës"*, me shkresën nr. 274/2 prot, datë 27.2.2026 (*prot KLSH nr. 277/30, dt. 2.3.2026*), është observuar nga Z.Albian Marku me pozicion anëtar i KPSH dhe Znj. Klodiana Elezi (përfaqësuese e MIE) , si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:
Në lidhje me dokumentacionin e pronësisë, përfaqësuesi i komisionit të ASHSH-së shprehet:
Komisioni e kundërshton këtë konstatim si të pabazuar në dokumentacionin e disponuar në dosjen për shpronësim, pasi nga verifikimi i dokumentacionit pronësor që disponohet rezulton se, sipas shkresës N. 5845 Prot., datë 18.05.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 165/8 Prot., datë 18.05.2022, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, është dërguar dokumntacioni kadastral lidhur me pasuritë dhe HTR e pasurive objekt shpronësimi, të konfirmuara nga ASHK Durrës, sipas shkresës datë 09.05.2022.
Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, përveç listës së ASHK-së për të gjitha pasuritë që marrin pjesë në shpronësim, nevojitet të dokumentohet bashkëngjitur edhe dokumentacioni i plotë i përditësuar

i të gjitha pasurive për të vërtetuar gjendjen e statusit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e vendosur në dispozicion u konstatua që kartelat e pasurisë nuk janë të përditësuara në 3 muajt e fundit dhe mungojnë hartat treguese për secilën pasuri. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Në shqyrtimin e dokumentacionit të pasqyruar për shpronësim nga ARRSH, u konstatua që për pasurinë e llojit "truall + ndërtesë", me nr.14/59, në ZK.3852, në Durrës, në pronësi të shoqërisë "IMPULS" sh.a **nuk paraqitet kartela e përditësuar e pasurisë.**

Pretendimet e subjektit:
Në lidhje me dokumentacionin e pronësisë, përfaqësuesi i komisionit të ASHSH-së shprehet:

Komisioni e kundërshton këtë konstatim si të pabazuar në dokumentacionin e disponuar në dosjen për shpronësim, pasi nga verifikimi i dokumentacionit pronësor që disponohet rezulton se, sipas shkresës N. 5845 Prot., datë 18.05.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 165/8 Prot., datë 18.05.2022, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, është dërguar dokumentacioni kadastral lidhur me pasurinë nr. 14/59, ZK. 3852, të konfirmuar nga ASHK Durrës, sipas shkresës datë 09.05.2022, brenda afatit ligjor 3 mujor nga data e paraqitjes së kërkesës për shpronësim, me datë lëshimi 16.6.2021.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e vendosur në dispozicion u konstatua që kartela e pasurisë nuk është e përditësuara në 3 muajt e fundit. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Nga verifikimi i projektit të infrastrukturës, u konstatua se gjurma e rrugës sipas projektit të miratuar



nuk



prek asnjë nga objektet e pasurisë 14/59, por prek vetëm një pjesë të sipërfaqes së truallit. Më poshtë pasqyrohen fragment nga foto ajrore e gjendjes së pasurisë në gjendjen ekzistuese dhe mbivendosja e gjurmës së rrugës sipas projektit të miratuar.

Pretendimet e subjektit:
Në lidhje me konstatimin se gjurma e rrugës nuk prek asnjë nga objektet e pasurisë 14/59, përfaqësuesi i komisionit të ASHSH-së shprehet:

ARRSH me Vendim të Këshillit Teknik Nr. 56., dt. 6.12.2019 ka miratuar projektin "Studim Projektim Mbikalim i Fllakës", në të cilin planimetritë e shpronësimit për pasuritë që janë pjesë e kësaj procedure.

Me shkresën Nr. 165., dt.31.01.2022 ASHSH i ka kërkuar ARRSH plotësim dokumentacioni ku ndër pikat më kryesore është të bëhet argumentimi juridik mbi arsyen e përfshirjes së këtyre veprave inxhinierike, për sa kohë ato nuk preken nga vija e shpronësimit si dhe bazën ligjore lidhur më mënyrën e llogaritur së vlerës së tyre. Për sa më sipërcituar ARRSH riverifikoi dhe njëherë dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës për plotësime, depozituar me shkresën Nr. 11164 Prot., dt. 06.12.2019 ku sqaron se, *"Referuar projekt zbatimit "Studim Projektim Mbikalim i Fllakës" miratuar me VKT Nr. 56 dt. 6.12.2019. Në planimetrinë e Shpronësimit të miratuar të paraqitur në orthofoto si dhe hedhur mbi hartën kadastrale paraqiten qartë objektet që do të shpronësohen, pjesë e këtij projekti është planimetria e shpronësimit dhe tabela e përcaktimit të pronësive sipas pikës 4 të Vendimit të Këshillit Teknik të sipërcituar.* Në planimetrinë e shpronësimit pasqyrohen pasuritë pronë private që duhet të prishen nga realizimi i këtij projekti, midis tyre ndodhet dhe pasuria **nr. 14/59, zk. 2547 e llojit njësi ekonomike** (biznes me veprimtari karburant) pasuri kjo e përfituar me leje ndërtimi të miratuar nga KKRRT me Nr 4., dt 28.01.2002 të Rrethit Durrës.

atua prek *pasi dëg.*

Gjithashtu ARRSH sqaron se objektet që nuk preken nga vija e shpronësimit janë pjesë e veprës në funksion të njësisë ekonomike *Karburant*, detyrimisht kjo pasuri trajtohet si një objekt i vetëm.

mbi të cilat mund të bëhen verifikimet e sipërfaqes). Kjo evidentohet edhe në mbivendosjen e projektit mbi foton ajrore dhe në gjendjen aktuale pas realizimit të projektit. E vetmja ndërhyrje që është realizuar është vetëm heqja e strehës së pikës së karburantit, por duke u ruajtur pika e daljes së karburantit dhe është prekur një pjesë e vogël e sipërfaqes së truallit të pasurisë 14/59, zk.2547, përkatësisht një pjesë e sistemimit të jashtëm me gjelbërim që ndan rrugën me pjesën e biznesit. Sipërfaqja që prek projekti nuk ndikon në mos funksionimin e njësisë ekonomike dhe nuk prek as daljen e pikës së karburantit dhe as objektet. Gjithashtu aksesi për në njësinë ekonimike të karburantit nuk kufizohet. Kjo evidentohet qartë edhe nga verifikimi i gjendjes aktuale pas realizimit të projektit. **Ndonëse i gjithë trualli dhe objektet e pasurisë 14/59 janë shpronësuar**, asnjë nga objektet nuk është prishur duke ruajtur gjendjen ekzistuese dhe është prekur vetëm një pjesë e vogël e sipërfaqes së truallit.



Në bazë të nenit 12 dhe nenit 13, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", i ndryshuar, si dhe në bazë të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "*Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH*", përcaktohet që komisioni bën verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues mbështetur në kërkesat dhe dokumentacioni shoqërues, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuar në ligj, përpara pranimit të kërkesës për shpronësim, Në përbërjen e KPSH të përbërë nga 5 anëtarë, pjesë e tyre janë specialistë të fushës së arkitekturës dhe inxhinierisë, kjo mospërputhshmëri duhet të ishte konstatuar nga komisioni dhe nuk paraqiten argumente e fakte që kundërshtojnë problematikat e ngritura nga grupi i auditimit. Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.

Në vlerësimin e ASHSH është përllogaritur shpronësimi i sipërfaqes së truallit prej 814 m^2 dhe sipërfaqen e "ndërtesave jo banim" prej 150.75 m^2, kjo në zbatim të VKM-së 89, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*", ndërsa për objektet "*ndertës jo banim*" është llogaritur në bazë të VKM-së 138, datë 23.02.2000 "*Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik*", sipas vlerës së situacionit të objektit.

Në situacionin përfundimtar të rishikuar që është pjesë e dosjes, janë parashikuar punime për sistemimin e sheshit të karburantit, **ndërkohë që e njëjta sipërfaqe e truallit është llogaritur të shpronësohet edhe si truall, duke e shpronësuar dy herë të njëjtën sipërfaqe.**

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me vlerësimin e truallit, përfaqësuesi i komisionit të ASHSH-së shprehet:

Në lidhje me këtë konstatim sqarojmë se, trualli është vlerësuar sipas çmimit të përcaktuar sipas VKM Nr. 89, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, vetëm një herë, ndërsa sistemimi i sheshit të karburantit është vlerësuar me preventiv punimesh në zbatim të pikës 3, të VKM Nr. 138., datë 23.03.2000, *"Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik"*, i ndryshuar, bazuar në zerat e punimeve të konstatuara në terren nga inxhinierët e ARRSH, sipas lejes të ndërtimit, të pasurisë që preket nga shpronësimi, praktikë kjo e ndjekur për vlerësim në të gjitha segmentet rrugore ku ka pasur për shpronësim pika karburanti.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se në situacionin përfundimtar të rishikuar janë parashikuar punime për sistemimin e sheshit të karburantit, ndërkohë që e njëjta sipërfaqe e truallit është llogaritur të shpronësohet edhe si truall. Duke qenë që sipërfaqja është vlerësuar si truall me vlerën sipas çmimit referuar VKM-së nr.89, datë 03.02.2016, e njëjta sipërfaqe nuk vlerësohet edhe në bazë të preventivit të punimeve sipas VKM-së nr.138, datë 23.03.2000. **Përsa më sipër, pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë.**

Gjithashtu, në situacion përshkruhen zërat e punimeve për dy objekte që gjenden në pasurinë 14/59, me funksion zyra në shërbim të pikës së karburantit, magazina si dhe zërat për depozitat, distributorët, **objekte të cilat nuk preken nga infrastruktura e re.** Në bazë të situacionit të paraqitur, vlera e shpronësimit për objektet "ndertës jo banim" është llogaritur 20,558,786 lekë. Vlera e shpronësimit e përcaktuar është 20,558,786 lekë për objektet "jo banim" + 446,886 lekë për sipërfaqen e truallit = **21,005,672 lekë në total**. ASHSH, përkatësisht KPSH i ngritur në bazë të urdhrit nr. 126, datë 10.09.2021, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për interes publik, **duhet të kishte vlerësuar për të shpronësuar vetëm pasurinë e llojit "truall", pasi vetëm sipërfaqja e truallit preket nga projekti i miratuar në pasurinë nr.14/59 dhe jo sipërfaqja e objekteve dhe sipërfaqja e sheshit**.
Vlera totale e shpronësimit prej 21,005,672 lekë është miratuar edhe në Vendimin nr. 8, datë 11.01.2023, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Studim projektim mbikalimi i Fllakës", duke i kaluar në favor të "Alpha Bank" ShPK.

Gjithashtu konstatohet se:
- Zbatimi i vendimit për shpronësimi, vjen në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", ku thuhet se: *"Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar, brenda afatit të treguar në shkronjën (c) te nenit 21 të këtij ligji, dhe në çdo rast jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati ose nga data që kanë marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, sipas pikës 2 të nenit 16 dhe 24 të këtij ligji"*.
- Nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 11, pika 5, shkronja (d) e cila parashikon se: *"ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban"*, kjo si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që

të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen. Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3, të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" e cila parashikon se: "*Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, **duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

- Në relacionin e përpiluar nga ASHSH drejtuar MIE, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve, gjë e cila nuk rezulton të jetë bërë dhe akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues ARRSH dhe ASHSH, ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 20, pika 1, shkronja (a) e cila parashikohet se: "*Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, ASHSH i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*
*Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, **afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve** ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilën citohen dhe dokumentet që kërkohen nga shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 10 të këtij ligji."*
Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se: "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit*".

- Vendimmarrja sipas procesverbalit të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), ku përcaktohet se: "*Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten te plotësuar ne afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur, për mungesë te shkakut ose te kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga ASHSH dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të shpronësimit*".

- Aktmarrëveshja e lidhur nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar)

- Në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH për likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar. Vetë ASHSH nuk ka dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, në të cilat ato nuk janë përcaktuar si përgjegjëse për likuidimin, ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 23, në të cilën parashikohet se "*Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar brenda afatit në shkronjën "c" të nenit 21 të këtij ligji dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës*".
Neni 1 i Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm", i ndryshuar, përcakton se objekti i këtij ligji është jo vetëm rregullimi i së drejtës

së shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, por edhe mbrojtja e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës.
Pika 3 e nenit 26 përcakton se, shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji nuk është kryer pagesa ose vënia në dispozicion të masës së shpërblimit, sipas këtij ligji, për llogari të pronarëve të shpronësuar, si dhe të pronarëve e personave të tretë të dëmtuar për shkak të shpronësimit" , si dhe neni 6, pika 3, shkronja (ç) e cila parashikon se: *" ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"*
Bazuar në këtë nen dhe pasi në dosje nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me shpërblimin e dhënë, grupi i auditimit e ka të pamundur të dalë me një konstatim përfundimtar nëse shpërblimi është dhënë në masën dhe në afatet e duhura ligjore.
- Në dosjen e projektit procesverbalet e mbledhjeve të KPSH, në të gjitha rastet, janë pa numër protokolli, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18 i cili parashikon se: *"Procesverbale te mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshëm.* ***Ato protokollohen.*** *"*
- Vendimmarrja sipas procesverbalit KPSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse,* pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet";
- Nuk është bërë i mundur zbatimi i pikës 10 të VKM nr. 117, datë 26.2.2025, ku thuhet se: *"ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale,* ***sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuar****, sipas këtij vendimi"*, në kundërshtim me 25 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"* (i ndryshuar),, ku thuhet se: *"Në rastet kur pasuria pronë private të shpronësuara duhet të regjistrohet sipas ligjit, ky regjistrim duhet të kruhet nga ministria kompetente brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësim*
- Në dosjen e shpronësimit, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës VKM për shpronësim, në kundërshtim të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur, në zbatim të nenit 11, pika 5/c të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se: *Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.*
Praktika është punuar nga: Kryetari i komisionit ***Erlis Hereni*** me pozicion Drejtor i Përgjithshëm dhe anëtarët ***Martin Beqiraj*** me profesion ekonomist, *Ermal Bala* me profesion inxhinier, ***Klodiana Elezi*** me profesion jurist, ***Albian Marku*** me profesion arkitekt *(Anëtar).*

VII. Mbi zbatimin e procedurës për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë, finalizuar me VKM nr. 867, datë 27.12.2022 "Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 20.12.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor **"Unaza lindore Tiranë, Loti III (Shtesa), i ndryshuar", në vlerën 45,651,432 lekë.**

Në bazë të urdhrit nr. 53, datë 05.04.2022, me nr.384/1 prot., u krijua komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për disa shtesa në vendimin e këshillit të Ministrave nr.769, datë 20.12.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza lindore Tiranë, Loti III (shtesa)", i ndryshuar, i përbërë nga Kryetari i komisionit Erlis Hereni me pozicion Drejtor i Përgjithshëm dhe anëtarët Denada Dosti me profesion jurist, Besnik Hysaj me profesion inxhinier, Albian Marku me profesion arkitekt, Spartak Kodra me profesion ekonomist.

- Autoriteti Rrugorë Shqiptar (*këtu e vijim ARRSH*), me shkresën nr. 4025 prot, datë 28.03.2022 ka paraqitur kërkesë për shpronësim me objekt: *"Unaza lindore Tiranë, loti III (Shtesa)"*, prot në Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve (*këtu e vijim ASHSH*), me nr. 384/3 prot, datë 31.03.2022. Vera e shpronësimit për realizimin e këtij projekti, do përballohet nga ARrSH.

-**ARRSH** me shkresën me nr. 7197 prot., datë 30.06.2022 , përcjell në **ASHSH** me nr. 384/3 prot., datë 04.07.2022 shkresën "Plotësim dokumentacioni "Unaza Lindore Tiranë, Loti II (Shtesa)" për disa shtesa në VKM-në nr. 769 prot., datë 20.12.2017".

Nga komisioni i posaçëm i shpronësimeve (Këtu e në vijim "KPSH") është mbajtur procesverbal nr. 2, datë 23.08.2022 mbi pranimin me kusht të kërkesës për shpronësim "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, loti III (Shtesat)" me vlerë të shpronësimit 45,651,432 lekë.

-**ASHSH** përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, njëkohësisht dhe Kryetar i KPSH, me shkresën nr. 384/2 prot., datë 27.04.2022, i drejtohet ARRSH me lëndën kthim dokumentacioni për plotësim, pasi në dokumentacionin shoqërues të ARRSH u konstatuan mangësitë, dhe konkretisht:

- Mungon dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare për realizimin e projektit.
- Mungojnë konfirmimet nga ASHK për statusin juridik të pasurive që shpronësohen, të shoqëruara me kartelë dhe HTR të rifreskuara 3(tre) muajt e fundit
- Mungojnë adresat dhe vendbanimet e fundit të pronarëve të pasurive që preken nga shpronësimi, në relacion shpjegoni se adresat janë marrë referuar dokumentacionit të pronësisë, ndërkohë që këtë informacion lidhur me vendbanimin duhet marrë pranë institucionit kompetent (Njësitë e pushtetit vendor).
- Kartelat e pasurisë nr. 155/50 dhe nr. 3/269 është e printuar nga sistemi i ASHK, e pa nënshkruar dhe pa vulën e këtij institucioni. Gjithashtu HTR e kësaj pasurie është fotokopje dhe e lëshuar në datë 29.12.2020.
  Të arsyetohet pse nuk është trajtuar më parë kjo pasuri në VKM nr. 769, datë 20.12.2017.
- Projekti është nënshkruar nga shoqëria projektuese e projektimit por jo nga strukturat përkatëse të ARRSH.
- Në kapakun e projektit duhet të shënohet: "Projekt i miratuar me V.K.T Nr. 50, datë 27.07.2018", si dhe të jetë e firmosur dhe vulosur nga titullari i institucionit.

- Mungon vlera e tokës sipas çmimeve të VKM nr. 89, datë 03.02.2016. në rastet kur mungojnë çmimet e miratuara për zonat kadastrale përkatëse, vlerësimi për tokën sipas llojit, përcaktohet si mesatare e shitblerjeve për njësi (m^2) që ka ASHK të 3(tre) muajve të fundit për zonën kadastrale ku ndodhet pasuria objekt i shpronësimit për zërin kadastral përkatës. Në rastet kur mungojnë treguesit e shitblerjeve, të deklaruara me shkrim nga ASHK, subjektet e interesuara për shpronësim kërkojnë pranë strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, vlerësimin teknik dhe përllogaritjet e shpërblimit të pronës private, që kërkohet të shpronësohet, përcaktuar në pikën "1", të VKM nr. 622, datë 18.12.2002.
- Materialet si Planimetria e Shpronësimit dhe lista e shpronësimit të sillen në format digjitale Autocad dhe Exel.
- Bëjmë me dije se, dokumentacionin që ju citoni se do e sillni gjatë fazës së publikimit nuk mund të pranohet nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit. I gjithë dokumentacioni duhet të vijë i plotë bashkëlidhur kërkesës për shpronësim.

-**ARRSH** në vijim të shkresës me nr. 384/4 prot., datë 24.08.2022, përcjell në ASHSH me nr. 8438/1 prot., datë 09.09.2022 shkresën "Plotësim dokumentacioni "Unaza Lindore Tiranë, Loti II (Shtesa)" duke vendosur në dispozicion dokumentacionin hipotekor të rifreskuar për pasuritë nr. 7/634 zk 8180 së bashku me kartelën dhe hartën për pasurinë.
-Në vijim **ASHSH** me shkresën me nr. 384/4 prot., datë 24.08.2022, i drejtohet ARRSH me njoftim ***për pranimin me kusht*** të kërkesës për shpronësim me interes publik, ku: pasuritë me nr. 7/634, ZK. 8180 me pronar Sadik Murat Luga,[pronësia truall 1,340 m^2 x 31,270 lekë = 41,901,800 lekë] dhe nr. 155/50, ZK 3976 me bashkëpronarët Alla, Qosja, Miccolis, Qosja ,[pronësia arë 334 m^2 x 448 lekë = 149,632 lekë] do të publikohen me shënimin përkatës "plotësim dokumentacioni", për të cilat nga ana e ARRSH brenda afatit të paraqitjes së pretendimeve nga pronarët, të përcaktuar në pikën 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, duhet të sillet konfirmimi përkatës sipas aplikimit të bërë nga ana Juaj me nr. 53637, datë 29.06.2022. Pasuria me pronarët Donald Bexhet Gega dhe Adriana Bexhet Gega me nr. 8/523, ZK. 8170 ,[pronësia ndërtesë 40 m^2 x 90,000 lekë = 3,600,000 lekë].
- **Akt-marrëveshja** ndërmjet ASHSH dhe ARRSH është lidhur me nr. 384/5, datë 24.08.2022 nga ASHSH me përfaqësues Znj. Egra Ibrahimi dhe nr. 8436, datë 26.06.2022 nga ARRSH me përfaqësues Z. Evis Berberi.
- **ASHSH** me shkresën nr. 384/6 prot, datë **02.09.2022** ka bërë publikimi i kërkesës për shpronësim pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, kjo në referencë të pikës 1, të nenin 15 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik"*, në zbatim të shkresë nr. 4025 prot., datë 28.03.2022 të ARRSH, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 45,651,432 lekë.
- Me shkresën nr. 384/7, datë 09.09.2022, nga ASHSH është bërë njoftimi i drejtpërdrejtë i pronarëve të pasurisë, pronë private që shpronësohet;
-**ARRSH** në vijim të shkresës me nr. 384/4 prot., datë 24.08.2022, përcjell në ASHSH me nr. 8438/1 prot., datë 09.09.2022 shkresën "Plotësim dokumentacioni "Unaza Lindore Tiranë, Loti II (Shtesa)" duke vendosur në dispozicion dokumentacionin hipotekor të rifreskuar për pasuritë nr. 7/634 zk 8180 së bashku me kartelën dhe hartën për pasurinë.
- Publikimi në Fletoren Zyrtare është bërë me datë 09.09.2022 me numër 121.
-Pronarët **Vjollca Alla dhe Myzejen Miccolis** ka në bërë ankesë pranë ASHSH me nr. 384/9 prot., datë **19.09.2022**, me objekt tek përcaktimi i statusit të tokës së kompensuar sipas VKM-së të kundërshtuar gjyqësish dhe nga shtetas të tjerë. Veç sa më sipër KKT (KKT) me vendimin nr. 1, datë 14.04.2017 ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, ku sipas tij toka nga bujqësore është kthyer në tokë truall. Bazuar në vendimin nr. 3, datë 18.12.2004, KRRT të RSH, ka miratuar vijën kufizuese të qytetit të Tiranës dhe, se pasuria nr. 155/50 zk 3976 me adresë Shkozë me sipërfaqe 1,180 m2, ndodhet brenda zonës së miratuar. Në kuptim të nenit 1, të Ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve", theksohet se: "*...Truall,*

quhet e gjithë toka që ndodhet brenda vijave kufizuese të qyteteve (Bashkive) pavarësisht nëse përdoret për ndërtim, kosht, arë, etj. Si dhe toka jashtë vijave kufizuese që në momentin e trajtimit është përdorur ose do të përdoret për ndërtim...". Sa më sipër, pasuria ime, duhet të llogaritet bazuar në VKM nr. 86, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", çmimi për m2 i truallit në zonën kadastrale nr. 8170, në të cilën ndodhet pasuria e paluajtshme parashikuar për shpronësim, është **334 m² x 32,878 lekë/m² = 10,981,252 lekë**.

-**KPSH**, pranë ASHSH, ka mbajtur procesverbal me nr. 3, datë **27.09.2022** mbi trajtimin e ankesës së **Vjollca Alla dhe Myzejen Miccolis**, lidhur me kërkesë për shpronësim "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 769, datë 20.12.2017, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Loti III (Shtesa)"" ku ndër të tjera theksohet se: ARRSH, në cilësinë subjektit kërkues të shpronësimit, me anë të shkresës nr. 4025 prot., datë **28.03.2022**, me lëndë "Kërkesë për shpronësim", protokolluar në ASHSH me nr. 384 prot., datë **31.03.2022**, ka paraqitur kërkesë për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga realizimi i projektit "Unaza Lindore Tiranë, Loti III", për disa shtesa në VKM-në nr. **769**, datë **20.12.2017**. ARRSH bashkëlidhur kërkesë për shpronësim ka vënë në dispozicion listën e pronarëve që shpronësohen, si dhe kartelat e pasurive të cilat duhet të jenë të rifreskuara të 3(tre) muajve të fundit që nga momenti i depozitimit të kërkesës së shpronësimet. Në kartelën e pasurisë me datë 24.03.2022 nga ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 vënë në dispozicion ARRSH, bashkëlidhur kërkesës për shpronësim, është parashikuar qartazi në seksionin A "Të dhënat e pasurisë" se, lloji i pasurisë është "**Arë**". ...Vlerësimi i pasurisë së bashkëpronarëve Alla, Qosja, Miccolis është llogaritur në bazë të vlerësimit për tokën "arë", pasi si e tillë rezulton e regjistruar në ASHK-në përkatëse.

-**ASHSH** me nr. 384/10 prot., datë **30.09.2022**, i kthen përgjigje ankuesve Vjollca Alla dhe Myzejen Miccolis, duke sqaruar ndër të tjera se: Vlerësimi i pasurisë së bashkëpronarëve të sipërcituar, është llogaritur në bazë të vlerësimit për tokën "**arë**", pasi si e tillë rezulton e regjistruar në ASHK-në përkatëse.

-**ARRSH** me shkresën nr. 9014/1 prot., datë 30.09.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 384/11 prot., datë **03.10.2022**) i kthen përgjigje Znj. Vjollca Alla dhe për dijeni ASHSH, duke sqaruar ndër të tjera se: bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik", i ndryshuar si dhe akteve nënligjore, për pasurinë nr. 155/5, zk. 3976 vlerësimi është bërë në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

-**Këshilli Teknik i Autoritetit Rrugor Shqiptar** (pranë ARRSH) ka nxjerrë Vendim nr. 50 (nr. 6610 prot., datë 27.07.2018) për "Rishikim e rikualifikim i projekt zbatimit të Unazë së Jashtme Tiranë (pjesa verilindore seg. Saukut – Bregu i lumit) Loti 3"

Projektit i segmentit rrugorë "Unazë së Jashtme Tiranë (pjesa verilindore seg. Saukut – Bregu i lumit) Loti 3 ", është hartuar nga shoqëria "Klodioda" shpk,

Sipas relacionit të hartuar nga ARRSH në adresë të ASHSH, shpronësimi i pasurive do realizohet në këto forma.

-**Komisioni i posaçëm i shpronësimit** (KPSH pranë ASHSH) ka mbajtur procesverbal me nr. 4, datë 04.10.2022, me objekt shqyrtimin e dokumentacionit plotësues të paraqitur nga ARRSH me shkresën nr. 8438/1 prot., datë 09.09.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 384/8 prot., datë 13.09.2022, në vijim të pranimit me kusht dhe publikimit në fletoren zyrtare nr. 121, datë 09.09.2022, ku i kërkohet Sekretarisë Teknike, si vijon:

- Të hartojë draft-projekt VKM dhe relacionin përmbledhës, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 769, datë 20.12.2017 "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë Loti 3 (shtesa)"".

- T'i paraqesë ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës ligjor, referuar nenit 20, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik", i ndryshuar, me ligjin nr. 11/20200 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrje në përdorim të përkohshëm të pasurive private për interes publik, të ndryshuar".

-ASHSH me shkresën nr. 384/12 prot., datë 05.10.2022 me lëndë "Dërgohet propozimi për shpronësim" i përcjell Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) propozimin e projektvendimit për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 769, datë 20.12.2017 "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë Loti III (shtesa)"", si më poshtë:

- a) Vlera e përgjithshme prej 491,309,103 lekë përballohet nga llogaria e veçantë për shpronësimet, në MIE.
- b) Vlera 45,651,432 lekë përballohen nga ARRSH.

-Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 867, datë **27.12.2022** (protokolluar në ASHSH me nr. 384/15, datë 30.12.2022) vendosi për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 769, datë 20.12.2017, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Loti III (Shtesa)", nënshkruar nga Z. Engëll Agaçi, në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të KM.

-ASHSH me shkresën me nr. 384/13 prot, datë **29.12.2022**, njofton për shpërblimin nga shpronësimi Vjollca Hajdar Alla, Avni Hajdar Qosja, Myzejen Hajdar Miccolis, Alime Qosja, për pasurinë nr. 155/50 e llojit "Arë", ndodhur në ZK. Nr. 3976 në vlerën **149,632** lekë (33 m^2 x 448 lekë).

-ASHSH me shkresën me nr. 384/13 prot, datë **29.12.2022**, njofton për shpërblimin nga shpronësimi Sadik Murat Luga, për pasurinë nr. 7/634 e llojit "Truall", ndodhur në ZK. Nr. 8180 në vlerën **41,901,800** lekë (1,340 m^2 x 31,270 lekë).

-ASHSH me shkresën me nr. 384/13 prot, datë **29.12.2022**, njofton për shpërblimin nga shpronësimi Adriana Muharrem Gega, Donald Bexhet Gega, për pasurinë nr. 8/523 e llojit "Ndërtesë", ndodhur në ZK. Nr. 8170 në vlerën **3,600,000** lekë (40 m^2 x 90,000 lekë).

-ASHSH me shkresën nr. 384/14 prot., datë 29.12.2022, i drejtohet ARRSH mbi pagesën e anëtarëve të KPSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor në dosje, u konstatua, se:

Në kërkesën për shpronësim për projektin e Unazës Lindore Loti 3 (për disa shtesa në VKM-në 769, datë 20.12.2017), nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me nr. 384 prot., datë 31.03.2022, paraqitet kërkesa për shpronësimin e dy pasurive në pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Loti 3", të cilat janë:

1.Pasuria e llojit "arë", në zonën kadastrale 3976, me numër pasurie 155/50, me një sipërfaqe totale 1180 m^2.

2. Pasuria e llojit "truall", në zonën kadastrale 8180, me numër pasurie 3/269, me një sipërfaqe totale 560 m^2.

Nga shqyrtimi i dosjes për shpronësim, janë pasqyruar të dhënat për pasuritë e mëposhtme që preken nga shpronësimi:

1.Pasuria e llojit "arë", në zonën kadastrale 3976, me numër pasurie 155/50, me një sipërfaqe totale 1180 m^2, nga të cilat do të shpronësohen 334 m^2.

2. Pasuria e llojit "truall", në zonën kadastrale 8180, me numër pasurie 7/634, me një sipërfaqe totale 1500 m^2, nga të cilat do të shpronësohen 1340 m^2.

3.Pasuria e llojit "ndërtesë", në zonën kadastrale 8170, me numër pasurie 8/523, me një sipërfaqe totale ndërtimi 85 m^2, nga të cilat do të shpronësohen 40 m^2.

Pasuria e llojit "truall", në zonën kadastrale 8180, me numër pasurie 3/269, me një sipërfaqe totale 560 m^2, pasqyrohet vetëm tek kërkesa e ARRSH-së për shpronësim, por nuk pasqyrohet më në dokumentacionin e dosjes dhe nuk bën më pjesë tek pasuritë që shpronësohen. Gjatë plotësimit të dokumentacionit, janë përfshirë dy pasuri të tjera që nuk janë paraqitur në kërkesë, përkatësisht:

1.Pasuria me numër 7/634, me një sipërfaqe totale 1,500 m^2

2.Pasuria me numër 8/523, me një sipërfaqe totale ndërtimi 85 m^2

Në raport me vlerën e shpronësimit, vlerësimi i pasurisë së llojit "arë" dhe pasurisë së llojit "truall" është llogaritur në bazë të VKM-së nr.89, datë 03.02.2016, "*Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*".

-Vlera totale e shpronësimit për pasurinë e llojit "arë", me numër pasurie 155/50 është llogaritur si më poshtë:

334 m^2 x 448 lekë/ m^2 =149,632 lekë

-Vlera e shpronësimit për pasurinë e llojit "truall", me numër pasurie 7/634 është llogaritur si më poshtë:

1,340 m^2 x 31,270 lekë/ m^2 =41,901,800 lekë

Ndërsa në lidhje me përcaktimin e vlerës së shpronësimit për ndërtesën ASHSH është bazuar në VKM-në nr.138, datë 23.08.2000, " *Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik*", të ndryshuar.

-Vlera e shpronësimit për pasurinë e llojit "ndërtesë", me numër pasurie 8/532 është llogaritur si më poshtë:

40 m^2 x 90,000 lekë/ m^2 =3,600,000 lekë

Në bazë të urdhrit nr.101, datë 11.03.2022, me nr.654 Prot., urdhërohet ndryshimi i Kryetarit të Komisionit nga Z. Erlis Hereni, me zëvendësimin si Kryetare Komisioni Znj. Egra Ibrahimi. Në bazë të VKM-së nr.867, datë 27.12.2022, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.769, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Loti III (shtesa), të ndryshuar, në pikën 4 të shtohet gërma "b", me vlerën 45,651,432 lekë, që do të jetë vlera e shpronësimit e përllogaritur nga fond i shpronësimeve dhe që do të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

VIII. Mbi zbatimin e procedurës për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë, finalizuar me VKM nr. 510, datë 21.03.2023 "*Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 20.12.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza lindore Tiranë, Loti III (Shtesa), i ndryshuar***", në shumën 18,040,988 lekë.**

Në bazë të urdhrit nr. 50, datë 21.03.2023, me nr.351/1 prot., u krijua komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për disa shtesa në vendimin e këshillit të Ministrave nr.769, datë 20.12.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza lindore Tiranë, Loti III (shtesa)", i ndryshuar, i përbërë nga Kryetari i komisionit Egra Ibrahimi me pozicion Drejtor i Përgjithshëm dhe anëtarët Besmira Nikolli me profesion ekonomist, Besnik Hysaj me profesion inxhinier, Ilirjana Hasanllari me profesion jurist, Sidorela Qato me profesion ekonomist, Albian Marku me profesion inxhinier, Kristi Qorri me profesion inxhinier.

Në kërkesën për shpronësim për projektin e Unazës Lindore Loti 3 (për disa shtesa në VKM-në 769, datë 20.12.2017), nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me nr.2374 prot., datë 16.03.2023, në dokumentacionin e paraqitur për shpronësim, kartelat e pasurisë dhe hartat treguese për pasuritë e llojit "truall" me nr. pasurie 10/94 dhe 10/95, të ndodhura në ZK.8170 dhe pasurisë të llojit "arë", me nr. 184/55, të ndodhura në ZK.3976, **janë jashtë afatit dhe nuk janë të përditësuara**, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik*" i ndryshuar, në të cilën përcaktohet që: "*Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ministria kompetente i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij sipas këtij neni, duke caktuar edhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.*".

Në bazë të pikës 1 dhe pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik*" i ndryshuar, në të cilën përcaktohet që: "***Në përfundim të verifikimeve të nevojshme,** si dhe të procedurave të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, **kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues përkatës janë të mbështetur në kushtet dhe kriteret e këtij ligji**, ministria kompetente vendos për pranimin e kërkesës për shpronësim, duke njoftuar menjëherë me shkrim subjektin kërkues në favor të të cilit kërkohet të bëhet shpronësimi.*" Aktmarrëveshja ndërmjet Agjencisë Shtetërore për Shpronësim dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar është lidhur në datën **29.05.2023**, për kryerjen e procedurave për shpronësim, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit *"Për disa shtesa në vendimin e këshillit të Ministrave nr.769, datë 20.12.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza lindore Tiranë, Loti III (shtesa)".*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në dosje, në momentin e lidhjes së Akt-marrëveshjes ndërmjet palëve në datën 29.05.2023, dokumentacioni i pronësisë për dy pasuritë nuk është i plotë dhe i përditësuar, në përputhje me kriteret e ligjit. Dokumentacioni i plotë është vënë në dispozicion me e-mail në datën **17.07.2023.** Në bazë të pikës 4, të nenit 13, *Aktmarrëveshja është e pavlefshme në rast se në çastin e nënshkrimit të saj nuk i bashkëlidhen dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim sipas këtij ligji.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të pasqyruar për shpronësim, përkatësisht pasuritë me nr.10/94 dhe 10/95, të ndodhura në ZK.8170, referuar kartelave të pasurisë të lëshuara nga ASHK Tirana Jug, rezultojnë të regjistruara në datën **08.11.2021**. Këto pasuri nuk janë trajtuar në VKM-në 769, datë 20.12.2017, të ndryshuar me VKM-në nr.867, datë **27.12.2022** dhe në relacionin sqarues mungojnë argumente të cilat vërtetojnë arsyet e mostrajtimit për shpronësim në vitin 2022, të pasurive të regjistruara sipas kartelave të pasurive të paluajtshme në vitin 2021.

1. Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me dokumentacionin e pronësisë, përfaqësuesit i komisionit të ASHSH-së shprehet:

Nga sa administrohet në dosjen për shpronësim, lidhur me procedurat e shpronësimit që janë ndjekur për realizimin e projektit "Për disa shtesa dhe ndyshime nr. 769, datë 20.12.2017 "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza lindore Tiranë, Loti III (shtesa)", i ndryshuar", rezulton se, për sa i përket dokumentacionit tekniko-ligjor, rezulton se, Komisioni i Posacëm për shpronësim, nëpërmjet shkresës nr. 351/2 prot., datë 06.04.2023, I është drejtuar subjektit kërkues Autoriteti Rrugor Shqiptar, (në vijim ARRSH), për dhënien e një informacioni në lidhje me, arsyen e përfshirjes në shpronësim të pasurive 10/94, 10/95 ZK. 8170 dhe nr. 184/55 ZK.3976, si dhe të përcillet dokumentacioni pronësor, kartelat e pasurive të paluajtshme dhe HTR të rifreskuara të tre mujorit të fundit.

Në vijim, ARRSH me shkresën datë 17.05.2023, protokolluar në ASHSH me nr. 351/3 prot., datë 22.05.2023 informon se: *Përsa i përket pikës së parë ju informojmë se, pasuria nr. 10/94 dhe nr.10/95, të ndodhura në ZK. 8170, sipas dokumentacionit të pronësisë (certifikatë pronësie, të cilën do ta gjeni bashkëlidhur), rezulton e datës* ***16.12.2022,*** *ndërsa për pasurinë nr. 184/55 ZK. 3976 përfshihet në këtë kërkesë shpronësimi pasi kemi marrë dijeni nga ankesa e pronarit të pasurisë.* Nëpërmjet të cilës ka vendosur në dispozicion edhe çertifikatat e pronësisë, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

Ndërkohë në lidhje me kartelat e pasurive dhe hartat treguese, subjekti kërkues ARRSH nëpërmjet kësaj shkrese, konkretisht relacionit bashkëlidhur ka cituar se, *"Për kartelat e pasurive dhe hartat treguese është bërë aplikimi nr. 11217, datë 10.03.2023 në ASHK Tirana*

Veri dhe aplikimi Nr. 8991, datë 10.03.2023 në ASHK Tirana Rurale 1. ***Kërkojmë përfshirjen e tyre për efekt publikimi.***

Sqarojmë se, në zbatim të nenit 2 pika 1 dhe 3 të Ligjit 8561/1999, ndryshuar, citohet konkretisht si më poshtë vijon:

Neni 2 1. *Personat fizikë dhe juridikë privatë kanë të drejtën për respektimin e pasurive në pronësi të tyre. Shpronësimi i pasurive pronë private bëhet vetëm për interes publik, në kushtet kur interesi publik mbizotëron kundrejt interesave private të pronarëve të tyre, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*

Neni 2 1. *Personat fizikë dhe juridikë privatë kanë të drejtën për respektimin e pasurive në pronësi të tyre. Shpronësimi i pasurive pronë private bëhet vetëm për interes publik, në kushtet kur interesi publik mbizotëron kundrejt interesave private të pronarëve të tyre, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*

Neni 3 *Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.*

Neni 3 *Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.*

Sa më sipër, sqarojmë se, Komisioni i Posacëm për Shpronësimin, në vijim të kërkesës së subjektit kërkues, për përfshirjen në shpronësim të pasurive për efekt publikimi, nëpërmjet procesverbalit të datës 25.05.2023, ka vijuar procedurat e pranimit të kërkesës për shpronësim, me kushtin që gjatë publikimit të kërkesës për shpronësim, të depozitohen kartelat e pasurive dhe HTR, të konfirmuar nga ASHK, në vijim të aplikimeve të bëra nga ARRSH, të sipërcituara.

Sa më sipër, lidhur me pikën e vendimmarrjes së konstatuar, si dhe pas verifikimit të dosjes së shpronësimit, ASHSH me shkresën Nr. 351/4 Prot., datë 25.05.2023, ka njoftuar subjektin kërkues të shpronësimit ARRSH, mbi pranimin e kërkesës për shpronësim për interes publik, si dhe me shkresën Nr. 351/4 Prot., datë 25.5.2023, ARRSH i është komunikuar kërkesa për plotësimin e dokumnetacionit për të cilën është bërë pranimi me kusht, duke i cilësuar se, "**Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit plotësues mbi konstatimet e sipërcituara, KPSH do të vijojë me përjashtimin e këtyre pasurive nga këkesa për shpronësim**".

Në vijim sipas dokumentacionit që disponohet për këtë dosje shpronësimi, rezulton se, nëpërmjet korrespondencës elektronike të dërguar nga ASHSH në datën 10.07.2023, drejtuar ARRSH është njoftuar subejkti kërkues, që duke qenë se afati 15, i publikimit të kërkesës për shpronësim, në Fletoren Zyrtare Nr. 85, datë 05.06.2023, është plotësuar, në rast se nuk paraqitet dokumentacioni plotësues, do të vijohet me heqjen e tyre nga lista përfundimtare për shpronësim.

Në vijim nëpërmjet korrespondencës elektronike, i përcjellë në ASHSH më datë 12.07.2023, ARRSH ka dërguar dokumentacionin e pronësisë të pasurive objekt shpronësimi, të lëshuara datë 27.06.2023, si dhe HTR të cilat rezultojnë të lëshuara me datë 23.06.2023, dhe me vulë dixhitale të konfirmuara nga ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug.

Sa më sipër, sqarojmë se, në kushtet kur dokumentacioni i pronësisë i përcjellë në formtin e sipërcituar, rezulton i nënshkruar elektronikisht nga institucioni kompetent me vulë dixhitale, nëpërmjet të cilës verifikohet statusi i pasurive objekt shpronësimi, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ka vijuar procedurat e miratimit të kërkesës për shpronësim.

Në vijim, Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin, në lidhje me dokumentacionin që duhet të përmbajë kërkesa për shpronësim shprehet se, është në disponibilitetin e plotë mbi gjetjen e këtij konstatimi, ku në vijim do të marrë të gjitha masat e nevojshme për përcaktimin e afatit kohor, për sa i përket dokumentacionit plotësues që duhet të përmbushet për një kërkesë për shpronësim, i cili duhet të konsiderohet i ezauruar përpara realizimit të pranimit të kërkesës për shpronësim me interes publik.

Sa më sipër, ASHSH sqaron se, jemi duke marrë masat e nevojshme për zbatimin me përpikmëri të çdo rekomadimi të lënë nga KLSH

I.1. Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionin e dërguar ana Juaj, konstatojmë se argumentet janë pjesërisht bindëse dhe qëndrojnë pjesërisht. Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë, dhe kjo do të reflektohet në Projektraportin e auditimit. Ndër të tjera në observacionin e paraqitur ju pranoni konstatimet e grupit të auditimit dhe vlerësojmë faktin se Institucioni Juaj ASHSH, jeni duke marrë masat e nevojshme për zbatimin me përpikmëri të çdo rekomandimi të lënë nga KLSH.

Në raport me vlerën e shpronësimit, vlerësimi i pasurisë së llojit "truall" është llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*.

-Vlera totale e shpronësimit për pasurinë e llojit "arë", me numër pasurie 184/55, në zonën kadastrale 3976 është llogaritur si më poshtë:
200 m^2 x 448 lekë/ m^2 =89,600 lekë.
-Vlera e shpronësimit për pasurinë e llojit "truall", me numër pasurie 10/95, në zonën kadastrale 8170 është llogaritur si më poshtë:
384 m^2 x 32,878 lekë/ m^2 = 12,625,152 lekë.
-Vlera e shpronësimit për pasurinë e llojit "truall", me numër pasurie 10/94, në zonën kadastrale 8170 është llogaritur si më poshtë:
162 m^2 x 32,878 lekë/ m^2 = 5,326,236 lekë.
Në bazë të VKM-së nr. 510, datë 01.08.2024, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.769, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë, Loti III (shtesa), të ndryshuar, në pikën 4 të shtohet germa "c", me vlerën 18,040,988 lekë, që do të jetë vlera e shpronësimit e përllogaritur nga fond i shpronësimeve dhe që do të përballohet nga buxheti i shtetit.

Praktika është realizuar nga: Znj. Egra Ibrahimi, në cilësinë e Kryetarit të KPSH; **Z. Alban Marku,** në cilësinë e anëtar të KPSH; **Znj. Besmira Nikolli,** në cilësinë e anëtar të KPSH; **Z. Besnik Hysaj,** në cilësinë e anëtar të KPSH; **Z. Ilirjana Hasanllari,** në cilësinë e anëtar të KPSH; **Znj. Sidorela Qato**, në cilësinë e anëtar të KPSH; **Kristi Qorri**, në cilësinë e anëtar të KPSH.

IX. Mbi zbatimin e procedurës për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 662, datë 13.10.2022 *"Për shpronësimin për interes publik të pasurive të pajutshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë "Rishikim i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Seshii Shqiponja-Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6" dhe "Studim-projektim, rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6" Bashkia Tiranë, finalizuar me VKM nr. 287, datë 17.05.2023 në vlerën 669,827,726.40 lekë.*

Përshkrimi i situatës së shpronësimit.
-ASHK me nr. 7993/1 prot., datë 07.09.2022 informon ARrSh me të cilin kërkohet çmimi mesatar sipas kontratave të shitblerjeve, për objektet e banimit në ZK 8110, se çmimi rezulton të jetë 60,959 -ASHK me nr. 7257/1 prot., datë 05.10.2022 informon ARrSh se çmimi për objektet e banimit në ZK 2460, për realizimin e procedurave të shpronësimit për segmentin rrugor "***Studim-projektim rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe "Studim-projektim-rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6***" është 66,505 lekë/m2.
- Autoriteti Rrugorë Shqiptar (*këtu e vijim ARRSH*), me shkresën nr. 10254 prot, datë 27.10.2022 ka paraqitur kërkesë për informacion të pasurisë që preken nga "Unaza e Madhe Tiranë, sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri Shkozë".
-ASHK me nr. 6743/1 prot., datë 04.11.2022 informon ARrSh me kthim përgjigje të shkresave me nr. 58513 dhe 5814, datë 02.09.2022 dhe shkresës me nr. 10294 prot., datë 27.10.2022, me protokoll hyrës me nr. 676743 prot., datë 02.11.2022, për aplikim kopje kartele pasurie dhe lëshim kopje të fragmentit të hartës dhe informacion për pasuritë që preken nga ndërtimi i

segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri" për 19 pronarë:
-RrSH me nr. 1124/3 prot., datë 23.11.2022 i drejtohet ASHK me kërkesë për informacion në kuadër procedurave të shpronësimit për segmentin rrugor *"Studim-projektim rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe "Studim-projektim-rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6"* mbi statusin juridik dhe informacion për sipërfaqet e katit 0 dhe katit 1 për pasuritë nr. 97/4ND1 për ZK.3976.
-ASHK me nr. 8806/1 prot., datë 44.11.2022 informon ARrSh me kthim përgjigje se pasuria nr. 97/4-ND1, vol.26, fq. 25, ZK.3976, lloji i pasurisë "Ndërtesë" me sip. 195 m2, në pronësi të Abedin Qazim Avdillari, kt përdhe është me sip. 195 m^2 dhe kt. I parë me sip. 195 m2.
-ASHK me nr. 1013/1 prot., datë 21.02.2022 i drejtohet Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve (Këtu e në vijim, KPSH) me kthim përgjigje të shkresës me nr. 254/2 prot., datë 17.02.2022 në kuadër procedurave të shpronësimit për segmentin rrugor *"Studim-projektim rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe "Studim-projektim-rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6"*se çmimi mesatar për pasurin e llojit "Banesë në ZK.1066 dhe 2884 është **52,000** lekë/m2, ku tek ky çmim nuk përfshihet vlera e truallit".
-Z. **Arben Qamil Lala** i drejtohet ARrSH dhe ASHSH me kërkesë për shpronësim, pasi nuk i është dërguar për shpronësim sip. e truallit 290.9 m2, me nr. Pasurie 3/895, ZK.8170.
-ASHSH me nr. 806/17 prot., datë 28.12.2022 i drejtohet ARrSh dhe për dijeni Z. Arben Qamil Lala, pasi pretendon përfshirjen e pasurisë nr. 3/895 e llojit "Truall" pasi në publikimin e kërkesë nr. 806/4 prot., datë 06.12.2022 në fletoren zyrtare nr. 164, datë 12.12.2022 janë përfshirë vetëm pasuritë me nr. 3/895-N1 dhe nr. 3/895-N2 e llojit "Ndërtesë".
-Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve pranë ARrSH i dërgon Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes ARrSH Vendimin për miratimin e Lejes së Zhvillimit Nr. 04, datë 13.07.2021 për *"Studim-projektim rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri"* dhe me nr. 11290 prot., datë 13.12.2021 i dërgon Vendimin për miratimin e Lejes së Zhvillimit Nr. 03, datë 13.07.2021 për *"Studim-projektim-rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6"*.
-Këshilli Teknik i ARRSH me Vendimin nr. 25 (nr. 5745/3 prot., datë 15.07.2021) miraton projektin e zbatimit të kontratës me objekt: *"Studim-projektim-rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6"*.
-Këshilli Teknik i ARRSH me Vendimin nr. 26 (nr. 5743/2 prot., datë 15.07.2021) miraton projektin e zbatimit të kontratës me objekt: *"Studim-projektim rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri"*.
- ARRSH, me shkresën nr. 10634 prot, datë 08.11.2022 ka paraqitur kërkesë për shpronësim (Për disa shtesa në VKM nr. 662, datë 13.10.2022) me objekt: *"Studim-projektim rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe "Studim-projektim-rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6"* , prot në ASHSH, me nr. 806 prot, datë 10.11.2022. Vera e shpronësimit për realizimin e këtij projekti, do përballohet nga ARSH.
-ASHSH me nr. 736/3 prot, datë 25.10.2022 i drejtohet me kthim përgjigje studios së avokatisë "Rexhepaj & Kambo" ku kërkohet të merret në shqyrtim kërkesa për shpronësim e Z. Miftar dhe Bilal Kolmila e datë 04.10.2022 dhe nr. 736/5 prot., datë 17.11.2022.
- Me shkresën nr. 806/3 prot, datë **05.12.2022**, ASHSH njofton ARRSH për **pranimin e kërkesës** për shpronësim me vlerë 669,827,726.40 lekë, ku në paragrafin 2 thuhet se *"Personi i autorizuar nga ana Juaj, duhet të paraqitet në ASHSH brenda 10 ditëve nga marrja e këtij*

njoftimi për nënshkrimin e akt-marrëveshjes për të drejtat dhe detyrimet që lidhen me realizimin e procesit të shpronësimit të pasurive që përfshihen në këtë projekt";
- Akt-marrëveshja ndërmjet ASHSH dhe ARRSH është lidhur me nr. 806/2, datë 05.12.2022 nga ASHSH me përfaqësues znj. Egra Ibrahimi dhe nr. 10634/1 prot, datë 05.12.2022 nga ARRSH me përfaqësues Evis Berberi.
- Me shkresën nr. 806/4 prot, datë **06.12.2022** nga ASHSH është bërë publikimi i kërkesës për shpronësim nga Qendrën së Publikimeve Zyrtare, kjo në referencë të nenin 15 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik"*, në zbatim të shkresë nr. 10634 prot, datë 08.11.2022 të ARRSH.
- ASHSH me shkresën nr. 806/5 prot, datë **07.12.2022** ka bërë publikimi për shpronësim publik për pronarët:[*1. Mehmet Hakim Zaçaj; 2. Albana Mitat Ismailaj; 3. Blerina Mitat Ismailaj; 4. Mitat Rane Ismailaj; 5. Valentina Mero Zaçaj; 6. Arbër Bashkim Zaçaj; 7. Artan Bashkim Zaçaj; 8. Feride Haki Tartaraj; 9. Përparim Hakim Zaçaj; 10. Arben Hakim Zaçaj*].
- Me shkresën nr. 254/28, datë 28.4.2022, është bërë njoftimi i drejtpërdrejtë i pronarëve të pasurisë, pronë private që shpronësohet;
- Këshilli i Ministrave ka finalizuar projektin me VKM nr. 662, datë 13.10.2022 (Protokolluar në ARrSh me nr. 9848 prot., datë 14.10.2022) *"Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë "Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6". Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse për pasuritë e llojit "truall", "tokë arë" dhe "ndërtesë" me një vlerë të përgjithshme prej **3,158,206,249** lekësh, përkatësisht: 3,035,497,750 lekë nga llogaria "Fondi i shpronësimeve" në Bankën e Shqipërisë dhe 122,708,499 lekë nga buxheti i ARrSH. Vlera e shpenzimeve prej 70,000 lekë përballohet nga ARrSH.*
Projektit i segmentit rrugor *"Studim-projektim rikualifikim i Unazës Lindore Tiranë për lotët 4,5,6"*, është hartuar nga BOE "Klodioda & Altea Geostudio 2000" shpk, ndërsa projekti i segmentit rrugorë *"Studim-projektim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të unazës së Madhe Tiranë nga Shehi Shqiponja-Bulevadri i Ri"*, është hartuar nga BOE "Seed Consulting & Atelier 4".
Me Vendim nr. 26 (*prot, 5745/3*), datë 15.7.2021, me objekt: *Mbi projektin e zbatimit të kontratës "Studim-projektim, rikualifikim i Unazës Lindore Tiranë, lotët 4,5,6"* , si dhe në zbatim të VKM nr. 276, datë 16.5.2018 *"Për miratimin e mënyrës së organizimit të strukturës, organikës dhe statusit të ARRSH"*, nga ARSH është marrë në shqyrtim projekti i zbatimit me objekt: *"Studim projektim rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4,5,6"*, sipas kontratës nr. 62357/7 prot, datë 7.12.2020 të lidhur midis ARRSH dhe BOE "Klodiola & Altea Geostudio 2000" ShPK.
Sipas relacionit të hartuar nga ARRSH në adresë të ASHSH, shpronësimi i pasurive do realizohet në këto forma.

a- *Për sipërfaqe e shpronësuar truall, arë, pemëtore, ullishte etj., vlera e shpronësuar përllogaritet sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH", i ndryshuar. Ndërsa për objektet të tipit ndërtesë e kemi në dy forma:*
b- *Për objektet social-ekonomik dhe ndërtesa që në kartelë është banim, por që nuk ka funksion banimi sipas terrenit, do realizohet sipas vlerës së preventivit, referuar UKM nr. 3, datë 28.12.2016* "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016" *dërguar nga MFE me shkresën nr. 1884/1 prot., datë 29.09.2017.*
c- *Për objektet me funksion banimi vlerësimi është për m2, sipas mesatares së kontratave të shitblerjes për 3 mujorin e fundit të ardhur nga ASHK Tiranë.*

-Me urdhrin nr. 159 prot, datë 11.11.2022, Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH, krijon KPSH me përbërje: [Egra Ibrahimi, Kryetar (Drejtor i Përgjithshëm); Ilirjana Hasanllari, anëtar (Jurist); Arlinda Drenofci, anëtar (Ekonomist); Besnik Hysaj, anëtar (Inxhinier); Altin Sula, anëtar (Inxhinier); Orlanda Murati, anëtar (Jurist); Sidorela Qato. Anëtar (Ekonomist)].
-Kërkesa për shpronësim publik me nr. 806/4, datë 06.12.2022 është publikuar në fletoren zyrtare me nr. 164/2022 datë 12.12.2022.
-ARRSH me nr. 10634/2 prot., datë 20.12.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 806/9 prot., datë 22.12.2022) i dërgon shkresën për plotësim dokumentacioni, sepse gjatë fazës së ankesave z. **Neshat** Sula ka depozituar ankesë për të shtuar pasurinë nr. 1.36/76, ZK. 3976.
-ASHSH me nr. 806/20 prot., datë 09.12.2022 i drejtohet ASHK (Drejtorisë së përgjithshme; Drejtorisë vendore Tirana rurale 1), dhe për dijeni ARRSH dhe z. Neshat Sula, me kërkesë për konfirmim.
-ASHSH me nr. 45/1 prot., datë 18.01.2023 i drejtohet ARRSH dhe z. Fluturim Rrahmani me Neshat Sula, në përgjigje të shkresës me nr. 45 prot., datë 09.012023, ku nëpërmjet të cilës kundërshtoni kërkesën nr. 806/4, datë 06.12.2022, lidhur me vlerësimin e pasurisë nr. 5/582 e llojit "truall" dhe "ndërtesë", ndodhur në ZK 8110.
-Z. Xhuljano Avdillari i drejtohet ASHSH (nr. Prot. 45/3, datë 23.01.2023), me objekt për njohje për shpronësim nr. 806/4, datë 06.12.2022 "Për shpronësim publik", ku bashkëlidhur ka dërguar dokumentet e pronësisë.
-ASHSH me nr. 21/1 prot., datë 18.01.2023 i kthen përgjigje znj. Ariana Agustin Bekteshi dhe Z. Arjan Agustin Kola, ku bashkëlidhur ASHSH ka vendosur në dispozicion dokumentacionin e njësuar për shpronësim.
-Drejtoria e Komunikimit me Qytetarët (Bashkia Tiranë) me nr. 677/1 prot., datë 25.01.2023, njofton për kryerje publikimi ASHSH dhe për dijeni DPS dhe Me urdhrin nr. 159 prot, datë 11.11.2022, Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH, krijon KPSH me përbërje: [Egra Ibrahimi, Kryetar (Drejtor i Përgjithshëm); Ilirjana Hasanllari, anëtar (Jurist); Arlinda Drenofci, anëtar (Ekonomist); Besnik Hysaj, anëtar (Inxhinier); Altin Sula, anëtar (Inxhinier); Orlanda Murati, anëtar (Jurist); Sidorela Qato. Anëtar (Ekonomist].
-ARRSH me shkresën me nr. 1004 prot., datë 02.02.2023 (protokolluar në ASHSH me nr. 45/7 prot., datë 02.02.2023) njofton mbi plotësim dokumentacioni "Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri Shkozë".
-Z. Lulzim Sula, dërgon në ASHSH (protokolluar me nr. 45/8 prot., datë 03.03.2023) Deklaratë Noteeriale.
-ASHSH me nr. 45/9 prot., datë 07.02.2023 i drejtohet ARRSH për trajtim dhe kompetencë dhe për dijeni Z. Xhuljano Avdillari.
-KPSh në ASHSH me datë 07.02.2023 mban procesverbal lidhur me kërkesën për shpronësim të paraqitur nga ARRSH me shkresën nr. 10634 prot., datë 08.11.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 806 prot., datë 10.11.2022.
-ASHSH me nr. 45/10 prot., datë 08.02.2023 i dërgon MIE propozim i projektvendimit për shpronësim.
-ASHK me nr. 9582/3 prot., datë 20.02.2023 (protokolluar në ASHSH me nr. 45/19 prot., datë 22.02.2023) i kthen përgjigje ASHK mbi trajtimin e shkresës nr. 806/20 prot., datë 29.12.2022 të ASHSH.
-ASHSH me nr. 45/27 prot., datë 23.05.2023 kreu njoftimin për shpronësim të Mehmet Bakim Zaçaj, Albana Mitat Ismailaj, Blerina Mitat Ismailaj, Mitat Rane Ismailaj, Valentina mero Zaçaj, Arbër Bashkim Zaçaj, Artan Bashkim Zaçaj, Feride Baki Haki Tartaraj, Përparim Hakim Zaçaj, Arben Hakim Zaçaj.
Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 287, datë 17.05.2023, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 662, datë 13.10.2022 *"Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë "Rishikim i projektit për segmentin*

rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6" dhe "Studim-projektim, Rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6", vendosi në vendimin nr. 662, datë 13.10.2022, të Këshillit të Ministrave, të miratojë këto shtesa dhe ndryshime.

-ASHSH me nr. 45/25 prot., datë 22.05.2023 i dërgon ARRSH Vendimin nr. 287, datë 17.05.2023 të Këshillit të Ministrave.

Problematika të konstatuara:

-Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar në dosjen e shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5, nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 24 të po këtij Ligji, ku përcaktohet se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit, si dhe në kundërshtim me nenin 3, pika 6 të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH.

I. Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me dokumentacionin e pronësisë, përfaqësuesi i komisionit të ASHSH-së shprehet:

Bazuar në VKM-në bazë Nr. 662 datë 13.10.2022 *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të 'Unazës së madhe' Tiranë nga 'Sheshi Shqiponja'-'Bulevardi i Ri' dhe 'Rikualifikimi i 'Unazës Lindore' për lotet 4, 5, 6"* në pikën në pikën 10 të saj thuhet se:

"Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi pasqyron në kartelat e pasurive të paluajtshme informacionin për miratimin e shpronësimit, për interes publik, të pasurive pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit. Regjistrimi i aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar kryhet pas aplikimit nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për shërbimin përkatës".

Në këto kushte, ASHSH nuk është autoriteti që kryen regjistrimin në ASHK, por subjekti kërkues (në rastin konkret ARRSH) është përgjegjës për dërgimin e dokumentacionit për regjistrim, dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës brenda 30 ditëve nga data e VKM-së kryen regjistrimin e pasurive të shpronësuara, thënë kjo dhe në ligjin 11/2020 neni 11.

Për më tepër, dërgimi i VKM-së dhe regjistrimi i pasurive shpronësuara nuk është procedurë që vonon apo pengon vlefshmërinë e vendimit të shpronësimit, pasi efekti juridik fillon në datën e hyrjes në fuqi të VKM-së (neni 21, pika 5 i Ligjit nr. 8561).

Theksojmë se, me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave, nga ky i fundit, vendose VKM në dispozicion, duke u mbajtur komunikim shkresor, drejtuar të gjitha institucioneve t ngarkuara në VKM me përgjegjësi.

Për sa më sipër, Komisioni i Posacëm i Shpronësimeve, kundërshton kontatimin e KLSH, si të pabazuar në ligj.

Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara.

Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.

1.1.Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari, referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.

Së dyti, sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti, nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja. Argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.

-Nga sa më sipër, konstatohet se numri i anëtarëve të KSHP, vjen në kundërshtim me VKM nr. 656, datë 31.10.2018, "*Për përcaktimin e masës së Shpërblimit të Anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershme të Njësive të Qeverisjes Qendrore*", (Ndryshuar me VKM nr. 559, datë 31.7.2019, nr. 612, datë 29.7.2020), i ndryshuar, pika 3, në të cilin përcaktohet që: "**Numri i anëtarëve duhet të ishte 4 dhe jo 6 në bazë të përcaktimeve ligjore, si dhe nenin 15.3 të Rregulloren e Brendshme të ASHSH,** miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "*Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH*", **veprime të cilat kanë çuar në pagesën më shumë të 2 anëtarëve të KSHP.**

Praktika është realizuar nga: Znj. Egra Ibrahimi, në cilësinë e Kryetarit të KPSH, znj. Ilirjana Hasanllari, në cilësinë e anëtar të KPSH, Znj. Arlinda Drenofci, në cilësinë e anëtar të KPSH, Z. Besnik Hysaj, në cilësinë e anëtar të KPSH, Z. Altin Sula, në cilësinë e anëtar të KPSH, znj. Orlanda Murati, në cilësinë e anëtar të KPSH, Sidorela Qato, në cilësinë e anëtar të KPSH.

X- Dosja e procedurës së shpronësimit për realizimin e "Projektit të rishikuar për Lotet 4, 5, 6. Unaza Lindore (VKM nr. 607. dt.2.10.2024) ndryshuar", me vlerë 51,071,853.42 lekë.

Në dosjen e fondit arkivor rezultoi se ARRSH me shkresën nr. 3766 prot., nr. 4578/l prot. datë 21.05.2025, kërkon shpronësimin e pronarëve për objektin " Rikualifikimi i "Unazës lindore" për lotet 4, 5, 6" i ndryshuar është kërkuar shpronësimi për pasuri me fond limit 51,071,853.42 lekë nga Ministria e Financave[1]. Me urdhrin nr. 121 datë, 22.05.2024 ASHSH ka ngritur Komisionin e Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e shpronësimit.

---

[1] *Shpronësimi kërkohet duke referuar Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 8, shkronja ç, e cila parashikon se: "Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës"*
Ne menyre deklarative pa u administruar ndonje akt shkresor qe verteton ekzistencen e fondeve te nevojeshme.

Me shkresën e ASHSH nr. 821/1prot., datë 14.06.2024 ka njoftuar subjektin kërkues për fillimin e procedurës së shpronësimit dhe plotësimin e dokumentacionit kërkesë e përsëritur me korrespondencën nr.821/2prot., datë 14.06.2024.

Konkluzion: Kërkesa për shpronësim, (për disa shtesa në VKM-në nr. 662 datë 13.10.2022 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të "Unazës së Madhe" Tiranë nga "Sheshi Shqiponja "Bulevardi I Ri" dhe Rikualifikimi i "Unazës lindore" për lotët 4, 5, 6" i ndryshuar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, është paraqitur e pa shoqëruar me dokumentacionin konform ligjit, është shqyrtuar e pranuar në tejkalim të parashikimeve ligjore.

Procedura e ndjekur për miratimin e shpronësimit. Me urdhrin nr. 121 datë 22.05.2024 ASHSH ka ngritur Komisionin e Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e shpronësimit.

Me shkresën e ASHSH nr. 821/1prot., datë 14.06.2024 ka njoftuar subjektin kërkues për fillimin e procedurës së shpronësimit dhe plotësimin e dokumentacionit kërkesë e përsëritur me korrespondencën nr.821/2prot., datë 14.06.2024.

Me shkresën nr. 4578/l prot., datë 25.06.2024 është plotësuar dokumentacioni nga ARRSH .

Sipas Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit ky dokumentacion nuk ka qenë përsëri brenda kuadrit ligjor duke pasjellë autoritetin të rikërkojë plotësim të dokumentacionit më shkresat nr. 821/4 prot., datë 28.06.2024 nr. 821/5 prot., datë 03.07.2024.

Me nr. 4903/1 port. datë 04.07.2024,ARRSH dërgon informacion shtesë shoqëruar me dokumentacion plotësues.

Me shkresën nr.821/7 prot., datë 08.07.2024 përsëri rikërkohet informacion tek subjekti duke arsyetuar se dokumentacioni i paraqitur nuk është i plote.

Me shkresën nr.821/8 prot., datë 08.07.2024 njoftohet ARRSH për pranim e kërkesës.

Konkluzion:

Ka mospërputhje me kërkesën e bërë nga ARRSH dhe miratimin e saj. Pasi është lidhur akt-marrëveshja dhe është bërë publikimi se kush janë pronarët që do të shpronësohen, konstatohet se ka shtesa dokumentacionesh dhe kërkesash nga ARRSH, pa dhënë komente se nga pse kanë ardhur këto ndryshime, nga ndryshimi i projektit apo nga komisioni i ngritur në ARRSH,(*kërkuesi*) i cili nuk ka përfshirë që në fillim të gjitha pronat të cilat preken nga ky projekt. Ky fakt nuk është konstatuar as trajtuar nga KPSH.

Nga auditimi mbi procedurën e shpronësimit për disa shtesa në VKM Nr. 607, datë 2.10.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 662, datë 13.10.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të "Unazës së madhe" Tiranë nga "Sheshi Shqiponja" – "Bulevardi i ri" dhe "Rikualifikimi i "Unazës lindore" për lotet 4, 5, 6", të ndryshuar grupi i auditimit;

Konstaton:

1. Kërkesa për shpronësim është shqyrtuar në mungesë të lejeve dhe miratimeve përkatëse nga organet kompetente në kundërshtim me *pikën dh, neni 10, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë sipas ligjit, kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse".*
2. Adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve private që shpronësohen , njoftimet e subjekteve të shpronësuara të pa dokumentuara në shkelje të *pikës 2, të nenit 15 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 dhe Nenit 14 pika 1, ku citohet se "Organi kompetent*

brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit, fillon përmbushjen e procedurave të njoftimit të drejtpërdrejtë... "

3. Aktmarrëveshja përfundimtare pashoqëruar me dokumentacion sipas ligjit ky fakt është në kundërshtim me *Nenin 13.pika 4. Aktmarrëveshja është e pavlefshme në rast se në çastin e nënshkrimit të saj nuk i bashkëlidhen dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim sipas legit nr. 8561, datë 22.12.1999.*
4. Procesverbalet e KPSH nuk janë në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor *Neni 7 dhe me nenin 41 të L.G.JA si dhe Rregulloren e Brendshme të A.SH.SH*[2].

Praktika është realizuar nga: Anëtarët e KPSH; K. Gurra, A. Marku, I. Hasanllari, E. Bytyçi, K. Lika, O. Murati, F.Cena.

XI. Dosja e procedurës së shpronësimit për realizimin e projektit Ndërtimi Unazës Lindore Loti II (status i finalizuar me VKM nr. 65 datë 8.2.2023) 51,071,853.42 lekë.

Në dosjen nr. 4 , Fondi ASHSH me titull Projekti "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i akseve rrugore "Unaza Lindore, Loti II" dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit" (finalizuar me VKM Nr. 65., datë 8.02.2023), ASHSH ka ngritur Komisionin e Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e shpronësimit. Kërkuesi A.RR.SH me shkresën Nr. 3722 prot., datë 16.03.2022 e ARRSH, drejtuar ASHSH, me lëndë: Kërkesë "Unaza lindore loti 2", sipas V.K.T Nr. 35 datë 13.09.2021; *Mbi disa përmirësime në projektvendimin e objektit "Rikualifikimi i akseve rrugore "Unaza Lindore Loti 2"*, ka vënë në dispozicion vendimin e këshillit teknik dhe legjitimuar me atë rast një kërkesë të re për shpronësim.

Konkluzion: Në këtë procedurë shpronësimi konkludohet se subjekti kërkues ka shteruar të drejtën për shpronësim me V.K.M kryesore në kuptimin e afatit të lejuar nga ligji për përfundimin e projekteve të financuara. Ligji saktëson se çdo kërkesë për shpronësim (*shtesë VKM nr.65, datë 08.2.2023 në këtë rast*) trajtohet si e tillë dhe nuk I referohet në ndonjë normim specifik se reduktohet procedura që do to respektohet për shkak të trajtimit njëherë në V.K.M fillestare. Në këtë kuadër si kërkesë fillestare ajo nuk është trajtuar në përputhje me kushtet dhe kriteret e ligjit I mungojnë të gjitha aktet e përcaktuara në ligj për tu shqyrtuar e pranuar si projektet, afatet e fillimit e përfundimit të punimeve, lejet etj. Në këtë kontekst në përputhje me nenin 26 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 juridikisht është prodhuar një akt I pavlefshëm.

Procedura e ndjekur për miratimin e shpronësimit.

---

[2] *Procesverbali (vendimi) për miratimin e kërkesës për Shpronësim nga pikëpamja formale është dokument jo në përputhje me atributet e Komisionit i cili ka detyrimin të dalë me Vendim siç parashikohet në Rregulloren e Brendëshme të ASHSH dhe në KPA.*
Procesverbali i komisionit të shpronësimit nuk është hartuar e arsyetuar në formën dhe përmbajtjen që kërkohet nga ligji, aktet nënligjore dhe praktikat e standardizuara2. Vendimi përfundimtar I Komisionit ad hoc është hartuar në kundërshtim me nenin 41 të LGJA. Ai duhet të përmbajë tri pjesët tradicionale me të gjithë elementët e kërkuar nga neni 310 i K.Pr.Civile, por me 3 elementë të shtuar shprehimisht: (1) hyrjen; (2) pjesën përshkruese-arsyetuese dhe (3) pjesën urdhëruese
Vendimi: Është një akt zyrtar që shpreh vullnetin, qëndrimin ose urdhrin e një organi drejtues për një çështje të caktuar. Ai ka fuqi detyruese dhe sjell pasoja juridike.
Procesverbali: Është një dokument që përshkruan ecurinë dhe përmbajtjen e një mbledhjeje, takimi, ose ngjarjeje të caktuar. Është më shumë një dëshmi e zhvillimit të diskutimeve apo vendimeve të marra.
.....Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen.Vendimmarrja sipas procesverbalit datë 26.04.2021 të Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), pasi në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa vepruar kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.

Nga auditimi mbi procedurën e shpronësimit konstatohet se me kërkesë të ASHSH, ARRSH ka hartuar vlerësimin ligjor nga sektori i sigurimit të tokës dhe kërkesën për ASHK (Agjencisë Shtetërore të Kadastrës), me aktin nr. ska datë ska me anë të së cilës është kërkuar konfirmimi i statusit juridik, të pasurive që preken nga ky projekt.
Nga ana e ASHK, nuk dokumentohet në dosje të jetë kryer evidentimi i sipërfaqeve të prekura, të pasqyruara në projektin e shpronësimit dhe të jetë hartuar tabela e llogaritjeve paraprake.
Por në dosje rezulton të jenë administruar dokumentacioni i pronësisë për pronat objekt i këtij projekti dhe një gjurme përgjigje nga ana e ASHK lidhur me statusin e pasurive dhe çmimet për këto pasuri sipas përllogaritjeve të ASHK nëse marrim të mirëqenë këtë dokument nr.1901.1 prot datë 12.08.2022.
Sipas VKM nr.65 datë 8.2.2022 rezultoi se nga zbatimi i projektit preken 10 prona.
Llogaritjet paraprake dhe çmimi i përcaktuar janë bazuar në VKM-në nr. 89 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, për llojin e pasurisë "Arë, vresht, pemëtore" e cila *për zonën kadastrale 3976 është 61.167 lekë/m²*. Për objektet e banimit në ZK 3550 çmimi është para vënë me vlerën 85.910 lekë m2 duke iu referuar çmimit të disa kontratave shitblerje të cilat nuk argumentohet se çfarë përfaqësojnë dhe nuk janë administruar në dosjen përkatëse.
Në vijim pas vlerësimit ligjor të kërkesës është konstatuar mospërputhja e saj me ligjin dhe kërkesa është rikthyer në subjektin ARRSH për plotësim të dokumentacionit.

Konkluzion; Komisioni ad hoc në përputhje me kompetencat mund të procedonte me refuzimin e kërkesës[3] sipas Nenit 12, pika 2 të ligjit, por ka proceduar me dhënien e një vendimmarrje ekstra ligjore në tejkalim të kompetencave që ligji i ka targuar.

Subjekti që ka kërkuar shpronësimin nëpërmjet ASHK ka plotësuar dokumentacionin. Me shkresat nr. 369/2 prot datë 17.06.2022, 369/3 datë 5.7.2022, nr.369/4 dt.26.7.2022, nr.369/5 datë 23.08.2022, ky dokumentacion është administruar në dosje.
Është miratuar vendimmarrja e ASHSH me VKM nr. 65 datë 08.02.2023, duke u administruar në dosje bashkë me kartelën shoqëruese ,gjithashtu kjo VKM i është dërguar edhe nga subjekti kërkues ARRSH me korrespondencë zyrtare nr. 254/2 datë 13.02.2025.
Procesi është mbyllur me korrespondencën e ASHSH me shtetasit e shpronësuar me nr.254/3 prot datë 13.02.2023[4] duke mos garantuar marrjen dijeni të personave të prekur sipas përcaktimeve të KPA
Ndërkohe në dosje janë administruar akte mbi bazën e te cilave Komisioni ad-hoc ka kryer pagesën për anëtarët e vet.
Nga komisioni nuk është kërkuar të bëhet publikimi i kërkesës për shpronësim të pronave, të cilat preken nga ky Project i cili ka ndryshuar për shkak të devijimeve nga projekti fillestar, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit.
Në dosje nuk është administruar ndonjë veprim administrativ që të pasqyrojë veprimet e Komisionit për monitorimin e procesit të shpërblimit për personat e shpronësuar. Një praktikë e tillë bie ndesh me përcaktimet ligjore për veprimtarinë ligjore të komisionit.
Nga auditimi i procedurës për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i akseve rrugore "Unaza Lindore, Loti II" dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit" (finalizuar me VKM Nr. 65., datë 8.02.2023)", grupi i auditimit
Konstaton:

---

[3] Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ministria kompetente i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij sipas këtij neni, duke caktuar edhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.
[4] Pika d) e Rregullores së Brendshme të ASHSH përcakton njoftimin e drejtpërdrejtë të pronarëve për shpronësim.

1. Se nuk ka patur një informacion apo njoftim zyrtar të saktë mbi projektin (ndryshimin e atij fillestar) që po zbatohej në këtë zone lejet përkatëse, vendimin me të cilin ai është finalizuar, koston e tij totale, si edhe koston e planifikuar për shpronësimin e banorëve në bazë të kuadrit ligjor që rregullon procedurat e shpronësimit. *me pikën 4, të nenit 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, dhe pikës 17, të nenit 3, të Ligjit nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, evidentojmë se në të përcaktohet shprehimisht që: "Leje zhvillimi" është akti i përcaktimit të kushteve zhvillimore për një parcelë/pronë të caktuar, që shërben si bazë për pajisjen me leje ndërtim*[5] *i*
2. Kërkuesi ARRSH nuk ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të përcaktuara në *Nenin 10 Ligji nr.8561 datë 22.12.1999 Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese të kërkesës për shpronësim1. Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë ne ministrinë kompetente sipas ligjit, kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: a) Aktet që vërtetojnë cilësinë dhe regjistrimin e tij si person juridik. b) Projektet e nevojshme dhe të miratuara sipas ligjit, si dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik, lidhur me realizimin e këtyre projekteve. c) Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit. ç) Vlerësimi paraprak i objekteve të shpronësimit dhe i masës së shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat. d) Lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet. dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse. e) Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës.*
3. Në lidhje me objektet në pasuritë që janë shpronësuar nuk rezulton të jenë kryer verifikime në terren ,por as të jenë kërkuar të dhëna specifike për çdo pasuri dhe vlerën nominale të saj (aty ku janë përjashtuar nga shpronësimi)[6].*Veprime këto që vijnë në kundërshtim me detyrën funksionale të anëtarëve të komisionit të normuara në Rregulloren e Brendshme të ASHSH*[7] *përcaktuara në VKM nr.395 datë 13.10.2020.*
4. Midis ASHSH dhe ARRSH është lidhur Aktmarrëveshja nr. 369/6 datë 06.09.2022 e cila rezulton të jetë hartuar e përfunduar për të gjitha efektet e saj një ditë para njoftimit për pranimin e kërkesës për shpronësim në kundërshtim të hapur me të gjitha dispozitat e urdhërimet e ligjit nr. 8561/1999 i ndryshuar saktësisht me *nenin 13 "Pranimi i kërkesës" pika 2, ku citohet se "Brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të pranimit të kërkesës për shpronësim ndërmjet subjektit kërkues në favor të të cilit kërkohet të bëhet shpronësimi dhe ministrisë kompetente, lidhet një marrëveshje për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella, lidhur me procedurën e shpronësimit".*
5. Nga komisioni nuk është kërkuar të bëhet publikimi i kërkesës për shpronësim të pronave, të cilat preken nga ky Project i cili ka ndryshuar për shkak të devijimeve nga projekti

---

[5] *Korrelacioni ligjor ndërmjet dy nocioneve dhe akteve administrative konkrete respektive, jepet në nenin 37, të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: "Zhvillimi lejohet vetëm në kushtet e përcaktuara nga dokumentet e planifikimit ose, në mungesë të tyre, të aprovuara nga organi kompetent, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit që shoqëron kërkesën për lejen e ndërtimit*

[6] *neni 16.pika c e rregullores së brendëshme të ashsh.*

[7] *a) të organizojë punën për planifikimin dhe trajtimin e kërkesave për shpronësim, të paraqitura nga subjektet kërkuese të shpronësimit dhe institucionet përkatëse; b) të organizojë punën për ndjekjen dhe realizimin e mbikëqyrjes së ecurisë së procedurave të procesit të shpronësimeve.*

fillestar, veprim në kundërshtim me nenin 15 *"Publikimi i kërkesës për shpronësim për interes publik"*, pika 1, i ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, si dhe njoftimi i drejtpërdrejtë i secilit pronar/ bashkëpronar të pasurive pronë private që kërkohet të shpronësohen ose zhvlerësohen[8]në kundërshtim me dispozitat e KPA.

6. Nuk eshte administruar ndonjë veprim administrativ që të pasqyrojë veprimet e Komisionit për monitorimin e procesit të shpërblimit për personat e shpronësuar. Një praktikë e tillë bie ndesh me përcaktimet ligjore për veprimtarinë ligjore të komisionit. Shkelje e Parimit të Sigurisë Juridike dhe të Shtetit të së Drejtës.

Praktika është realizuar nga: Anëtarët e komisionit të posaçëm të shpronësimeve me përbërje B. Nuredini Ekonomiste, B. Hysaj Inxhinier, E. Bytyçi Inxhinier, D. Dosti Jurist, A. Koçi Ekonimist.

XII. Dosja e procedurës së shpronësimit për realizimin e projektit "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë – Vorë – Kashar " (finalizuar me VKM Nr. 332., datë 31.05.2023) në shumën 115,359,481.9 lekë.

Shoqëria "G2 Infra" shpk, së bashku me Shoqërinë "Gener 2" sh.p.k në cilësinë e Koncesionarit ka nënshkruar me Autoritetin Kontraktor, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Kontratën e Koncesionit Nr. 2088 Rep, Nr. 670 Kol, datë 09.05.2022, "Për Projektimin, Ndërtimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Aksit Rrugor "Thumanë- Vorë — Kashar", miratuar me VKM Nr. 360, datë 26.05.2022, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 82, datë 01.06.2022 Në kontratën e koncesionit, nga ana e Koncesionarit është marrë përsipër detyrimi për identifikimin e objekteve për shpronësim e cila përkufizohet në faqen 12 të kontratës si detyrimi për përpilimin nga Shoqëria Koncesionare të një liste të pronave dhe pronarëve brenda territorit të projektit, të cilat në datën e nënshkrimit ndodhen të regjistruara në ASHK dhe që duhen shpronësuar nga Autoriteti Përkatës.

Konkluzion:Në këtë procedurë shpronësimi është konstatuar fenomeni se gjatë fazës së publikimit të kërkesës për shpronësim si dhe afatit të paraqitjes së ankesave, janë paraqitur në rrugë administrative 50 ankesa nga qytetarët të cilët kanë paraqitur pretendime lidhur me masën e vlerësimit. Ankesat e pronarëve janë dërguar për trajtim dhe kompetencë subjektit kërkues Shoqërisë "G2 Infra",sh.p.k., të cilat pasi janë kthyer përgjigje, janë vijuar procedurat e mëtejshme për shpronësim, për interes publik.Nuk është dokumentuar ndonjë formë e zgjidhjes së ankesave si nga ana e subjektit kërkues ashtu edhe nga ana e Institucionit shtetëror që sipas ligjit e ka detyrë funksionale. Nga ana e Institucionit është " **deleguar**" defacto kompetenca ligjore e negocimit me pronarët që sipas ligjit nr.8561 datë 22.12.1999, i përket vetëm K.P.SH.

Procedura e ndjekur për miratimin e kërkesës për shpronësim.

Nëpërmjet shkresës me Nr. 7 Prot., datë 11.01.2023, protokolluar në ASHSH me Nr. 8 Prot., datë 11.01.2023, është paraqitur "Kërkesë për Shpronësim në Aksin Rrugor "Thumanë-Vorë-Kashar".

ASHSH, në zbatim të nenit 11, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, si dhe në vijim të kërkesës për shpronësim të sipërcituar, me urdhrin Nr. 179, datë 06.12.2022, të Drejtorit të

---

[8] *Neni 106 KPA Botimi i akteve në Fletoren Zyrtare 1. Botimi i akteve administrative në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm, kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji. 2. Mosbotimi i aktit në Fletoren Zyrtare, kur kjo kërkohet shprehimisht nga ligji, shkakton moshyrjen në fuqi të aktit*

Përgjithshëm në ASHSH, ka ngritur Komisionin e Posaçëm të Shpronësimit, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, në zbatim të Ligjit Nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar.
Pasuritë të cilat janë prekur nga projekti rezultojnë të llojit "arë", "truall" dhe "ndërtesë".
Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, pranë ASHSH, ka verifikuar dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës për shpronësim, si dhe dokumentacionit të paraqitur nga Shoqëria "G2 Infra" sh.p.k., me shkresën Nr. 56 Prot., datë 31.03.2023, protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin me shkresën nr. 78/16 prot., datë 31.03.202 dhe ka vijuar me pranimin e kërkesës për shpronësim.
Konkretisht me shkresën nr. 78/17 prot., datë 31.03.2023., është njoftuar Shoqëria "G2 Infra", sh.p.k për pranimin e kërkesës për shpronësim;
Është lidhur akt-marrëveshje ndërmjet subjektit kërkues Shoqërisë "G2 Infra", sh.p.k dhe ASHSHin, për detyrimet e ndërsjella, lidhur me procedurën e shpronësimit, me akt notarial Nr. rep., 1866 Nr. Kol. 606, Tiranë datë 05.04.2023.
Me shkresën nr. 78/22 datë 05.04.2023, është dërguar shkresa për publikimin e kërkesës për shpronësim në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 05.04.2023
Me shkresat nr. 78/23 prot, datë 05.04.2023, njoftimi i drejtpërdrejt i pronarëve të pasurive, pronë private që shpronësohen.
Në Fletoren Zyrtare Nr. 49, datë 27.03.2023, është publikuar kërkesa nr. 78/22, datë 05.04.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë-Vorë-Kashar".

Konkluzion: Grupi I Auditimit konkludon se në këtë procedure shpronësimi nuk u konstatuan problematikat lidhur me mungesën e projekteve, lejeve zhvillimore, njoftimeve, dokumentacion pronësie harta treguese, publikime aktesh etj., që janë ndeshur në procedurat e tjera të shpronësimit.
Ky fenomen tregon standardin e dyfishtë të punës së K.P.SH-së. Në rastin kur subjekti kërkues është ent ose institucion shtetëror kërkesat e ligjit janë anashkaluar, toleruar e shkelur.

Konstatime:

1. Me paraqitjen e kërkesës për shpronësim, ASHSH-ja ka urdhëruar ngritjen e komisionit të posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit (neni 11, pika 2 e ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999)
2. ASHSH-ja Ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, në favor të të cilit është kërkuar shpronësimi, për dokumentacionin e paraqitur, për shkakun e shpronësimit, si dhe administruar aktet e pronësisë për objektet e shpronësimit, duke kryer edhe verifikime (neni 12, pika 1 ligji 8561/1999 I ndryshuar). Në përfundim të verifikimeve të nevojshme, si dhe të procedurave të parashikuara në nenin 12 të ligjit sipërcituar, pas konstatimit se kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues përkatës kanë qenë të mbështetura në kushtet dhe kriteret e këtij ligji, ASHSH ka vendosur për pranimin e kërkesës për shpronësim, duke njoftuar me shkrim subjektin kërkues në favor të të cilit bëhej shpronësimi. Brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të pranimit të kërkesës për shpronësim ndërmjet subjektit kërkues në favor të të cilit të bëhej shpronësimi dhe ASHSHin, është lidhur një marrëveshje për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella mes palëve, lidhur me procedurën e shpronësimit. Në rastin e kërkuesit subjekt privat kjo marrëveshje është bërë me akt noterial. Në aktmarrëveshje palët kanë marrin përsipër plotësimin e detyrimeve të ndërsjellta.

3. Aktmarrëveshja është e pavlefshme në rast se në çastin e nënshkrimit të saj nuk i bashkëlidhen dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim sipas nenit 13.pika 4 e ligjit nr. 8561/1999. Nga auditimi ka rezultuar se Aktmarrëveshja nuk ka bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues sipas ligjit.
4. Grupi I Auditimit konstaton se këto veprime cënojnë parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet "Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi". Mosveprimi në këtë kuptim, vendos organin administrative shtetëror në kushtet e parashikuara në ligjin nr. 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike", të ndryshuar (ligji nr. 8510/1999), Në kuptimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore, si një detyrim i organeve të administratës shtetërore, për të shpërblyer dëmin që i është shkaktuar interesave të shtetit dhe/ose shtetasëve privat, në ushtrim e sipër të funksioneve publike, shkronja "a", e nenit 3, e ligjit nr. 8510/1999, parashikon se: "Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijojnë: Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme". Në procedurën e shpronësimit për realizimin e Projektit Thumanë-Kashar nga ana e organit administrativ janë shkelur procedurat ligjore.

Praktika është realizuar nga: Anëtarët e komisionit të posaçëm të shpronësimeve me përbërje E. Ibrahimi, A. Drenofci, K. Guci, B. Hysaj.

XIII. Dosja e procedurës së shpronësimit për realizimin e Projektit "Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik "Teda Tiranë" V.K.M nr. 286, datë 17.5.2023 , vlera 115,592,960 lekë (16 milion euro).

Në funksion të realizimit të veprës publike, Bashkia Tiranë me cilësinë e kërkuesit në zbatim të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private, për interes publik" i ndryshuar, datë 21.11.2022, është depozituar kërkesa për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit "Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik "Teda Tiranë". Nga ana e Bashkisë Tiranë, janë bërë veprimet paraprake për evidentimin, shpronësimin dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private për interes publik, që preken nga projekti.

Konkluzion: Grupi i Auditimit konkludoi se në kërkesën e Bashkisë Tiranë, në cilësinë e subjektit kërkues të shpronësimit, gjatë evidentimit të pronave që përfshiheshin brenda gjurmës së rrugës, listën e pasurive pronë private që preken nga shpronësimi si dhe vlerësimin paraprak për kompensim, për pasuritë objekt shpronësimi, nuk është janë konsideruar aktet administrative në që përcaktojnë vijën kufizuese të qyetit. Vlerësimi paraprak për kompensimin, për pasuritë objekt shpronësimi është realizuar në mbështetje të Vendimit Nr. 89, datë 03.02.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.

Procedura e ndjekur për miratimin e kërkesës për shpronësim.

Pas shqyrtimit të kërkesës me shkresën Nr. 326/2 Prot., datë 7.3.2023 është njoftuar Bashkia Tiranë, për pranimin e kërkesës për shpronësim dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 13, të Ligjit nr. 8561, datë.22.12.1999, i ndryshuar, është lidhur akt-marrëveshje ndërmjet subjektit kërkues Bashkisë Tiranë dhe ASHSHin, *për detyrimet e ndërsjella, lidhur me procedurën e shpronësimit.*

Me shkresën Nr. 326/4 Prot., datë 10.3.2023, është dërguar për publikimin e kërkesës për shpronësim në Qendrën e Botimeve Zyrtare. Kërkesa është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 40, datë 13.3.2023.
Me shkresën Nr. 326/5 Prot., datë 13.3.2023, është bërë njoftimi i drejtpërdrejtë i pronarëve të pasurive, pronë private që shpronësohen.
Në Fletoren Zyrtare Nr. 40, datë 13.3.2023, është publikuar Kërkesa Nr. 326/4, datë 10.3.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik 'TEDA Tiranë".
Gjatë fazës së publikimit të kërkesës si dhe afatit të paraqitjes së ankesave, rezultoi se, nuk janë paraqitur ankesa në ASHSH nga qytetarët e prekur nga realizimi i këtij projekti, për interes publik.
Vlerësimi për pasuritë e llojit "*arë*", të përcaktuar sipas zërit kadastral në kartelën e pasurisë, është bërë bazuar në Vendimin Nr. 89, datë 03.02.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
Këshilli i Ministrave, me anë të VKM Nr. 286, datë 17.5.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik 'TEDA Tiranë", e miratoi këtë projekt-vendim.
Sipas VKM Nr. 286, datë 17.5.2023, rezultojnë të shpronësuara gjithsej **64 pasuri pronë private**.

Konkluzion: Grupi i Auditimit konkludoi se VKM Nr. 286, datë 17.5.2023, sa i përket vlerës së shpronësimit të pasurive prone private , si dhe pretendimit mbi kompensimin e sipërfaqes përjashtuar nga shpronësimi, si rrjedhojë e realizimit të projektit 'TEDA Tiranë" është kundërshtuar gjyqësisht nga të shpronësuarit. Janë dhënë vendime gjyqësore për pranim të kërkesëpadisë në 10 procese gjyqësore, nga Gjykata e Shkallës së Parë me trend në rritje të kërkesave të pranuara.

Pranimi i pretendimeve të të shpronësuarave në masën mbi 50% nga ana e Gjykatës tregon një probabilitet që duhet konsideruar që në këtë fazë me pasoja në disa drejtime.
Në thelb vendimi i gjykatës ka pranuar kundërshtimin e vlerës së shpronësimit të përllogaritur nga Bashkia Tiranë dhe të miratuar nga KM.
Nga ASHSH është legjitimuar vlera e shpronësimit për pasuritë me status juridik të pronës '' Arë'' sipas kritereve ligjore të sipërcituar për këtë lloj pasurie të pasqyruara në zonat kadastrale.
Bashkia (kërkuesi) nuk ka reflektuar pranë Kadastrës aktet nënligjore që vetë ka miratuar që automatikisht ndryshojnë zërin kadastral të pronës që reflekton dhe vlerën e saj, por as nuk e ka bërë të ditur për ASHSH këtë fakt.
Gjykata me të drejtë ka arsyetuar se me vendimin *Nr.3 datë 16.12.2004 KRRTSH ka miratuar vijën kufizuese të qytetit Tiranë. Ky vendim ka ndryshuar statusin juridik të pasurive sipas përcaktimeve të ligjit Nr.7980 datë 27.5.1995 "Për shitblerjen e trojeve në RSH", konkretisht nenit 1 të këtij ligji; ''truall quhet e gjithë toka që ndodhet brenda vijave kufizuese të qyteteve (Bashkive) pavarësisht nëse përdoret për ndërtim, kopësht, arë etj. etj.... ". Vendimi i KRRTSH nuk është reflektuar në zërat kadastralë të pasurive me qëllim saktësimin e statusit juridik të secilës pasuri për të cilën është kërkuar shpronësimi. Siç dhe Bashkia si institucioni kompetent për menaxhimin e territorit të saj nuk ka reflektuar në kërkesat për ASHK dhe për ASHSH pasojat ligjore të vendimit të KRRTSH nr.3 datë 16.12.2004.*

Të dhënat në shifrat e përfituara paraqiten në tabelën si vijon:

PROCESE GJYQESORE PER PROJEKTIN TEDA

	Pala Paditëse	Nr. i pasurisë	Shpronësuar për sipërfaqen tokë "arë" m2	Vlera e përcaktuar me VKM Nr. 286/2023	Vlera e akorduar sipas Vendimit të Gjykatës	Diferenca llogaritur "Truall".
1	Hamza Gjokmeli	23/24	2300 m2	1,030,400 lekë	*/Pranim detyrimi i Bashkisë Tiranë*	Detyrim i bashkisë
2	Avdulla Bakalli	181/28	6500 m2	2,912,000 lekë	Në proces gjyqësor	
3	Banush Bakalli	181/29	4500 m2	2,016,000 lekë	Në proces gjyqësor	
4	Fatbardha Nozlli Sherif Nozlli	23/10	2550 m2	1,142,400 lekë	Në proces gjyqësor	
5	Albert Nozlli Baki Nozlli	23/29	5100 m2	2,284,800 lekë	88,021,680 lekë	85,736,880 lekë
6	Selim Çaushi	116/12	5281 m2	2,365,888 lekë	42,000,000 lekë	39,634,112 lekë
7	Baki Nozlli Hike Nozlli	23/3	5100 m2	2,284,800 lekë	*/Pranim i pjesshëm i kërkesëpadisë dhe detyrimi i Bashkisë Tiranë*	Detyrim i bashkisë
8	Ramazan Lasku	181/3	5300 m2	2,374,400 lekë	20,108,200 lekë	17,733,800 lekë
9	Vathe Egra	562/10	1037 m2	464,576 lekë	13,960,094 lekë	13,495,518 lekë
10	Vilson Milloshi	116/37	3800 m2	1,702,400 lekë	Në proces gjyqësor	
11	Kujtim Çaushi	116/21	4200 m2	1,881,600 lekë	Në proces gjyqësor	
12	Shoqëria "Everest IE"	116/6 116/9	6000m2 8000 m2	2,688,000lekë 3,584,000 lekë	111,642,600 lekë	108,058,600 lekë
13	Ferdinand Hysenbelliu	562/4	6760 m2	3,028,480 lekë	91,003,120 lekë	87,974,640 lekë
14	Halil Nozlli	23/6	3000 m2	1,344,000	Në proces gjyqësor	
15	Xhevdet Nozlli	23/5	6000 m2	2,688,000 lekë	Në proces gjyqësor	
16	Mustafa Gjokmeli	23/11	1507 m2	675,136	17,833,838 lekë	17,158,702 lekë
17	Elidian Nozlli Erjon Sulaj	181/32 181/34 181/68	3700 m2 800 m2 1200 m2	1,657,600 lekë 358,400 lekë 537,600 lekë	Në proces gjyqësor	
18	Sami Nozlli	23/27	1000 m2	448,000 lekë	Në proces gjyqësor	
19	Myzafer Milloshi	116/3	5550 m2	2,486,400 lekë	Në proces gjyqësor	
20	Petrit Bakalli/Vjollca Bakalli	23/28 23/31	1500 m2 1500 m2	672,000 lekë 672,000 lekë	Në proces gjyqësor	
21	Shaqir Shehi	181/54	3300 m2	1,478,400 lekë	Në proces gjyqësor	
22	Ismail Nozlli	23/1	11,000 m2	4,928,000 lekë	148,082,000 lekë	143,154,000 lekë
23	Baki Bakalli	181/2	11,000 m2	4,928,000 lekë	Në proces gjyqësor	
24	Ardjana Çaushaj	23/32	500 m2	224,000 lekë	Në proces gjyqësor	
25	Hysen Çaushi	116/24	2100 m2	940,800 lekë	19,963,680 lekë	19,022,880 lekë

Nga të dhënat e tabelës konkludohet qartazi se formula e shpronësimit e aplikuar nga gjykata derivon një vlerë shpronësimi preferenciale por ligjore për subjektet e shpronësuara.
Ky fakt ka ardhur si rezultat I zbatimit korrekt te dispozitave ligjore në mënyrë analitike.

Konstatime :

1. Grupi i auditimit nuk vlerëson se ka shkelje të ligjit nga ana e ASHSH gjatë procedurës së aplikuar në këtë proces ,por është domosdoshmëri që të rekomandojë ndërhyrje ligjore Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar; Ligji nr. 7980, datë 27.5.1995, "Për shitblerjen e tokave në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar. Ligjin Nr. 10018, Datë 13.11.2008: Për Avokaturën e Shtetit" ndryshuar me ligjin nr. 86/2018 për të mbuluar paqartësitë dhe zbatimin e standardit të vendosur nga ana e gjykatës me qëllimin parandalimin e ardhjes së pasojës financiare në dëm të buxhetit të shtetit.

2. Nuk është vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit duke mos marrë masa për të parandaluar ardhjen e dëmit ekonomik për buxhetin e shtetit ose efektin financiar negativ si rezultat i llogaritjes së gabuar të vlerës së shpronësimeve konstatuar nga gjykata në masën 560,230,000 lekë nëpërmjet mos aplikimit të çmimit të pronës sipas standardit të vendosur nga

Gjykata që rrjedh si pasojë ligjore e vendimit të K.RR.T.SH nr. 3, datë 16.12.2004 për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit Tiranë.

Praktika e shpronësimit është realizuar nga: Anëtarët e komisionit të posaçëm të shpronësimeve E. Ibrahimi, B. Nuredini, B. Hysaj, O. Murataj S. Qato.

Komente të Subjektit: Ndër të tjera subjekti ka sqaruar se, vlerësimi për pasuritë objekt shpronësimi të prekura në kuadër të realizimit të projektit "TEDA Tiranë" është llogaritur sipas vlerësimit për tokën "Arë", të konfirmuar sipas dokumentacionit pronësor të vendosur në dispozicion nga ana e subjektit kërkues Bashkia Tiranë, ndaj me të drejtë nga ana e ASHSH pasuritë e shpronësuara janë trajtuar sipas këtij regjimi. Në rast se komisioni i posaçëm për shpronësimin do të vlerësonte pasuritë objekt shpronësimi me vlerësim për truall, ndërkohqë që këto pasuri referuar dokumentacionit pronësor rezultojnë të llojit "Arë", mund të krijonte rrezikun që të shkaktohej apo të rëndohej buxheti i shtetit, pasi vetë dokumentacioni pronësor të dikton për ti vlerësuar këto pasuri sipas vlerës që përkon për llojin e pasurisë "Arë".

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Komentet janë të pa mbështetura në Ligj. Por veprimet e ASHSH të cila janë të kontestuara nëpërmjet komenteve nuk janë gjetur në shkelje të ligjit dhe ky fakt është bërë i qartë në PRA, është gjykata ajo që ka disponuar me vendim gjyqësor dhe ka diktuar një " *status*" tjetër për pasuritë e shpronësuara. Vendimet e gjykatës zbatohen pa interpretim.

XIV. Dosja e procedurës së shpronësimit për realizimin e projektit "Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore" vlera e projektit 537,441,630 lekë.

Në funksion të realizimit të veprës publike, në zbatim të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private, për interes publik" i ndryshuar, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e subjektit kërkues të shpronësimit me datë 20.03.2023, është depozituar kërkesa "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, janë bërë veprimet paraprake për evidentimin, shpronësimin dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private për interes publik, që preken nga projekti si më sipër, duke sqaruar se, ky shpronësim kërkohet sipas germës d, të pikës 8, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, (d) *Për realizimin e programeve dhe investimeve në fushën e mbrojtjes kombëtare".*

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e subjektit kërkues të shpronësimit, ka kryer evidentimin e pronave që përfshiheshin brenda gjurmës së projektit, duke përcjellë pranë ASHSH, listën e pasurive pronë private që preken nga shpronësimi si dhe vlerësimin paraprak për kompensim, për pasuritë objekt shpronësimi.

Procedura e ndjekur për miratimin e kërkesës për shpronësim.

ASHSH, në zbatim të nenit 11, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, si dhe në vijim të kërkesës për shpronësim të sipërcituar, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm në ASHSH, nr. 52, datë 23.03.2023, i ndryshuar, ka ngritur Komisionin e Posaçëm të Shpronësimit, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, në zbatim të Ligjit Nr. 8561 datë 22.12.1999 i ndryshuar.

Pasuritë të cilat preken nga projekti janë të llojit "ndërtesë" dhe "njësi".

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, ngritur pranë ASHSH, pasi ka verifikuar të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës për shpronësim, si dhe dokumentacionin e depozituar ka vijuar me pranimin e kërkesës për shpronësim.

Konkretisht, me shkresën Nr. 362/12 prot., datë 26.09.2023, njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për pranimin e kërkesës për shpronësim; Në zbatim të pikës 2, të nenit 13, të Ligjit nr. 8561, datë.22.12.1999, i ndryshuar, është lidhur akt-marrëveshje ndërmjet subjektit

kërkues Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ASHSH-in, për detyrimet e ndërsjella, lidhur me procedurën e shpronësimit duke iu bashkëlidhur aktet. Me shkresën Nr. 362/14 prot., datë 27.09.2023, dërgohet shkresa për publikimin e kërkesës për shpronësim në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe botohet në Fletoren Zyrtare Nr. 140, datë 27.09.2023. Me shkresën Nr. 362/15 prot., datë 28.09.2023, njoftohen drejtpërdrejtë pronarët pasurive, pronë private që shpronësohen.
Gjatë fazës së publikimit të kërkesës si dhe afatit të paraqitjes së ankesave, rezultoi se, nuk janë paraqitur ankesa nga qytetarët e prekur nga realizimi i këtij projekti. Nuk ka pasur kërkesëpadi/proces gjyqësor, me objekt kundërshtim VKM Nr. 800, datë 28.12.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore". Procedura rezulton korrekte.

XV. Dosja e procedurës së shpronësimit për realizimin e projektit "Ndërtimi i Rrugës Shëngjin – Baks - Rrjoll, segmenti nga km + 0.00 deri në km 7 + 310" me vlerë 14,453,706,763 lekë.

Në funksion të realizimit të veprës publike, bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet për interes publik të pasurive pronë private", të ndryshuar, Bashkia Lezhë, me shkresën nr. 19731 prot., datë 14.12.2022, protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin (Në vijim ASHSH) me shkresën me nr. 905 prot., datë 20.12.2022, ka paraqitur kërkesën për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Rrugës Shëngjin – Baks-Rrjoll, segmenti nga km + 0.00 deri në km 7 + 310".
Projekti është pjesë e projekteve për zbatim, në vijim të Marrëveshjes së Huasë datë 10.02.2020, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim "Për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri", të miratuar me Ligjin Nr. 44/2020 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropianë për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri", ku vlerësimi i pasurive objekt shpronësimi bazohet në pikën 5.1, Skeduli 3 "Plani i veprimit mjedisor dhe social", Kërkesa e shpronësimit në Shqipëri, sipas BERZH.

Konkluzion: Vlerësimi për pasuritë e llojit "arë", "truall" "pyll" dhe "kullotë", në zbatim të marrëveshjes së sipërcituar, është bërë në zbatim të pikës 4, të nenit 17, "Vlerësimi i objekteve që shpronësohen", të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se, "Masa e shpërblimit për pasuritë, pronë private, që shpronësohen për interes publik, për realizimin e projekteve dhe të investimeve në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar me ligj, llogaritet në përputhje me parashikimet e marrëveshjes, në rastet kur atje përcaktohet edhe mënyra e përllogaritjes së masës së shpërblimit" **sipas çmimit të tregut në çdo rast.**

Procedura e ndjekur për realizimin e shpronësimit.
Rezultoi se, në zbatim të dispozitës ligjore në fjalë si dhe referuar dispozitave të Marrëveshjes së Huasë datë 10.02.2020, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim *"Për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri", të miratuar me Ligjin Nr. 44/2020 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e*

Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri", vlerësimi i pasurive objekt shpronësimi bazohet në pikën 5.1, Skeduli 3 "Plani i veprimit mjedisor dhe social", Kërkesa e shpronësimit në Shqipëri, sipas BERZH.

Në zbatim të këtyre dispozitave është përgatitur Raporti i Vlerësimit nga "AOL Studio sh.p.k.", të kontraktuar dhe miratuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në bazë të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis kësaj të fundit dhe Bashkisë Lezhë, për realizimin e projektit "Ndërtimi i Rrugës Shëngjin – Baks - Rrjoll, segmenti nga km + 0.00 deri në km 7 + 310".

Në marrëveshjen e Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale në Shqipëri, e ratifikuar me ligjin nr. 44/2020, në seksionin 3.05 është parashikuar që për të asistuar në zbatimin e Projektit, Huamarrësi përmes Entit Zbatues, përveç kur bihet dakord ndryshe me Bankën, punëson ose nxit punësimin, sipas kërkesës dhe përdor konsulentë, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës së të cilëve janë të pranueshme për Bankën.

Bazuar në këtë parashikim të Marrëveshjes së Huas është bërë inicimi i lidhjes së kontratës ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe "AOL Studio sh.p.k." për të vijuar më pas me **përgatitjen e Raportit për vlerësimin dhe planin e shpronësimit si dhe të risistemimit për objektet. Në këtë raport, i cili është i miratuar edhe nga BERZH, është shpjeguar mënyra e përllogaritjes për vlerësimin përfundimtar të pasurive objekt shpronësimi.**

Vlerësimi i pasurive objekt shpronësimi është bërë duke pasur parasysh shkronjën "a", në Seksionin 3.04, të Marrëveshjes së Huas e cila parashikon që "Huamarrësi, drejtpërdrejtë, përmes Entit Zbatues apo mënyrave të tjera (si të çmohet e përshtatshme) siguron që çdo kontraktues ta zbatojë Projektin në përputhje me Kërkesat e përcaktuara të Performancës, Ligjet Mjedisore dhe Sociale dhe të gjitha lejet, licencat, certifikatat dhe miratimet përkatëse mjedisore. Bazuar në përkufizimet që gjenden në Seksionin 1.02 të Marrëveshjes së Huasë, "Kërkesat e Përcaktuara të Performancës", janë Kërkesat e Performancës nga 1-shi deri te 8-a, si dhe 10-ta (në varësi të kontekstit), të Kërkesave të Performancës të majit 2014, lidhur me Politikën Mjedisore dhe Sociale të Bankës, të muajit maj 2014. Gjithashtu, në po këtë Marrëveshje, në Skedulin 3, në pikën 5.1, është parashikuar si veprim që kuadri i politikave të zhvendosjes të jetë i bashkërenduar me Kërkesën e Performancës nr. 5.

Duke vijuar, Kriteri i Performancës nr. 5, në dokumentin Politika Mjedisore dhe Sociale të Bankës, "*Marrja e tokës, shpërngulja e detyruar dhe zhvendosja për arsye ekonomike*", ndër të tjera parashikon që "Objektivat e këtij kriteri performance janë: zbutja e ndikimeve të padëshirueshme sociale dhe ekonomike nga marrja e tokës ose kufizimet mbi përdorimin dhe të drejtën e përdorimit të mjeteve dhe të tokës së personave të prekur përmes: i. ofrimit të kompensimit për humbjen e mjeteve me koston e zëvendësimit...". Lidhur me shkronjën "*i*" është sqaruar në vijim në këtë dokument se "Zakonisht kjo llogaritet me vlerën e tregut të mjeteve plus kostot e transaksionit të lidhura me rivendosjen e këtyre mjeteve. Llogaritja e kostove të zëvendësimit është komplekse për shkak të luhatshmërisë së mundshme të tokës, pretenduesve për përdorimin e tokës dhe niveleve të ndryshme të zhvillimit të tregut të tokës në vendet e ndryshme anëtare.

Për këtë arsye, klientët duhet të identifikojnë dhe të konsultojnë të gjithë personat dhe komunitetet që do të zhvendosen për shkak të marrjes së tokës, si edhe komunitetet pritëse që do të pranojnë personat e shpërngulur, në mënyrë që të merret informacioni i duhur për titujt, të drejtat dhe përdorimin e tokës. Metoda e vlerësimit për përcaktimin e kostos së zëvendësimin duhet të dokumentohet në planet përkatëse të shpërnguljes dhe/ose të rivendosjes së mjeteve të jetesës. Kur tregjet e tokës janë ende në fazën e lindjes, klientët duhet të kërkojnë vlerësimin e ekspertëve të jashtëm, të pavarur e profesionistë të vlerësimit (*ose nëse nuk ka ekspertë të tillë profesionistë vlerësimi, profesionistë të tjerë me njohuritë përkatëse prej eksperti, të pranueshme për BERZH-in dhe klientin).*

Duke pasur parasysh bazën ligjore të mësipërme, "AOL Studio sh.p.k.", në raportin për vlerësimin dhe planin e shpronësimit si dhe të risistemimit për objektet, të miratuar nga BERZH, ka shpjeguar metodologjinë e përdorur për përcaktimin e vlerës për pasuritë që janë objekt shpronësimi sipas këtij projekti.

Në përfundim të të gjitha fazave dhe marrjes në konsideratë të indikatorëve, ekspertët kanë bërë vlerësimin përfundimtar për vlerën e pasurive, konform Kërkesave të Performancës numër 5, të përcaktuar në Politikat Mjedisore dhe Sociale të BERZH, si dhe ky vlerësim i bërë nga ekspertët është miratuar më pas nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. *Në faqet 95-96 të Planit për Shpronësimin dhe Risistemimin (LARP) të miratuar nga BERZH, gjenden vlerat e përllogaritura për pasuritë që prekën nga ky projekt.*

Pas përfundimit të afatit 15 ditor të publikimit të kërkesës për shpronësim, në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 03.02.2023, të kërkesës nr. 62/4, datë 26.01.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll-Velipojë Loti 1, Faz 1", Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit më datë 20.02.2023, ka miratuar propozimin për shpronësim për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll-Velipojë Loti 1, Faz 1", sipas listës bashkëlidhur procesverbalit, në vlerë të përgjithshme prej 9 337 698.25 (nëntë milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë njëzet e pesë) lekë.

-Për VKM Nr. 246/2023 që ka miratuar shpronësimet në kuadër të realizimit të këtij projekti nuk ka asnjë ankim administrativ, apo proces gjyqësor të nisur në kuadër të këtij projekti.

XVI. Dosja e procedurës së shpronësimit për realizimin e projektit "Ndërtimi i Nënstacionit 400 kv Elbasan 3" vlera 36,881,231.58 lekë.

Në funksion të realizimit të veprës publike, në zbatim të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private, për interes publik" i ndryshuar, nga ana e subjektit në favor të të cilit realizohet projekti, Operatori i Sistemit të Transmetimit, ka paraqitur kërkesën për shpronësimin për disa shtesa dhe ndryshime në "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 749, datë 01.12.2022 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i nënstacionit 400 kv Elbasan 3".

Konkluzion: Kriteret e Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar janë aplikuar me standard të dyfishtë duke cënuar parimin e sigurisë juridike. Në rastin e ekzekutimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare të Huasë vlera e pasurive të shpronësuara është llogaritur sipas termave të dakortësuara në marrëveshje(vlerës së tregut), jo sipas hartës së çmimeve të miratuara me VKM-në nr. 89 datë 03.02.2016 për pasuri të të njëjtit lloj kadastral.

Procedura e ndjekur për realizimin e shpronësimit.

Kërkesa për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 749, datë 01.12.2022 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i nënstacionit 400 kv Elbasan 3", është shqyrtuar nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ngritur me Urdhrin nr. 18, datë 08.01.2024, të ndryshuar, të Drejtorit të Përgjithshëm, të ASHSHin.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur kërkesës për shpronësim, komisioni ka mbajtur procesverbal, në të cilin ka vendosur pranimin e kërkesës.

Pas përmbushjes së dokumentacionit të kërkuar për shpronësim, në zbatim të nenit 10 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të

pasurive pronë private, për interes publik", i ndryshuar, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ka pranuar kërkesën për shpronësim dhe ka lidhur akt-marrëveshjen me subjektin kërkues duke njoftuar drejtpërdrejt Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a dhe pronarët.
Shpronësimi është realizuar sipas standardeve ndërkombëtare të fushës shpjeguar në dokumentin LACP/RAP), për ndërtimin e nënstacionit 400 KV Elbasan 3, kërkesë e Bankës Financuese KFV e bazuar në marrëveshjen e Huasë së projektit dhe e parashikuar në dokumentet kontraktuale.
Grupi i Auditimit nga kjo procedurë ka këto
Konstatime :

1. Trajtimi i pabarabartë në llogaritjen e vlerës së pronës ka krijuar dy standarde në zbatimin e të drejtës për shpronësim dhe është në kundërshtim me parimet Kushtetuese të barazisë para ligjit (neni 18 i Kushtetutës);parimin e proporcionalitetit dhe të së drejtës së pronës, të sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës dhe në nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ);legjislacionin shqiptar për shpronësimet, i cili parashikon se kompensimi duhet të jetë i drejtë dhe në përputhje me vlerën reale të pronës.
2. Në procedurën e realizimit të projektit Koncesionar rezultoi se pavarësisht se politikat e shpronësimit realizohen me të njëjtin standard ligjor vendas duke aplikuar të njëjtat ligje për vlerat e pasurive të shpronësuara çmimi diktohet nga vlera e tregut dhe koncesionari me qëllim që të shmangen me çdo kusht procedurat gjyqësore për procesin. Ky fakt krijon babarazi reale para ligjit dhe në treg për pronarët e pasurive objekt shpronësimi. I njëjti ligj nuk mund të ketë efekt diskriminues për një pronar dhe diskriminim pozitiv për një kategori tjetër pronarësh.
3. E drejta për një proces të rregullt ligjor konsiston në mbrojtjen e të drejtave të shtetasve dhe në detyrimin e organeve të pushtetit publik për të respektuar këto të drejta, duke përmbushur korrektësisht procedurat ligjore, në frymën dhe kuptimin e ligjit. Trajtimi i kësaj çështjeje në kushtet e analizuara në këtë auditim nga ana e organeve publike përgjegjëse, vjen ndesh me respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në rrafshin administrativ.

Observacione dhe komente të subjektit. Përsa më sipër, ndër të tjera sqarojmë se, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, me Memon Nr. 874/2/Prot., datë 13.11.2023, "Mbi problemet e hasura në praktikë nga legjislacioni në fuqi në fushën e shpronësimit për interes publik", drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës ka paraqitur kërkesën për mundësinë e ndryshimit të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe ndryshimin/përditësimin e akteve nënligjore përkatëse, ku midis të tjerave janë parashtruar problematikat lidhur me përcaktimin e pikës 4 të nenit 17 të ligjit. Pavarësisht sa më sipër, ASHSH do të vijojë përsëri të kërkojë ndryshimet e nevojshme ligjore të cilat do ti shërbejnë në përmirësim të legjislacionit...
Qëndrimi i Grupit të Auditimit.
Pranohet komenti i subjektit, është konstatim dhe i grupit të auditimit, për transparencë duhet sqaruar se subjekti nuk është gjetur me shkelje të procedurës së shpronësimit në rastin më sipër, problematika e analizuar është trajtuar në këndvështrimin e pabarazisë që vetë ligji ka krijuar.

XVII. Dosja e procedurës së shpronësimit që preken nga ndërtimi i objektit "Unaza Lindore Tiranë, Loti 3" finalizuar me VKM-në nr. 487, datë 30.07.2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e shpronësimit, për interes publik, "Kërkesë për shpronësim, (për disa shtesa në VKM-në nr.397, datë 13.05.2020), konstatohet që:

(Praktika e finalizuar me VKM-në 397, datë 13.05.2020 nuk është ndjekur nga ASHSH pasi kjo Agjenci nuk ishte krijuar ende)

Me anë të shkresës nr. 1978 Prot., datë 23.02.2021 (protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim (këtu e në vazhdim ASHSH) me nr. 47 Prot., datë 26.02.2021), Autoriteti Rrugor Shqiptar (këtu e në vazhdim ARRSH) ka paraqitur kërkesën për shpronësim, (për disa shtesa në VKM-në nr. 397, datë 13.05.2020) bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues.

Me shkresën nr. 47/1 prot., datë 25.03.2021, Urdhër nr. 28, datë 25.03.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, është krijuar Komisioni i Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurës së shpronësimit, për disa shtesa në VKM-në nr. 397, datë 13.05.2020 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit 'Unaza Lindore Tiranë, Loti 3', me përbërje: Erlis Hereni, Drejtor i Përgjithshëm, Kryetar; Martin Beqiraj, Ekonomist, anëtar; Blerta Dyrmishi, inxhiniere, anëtare; Klodian Elezi, jurist, anëtar; Aida Nika, Inxhiniere, anëtar; Funksioni i Sekretarisë Teknike kryhet nga z. Aleksandër Toma.
Me anë të procesverbalit datë 26.04.2021 Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit në ASHSH pas shqyrtimit të kërkesës vendosi;
Pranimin e kërkesës për shpronësim, të dërguar nga ARRSH, Për disa shtesa në Vendimin nr. 397, datë 13.05.2020 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit "Unaza Lindore Tiranë, Loti 3", me vlerë totale të shpronësimit **62,764,102** (gjashtëdhjetë e dy milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dy) lekë;
Me shkresën nr. 47/2, datë 28.04.2021, ASHSH i njofton ARRSH-së pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik, bashkëlidhur procesverbalin datë 26.04.2021.
Me shkresën nr. 47/3, datë 28.04.2021 mes ASHSH dhe ARRSH lidhet akt-marrëveshja për angazhimin e ndërsjellët të ASHSH, si autoritet përgjegjës dhe ARRSH, si subjekt kërkues, për marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave për shpronësim.
Me shkresën nr. 47/4, datë 10.05.2021, ASHSH dërgon për publikim pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare kërkesën për shpronësim për interes publik.
Me shkresën nr. 47/5, datë 10.05.2021, ASHSH njofton (nëpërmjet ARRSH-së) subjektin privat Rezart Ramazan Kthupi pasuria e të cilit preket nga shpronësimi për interes publik.
Me anë të procesverbalit nr. 2 datë 03.06.2021 Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit në ASHSH pas përfundimit të afatit 15 ditor të publikimit të kërkesës për shpronësim nr.47/4, datë 10.05.2021, në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 15.05.2021, në përfundim vendosi;
Miratimin e propozimit për shpronësim, për disa shtesa në Vendimin nr. 397, datë 13.05.2020 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit "Unaza Lindore, Loti 3", me vlerë totale të shpronësimit 62,764,102.00 (gjashtëdhjetë e dy milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dy) lekë.
Me shkresën nr. 47/6, datë 02.07.2021, ASHSH dërgon pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës (këtu e në vazhdim MIE) propozimin e projektvendimit për shpronësim, bashkëlidhur relacionin shoqërues.
Me shkresën nr. 3681/1 datë 02.08.2021 (protokolluar në ASHSH me nr. 47/7, datë 03.08.2021) Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH, VKM-në nr. 487, datë 30.07.2021 " Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 397, datë 13.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i objektit "Unaza Lindore , Loti 3".
Me shkresën nr. 47/9, datë 12.08.2021, ASHSH dërgon pranë ARRSH, VKM-në nr.487, datë 30.07.2021

Me shkresën nr. 47/10, datë 12.08.2021, ASHSH njofton (nëpërmjet ARRSH-së) subjektin privat Rezart Ramazan Kthupi për shpërblimin nga shpronësimi.

Konkluzion:

1. Kërkesa për shpronësim, (për disa shtesa në VKM-në nr.397, datë 13.05.2020), protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr. 47 Prot., datë 26.02.2021, është paraqitur e pa shoqëruar me dokumentacionin e plotë: Leje dhe miratim përkatës nga organet kompetente; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse; Dokumentacioni që vërteton shkakun e shpronësimit; Adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privatë që shpronësohen, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 "*Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999*" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 18 të "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*", ku përcaktohet se: "*Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen...*".
3. Vendimmarrja sipas procesverbalit datë 26.04.2021 të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar), ku përcaktohet se:
Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse, pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 23.03.2000, "*Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet*"
4. Aktmarrëveshja e lidhur mes ASHSH dhe ARRSH nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar)
5. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar, i kërkon ARRSH-së, *(citojmë:* Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e ARRSH marrjen e masave për njoftimin e tij.*)* realizimin e "Njoftim për shpronësim publik", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar), pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 23.03.2000, "*Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet*", pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.127, datë 23.03.2000, "*Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi. Ky njoftim është kryer përtej afatit 10 ditor nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit,
6. Në relacionin bashkëlidhur propozimit të projektvendimit për shpronësim, nisur me shkresën nr. 47/6, datë 02.07.2021 pranë MIE, nuk përcaktohet qartësisht afati i fillimit dhe përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në kundërshtim me nenin

20 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

7. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon ARRSH-së, *(citojmë:* Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e ARRSH marrjen e masave për njoftimin e tij.*)* realizimin e "Njoftimit për shpërblimin nga shpronësimi", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

8. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, në kundërshtim të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH, nenin 11, pika 5, nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se: *Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.*

Praktika e shpronësimit është realizuar nga: Z. Erlis Hereni me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e Kryetait të KPSH, Z. Martin Beqiraj me detyrë ekonomist, në cilësinë e anëtarit të KPSH, Znj. Blerta Dyrmishi, me detyrë inxhinier, në cilësinë e anëtarit të KPSH, Znj. Klodiana Elezi, me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të KPSH, Znj. Aida Nika, me detyrë inxhinier, në cilësinë e anëtarit të KPSH.

XVIII. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik, "Projektimi i "Shkollës së Biçikletave" për grupmoshat 7-10 vjeç, Tiranë" finalizuar me VKM-në nr. 510, datë 27.07.2022.

Me anë të shkresës nr. 49693/5 Prot., datë 16.12.2021 (protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr. 646 Prot., datë 17.12.2021), Bashkia Tiranë ka paraqitur kërkesën për shpronësim, "Projektimi i "Shkollës së Biçikletave" për grupmoshat 7-10 vjeç, Tiranë" bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues.

Me shkresën nr. 646/1 Prot., datë 20.12.2021 Urdhër nr. 195, datë 20.12.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, është krijuar Komisioni i Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga zbatimi i projektit "Projektimi i "Shkollës së Biçikletave" për grupmoshat 7-10 vjeç, Tiranë", me përbërje: Erlis Hereni, Drejtor i Përgjithshëm, Kryetar; Denada Dosti, juriste, anëtare; Entela Bytyçi, inxhiniere, anëtare; Besnik Hysaj, inxhinier, anëtar; Besmira Nuredini ekonomiste, anëtare; Funksioni i Sekretarisë Teknike kryhet nga znj. Sidorela Qato.

Me anë të shkresës nr. 49693/5 Prot., datë 29.12.2021 (protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr. 646/2 Prot., datë 30.12.2021), Bashkia Tiranë dërgon pranë ASHSH dokumentacion shtesë në plotësim të kërkesës së datës 16.12.2025.

Me shkresën nr. 646/4 datë 31.12.2021 me lëndë "Plotësim dokumentacioni", ASHSH i kërkon Bashkisë Tiranë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur edhe procesverbalin e KPSH, datë 31.12.2021 (pa caktuar afat).

Me shkresën nr. 303 datë 24.02.2022 me lëndë "Kujtesë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim", ASHSH i kërkon edhe njëherë Bashkisë Tiranë

plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim duke caktuar një afat 30 ditor në tejkalim të të cilit do të procedohet me kthimin e kërkesës për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga zbatimi i projektit "Projektimi i "Shkollës së Biçikletave" për grupmoshat 7-10 vjeç, Tiranë".
Me anë të shkresës nr. 8461/2 Prot., datë 06.05.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.303/1 Prot., datë 09.05.2022), Bashkia Tiranë dërgon pranë ASHSH dokumentacion në plotësim të kërkesës së datës 16.12.2021 , kërkuar nga ASHSH me shkresën nr. 303 datë 24.02.2022 me lëndë "Kujtesë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim".
Me shkresën nr. 303/2 datë 24.02.2022 me lëndë "Njoftim për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik", ASHSH i komunikon Bashkisë Tiranë pranimin e kërkesës, bashkëlidhur edhe procesverbalin e KPSH, datë 09.05.2022.
Me shkresën nr.303/3, datë 10.05.2022 mes ASHSH dhe Bashkisë Tiranë lidhet akt-marrëveshja për angazhimin e ndërsjellë të ASHSH, si autoritet përgjegjës dhe Bashkisë Tiranë, si subjekt kërkues, për marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave për shpronësim.
Me shkresën nr.303/4, datë 11.05.2022, ASHSH dërgon për publikim pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare kërkesën për shpronësim për interes publik.
Me shkresën nr.303/5, datë 12.05.2022, ASHSH njofton (nëpërmjet Bashkisë Tiranë) subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik.
Me shkresën nr.17917/2 Prot., datë 23.05.2022 (protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr.303/6 Prot., datë 23.05.2022) Bashkia Tiranë konfirmon kryerjen e njoftimit publik për pronarët e pasurive private që do të shpronësohen.
Me shkresën nr. ska ., datë 23.05.2022 (protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr.518 Prot., datë 26.05.2022) përfaqësues të bashkëpronarëve paraqesin një kërkesë me objekt "Ndërprerjen e menjëhershme të procedurave të shpronësimit të pronës private, pasuri nr. 6/438, zk 8160, me sipërfaqe 5269 m2", duke pretenduar mungesë të shkakut ligjor për shpronësimin, mos vërtetim të domosdoshmërisë për shpronësim nga ana e subjektit kërkues Bashkia Tiranë dhe ardhje të pasojave me dëm ekonomik për shtetin lidhur me kompensimin e drejtë të pronarëve.
Me shkresën nr. 518/1, datë 03.06.2022, ASHSH i kthen përgjigje përfaqësuesve të bashkëpronarëve për sa pretenduar në kërkesën e datës 23.05.2022 (protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr.518 Prot., datë 26.05.2022), bashkëlidhur procesverbal i datës 03.06.2022.
Me procesverbalin e datës 07.06.2022 KPSH vendos miratimin e propozimit për shpronësim publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi "Projektimi i "Shkollës së Biçikletave" për grupmoshat 7-10 vjeç, Tiranë".
Me shkresën nr. 303/7, datë 08.06.2022, ASHSH dërgon pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës propozimin e projektvendimit për shpronësim, bashkëlidhur relacionin shoqërues.
Me shkresën nr.D13192/1, datë 20.06.2022, (protokolluar në ASHSH me nr.303/8 Prot., datë 20.06.2022) Bashkia Tiranë i kthen përgjigje përfaqësuesve të bashkëpronarëve për sa pretenduar në kërkesën e datës 23.05.2022.
Me shkresën nr.4084/2, datë 28.07.2022, (protokolluar në ASHSH me nr.303/9 Prot., datë 29.07.2022) Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH, VKM-në nr.510, datë 27.07.2022 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Projektimi i "Shkollës së Biçikletave" për grupmoshat 7-10 vjeç, Tiranë".
Me shkresën nr. 303/10, datë 29.07.20222, ASHSH njofton (nëpërmjet Bashkisë Tiranë) subjektet privatë për shpërblimin nga shpronësimi.
Me shkresën nr. 303/11, datë 29.07.2022, ASHSH i drejtohet Bashkisë Tiranë për pagesën e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm.

Konkluzion:

1. Kërkesa për shpronësim, "Projektimi i "Shkollës së Biçikletave" për grupmoshat 7-10 vjeç, Tiranë", është paraqitur e pa shoqëruar me dokumentacionin e plotë: Leje dhe miratim

përkatës nga organet kompetente; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse; Dokumentacioni që vërteton shkakun e shpronësimit; Adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privatë që shpronësohen, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"*, (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 *"Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999"* dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/28 prot., datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, si më poshtë vijon:

1.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimet **mbi lejet dhe aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit te projektit, shkakut te shpronësimit, adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privat që shpronësohen**, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:

Referuar pikës 2 të nenit 12 të Ligjit Nr. 8561/1999, ku citohet se, *"2. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij sipas këtij neni, duke caktuar edhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse"*.

Sa më sipër sqarojmë se, KPSH në çdo rast ka vepruar në përputhje të dispozitës së sipërcituar ku në rastin konkret pasi janë konstatuar mangësitë mbi dokumentacionin e depozituar nga ana e subjektit kërkues është lënë mundësia në zbatim të kësaj dispozite të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për shpronësim.

1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se konstatimi i mësipërm i referohet dokumentacionit të plotë që duhet të shoqërojë kërkesën për shpronësim sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Fakti që mes ASHSH dhe subjektit kërkues ka një korrespondencë të përsëritur për plotësim dokumentacioni konfirmon qëndrimin e grupit të auditimit. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**.

2. Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 18 të *"Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, ku përcaktohet se:

"Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen.....".

2.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi protokollimin e procesverbaleve** të KPSH, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:

Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast

2.2 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se neni 18 i Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që

përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja*, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

3. Vendimmarrja sipas procesverbalit datë 31.12.2022 të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar), ku përcaktohet se:
   Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.
   Në rastin konkret KPSH ka konstatuar mungesë të dokumentacionit që shoqëron kërkesën por nuk e ka kthyer atë për plotësim dhe nuk ka caktuar një afat të posaçëm për paraqitjen e tij.
4. Shkresa e KPSH nr.303 prot., datë 24.02.2022, me lëndë, "Kujtesë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim", është një shkresë që nuk gjen mbështetje në aktet ligjore e nënligjore të cilat rregullojnë mënyrën e funksionimit të KPSH. Kjo shkresë i është dërguar subjektit kërkues Bashkia Tiranë 55 ditë pasi KPSH ka konstatuar mungesë të dokumentacionit që shoqëron kërkesën në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*".
5. Shkresa me nr. 8461/2 prot., datë 06.05.2022 (protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr.303/1 Prot., datë 09.05.2022) është paraqitur jashtë afateve në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

5.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi paraqitjen jashtë afateve të shkresës me nr. 8461/2 prot., datë 06.05.2022** (protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr.303/1 Prot., datë 09.05.2022) në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin Komisioni sqaron se, sikurse ju ka bërë me dije në observacionet e paraqitura nëpërmjet shkresës nr. 1144/1 prot., datë 07.11.2025, se në shkresën Nr. 646/4 prot. datë 31.12.2021, me lëndë "Plotësim dokumentacioni" Komisioni i Posaçëm për Shpronësim, në zbatim të pikës 2 të nenit 12 të ligjit, i ka bërë me dije subjektit kërkues mangësitë e konstatuara nga shqyrtimi i kërkesës për shpronësim, por në këtë shkresë nuk ishte caktuar një afat kohor mbi plotësimin e mangësive të konstatuara nga komisioni, në kushtet kur subjekti kërkues nuk kishte vijuar mbi shkresën e dërguar nga ASHSH, në zbatim të pikës 1, të nenit 10 Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", u vijua nga ana e ASHSH me shkresën Nr. 303 Prot., datë 24.02.2022, me lëndë, "Kujtesë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim", kemi njoftuar subjektin kërkues se, vonesat e tejzgjatura në plotësimin e dokumentacionit, përbëjnë shkak për kthimin e dosjes së shpronësimit dhe refuzimin e kërkesës për shpronësim, referuar përcaktimeve të nenit 12, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar.

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin (ASHSH) sqaron se, duke qenë një institucion relativisht i ri dhe në fazë konsolidimi të procedurave të saj administrative, ajo është në dispozicion për të marrë në konsideratë gjetjen e këtij konstatimi.
Komisioni sqaron gjithashtu se, në praktikat e mëvonshme të ASHSH-së, kjo procedurë është zbatuar në mënyrë të rregullt: çdo kërkesë për shpronësim me dokumentacion të paplotë kthehet menjëherë tek subjekti kërkues, së bashku me udhëzimet për plotësimin e dokumentacionit, duke përcaktuar një afat të qartë dhe të monitorueshëm për paraqitjen e dokumentacionit plotësues.
5.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se shkresa me nr. 8461/2 prot., datë 06.05.2022 (protokolluar në ASHSH me Nr. 303/1 Prot., datë 09.05.2022) ka mbërritur në ASHSH pas shkresës nr. 303 datë 24.02.2022 me lëndë "Kujtesë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim", ku ASHSH i kërkon edhe njëherë Bashkisë Tiranë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim duke caktuar një afat 30 ditor. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

6. Vendimmarrja sipas procesverbalit datë 09.05.2022 të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar), ku përcaktohet se: Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të shpronësimit.

6.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi vendimmarrjen për pranimin e kërkesës për shpronësim**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Sqarojmë për KLSH se korrespondencat vijuese midis ASHSH dhe subjektit kërkues në çdo rast janë mbështetur në pikën 2 të nenit 12 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar.
Arsyetimi KLSH se, nuk jemi në kushtet e pikës 2 të nenit 12, por në kushtet e pikës 3 të këtij neni, komisioni e kundërshton për arsye se vetë pika 2 e nenit 12 nuk ka të përcaktuar detyrim mbi numrin apo sasinë e korrespondencave që duhet të mbajmë me subjektin kërkues apo të jetë specifikuar që domosdoshmërish vetëm një korrespondencë shkresore të mbahet me subjektin kërkues.
Gjithashtu sqarojmë se, pika 3 e nenit 12 përcakton rastet e refuzimit kur mungon shkaku apo kushti i shpronësimit ose kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar.
Ndërkohë në rasti konkret, kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues është paraqitur brenda afatit të caktuar, në shkresën Nr. 303 Prot., datë 24.02.2022, me lëndë, "Kujtesë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim", si dhe kërkesa për shpronësim i plotëson kushtet dhe shkakun ligjor për realizimin e shpronësimit për interes publik.
6.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se konstatimi i grupit të auditimit i referohet pikërisht vendimmarrjes sipas procesverbalit të mbajtur më datë 09.05.2022, në të cilin është vendosur për pranimin e kërkesës për shpronësim edhe pse dokumentacioni shoqërues është paraqitur pas dërgimit nga ASHSH të shkresës nr. 646/4 datë 31.12.2021 me lëndë "Plotësim dokumentacioni", dhe shkresës nr. 303 datë 24.02.2022 me lëndë "Kujtesë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim", ku ASHSH i kërkon edhe njëherë Bashkisë Tiranë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim duke caktuar një afat 30 ditor. Për këtë arsye, jemi plotësisht në kushtet e pikës 3 të nenit 12 ku përcaktohet se: Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut

ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të shpronësimit. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**

7. Aktmarrëveshja e lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Tiranë nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

7.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit bashkëlidhur Aktmarrëveshjes**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1144/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve. Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH.
7.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivin tuaj. Aktmarrëveshja është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për palët. Ligji kërkon në mënyrë të shprehur qartë domosdoshmërinë e bashkëlidhjes së dokumentacionit që ka shoqëruar kërkesën për shpronësim. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

8. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjekteve privatë që shpronësohet, i kërkon Bashkisë Tiranë, *(Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e* Bashkia Tiranë *marrjen e masave për njoftimin e tij.)* realizimin e "Njoftimit për shpronësim publik", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

8.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të njoftuar subjektin privat që shpronësohet**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "*Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij*", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.

Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrit të titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "*korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin*".

Gjithashtu, sikurse u kemi cituar observacionet e paraqitura nga ana jonë me shkresën nr.1144/1 prot., datë 07.11.2025, nëpërmjet shkresës nr. 49693/5 prot., datë 29.12.2021 të subjektit kërkues protokolluar në ASHSH me numër 646/2 prot., datë 30.12.2021 është cituar se: *"Përsa i përket adresave të pronarëve të pasurive të sipërcituara, theksojmë se adresat e poshtëshënuara janë marrë nga korrespondenca me pronaret tek projekti "Asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve pranë Stadiumit "Qemal Stafa"*

Arben Hoxha - Rruga "Thoma Kaçorri", Godina Nr.1

Andi Grori - Rruga "Budi", Godine Private nr.7

Ylber Grori- Rruga "Budi", Godina nr.72, Hyrja 1, Ap.1".

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.

8.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

9. Në relacionin bashkëlidhur propozimit të projektvendimit për shpronësim, nisur me shkresën nr. 303/7, datë 08.06.2022 pranë MIE, nuk përcaktohet qartësisht afati i fillimit dhe përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

9.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin mbi afatet e fillimit dhe të përfundimit të punimeve, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:

Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "*Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin*", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative, nga ana e Ministrisë apo ministrive të linjës nuk është lënë koment mbi afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve.

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në relacionin shoqërues të projektvendimit do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.

9.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se komenti nga subjekti i audituar nuk përkon me gjetjen dhe konkretisht, është pikërisht ASHSH që me shkresën nr.303/7 Prot., datë 08.06.2022 ka dërguar pranë MIE propozimin për projektvendimin e shpronësimit së bashku me relacionin shoqërues bazuar kjo dhe në, *neni 16, pikën m, "Kompetencat e KPSH", të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e ASHSH,* miratuar me urdhrin e ministrit nr. 199 datë 14.10.2022. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

10. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjekteve privatë që shpronësohet, i kërkon Bashkisë Tiranë, *(Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e* Bashkia Tiranë *marrjen e masave për njoftimin e tij.)* realizimin e "Njoftimit për shpërblim nga shpronësimi", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

10.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **mbi njoftimit për shpërblimin nga shpronësimi,** Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "*Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij*", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.
Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "*korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin*".
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.
10.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

11. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5, nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"*, i ndryshuar dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Tiranë, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se: *Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.*

11.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të përcjellë VKM-në shpronësimit pranë ASHK**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:

KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim.

Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit.

ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022.

Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 *"Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin"* ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.

11.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari, referuar nenit 11, pika 5, gërma "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.

Së dyti, sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti, nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja.

Sqarimi se ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit, nuk përkon me gjetjen pasi në asnjë moment nuk është konkluduar se ASHSH duhet të kryejë aplikimet përkatëse pranë ASHK shërbime të cilat kërkojnë pagesë.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Praktika e shpronësimit është realizuar nga: **Z. Erlis Hereni** me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e Kryetarit të KPSH, **Znj. Denada Dosti** me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Znj. Entela Bytyçi**, me detyrë inxhiniere, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Znj. Besmira Nuredini**, me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Znj. Besnik Hysaj**, me detyrë inxhinier, në cilësinë e anëtarit të KPSH.

XIX. Dosja e procedurës së shpronësimit që preken për interes publik, nga "Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "Qazim Turdiu" finalizuar *me VKM-në nr. 663, datë 13.10.2022.*

Me anë të shkresës nr. 11667/1 Prot., datë 25.03.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.372 Prot., datë 28.03.2022), Bashkia Tiranë ka paraqitur kërkesën për shpronësim, "Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "Qazim Turdiu", bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues.
Me shkresën nr. 372/1 datë 29.03.2022 Urdhër nr. 49, datë 29.03.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, është krijuar Komisioni i Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurës së shpronësimit për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "Qazim Turdiu", me përbërje: Erlis Hereni , Drejtor i Përgjithshëm, Kryetar; Entela Bytyçi, inxhiniere, anëtare; Areda Koçi, ekonomiste, anëtare ; Ilirjana Hasanllari, juriste, anëtare; Aida Nika, inxhinier, anëtare; Funksioni i Sekretarisë Teknike kryhet nga znj. Sidorela Qato.
Me shkresën nr. 372/2 datë 15.04.2022 me lëndë "Kthim pa veprim të kërkesës për shpronësim", ASHSH i kërkon Bashkisë Tiranë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur edhe procesverbalin e KPSH, datë 14.04.2022, ku vendos: Sekretaria Teknike t'i dërgojë shkresë për plotësim dokumentacioni Bashkisë Tiranë për të vijuar me procedurat e shpronësimit. Në zbatim të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), dokumentacioni plotësues të paraqitet në ASHSH, për shqyrtim brenda 45 ditëve nga marrja e këtij njoftimi.
Me shkresën nr.11667/3 Prot., datë 11.05.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.372/3 Prot., datë 11.05.2022) Bashkia Tiranë kthen përgjigje duke plotësuar dokumentacionin për sa kërkuar nga KPSH.
Me shkresën nr.372/4, datë 23.05.2022, ASHSH i njofton Bashkisë Tiranë pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik, bashkëlidhur edhe procesverbalin e KPSH, datë 23.05.2022
Me shkresën nr.372/5, datë 23.05.2022 mes ASHSH dhe Bashkisë Tiranë lidhet akt-marrëveshja për angazhimin e ndërsjellë të ASHSH, si autoritet përgjegjës dhe Bashkisë Tiranë, si subjekt kërkues, për marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave për shpronësim.
Me shkresën nr.372/7, datë 31.05.202, ASHSH njofton subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik.
Me anë të procesverbalit datë 27.06.2022 KPSH në ASHSH pas përfundimit të afatit 15 ditor të publikimit të kërkesë për shpronësim nr. 372/6, datë 31.05.2022, në Fletoren Zyrtare nr. 84, datë 06.06.2022, në përfundim vendosi;
Miratimin e propozimit, "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "Qazim

Turdiu", me vlerë totale të shpronësimit **10,833,624** (dhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzetë e katër) lekë;
Me anë të shkresës nr. 372/8 datë 29.06.2022 ASHSH i drejtohet MIE duke përcjellë propozimin për projektvendimin për shpronësim bashkëlidhur relacionin përkatës..
Me shkresën nr. 5455/1, datë 13.10.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.372/9, datë 14.10.2022) Këshilli i Ministrave përcjell VKM nr. 663, datë 13.10.2022.
Me shkresën nr. S-22162/1, datë 17.10.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.372/10, datë 17.10.2022) Bashkia Tiranë përcjell kërkesën për shqyrtim dhe vlerësim, duke kërkuar informacion lidhur me ecurinë e procedurës së shpronësimit dhe statusin e saj.
Me shkresën nr.372/11, datë 21.10.2022, ASHSH përcjell pranë Bashkisë Tiranë, VKM nr. 663, datë 13.10.2022 të Këshillit të Ministrave. (mungon VKM-ja bashkëlidhur)
Me shkresën nr.372/12, datë 21.10.2022, ASHSH njofton subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik, VKM nr. 663, datë 13.10.2022 të Këshillit të Ministrave për shpërblimin nga shpronësimi.
Me shkresën nr.372/13, datë 24.10.2022, ASHSH i drejtohet Bashkisë Tiranë për pagesën e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm.
Me shkresën nr.372/14, datë 26.10.2022, ASHSH i përgjigjet Bashkisë Tiranë lidhur me kërkesën për shqyrtim dhe vlerësim nr. S-22162/1, datë 17.10.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.372/10, datë 17.10.2022) duke sugjeruar që të iniciohet kërkesë për ndryshim/korrigjim të Vendimit nr. 663, datë 13.10.2022, të Këshillit të Ministrave, *"Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "Qazim Turdiu", duke paraqitur në ASHSH gjithë dokumentacionin justifikues të kërkuar bazuar në* nenin 10 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar).*
Me shkresën nr. A-25103/1 prot., S-22162/2 datë 10.11.2022, (protokolluar në ASHSH me nr.372/15, datë 15.11.2022) Bashkia Tiranë kërkon nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Veri, konfirmim të historikut të pasurisë nr. 9/216, zk. 8330 e cila rezulton e mbyllur, informacion për pasuritë në të cilat ajo ka vijuar si dhe vendosjen në dispozicion të kartelave dhe hartave treguese të regjistrimit të secilës prej tyre.

Konkluzion:

1. Kërkesa për shpronësim, "Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "Qazim Turdiu", është paraqitur e pa shoqëruar me dokumentacionin e plotë: Argumentet përkatëse ligjore për interesin publik, lidhur me realizimin e projektit; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse; Dokumentacioni që vërteton shkakun e shpronësimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/28 prot; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, si më poshtë vijon:

1.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimet **mbi aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, afatet përkatëse dhe shkakut te shpronësimit**, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se
Referuar pikës 2 të nenit 12 të Ligjit Nr. 8561/1999, ku citohet se, *"2. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit*

dhe dokumentacionin shoqërues të tij sipas këtij neni, duke caktuar edhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse".
Sa më sipër sqarojmë se, KPSH në çdo rast ka vepruar në përputhje të dispozitës së sipërcituar ku në rastin konkret pasi janë konstatuar mangësitë mbi dokumentacionin e depozituar nga ana e subjektit kërkues është lënë mundësia në zbatim të kësaj dispozite të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për shpronësim.
1.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se konstatimi i mësipërm i referohet dokumentacionit të plotë që duhet të shoqërojë kërkesën për shpronësim sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**

2.Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 18 të "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se:
"Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen".

2.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi protokollimin e procesverbaleve** të KPSH, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast.
2.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se neni 18 i Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

3. Vendimmarrja sipas procesverbalit datë 14.04.2022 të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.* Në rastin konkret, dokumentacioni shoqërues nuk i është kthyer kërkuesit të shpronësimit me qëllim plotësimin e tij sipas kërkesave të vetë KPSH shprehur në procesverbal.

3.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **mbi vendimmarrjen për moskthimin e dokumentacionit shoqërues së bashku me kërkesën për shpronësim**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:

Fillimisht sqarojmë se, sikurse ju kemi parashtruar me observacionet e paraqitura përmes shkresës 1144/1 prot., datë 07.11.2025, me shkresën tonë Nr. 972/2 Prot., datë 15.4.2022, KPSH ka vendosur "*Kthimin pa veprim të kërkesës për shpronësim*", duke i bërë me dije subjektit kërkues mangësitë e konstatuara gjatë shqyrtimit të dosjes.
Sqarojmë për KLSH se korrespondencat vijuese midis ASHSH dhe subjektit kërkues në çdo rast janë mbështetur në pikën 2 të nenit 12 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar.
Gjithashtu sqarojmë se, pika 3 e nenit 12 përcakton rastet e refuzimit kur mungon shkaku apo kushti i shpronësimit ose kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar.
Ndërkohë në rasti konkret, kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues është paraqitur brenda afatit të caktuar, në shkresën Nr. 303 Prot., datë 24.02.2022, me lëndë, "*Kujtesë lidhur me plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim*", si dhe kërkesa për shpronësim i plotëson kushtet dhe shkakun ligjor për realizimin e shpronësimit për interes publik
3.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se: sa parashtroni nuk përkon me konkluzionin, pasi KPSH në rastin e sipërcituar, nuk i ka kthyer dokumentacionin shoqërues kërkuesit të shpronësimit me qëllim plotësimin e tij sipas kërkesave të shprehura në procesverbal.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

4. Aktmarrëveshja e lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Tiranë nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar)

5. Në relacionin bashkëlidhur propozimit të projektvendimit për shpronësim, nisur me shkresën nr. 372/8, datë 29.06.2022 pranë MIE, nuk përcaktohet afati i fillimit dhe përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar).

5.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin mbi **afatet e fillimit dhe të përfundimit të punimeve**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative.
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në relacionin shoqërues të projektvendimit do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve
5.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se komenti nga subjekti i audituar nuk përkon me gjetjen dhe konkretisht, është pikërisht ASHSH që me shkresën nr.372/8 Prot., datë 29.06.2022 ka dërguar pranë MIE propozimin për projektvendimin e shpronësimit së bashku me relacionin shoqërues bazuar kjo dhe në, *neni 16, pikën m "Kompetencat e KPSH", të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e ASHSH,* miratuar me urdhrin e ministrit nr. 199 datë 14.10.2022.
Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

6. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell ASHK vendimin e KM për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5, nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Tiranë, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se: *Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.*

6.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të përcjellë VKM-në shpronësimit pranë ASHK**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim.
Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit.
ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022.
Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 *"Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin"* ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.
6.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:
Së pari, referuar nenit 11, pika 5, gërma "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.
Së dyti, sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti, nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja. Sqarimi se ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit, nuk përkon me gjetjen pasi në asnjë moment nuk është konkluduar se ASHSH duhet të kryejë aplikimet përkatëse pranë ASHK shërbime të cilat kërkojnë pagesë.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Praktika e shpronësimit është realizuar nga: Z. Erlis Hereni me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e Kryetarit të KPSH, **Znj. Ilirjana Hasanllari** me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Znj. Entela Bytyçi**, me detyrë inxhiniere, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Znj. Areda Koçi**, me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Znj. Aida Nika**, me detyrë inxhinier, në cilësinë e anëtarit të KPSH.

XX. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik, "Kërkesë për shpronësim, "Ndërtimi i qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço" finalizuar me VKM-në nr. 218, datë 13.04.2023.

Me anë të shkresës nr. 6067 Prot., datë 06.07.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 609 Prot., datë 12.07.2022), Bashkia Lushnjë ka paraqitur kërkesën për shpronësim, "Ndërtimi i qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço", bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues.
Me shkresën nr. 609/1 Prot., datë 13.07.2022 Urdhër nr. 91, datë 13.07.2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, është krijuar KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurës së shpronësimit, "Ndërtimi qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço", me përbërje: Erlis Hereni, Drejtor i Përgjithshëm, Kryetar; Klodiana Guci, ekonomiste, anëtare; Entela Bytyçi, inxhiniere, anëtare; Orlanda Murati, juriste, anëtare; Albian Marku, arkitekt, anëtar; Funksioni i Sekretarisë Teknike kryhet nga z. Spartak Kodra.
Me shkresën nr. 609/2., datë 28.07.2022 me lëndë "***Plotësim dokumentacioni***", ASHSH i kërkon Bashkisë Lushnje plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë 27.07.2022, ku konstatohet mungesa e dokumentacionit shoqërues dhe i lihet subjektit kërkues një afat prej 30 ditësh për plotësim. Sekretaria Teknike të hartojë shkresën drejtuar Bashkisë Lushnje për plotësim dokumentacioni.
Me shkresën nr.6067/2 Prot., datë 22.08.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.609/3 Prot., datë 24.08.2022) Bashkia Lushnje kthen përgjigje për sa kërkuar nga KPSH.
Me shkresën nr. 609/4, datë 06.09.2022 me lëndë "***Plotësim dokumentacioni***", ASHSH i kërkon sërish Bashkisë Lushnje plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur edhe procesverbalin e KPSH, datë 01.09.2022, ku konstatohet sërish mungesa e dokumentacionit shoqërues dhe i lihet subjektit kërkues një tjetër afat prej 30 ditësh për plotësim. Sekretaria Teknike t'i dërgojë shkresë për plotësim dokumentacioni Bashkisë Lushnje, në mënyrë që KPSH, të vijojë pa vonesa me procedurat e mëtejshme për shpronësim.
Me shkresën nr. 8372 Prot., datë 23.09.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 609/5 Prot., datë 26.09.2022) Bashkia Lushnje kthen përgjigje për sa kërkuar nga KPSH.
Me shkresën nr. 9490 Prot., datë 26.10.2022 (protokolluar për dijeni në ASHSH me nr. 792 Prot., datë 28.10.2022) Bashkia Lushnje i kërkon ASHK-së sqarime lidhur me kartelat "jo përfundimtare" të pasurive që duhet të shpronësohen pasi ASHSH nuk e pranon dokumentin "kartelë jo përfundimtare" si dokument të vlefshëm për shpronësim.

Me shkresën nr.1954/1 Prot., datë 06.12.2022 (protokolluar për dijeni në ASHSH me nr.866 Prot., datë 09.12.2022) ASHK i kthen përgjigje Bashkisë Lushnje lidhur me vlefshmërinë ligjore të dokumentit "kartelë jo përfundimtare.

Me shkresën nr. 609/6 datë 14.10.2022 me lëndë "***Plotësim dokumentacioni***", ASHSH përsëri i kërkon Bashkisë Lushnje plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë 12.10.2022, ku konstatohet sërish mungesa e dokumentacionit shoqërues dhe i lihet subjektit kërkues një tjetër afat prej 45 ditësh për plotësim. Sekretaria Teknike t'i dërgojë shkresë për plotësim dokumentacioni Bashkisë Lushnje, në mënyrë që KPSH, të vijojë pa vonesa me procedurat e mëtejshme për shpronësim.

Me shkresën nr.8372/2 Prot., datë 15.12.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 609/7 Prot., datë 19.12.2022) Bashkia Lushnje kthen përgjigje për sa kërkuar nga KPSH.

Me shkresën nr. 6067/4 Prot., datë 06.01.2023 (protokolluar në ASHSH me nr.83 Prot., datë 12.01.2023) Bashkia Lushnje dërgon pranë ASHSH plotësim dokumentacioni për sa komunikuar dhe rekomanduar nga ASHSH.

Me shkresën nr. 83/1, datë 24.01.2023, ASHSH i njofton Bashkisë Lushnjë pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik, bashkëlidhur edhe procesverbalin e KPSH, datë 24.01.2023

Me shkresën nr. 83/2, datë 24.01.2023 mes ASHSH dhe Bashkisë Lushnje lidhet akt-marrëveshja për angazhimin e ndërsjellë të ASHSH, si autoritet përgjegjës dhe Bashkisë Lushnje, si subjekt kërkues, për marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave për shpronësim.

Me shkresën nr. 83/3, datë 24.01.2023, ASHSH dërgon për publikim pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare kërkesën për shpronësim për interes publik.

Me shkresën nr.83/4, datë 24.01.2023, ASHSH njofton (nëpërmjet Bashkisë Lushnje) subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik.

Me shkresën nr.742/3 Prot., datë 08.02.2023 (protokolluar në ASHSH me nr. 83/5 Prot., datë 09.02.2023) Bashkia Lushnje konfirmon marrjen e njoftimit nga ana e subjekteve pronarë të pasurive private që do të shpronësohen.

Me anë të procesverbalit datë 16.02.2023 KPSH në ASHSH pas përfundimit të afatit 15 ditor të publikimit të kërkesë për shpronësim nr. 83/3, datë 24.01.2023, në Fletoren Zyrtare nr. 15, datë 30.01.2023, në përfundim vendosi;

Miratimin e propozimit, "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço", me vlerë totale të shpronësimit 2,251,070 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëdhjetë) lekë;

Me shkresën nr. 83/6, datë 17.02.2023 ASHSH ka dërguar pranë MIE propozimin e projektvendimit për shpronësim, bashkëlidhur relacionin shoqërues.

Me shkresën nr. ska, datë 13.04.2023 (protokolluar në ASHSH me nr.83/7, datë 14.04.2023) Këshilli i Ministrave përcjell VKM nr.218, datë 13.03.2021 "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço", Bashkia Lushnje. Me shkresën nr. 83/8, datë 19.04.2021, ASHSH përcjell pranë Bashkisë Lushnje, VKM nr. 218, datë 13.03.2021 të Këshillit të Ministrave.

Me shkresën nr. 83/9, datë 19.04.2021, ASHSH njofton (nëpërmjet Bashkisë Lushnje) subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik, VKM nr. 218, datë 13.03.2021 të Këshillit të Ministrave.

Me shkresën nr. 83/10, datë 19.04.2021, ASHSH i drejtohet Bashkisë Lushnje për pagesën e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm.

Konkluzion:

1. Kërkesa për shpronësim, "Ndërtimi i qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço", është paraqitur e pa shoqëruar me dokumentacionin e plotë: Argumentet përkatëse ligjore për

interesin publik, lidhur me realizimin e projektit; Afatet përkatëse të realizimit të projektit; Adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privatë që shpronësohen, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", (i ndryshuar), pikës 1 të VKM nr. 127, datë 23.03.2000 "*Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999*" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/28 prot; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, si më poshtë vijon:
1.1. <u>Pretendimi i subjektit:</u> Në lidhje me konstatimet **mbi argumentet përkatëse ligjore, për interesin publik, lidhur me realizimin e projektit, afatet përkatëse të realizimit të projektit, adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privat që shpronësohen,** Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1144/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se, dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim si dhe dokumentacioni plotësues në çdo rast janë pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qënë se ky dokumentacion depozitohet nga ana e subjektit kërkues pranë ASHSH kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit.
Sa më sipër, sqarojmë se, në rastin konkret pasi janë konstatuar mangësitë nga ana e KPSH mbi dokumentacionin e depozituar nga ana e subjektit kërkues është lënë mundësia (në mbështetje të pikës 2, të nenit 12 të ligjit 8561/1999, të ndryshuar) të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për shpronësim.
Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH
<u>1.2. Qëndrimi i grupit të auditimit:</u> Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se konstatimi i mësipërm i referohet dokumentacionit të plotë që duhet të shoqërojë kërkesën për shpronësim sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Fakti që mes ASHSH dhe subjektit kërkues ka një korrespondencë të përsëritur për plotësim dokumentacioni konfirmon qëndrimin e grupit të auditimit.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

2. Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 18 të "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*", ku përcaktohet se: "<u>Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen</u>".

<u>2.1. Pretendimi i subjektit:</u> Në lidhje me **konstatimin mbi protokollimin e procesverbaleve** të KPSH, ASHSH shprehet se: *Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast.*

2.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se neni 18 i Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

3. Vendimmarrja sipas procesverbaleve datë 06.09.2022 dhe datë 14.10.2022 të KPSH në ASHSH janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar), ku përcaktohet se: Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të shpronësimit.

4. Aktmarrëveshja e lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Lushnje nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

4.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit bashkëlidhur Aktmarrëveshjes**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1144/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve.
Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH.
4.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivin tuaj. Aktmarrëveshja është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për palët. Ligji kërkon në mënyrë të shprehur qartë domosdoshmërinë e bashkëlidhjes së dokumentacionit që ka shoqëruar kërkesën për shpronësim. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

5. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjekteve privatë që shpronësohet, i kërkon Bashkisë Lushnje, *(Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e* Bashkia Lushnje *marrjen e masave për njoftimin e tij.)* realizimin e "Njoftimit për shpronësim publik", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të ligjit

8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar), pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "*Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet*", pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.127, datë 23.03.2000, "*Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

5.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin që lidhet me **detyrimin e ASHSH për të njoftuar subjektin privat që shpronësohet**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "*Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij*", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.
Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "*korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin*".
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.
5.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që, në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

6. Në relacionin bashkëlidhur propozimit të projektvendimit për shpronësim, nisur me shkresën nr. 86/3, datë 17.02.2023 pranë MIE, nuk përcaktohet afati i fillimit dhe përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).

6.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **mbi afatet e fillimit dhe të përfundimit të punimeve**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për Shpronësimin *"Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin"*, në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative.
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në relacionin shoqërues të projektvendimit do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.
6.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se komenti nga subjekti i audituar nuk përkon me gjetjen dhe konkretisht, është pikërisht ASHSH që me shkresën nr. 83/6 Prot., datë 17.02.2023 ka dërguar pranë MIE propozimin për projektvendimin e shpronësimit së bashku me relacionin shoqërues bazuar kjo dhe në, *neni 16, pikën m, "Kompetencat e KPSH", të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e ASHSH*, miratuar me urdhrin e ministrit nr. 199 datë 14.10.2022. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja. sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

7. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjekteve privatë që shpronësohet, i kërkon Bashkisë Lushnje, *(Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e* Bashkia Lushnje *marrjen e masave për njoftimin e tij.)* realizimin e "Njoftimit për shpërblimin nga shpronësimi", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"* (i ndryshuar).

7.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **mbi "Njoftimit për shpërblimin nga shpronësimi"** Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin *"Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij"*, është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.
Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, *"korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin"*.
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së

mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar

7.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura.

Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

8. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell ASHK vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5, nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Lushnje, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se: "Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara". Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me VKM dhe legjislacionin në fuqi.

8.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të përcjellë VKM-në shpronësimit pranë ASHK**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:

KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim.

Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit.

ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 *"Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin"* ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më

sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.

8.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:
Së pari: referuar nenit 11, pika 5, gërma "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.
Së dyti: sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.
Së treti: nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja Sqarimi se ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit, nuk përkon me gjetjen pasi në asnjë moment nuk është konkluduar se ASHSH duhet të kryejë aplikimet përkatëse pranë ASHK shërbime të cilat kërkojnë pagesë.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Praktika e shpronësimit është realizuar nga: Z. Erlis Hereni me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e Kryetarit të KPSH, **Znj. Klodiana Guci** me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Znj. Entela Bytyçi**, me detyrë inxhiniere, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Znj. Orlanda Murati**, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të KPSH, **Z. Albian Marku**, me detyrë arkitekt, në cilësinë e anëtarit të KPSH.

XXI. Dosja e procedurës së shpronësimit që preken nga ndërtimi i objektit "Kërkesë për shpronësim, Unaza Lindore Loti 2, dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit **(për disa shtesa në VKM-në nr.65, datë 08.02.2023)" finalizuar me VKM-në nr. 66, datë 14.02.2024.**

Me anë të shkresës nr. 4200/2 Prot., datë 09.06.2023 (protokolluar në ASHSH me nr. 550 Prot., datë 13.06.2023), ARRSH ka paraqitur kërkesën për shpronësim, Unaza Lindore, Loti 2, (për disa shtesa në VKM-në nr. 65, datë 08.02.2023) bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues.
Me shkresën nr. 550/1 Prot., datë 15.06.2023 Urdhër nr. 91, datë 15.06.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, është krijuar KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurës së shpronësimit, për disa shtesa në VKM-në nr. 65, datë 08.02.2023 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i akseve rrugore 'Unaza Lindore, Loti 2' dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit", me përbërje: Egra Ibrahimi, Drejtor i Përgjithshëm, Kryetar; Besnik Hysaj, inxhinier, anëtar; Ilirjana Hasanllari, juriste, anëtare; Entela Bytyçi, inxhiniere, anëtare; Spartak Kodra, ekonomist, anëtar; Funksioni i Sekretarisë Teknike kryhet nga z. Spartak Kodra.
Me shkresën nr. 550/2, ASHSH i kërkon ARRSH-së plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur edhe procesverbalin e KPSH, datë 21.07.2023, ku vendos: ***Pranimin me kusht të kërkesës dërguar nga ARRSH me kushtin që, subjekti kërkues ARRSH, brenda një afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditor nga data e publikimit të kërkesës në QBZ, të plotësojë dokumentacionin*** si më poshtë dhe ta paraqesë në ASHSH:
Pasuria nr.45/13, ZK 1604 dhe nr.45/11, ZK 1604, kartelë dhe HTR janë jashtë afatit, për këtë arsye duhen të rifreskuara.

Me shkresën nr. 550/3, datë 21.07.2023, ASHSH i njofton ARRSH-së pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik.
Me shkresën nr. 550/4, datë 21.07.2023 mes ASHSH dhe ARRSH lidhet akt-marrëveshja për angazhimin e ndërsjellë të ASHSH, si autoritet përgjegjës dhe ARRSH, si subjekt kërkues, për marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave për shpronësim.
Me shkresën nr.550/5, datë 28.07.2023, ASHSH dërgon për publikim pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare kërkesën për shpronësim për interes publik.
Me shkresën nr.550/6, datë 28.07.2023, ASHSH njofton (nëpërmjet ARRSH-së) subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik.
Me anë të procesverbalit datë 30.08.2023 KPSH në ASHSH pas përfundimit të afatit 15 ditor të publikimit të kërkesë për shpronësim nr.550/5, datë 28.07.2023, në Fletoren Zyrtare nr. 113, datë 01.08.2023, në përfundim vendosi;
Miratimin e propozimit, për disa shtesa në VKM nr. 65, datë 08.02.2023 "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i akseve rrugore "Unaza Lindore , Loti II" dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit", me vlerë totale të shpronësimit 1, 077,705 (një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesë) lekë;
Me shkresën nr. 550/7, datë 31.08.2023 ASHSH ka dërguar pranë MIE propozimin e projektvendimit për shpronësim, bashkëlidhur relacionin shoqërues. (prezent në dosje por i pa inventarizuar)
Me shkresën nr. 4200/6, datë 18.09.2023 (protokolluar në ASHSH me nr.550/8, datë 20.09.2023) ARRSH ka kthyer përgjigje për zbatimin e kushtit të lënë për plotësim dokumentacioni, duke paraqitur kartelat e pasurisë dhe HTR të rifreskuara për pasuritë nr.45/13, ZK 1604 dhe nr.45/11, ZK 1604.
Me shkresën nr. 389, datë 16.01.2024 (protokolluar në ASHSH me nr.170, datë 22.01.2024) ARRSH kthen përgjigje për plotësim dokumentacioni duke paraqitur tabelën e shpronësimit të plotësuar sipas kërkesës së ASHSH bërë nëpërmjet komunikimit elektronik.
Me anë të procesverbalit datë 23.01.2024 Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit në ASHSH, pas verifikimit të kthimit të përgjigjes nr. 170 prot. datë 22.01.2024 nga ARRSH, vendos: Miratimin përfundimtar të tabelës së shpronësimit, bashkëlidhur këtij procesverbali, me shënimet përkatëse sipas tabelës së përcjellë nga ARRSH, me qëllim vijimin e dërgimit të saj për miratim pranë Këshillit të Ministrave. (procesverbal i firmosur vetëm nga tre prej anëtarëve të Komisionit të Posaçëm, prezent në dosje por i pa inventarizuar)
Me shkresën nr. 653, datë 19.01.2024 (protokolluar në ASHSH me nr.170/1, datë 24.01.2024) MIE duke shpjeguar se projektvendimi është kthyer nga Kryeministria pasi nuk janë dhënë sqarime në relacion, kërkon sqarim lidhur me tabelën e shpronësimit për sa i përket shënimeve në nr. 11 të saj.
Me anë të shkresës përcjellëse nr. 170/2 datë 24.01.2024 ASHSH i drejtohet MIE duke informuar për plotësimin e dokumentacionit nga ARRSH dhe përcjell shkresën nr. 389, datë 16.01.2024 me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme për shpronësim për projektin e sipërcituar. (inventarizuar 14 faqe prezent 1)
Me shkresën nr. 931/1, datë 15.02.2024 (protokolluar në ASHSH me nr.350, datë 16.02.2024) Këshilli i Ministrave përcjell VKM nr. 66, datë 14.02.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 65, datë 08.02.2023 të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i akseve rrugore "Unaza Lindore , Loti II" dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit"
Me shkresën nr.350/1, datë 19.02.2024, ASHSH përcjell pranë ARRSH-së, VKM nr. 66, datë 14.02.2024 të Këshillit të Ministrave.

Me shkresën nr.350/2, datë 19.02.2024, ASHSH njofton (nëpërmjet ARRSH-së) subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik, VKM nr. 66, datë 14.02.2024 të Këshillit të Ministrave.
Me shkresën nr.350/3, datë 19.02.2024, ASHSH i drejtohet ARRSH-së për pagesën e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm

Konkluzion:

1. Kërkesa për shpronësim, (për disa shtesa në VKM-në nr.65, datë 08.02.2023), është paraqitur e pa shoqëruar me dokumentacionin e plotë: Leje dhe miratim përkatës nga organet kompetente; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse; Dokumentacioni që vërteton shkakun e shpronësimit; Adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privatë që shpronësohen, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", (i ndryshuar), pikës 1 të VKM nr. 127, datë 23.03.2000 dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/28 prot; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, si më poshtë vijon:
1.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi Lejet dhe miratim përkatës nga organet kompetente; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse; Dokumentacioni që vërteton shkakun e shpronësimit; Adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privatë që shpronësohen**, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se:
KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1144/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se, dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim si dhe dokumentacioni plotësues në çdo rast janë pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet nga ana e subjektit kërkues pranë ASHSH kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit.
Sa më sipër, sqarojmë se, në rastin konkret pasi janë konstatuar mangësitë nga ana e KPSH mbi dokumentacionin e depozituar nga ana e subjektit kërkues është lënë mundësia (në mbështetje të pikës 2, të nenit 12 të ligjit 8561/1999, të ndryshuar) të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm për shpronësim.
Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH.
1.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se konstatimi i mësipërm i referohet dokumentacionit të plotë që duhet të shoqërojë kërkesën për shpronësim sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Fakti që mes ASHSH dhe subjektit kërkues ka një korrespondencë të përsëritur për plotësim dokumentacioni konfirmon qëndrimin e grupit të auditimit.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**

2. Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 18 të *"Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, ku përcaktohet se: "Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen".

2.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi protokollimin e procesverbaleve** të KPSH, ASHSH shprehet se:
Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast.
2.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se neni 18 i Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

3. Vendimmarrja sipas procesverbalit datë 21.07.2023 të KPSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"* (i ndryshuar), ku përcaktohet se: *Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse,* pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, *"Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet"*.

3.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi vendimmarrjen sipas procesverbalit datë 21.07.2023**, ASHSH shprehet se:
Në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin Komisioni sqaron se, në përputhje me nenin 12 të Ligjit 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, janë dërguar shkresat përkatëse me lëndë *"Për plotësim dokumentacioni"* pranë subjektit kërkues për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për shpronësim.
Lidhur me pikën e vendimmarrjes së konstatuar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin (ASHSH) sqaron se, duke qenë një institucion relativisht i ri dhe në fazë konsolidimi të procedurave të saj administrative, ajo është në dispozicion për të marrë në konsideratë gjetjen e këtij konstatimi.
ASHSH garanton se, në vijim, do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përcaktimin e afatit kohor dhe për organizimin e procedurave të brendshme, në mënyrë që çdo kërkesë për shpronësim, e cila paraqitet me dokumentacion të paplotë ose të pasaktë, të trajtohet në përputhje me nenin 12, pikën 2 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar).
Komisioni sqaron gjithashtu se, në praktikat e mëvonshme të ASHSH-së, kjo procedurë është zbatuar në mënyrë të rregullt: çdo kërkesë për shpronësim me dokumentacion të paplotë kthehet menjëherë tek subjekti kërkues, së bashku me udhëzimet për plotësimin e dokumentacionit, duke përcaktuar një afat të qartë dhe të monitorueshëm për paraqitjen e dokumentacionit plotësues.

Ky mekanizëm ka siguruar respektimin e ligjit dhe garanton që çdo vendimmarrje për shpronësim të bazohet mbi një dosje të plotë, të verifikuar dhe të dokumentuar, duke eliminuar çdo mungesë të dokumentacionit që mund të ndikojë në ligjshmërinë dhe korrektësinë e procedurës.

3.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se sipas procesverbalit datë 21.07.2023 KPSH ka vendosur Pranimin me kusht të kërkesës dërguar nga ARRSH me kushtin që, subjekti kërkues ARRSH, brenda një afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditor nga data e publikimit të kërkesës në QBZ, të plotësojë dokumentacionin si më poshtë dhe ta paraqesë në ASHSH: Pasuria nr.45/13, ZK 1604 dhe nr.45/11, ZK 1604, kartelë dhe HTR janë jashtë afatit, për këtë arsye duhen të rifreskuara dhe jo "Kthim pa veprim të kërkesës për shpronësim dhe plotësim dokumentacioni".

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**

4. Pranimi me kusht i kërkesës, është një vendimmarrje që nuk gjen mbështetje në aktet ligjore e nënligjore të cilat rregullojnë mënyrën e funksionimit të KPSH. Kjo lloj vendimmarrje është jashtë kompetencave të këtij Komisioni. Vendimmarrja sipas procesverbalit datë 30.08.2023 të KPSH ***ka ardhur në mungesë të plotësimit të kushtit të vendosur nga vetë*** KPSH në procesverbalin e KPSH, datë 21.07.2023 në kundërshtim me përcaktimet e nenit 10, pika 1 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", (i ndryshuar), pikës 1 të VKM nr. 127, datë 23.03.2000 dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Aktmarrëveshja e lidhur mes ASHSH dhe ARRSH nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", (i ndryshuar).

5.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit bashkëlidhur Aktmarrëveshjes**, ASHSH shprehet se:

KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1144/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve.

Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH.

5.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivin tuaj. Aktmarrëveshja është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për palët. Ligji kërkon në mënyrë të shprehur qartë domosdoshmërinë e bashkëlidhjes së dokumentacionit që ka shoqëruar kërkesën për shpronësim. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

6. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon ARRSH, (Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e ARRSH marrjen e masave për njoftimin e tij.) realizimin e "Njoftimit për shpronësim publik", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "*Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të KPSH*", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM nr.127, datë 23.03.2000, "*Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

6.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje **me konstatimin që lidhet me detyrimin e ASHSH për të njoftuar subjektin privat që shpronësohet**, ASHSH shprehet se:
Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "*Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij*", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "*korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin*".
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar
6.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që, në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**

7. Në relacionin bashkëlidhur propozimit të projektvendimit për shpronësim, nisur me shkresën nr. 550/7, datë 31.08.2023 pranë MIE, *nuk përcaktohet afati i fillimit dhe përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit*

8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar).

8. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon ARRSH, *(Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e ARRSH marrjen e masave për njoftimin e tij.)* realizimin e "Njoftimit për shpërblimin nga shpronësimi", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"* (i ndryshuar).

7.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **mbi "Njoftimit për shpërblimin nga shpronësimi"** ASHSH shprehet se:
Komisioni sqaron se, ky konstatim është trajtuar më sipër.
7.2 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. *Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja,* sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**

9. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell ASHK vendimin e KM për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5 nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"*, i ndryshuar dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit. Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.

8.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të përcjellë VKM-në shpronësimit pranë ASHK**, ASHSH shprehet se: Sikurse ju kemi shpjeguar në konstatimin e sipërcituar, ASHSH nuk është autoriteti që kryen regjistrimin në ASHK, por subjekti kërkues (në rastin konkret Bashkia Tiranë) është përgjegjës për dërgimin e dokumentacionit për regjistrim, dhe ASHK brenda 30 ditëve nga data e VKM-së kryen regjistrimin e pasurive të shpronësuara, thënë kjo dhe në ligjin Nr. 11/2020 neni 11.
KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim.

Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit.
ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 *"Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin"* ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.
8.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:
Së pari: referuar nenit 11, pika 5, gërma "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.
Së dyti: sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.
Së treti, nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja Sqarimi se ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit, nuk përkon me gjetjen pasi në asnjë moment nuk është konkluduar se ASHSH duhet të kryejë aplikimet përkatëse pranë ASHK shërbime të cilat kërkojnë pagesë.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Praktika e shpronësimit është realizuar nga: Znj. Egra Ibrahimi me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e Kryetarit të KPSH, dhe anëtarët e KPSH Z. Besnik Hysaj me detyrë inxhinier, Znj. Ilirjana Hasanllari, me detyrë jurist, Znj. Entela Bytyçi, me detyrë inxhinier, Z. Spartak Kodra, me detyrë ekonomist.

XXII. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik, "Kërkesë për shpronësim, lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë", finalizuar me VKM-në *nr. 20, datë 17.01.2024*.

Me anë të shkresës nr. 10411 Prot., datë 12.11.2020 (protokolluar në MIE me nr. 8152 Prot., datë 20.11.2020), Bashkia Vlorë ka paraqitur kërkesën për shpronësim, "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë" bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues.
Me shkresën nr. 8517 Prot., datë 07.12.2020, Urdhër nr. 343, datë 07.12.2020 i Ministrit të Infrastukturës dhe Energjisë, është krijuar Komisioni i Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurës së shpronësimit, pasuritë pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë", me përbërje: Artan Shkreli, Zëvendësministër, Kryetar; Vjollca Bazaiti, inxhinier, anëtar; Etleva Malile, juriste, anëtare;

Valbona Pepa, juriste, anëtare; Martin Beqiraj, ekonomist, anëtar; Funksioni i Sekretarisë Teknike kryhet nga Aida Nika.
Me shkresën nr. 629 Prot., datë 15.01.2021, Urdhër nr. 23 datë 15.01.2021 të Ministrit të Infrastukturës dhe Energjisë, Kryetari z. Artan Shkreli zëvendësohet me z. Etjen Xhafaj.
Me shkresën nr. 6878 Prot., datë 22.09.2021 Udhër nr. 373 datë 22.09.2021 të Ministrit të Infrastukturës dhe Energjisë Kryetari z. Etjen Xhafaj zëvendësohet me z. Erlis Hereni Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH.
Me shkresën nr. 6 Prot., datë 29.08.2022 Urdhër nr. 162 datë 29.08.2022 të Ministrit të Infrastukturës dhe Energjisë Kryetari z. Erlis Hereni zëvendësohet me znj. Egra Ibrahimi Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH.
Me shkresën nr. 918 prot., datë 21.01.2021 me lëndë "***Plotësim dokumentacioni***", MIE i kërkon Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë 19.01.2021, ku konstatohet mungesa e dokumentacionit shoqërues dhe i kërkohet Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit (pa caktuar afat).
Me shkresën nr. ska., datë 15.01.2021 protokolluar në MIE me nr.772 Prot., datë 19.01.2021) Shoqëria "Relti 2010" kërkon: Shfuqizimin e kërkesës për shpronësim të Komisionit Paraprak të Vlerësimit për pronën nr. 33/392 v.31 f.177, ZK 8604 Bashkia Vlorë.
Me shkresën nr. 772/1 Prot., datë 25.01.2021 MIE i dërgon për kompetencë Bashkisë Vlorë kërkesën e sipërcituar.
Me shkresën nr. 996/1., datë 12.02.2021 protokolluar në MIE me nr. 772/2 Prot., datë 18.01.2021) Bashkia Vlorë dërgon informacion lidhur me pronën nr.33/392, ZK 8604.(pa bashkëlidhur kopje te projektit)
Me shkresën nr. ska., datë 03.03.2021 protokolluar në MIE me nr.772/3 Prot., datë 08.03.2021) Shoqëria "Relti 2010" kërkon përsëri: Shfuqizimin e kërkesës për shpronësim të Komisionit Paraprak të Vlerësimit për pronën nr. 33/392 v.31 f.177, ZK 8604 Bashkia Vlorë.
Me shkresën nr. 4394 Prot., datë 19.03.2021 (protokolluar në MIE me nr. 918/1 Prot., datë 29.11.2021), Bashkia Vlorë dërgon plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar", Vlorë.
Me shkresën nr. 918/2 prot., datë 18.05.2021 me lëndë "***Plotësim dokumentacioni***", MIE i kërkon përsëri Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë ska .05.2021, ku i kërkohet Bashkisë Vlorë që plotësimi i dokumentacionit të ketë një rrjedhë kronologjike sipas kërkesave të KPSH dhe të jenë qartësisht të argumentuara (përsëri pa caktuar afat).
Me shkresën nr. 455 prot., datë 29.09.2021 me lëndë "***Kujtesë mbi plotësimin e dokumentacionit të kërkesës për shpronësim***", MIE i kërkon përsëri Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim duke caktuar një afat 30 ditor në tejkalim të të cilit do të procedohet me kthimin e kërkesës për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga zbatimi i projektit "Lidhja e rrugës Transballkanike me portin Detar" Vlorë.
Me shkresën nr. 249 prot., datë 15.02.2022 ASHSH i kthen Bashkisë Vlorë kërkesën për shpronësim së bashku me dokumentacionin shoqërues, bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë 14.02.2021, ku konstatohet mosplotësimi i dokumentacionit nga Bashkia Vlorë dhe vendoset kthimi i kërkesës për shpronësim së bashku me dokumentacionin shoqërues.
Me anë të shkresës nr.2332 Prot., datë 04.03.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.337 Prot., datë 07.03.2022), Bashkia Vlorë ka paraqitur kërkesën për shpronësim, "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë" **bashkëlidhur dokumentacionin shoqërues të dërguar më parë me kërkesën për shpronësim protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 8152 Prot., datë 20.11.2020**.

Me shkresën nr. 337/1 prot., datë 21.04.2022 me lëndë "***Plotësim dokumentacioni***", ASHSH i kërkon Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë 21.04.2022, ku i kërkohet Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit. (pa caktuar afat).
Me shkresën nr. 2332/2 Prot., datë 04.05.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 337/2 Prot., datë 16.05.2022,) Bashkia Vlorë dërgon plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë".
Me shkresën nr. 8331 Prot., datë 21.07.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 337/4 Prot., datë 08.08.2022) Bashkia Vlorë dërgon përsëri, plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë".
Me shkresën nr. 337/6 prot., datë 07.09.2022 me lëndë "***Plotësim dokumentacioni***", ASHSH i kërkon Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë 06.09.2022, ku i kërkohet Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit brenda 30 (tridhjetë) ditëve në mënyrë që Komisionit i Posaçëm i Shpronësimit, të vijojë pa vonesa me procedurat e mëtejshme për shpronësim.
Me shkresën nr. 10123/1 Prot., datë 19.09.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.337/7 Prot., datë 21.09.2022) Bashkia Vlorë dërgon, plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë".
Me shkresën nr. 10123/2 Prot., datë 11.10.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 337/8 Prot., datë 14.10.2022) Bashkia Vlorë dërgon përsëri, plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë".
Me shkresën nr.ska, datë 11.11.2022 (protokolluar në ASHSH me nr. 337/9 Prot., datë 11.11.2022) paraqitet deklaratë noteriale nr. 7199 Rep 3081 Kol nga pronarët Çota për dakordësi për mosshpronësim të pasurive të tyre që preken nga "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë".
Me shkresën nr. 337/10 prot., datë 13.12.2022 me lëndë "***Plotësim dokumentacioni***", ASHSH i kërkon Bashkisë Vlorë plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë 13.12.2022, ku i kërkohet Bashkisë Vlorë të plotësojë dokumentacionin duke u shprehur mbi burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshëm për shpronësim në mënyrë që KPSH, të vijojë pa vonesa me procedurat e mëtejshme për shpronësim. Gjithashtu KPSH shprehet dhe njëherë se deklaratat për heqjen dorë nga shpronësimi nuk mund të meren parasysh dhe këto pasuri të përfshihen në listën e shpronësimit.
Me shkresën nr. 10123/4 Prot., datë 15.12.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.337/11 Prot., datë 30.12.2022) Bashkia Vlorë dërgon përsëri, plotësim të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për shpronësim, "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë", duke u shprehur se: *në dijeninë tonë fondi i shpronësimit me burim nga Buxheti i Shtetit është transferuar për projekte të tjera për nevoja emergjente.....lutemi planifikoni shumën 206,784,251.9 lekë për garantimin e fondeve të nevojshme për shpronësim për finalizimin e kërkesës me VKM-në e shpronësimit.*
Me anë të email datë 12.01.2023 (printuar dhe protokolluar në ASHSH me nr 81 prot. datë 12.01.2023 Bashkia Vlorë dërgon tabelën e shpronësimit për "Realizimi i projektit lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë".
Me shkresën nr. 81/1 prot., datë 13.01.2023 me lëndë "***Njoftim për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik***", bashkëlidhur procesverbalin e KPSH, datë 13.01.2023 ASHSH i njofton Bashkisë Vlorë pranimin e kërkesës për shpronësim.
Me shkresën nr.81/2, datë 13.01.2023 mes ASHSH dhe Bashkisë Vlorë lidhet akt-marrëveshja për angazhimin e ndërsjellë të ASHSH, si autoritet përgjegjës dhe Bashkisë Vlorë, si subjekt kërkues, për marrjen e masave dhe kryerjen e procedurave për shpronësim.

Me shkresën nr. 81/3 prot., datë 13.01.2023 me lëndë "***Mbi garantimin e fondeve për shpronësim***", ASHSH i kërkon MFE konfirmim për dokumentacionin lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo zhvlerësimit.
Me shkresën nr. 504 Prot., datë 16.01.2023 (protokolluar në ASHSH me nr.81/4 Prot., datë 16.01.2023) me lëndë "Mbi plotësimet për dosjen e shpronësimit për projektin "Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë", Bashkia Vlorë dërgon, tabelën e shpronësimit dhe shkresën nr.349 prot datë 12.01.2023 me lëndë "Kërkesë për alokim fondi të shpronësimit për projektin "Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë" drejtuar Ministrisë së Financave, ku kërkohet planifikimi i shumës prej **206,784,215.9** lekë për garantimin e fondeve financiare të nevojshme për shpronësim.
Me shkresën nr. 81/5, datë 25.01.2023, ASHSH dërgon për publikim pranë Qëndrës së Botimeve Zyrtare kërkesën për shpronësim për interes publik.
Me shkresën nr. 81/6, datë 25.01.2023, ASHSH njofton (nëpërmjet Bashkisë Vlorë) subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik.
Me shkresën protokolluar në ASHSH me nr.81/7, datë 06.02.2023 shtetasi Leonard Xhako paraqet kërkesë për shpronësim të drejtë dhe real.
Me shkresën protokolluar në ASHSH me nr.81/8, datë 14.02.2023 shtetasi Sotiraq Papajani paraqet kërkesë për mosprishje objekti dhe kundërshtim i vlerësimit paraprak.
Me shkresën nr.81/9, datë 14.01.2023, ASHSH i dërgon për kompetencë Bashkisë Vlorë ankesën e shtetasit Leonard Xhako bashkëlidhur procesverbali i KPSH datë 10.02.2023.
Me shkresën nr.ska, datë 13.02.2023 protokolluar në ASHSH me nr.81/10, datë 15.02.2023 shtetasja Dhimitra Zotaj paraqet kërkesë për saktësim të vlerës së objektit.
Me shkresën nr.81/13, datë 16.02.2023, ASHSH i dërgon për kompetencë Bashkisë Vlorë ankesën e shtetasit Sotiraq Papajani bashkëlidhur procesverbali i KPSH datë 14.02.2023
Me shkresën nr.ska, datë ska protokolluar në ASHSH me nr.81/14, datë 16.02.2023 shtetasi Odise Anagnosti paraqet ankesë për vlerën e shpornësimit të objektit.
Me shkresën nr.81/15, datë 17.02.2023, ASHSH i kthen përgjigje shtetases Dhimitra Zotaj lidhur me kërkesën protokolluar në ASHSH me nr.81/10, datë 15.02.2023.
Me shkresën nr.81/16, datë 21.02.2023, ASHSH i dërgon për kompetencë Bashkisë Vlorë ankesën e shtetasit Odise Anagnosti bashkëlidhur procesverbali i KPSH datë 17.02.2023.
Me shkresën nr. ska datë ska, protokolluar në ASHSH me nr.81/17, datë 23.02.2023 shtetasi Agim Mustafaraj paraqet kërkesë për prerjen e objektit deri tek vija e shpronësimit.
Me shkresën nr. 1678/1 datë 23.02.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/18, datë 27.02.2023 Bashkia Vlorë përcjell pranë ASHSH ankesën e shtetasit Gëzim Lako.
Me shkresën nr. 1464/1 datë ska, protokolluar në ASHSH me nr.81/21, datë 01.03.2023 Bashkia Vlorë përcjell pranë ASHSH ankesën e shtetasit Jaho Dano.
Me shkresën nr. 2449 datë 27.02.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/22, datë 01.03.2023 Bashkia Vlorë përcjell pranë ASHSH lejen e zhvillimit nr.107 datë 03.02.2023 miratuar nga Bashkia Vlorë , në pronën e BP Çota .
Me shkresën nr. 2456 datë 27.02.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/23, datë 01.03.2023 Bashkia Vlorë përcjell pranë ASHSH kërkesa e subjektit të shpronësuar BP Mustafaraj.
Me shkresën nr. 1721/1 datë 24.02.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/24, datë 01.03.2023 Bashkia Vlorë përcjell pranë ASHSH ankesën e shtetasit Leonard Xhaho.
Me procesverbalin datë 16.03.2023 Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit ka shqyrtuar ankesat e ardhura pranë ASHSH me nr.81/17, datë 23.02.2023; nr.81/18, datë 27.02.2023; nr.81/21, datë 01.03.2023; nr.81/24, datë 01.03.2023 dhe nr.81/22, datë 01.03.2023.
Me shkresën nr.81/33, datë 21.03.2023, ASHSH i dërgon për kompetencë Bashkisë Vlorë ankesën e shtetasit Gëzim Lako.

Me shkresën nr.81/34, datë 21.03.2023, ASHSH i dërgon për kompetencë Bashkisë Vlorë ankesën e shtetasit Jaho Dano.
Me shkresën nr.81/35, datë 21.03.2023, ASHSH i kthen përgjigje Bashkisë Vlorë lidhur me shkresën protokolluar në ASHSH me nr.81/22, datë 01.03.2023.
Me shkresën nr.81/36, datë 21.03.2023, ASHSH i kthen përgjigje Bashkisë Vlorë, për dijeni Agim Mustafaraj, lidhur me shkresën protokolluar në ASHSH me nr.81/23, datë 01.03.2023.
Me shkresën nr.81/37, datë 21.03.2023, ASHSH i dërgon për kompetencë Bashkisë Vlorë ankesën e shtetasit Leonard Xhaho.
Me shkresën nr. 5060 datë 28.04.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/40, datë 05.05.2023 Bashkia Vlorë dërgon përgjigjen për kërkesën protokolluar me nr. 7971 datë 28.04.2023 të shtetasit Esli Hajdëri.
Me shkresën nr. 1678/3 datë 03.05.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/41, datë 09.05.2023 Bashkia Vlorë dërgon përgjigjen e kthyer shtetasit Gëzim Lako.
Me shkresën nr. 5282 datë 04.05.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/42, datë 09.05.2023 Bashkia Vlorë dërgon përgjigjen e kthyer shtetasit Jaho Dano.
Me anë të e-mail datë 02.05.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/43, datë 09.05.2023 Bashkia Vlorë dërgon përgjigjet e kthyera ankesave të subjekteve të shpronësuara.
Me shkresën nr. 5527 datë 09.05.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/44, datë 11.05.2023 Bashkia Vlorë dërgon listën e pronarëve që preken nga realizimi i projektit "Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë" së bashku me trajtimin e bërë të ankesave paraqitur nga subjektet e shpronësuar.
Me procesverbalin datë 24.05.2023 Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit vendos: Miratimin e propozimit "Për shpronësimin, për inters publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë", me vlerë totale të shpronësimit 182,020,370.86 (njëqind e tetëdhjetë e dy milionë e njëzetëmijë e treqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë.
Me shkresën nr. 5521/1 datë 23.05.2023, protokolluar në ASHSH me nr.81/46, datë 29.05.2023 Bashkia Vlorë dërgon përgjigjen e kthyer shtetasit Stefan Papajani.
Me shkresën nr. 81/47, datë 31.05.2023 ASHSH ka dërguar pranë MIE propozimin e projektvendimit për shpronësim, bashkëlidhur relacionin shoqërues.
Me shkresën nr. ska datë ska, protokolluar në ASHSH me nr.81/55, datë 27.10.2023 Bashkia Vlorë përcjell "Plotësim dokumentacioni", vendim gjykate dhe listën e pronarëve të pasurive që shpronësohen.
Me shkresën nr. ska, datë 17.01.2024 (protokolluar në ASHSH me nr.22/1, datë 16.02.2024) Këshilli i Ministrave përcjell VKM nr. 20, datë 17.01.2024 *"Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar", Vlorë.*
Me shkresën nr.22/2, datë 29.01.2024, ASHSH njofton (nëpërmjet Bashkisë Vlorë) subjektet privatë pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes publik, VKM nr. 20, datë 17.01.2024 të Këshillit të Ministrave për shpërblimin nga shpronësimi.
Me shkresën nr.22/3, datë 29.01.2024, ASHSH i drejtohet Bashkisë Vlorë për pagesën e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm.
Me shkresën nr. ska datë 21.02.2024, protokolluar në ASHSH me nr.22/4, datë 27.02.2024, Shoqëria "A.T. Oricum" sh.p.k i drejtohet Bashkisë Vlorë dhe ASHSH me propozim për aplikimin e instrumentave për drejtimin e zhvillimit të territorit,në lidhje me pasurinë e llojit truall me nr.32/306.
Me shkresën nr.22/5, datë 28.03.2024, ASHSH i dërgon për kompetencë Bashkisë Vlorë kërkesën e subjektit Shoqëria "A.T. Oricum" sh.p.k.

Konkluzion:

1. Kërkesa për shpronësim, (Kërkesë për shpronësim, lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë), është paraqitur e pa shoqëruar me dokumentacionin e plotë: Leje dhe miratim përkatës nga organet kompetente; Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse; Dokumentacioni që vërteton shkakun e shpronësimit; Dokumentacionin lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit; Adresat zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privatë që shpronësohen, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"*, (i ndryshuar), pikës 1 të VKM nr. 127, datë 23.03.2000 dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 18 të *"Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, ku përcaktohet se: *"Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen"*.
3. Vendimmarrjet sipas procesverbaleve datë 21.04.2022; 07.09.2022 dhe 13.12.2022 të KPSH në ASHSH janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"* (i ndryshuar), ku përcaktohet se:
   Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.
   Në rastin konkret KPSH ka konstatuar mungesë të dokumentacionit që shoqëron kërkesën por nuk e ka kthyer atë për plotësim dhe nuk ka caktuar një afat të posaçëm për paraqitjen e tij. Më tej është vijuar me kërkesa të vazhdueshme për plotësim dokumentacioni dhe sjellje të tij nga Bashkia Vlorë.
4. Vendimmarrja sipas procesverbalit datë 13.01.2023 të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"* (i ndryshuar), ku përcaktohet se: Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij duke caktuar një afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.
   Në rastin konkret, dokumentacioni shoqërues nuk i është kthyer kërkuesit të shpronësimit me qëllim plotësimin e tij sipas kërkesave të vetë KPSH. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit ka pranuar kërkesën për shpronësim në dijeni të plotë të mungesës të fondeve financiare të nevojshme për shpronësim shprehur në shkresën nr.10123/4 Prot., datë 15.12.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.337/11 Prot., datë 30.12.2022) të Bashkisë Vlorë si dhe shkresën nr. 81/3 prot., datë 13.01.2023 me lëndë "Mbi garantimin e fondeve për shpronësim", ku ASHSH i kërkon Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë konfirmim për dokumentacionin lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo zhvlerësimit.
5. Aktmarrëveshja e lidhur mes ASHSH dhe ARRSH nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar)

6. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon Bashkisë Vlorë, (Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e Bashkisë Vlorë marrjen e masave për njoftimin e tij.) realizimin e "Njoftimit për shpronësim publik", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar), pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 23.03.2000, "*Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet*", pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.127, datë 23.03.2000, "*Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Në relacionin bashkëlidhur propozimit të projektvendimit për shpronësim, nisur me shkresën nr. 81/47, datë 31.05.2023 pranë MIE, nuk përcaktohet afati i fillimit dhe përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", (i ndryshuar).
8. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon Bashkisë Vlorë, (Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e Bashkisë Vlorë marrjen e masave për njoftimin e tij.) realizimin e "Njoftimit për shpërblimin nga shpronësimi", në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*" (i ndryshuar).
9. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5/c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Vlorë, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se: *regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit*. Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.

Praktika e shpronësimit është realizuar nga: Znj. Egra Ibrahimi me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e Kryetait të KPSH dhe anëtarët Znj. Vjollca Bazaiti me detyrë inxhiniere, Znj. Etleva Malile, me detyrë juriste, Znj. Valbona Pepa, me detyrë juriste, Z. Martin Beqiraj, me detyrë ekonomist.

XXIII. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt " Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit '**Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)" finalizuar me VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022**.

Nëpërmjet shkresës nr. 10321 Prot., datë 16.11.2021, protokolluar në ASHSH me nr. 597 Prot., datë 19.01.2022, ARRSH, ka paraqitur kërkesën për shpronësim, në funksion të disa shtesave në VKM nr. 658, datë 08.10.2014, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)'".

Me shkresën nr. 597/1 Prot., datë 22.11.2021, bazuar në urdhrin nr. 181, datë 22.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, është krijuar KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, në funksion të disa shtesave në Vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)"", me kërkesë të paraqitur nga ARRSH.

Komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Emri dhe Mbiemri	*Roli në Komision*	*Pozicioni*
Erlis Hereni	Drejtor i Përgjithshëm	Kryetar
Denada Dosti	Juriste	Anëtare
Aida Nika	Ekonomiste	Anëtare
Besnik Hysaj	Inxhinier	Anëtar
Ermal Bala	Inxhinier	Anëtar

***Funksioni i Sekretarisë Teknike** për këtë komision ushtrohet nga Entela Bytyçi.*

Nëpërmjet procesverbalit të mbajtur më datë 25.11.2021 dhe shkresës nr. 597/2 prot., datë 26.11.2021, KPSH i është drejtuar ARRSH me një kërkesë zyrtare për **plotësimin e dokumentacionit** të domosdoshëm. Kjo kërkesë u bë pas shqyrtimit të materialeve të paraqitura, nga ku u konstatua se dokumentacioni i dorëzuar ishte i paplotë.

ARRSH, me shkresën nr. 10780/1 prot., datë 14.12.2021, e protokolluar në ASHSH me nr. 597/3 prot., datë 17.12.2021, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga kjo e fundit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues të dërguar nga ARSH, KPSH nëpërmjet procesverbalit të mbajtur më datë 21.12.2021, pranon kërkesën për disa shtesave në VKM nr. 658, datë 08.10.2014, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)"", me vlerë paraprake të shpronësimit 2,025,300.00 lekë.

Sa më sipër, Sekretaria Teknike duhet: (Të njoftojë subjektin kërkues; Të hartojë akt-marrëveshjen ndërmjet ASHSH dhe ARSH, Të bëjë publikimin e kërkesës për shpronësim të pronave që preken nga realizimi i projektit në Qendrën e Botimeve Zyrtare, Të bëjë njoftimin e drejtpërdrejtë të secilit pronar a bashkëpronar të pasurive, pronë private).

Nisur nga sa më sipër, me shkresën nr. 597/4 prot., datë 21.12.2021, është bërë njoftimi për pranimin e kërkesës për shpronësim drejtuar ARRSH.

Në vijim, me shkresën nr. 597/5 prot., datë 21.12.2021, është lidhur Akt-Marrëveshja për disa shtesa në VKM nr. 658, datë 08.10.2014, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)"".

Në vijim, me shkresën nr. 7 prot., datë 05.01.2022, ASHSH ka dërguar për publikim pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare kërkesën për shpronësim.

Me shkresën nr. 7/1 Prot., datë 05.01.2022, ASHSH ka dërguar njoftimin përkatës drejtuar subjektit privat Besim Valteri dhe ARRSH.

Me anë të procesverbalit të mbajtur më datë 22.02.2022, KPSH pranë ASHSH, pas përfundimit të afatit 15-ditor nga publikimi i kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, në përfundim vendosi:

- **Miratimin e propozimit për shpronësim për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)"", me vlerë totale të shpronësimit prej 2,025,300 lekë.**

Me shkresën nr. 7/2 prot., datë 23.02.2022, ASHSH i dërgon MIE propozimin për projektvendimin e shpronësimit, të shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës
Nëpërmjet shkresës nr. 2247 prot., datë 29.04.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 7/3 prot., datë 05.05.2022, Këshilli i Ministrave i dërgon ASHSH, Vendimin e miratuar nr. 279, datë 29.04.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)"", të ndryshuar.
Me shkresën nr. 7/4 prot., datë 09.05.2022, ASHSH i përcjell ARRSH, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 279, datë 29.04.2022.
Me shkresën nr. 7/5 prot., datë 09.05.2022, ASHSH njofton ARRSH dhe subjektin privat, z. Besim Ramis Valteri, lidhur me shpërblimin për shpronësimin. Në këtë shkresë, theksohet se, për shkak të mungesës së adresës së subjekteve të shpronësuara, i kërkohet ARRSH-së të marrë masat për njoftim.

Konkluzion:

1. Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, "*Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore*", ku parashikohet se:

"Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse."

2. Vendimmarrja për pranimin e kërkesës sipas procesverbalit datë 21.12.2021 e KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, ku parashikohet se në rastet kur dokumentacioni shoqërues i kërkesës për shpronësim nuk paraqitet i plotësuar brenda afatit të caktuar ose rezulton i pambështetur, kërkesa duhet të refuzohet nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe kërkuesi duhet të njoftohet menjëherë.
Nisur nga sa më sipër, kërkesa është miratuar në mungesë të, Adresës zyrtare më të fundit të njohura të subjekteve privatë që shpronësohen.
3. Aktmarrëveshja e lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH nuk ka të bashkëlidhur dokumentacionin që shoqëron kërkesën për shpronësim, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pika 4, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"Aktmarrëveshja është e pavlefshme në rast se në çastin e nënshkrimit të saj nuk i bashkëlidhen dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim sipas këtij ligji."

4. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon ARRSH realizimin e njoftimit të tij, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar.

5. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell ASHK vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5, nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit, si dhe të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH.
Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.
Praktika e shpronësimit u përgatit nga: Z. Erlis Hereni me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e Kryetait të KPSH, dhe anëtarët e KPSH **Znj. Denada Dosti** me detyrë jurist, **Znj. Aida Nika**, me detyrë ekonimist, **Z. Besnik Hysaj**, me detyrë inxhinier, **Z. Ermal Bala**, me detyrë inxhinier.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/30 prot; datë 02.03.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH-së, me anë të shkresës nr. 274/2 prot; datë 27.02.2026, si më poshtë vijon:
1.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi protokollimin e procesverbaleve** të KPSH, ASHSH shprehet se: *"Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast"*
1.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se neni 18 i Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.
2.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit bashkëlidhur Aktmarrëveshjes**, ASHSH shprehet se: *"KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1144/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve.*
Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH.".
2.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes

së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivën tuaj. Aktmarrëveshja ka funksionin të ribashkëngjisë dokumentet e dosjes, si dhe të formalizojë dakordësinë ndërmjet palëve mbasi gjithë dokumentacioni i kërkuar nga legjislacioni për shpronësimin është dorëzuar dhe verifikuar më parë. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

3.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të njoftuar subjektin privat që shpronësohet**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se: *"Nëpërmjet, shkresës nr. 10780/1 prot., datë 14.12.2021, e protokolluar në ASHSH me nr. 597/2 prot., datë 26.11.2021, nëpërmjet së cilës ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar, ka depozituar listën e shpronësimit, në të cilën evidentohet adresa e pronarit të pasurisë nr. 11/1423, ZK 8190, në listë është përcaktuar adresa e pronarit z. Besim Valteri, me adresë "Torre Drini", Njësia 4."*

3.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se nga ana juaj është paraqitur dokumentacioni teknik dhe ligjor për të vërtetuar njoftimin subjektin privat që shpronësohet Për rrjedhojë, ky konstatim nuk do të jetë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit.

4.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të përcjellë VKM-në e shpronësimit pranë ASHK**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se: *"KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim.*

Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit.

ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit".

4.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari: Referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve, përfshirë fazën e pas-shpronësimit dhe bashkërendimin me institucionet përgjegjëse.

Së dyti: sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila është kërkesë ligjore, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti: nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja Sqarimi se ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfitues i procedurës së shpronësimit, nuk përkon me gjetjen pasi në asnjë moment nuk është konkluduar se ASHSH duhet të kryejë aplikimet përkatëse pranë ASHK shërbime të cilat kërkojnë pagesë.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

XXIV. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 122, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor **'Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)" finalizuar me VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023**.
Nëpërmjet shkresës nr. 7606 Prot., datë 23.08.2021, protokolluar në ASHSH me nr. 381 Prot., datë 24.08.2021, ARRSH ka paraqitur kërkesën për shpronësim, në funksion të disa shtesave në VKM nr. 122, datë 03.05.2014, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)".
Me shkresën nr. 381/1 Prot., datë 25.08.2021, bazuar në urdhrin nr. 112, datë 25.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, është krijuar komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, në funksion të disa shtesave në Vendimin nr. 122, datë 03.05.2014, të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)", me kërkesë të paraqitur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH).
Komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Emri dhe Mbiemri	*Roli në Komision*	*Pozicioni*
Erlis Hereni	Drejtor i Përgjithshëm	Kryetar
Albian Marku	Arkitekt	Anëtare
Ermal Bala	Inxhinier	Anëtare
Sidorela Qato	Ekonomist	Anëtar
Etleva Malile	Jurist	Anëtar

***Funksioni i Sekretarisë Teknike** për këtë komision ushtrohet nga Areda Koçi.*

Ky komision, me urdhër nr. 74, datë 30.05.2022 është ndryshuar, si më poshtë:

Emri dhe Mbiemri	*Roli në Komision*	*Pozicioni*
Erlis Hereni	Drejtor i Përgjithshëm	Kryetar
Albian Marku	Arkitekt	Anëtare
Entela Bytyçi	Inxhinier	Anëtare
Sidorela Qato	Ekonomist	Anëtar
Etleva Malile	Jurist	Anëtar

***Funksioni i Sekretarisë Teknike** për këtë komision ushtrohet nga Areda Koçi.*

Me urdhër nr. 101, datë 11.08.2022, komisioni është ndryshua si më poshtë:

Emri dhe Mbiemri	*Roli në Komision*	*Pozicioni*
Egra Ibrahimi	Drejtor i Përgjithshëm	Kryetar
Albian Marku	Arkitekt	Anëtare

Entela Bytyçi	Inxhinier	Anëtare
Sidorela Qato	Ekonomist	Anëtar
Etleva Malile	Jurist	Anëtar

***Funksioni i Sekretarisë Teknike** për këtë komision ushtrohet nga Areda Koçi.*

Nëpërmjet procesverbalit të mbajtur më datë **27.09.2021** dhe shkresës nr. 381/2 Prot., datë 27.09.2021, KPSH i është drejtuar ARRSH me një kërkesë zyrtare për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm. Kjo kërkesë u bë pas shqyrtimit të materialeve të paraqitura nga kërkuesi.

Në vijim të sa më sipër, me shkresën nr. 45 Prot., datë 11.01.2022, ASHSH i ka dërguar ARRSH një shkresë me objekt "Kujtesë për plotësimi i dokumentacionit", duke u mbështetur në nenin 12, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik".

ARRH, me shkresën nr. 1393 Prot., datë 07.02.2022, e protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim me nr. 45/1 prot., datë 14.02.2022, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga kjo e fundit.

Përsëri, nëpërmjet procesverbalit të mbajtur më datë **30.03.2022** dhe shkresës nr. 45/2 Prot., datë 30.03.2022, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit i është drejtuar ARRSH me një kërkesë zyrtare për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm. Kjo kërkesë u bë pas shqyrtimit të materialeve të paraqitura nga kërkuesi.

Më datë 13.05.2022, pranë ASSH është administruar shkresa e protokolluar me nr. 45/3 Prot., datë 13.05.2022, e dërguar nga subjekti privat z. Fatmir Kazazi, i cili bën deklarimin e adresës së banimit.

ARRSH, me shkresën nr. 4207/1 Prot., datë 07.02.2022, e protokolluar në ASHSH me nr. 45/4 prot., datë 09.06.2022, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga kjo e fundit.

Përsëri, nëpërmjet procesverbalit të mbajtur më datë 13.07.2022 dhe shkresës nr. 45/5 Prot., datë 15.07.2022, KPSH i është drejtuar ARRSH me një kërkesë zyrtare për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm. Kjo kërkesë u bë pas shqyrtimit të materialeve të paraqitura nga kërkuesi.

ARRSH, me shkresën nr. 7651/1 Prot., datë 29.07.2022, e protokolluar në ASHSH me nr. 45/6 Prot., datë 04.08.2022, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nga kjo e fundit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues të dërguar nga ARSH, KPSH nëpërmjet procesverbalit të mbajtur më datë 25.08.2022, pranon kërkesën disa shtesave në VKM nr. 122, datë 03.05.2014, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ''Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)", me vlerë paraprake të shpronësimit 1,063,927.00 lekë.

Sa më sipër, Sekretaria Teknike duhet: (Të njoftojë subjektin kërkues, Të hartojë akt-marrëveshjen ndërmjet ASHSH dhe ARSH, Të bëjë publikimin e kërkesës për shpronësim të pronave që preken nga realizimi i projektit në Qendrën e Botimeve Zyrtare, Të bëjë njoftimin e drejtpërdrejtë të secilit pronar a bashkëpronar të pasurive, pronë private).

Nisur nga sa më sipër, me shkresën nr. 45/7 Prot., datë 26.08.2022, është bërë njoftimi për pranimin e kërkesës për shpronësim drejtuar ARRSH-së.

Në vijim, me shkresën nr. 45/8 Prot., datë 26.08.2022, është lidhur Akt-Marrëveshja për disa shtesave në VKM nr. 122, datë 03.05.2014, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ''Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)".

Në vijim, me shkresën nr. 45/9 prot., datë 02.09.2022, ASHSH ka dërguar për publikim pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare kërkesën për shpronësim.

Me shkresën nr. 45/10 Prot., datë 13.09.2022, ASHSH ka dërguar njoftimin përkatës për shpronësim drejtuar subjektit privat Seid Osman Mersini dhe Adelina Isa Bana, Avdulla Duro Bana, si dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Me anë të procesverbalit të mbajtur më datë 10.10.2022, KPSH pranë ASHSH, pas përfundimit të afatit 15-ditor nga publikimi i kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, në përfundim vendosi:

- **Miratimin e propozimit për shpronësim për disa shtesave në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 03.05.2014, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)", me vlerë totale të shpronësimit 1,063,927.00 lekë.**

Me shkresën nr. 45/11 Prot., datë 14.10.2022, ASHSH i dërgon MIE propozimin për projektvendimin e shpronësimit, të shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës

Nëpërmjet shkresës, protokolluar në ASHSH me nr. 127 prot., datë 20.01.2023, Këshilli i Ministrave i dërgon ASHSH, Vendimin e miratuar nr. 13, datë 18.01.2023, "Për disa shtesave në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 03.05.2014 "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)", të ndryshuar.

Me shkresën e protokolluar në ASHSH me nr. 127/1, subjekti privat, z. Fatmir Kazazi, emri i të cilit është përfshirë nga ARRSH në kërkesën fillestare për shpronësim, ka paraqitur një kërkesë pranë ASHSH-së, ku shpreh pretendimin se pasuria e tij nuk është përfshirë në VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023. Në këtë kuadër, z. Kazazi kërkon që pasuria e tij të përfshihet në vendimin për shpronësim.

ASHSH, nëpërmjet shkresës me nr. 127/5 Prot., datë 01.02.2023, i bën me dije ARRSH dhe subjektit privat se pasuria me nr. 6/231 nuk rezulton të jetë përfshirë në VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme private, që preken nga ndërtimi i objektit …". Gjithashtu, kjo shkresë përcillet për trajtim dhe kompetencë ligjore.

Me shkresën nr. 127/2 Prot., datë 30.01.2023, ASHSH i përcjell ARRSH, VKM-në nr. 13, datë 18.012023.

Me shkresën nr. 127/3 Prot., datë 30.01.2023, ASHSH i përcjell ARRSH si dhe subjektet private Seid Osman Mersini dhe Adelina Isa Bana, Avdulla Duro Bana, njoftimin për shpërblimi nga shpronësimi publik. Në këtë shkresë, theksohet se, për shkak të mungesës së adresës së subjekteve të shpronësuara, i kërkohet ARRSH-së të marrë masat për njoftim.

Konkluzion:

1. Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, *"Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore"*, ku parashikohet se:

"Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse."

2. Vendimmarrja për plotësimin e dokumentacionit sipas procesverbalit datë 27.09.2021 të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"*, i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti shpronësues duhet të vendosë një afat të posaçëm për plotësimin e dokumentacionit nga autoriteti përkatës.

Nga auditimi u konstatua se KPSH, nuk ka përcaktuar një afat të veçantë për dorëzimin e këtij dokumentacioni, pasi në rast të mos plotësimit të dokumentacionit brenda afatit të caktuar, vonesat e pajustifikuara mund të konsiderohen si shkak për refuzimin e kërkesës për shpronësim.

3. Vendimmarrja për pranimin e kërkesës sipas procesverbalit datë 25.08.2022 e KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, ku parashikohet se në rastet kur dokumentacioni shoqërues i kërkesës për shpronësim nuk paraqitet i plotësuar brenda afatit të caktuar ose rezulton i pambështetur, kërkesa duhet të refuzohet nga ASHSH dhe kërkuesi duhet të njoftohet menjëherë.

Nisur nga sa më sipër, KPSH ka lejuar dorëzimin e përsëritur të dokumentacionit plotësues nga subjekti, megjithëse dispozitat ligjore parashikojnë refuzimin e menjëhershëm të kërkesës nëse dokumentacioni nuk paraqitet i plotë brenda afatit të caktuar.

Aktmarrëveshja e lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH nuk ka të bashkëlidhur dokumentacionin që shoqëron kërkesën për shpronësim, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pika 4, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"Aktmarrëveshja është e pavlefshme në rast se në çastin e nënshkrimit të saj nuk i bashkëlidhen dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim sipas këtij ligji."

4. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon ARRSH realizimin e njoftimit të tij, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

5. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon ARRSH-së realizimin e njoftimit të tij, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar.

6. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell ASHK vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5, nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit, si dhe të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH.

Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.

Praktika e shpronësimit është përgatitur nga: **Znj. Egra Ibrahimi** me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e KPSH dhe anëtarët **Z. Albian Marku** me detyrë arkitekt, **Znj. Entela Bytyçi**, me detyrë inxhinier, **Znj. Sidorela Qato**, me detyrë ekonomist, **Znj. Etleva Malile**, me detyrë jurist.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/30 prot; datë 02.03.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH-së, me anë të shkresës nr. 274/2 prot; datë 27.02.2026, si më poshtë vijon:

1.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi protokollimin e procesverbaleve** të KPSH, ASHSH shprehet se: *"Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast".*

1.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se neni 18 i Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

2.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit bashkëlidhur Aktmarrëveshjes**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se: *"KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1144/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qenë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve.*

Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH."

2.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivën tuaj. Aktmarrëveshja ka funksionin të ribashkëngjisë dokumentet e dosjes, si dhe të formatizojë dakordësinë ndërmjet palëve mbasi gjithë dokumentacioni i kërkuar nga legjislacioni për shpronësimin është dorëzuar dhe verifikuar më parë. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

3.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të njoftuar subjektin privat që shpronësohet**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se: "Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin *"Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij"*, është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13,

14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "*korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin*".

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar".

3.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim ligjor i përcaktuar qartë në aktet në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, në mungesë të adresës, të ezaurohet nga subjekti kërkues, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura.

Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

4.1 Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të përcjelle VKM-në e shpronësimit pranë ASHK**, Agjencia Shtetërore për Shpronësim shprehet se: "*KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim.*

Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit.

ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit."

4.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari: Referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve, përfshirë fazën e pas-shpronësimit dhe bashkërendimin me institucionet përgjegjëse.

Së dyti: sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila është kërkesë ligjore, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet përkatëse në

regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.
Së treti: nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja Sqarimi se ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit, nuk përkon me gjetjen pasi në asnjë moment nuk është konkluduar se ASHSH duhet të kryejë aplikimet përkatëse pranë ASHK shërbime të cilat kërkojnë pagesë.
Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

XXV. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt " Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor **"Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)" finalizuar me VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022**.

Nëpërmjet shkresës nr. 5437 Prot., datë 07.05.2022, protokolluar në ASHSH me nr. 482 Prot., datë 12.05.2022, ARRSH ka paraqitur kërkesën për shpronësim.
Me shkresën nr. 482/1 Prot., datë 18.05.2022, bazuar në urdhrin nr. 68, datë 18.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, është krijuar komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit: "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)"
Komisioni i posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Emri dhe Mbiemri	***Roli në Komision***	***Pozicioni***
Erlis Hereni	Drejtor i Përgjithshëm	Kryetar
Albian Marku	Arkitekt	Anëtare
Ilirjana Hasanllari	Juriste	Anëtare
Besnik Hysaj	Inxhinier	Anëtar
Sidorela Qato	Ekonomiste	Anëtar

***Funksioni i Sekretarisë Teknike** për këtë komision ushtrohet nga Aida Nika.*

Me urdhër nr. 101, datë 11.08.2022, komisioni është ndryshua si më poshtë:

Emri dhe Mbiemri	***Roli në Komision***	***Pozicioni***
Egra Ibrahimi	Drejtor i Përgjithshëm	Kryetar
Albian Marku	Arkitekt	Anëtare
Ilirjana Hasanllari	Juriste	Anëtare
Besnik Hysaj	Inxhinier	Anëtar
Sidorela Qato	Ekonomiste	Anëtar

***Funksioni i Sekretarisë Teknike** për këtë komision ushtrohet nga Aida Nika.*

Pas shqyrtimit të dokumentacionit KPSH nëpërmjet procesverbalit nr.1 të mbajtur më datë 24.05.2022, pranon kërkesën "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)", me vlerë paraprake të shpronësimit **131,674,123.70** lekë.
Sa më sipër, Sekretaria Teknike duhet: (Të njoftojë subjektin kërkues, Të hartojë akt-marrëveshjen ndërmjet ASHSH dhe ARSH, Të bëjë publikimin e kërkesës për shpronësim të

pronave që preken nga realizimi i projektit në Qendrën e Botimeve Zyrtare, Të bëjë njoftimin e drejtpërdrejtë të secilit pronar a bashkëpronar të pasurive, pronë private).
Nisur nga sa më sipër, me shkresën nr. 482/2 prot., datë 24.05.2022, është bërë njoftimi për pranimin e kërkesës për shpronësim drejtuar ARRSH.
Në vijim, me shkresën nr. 482/3 prot., datë 24.05.2022, është lidhur Akt-Marrëveshja për disa shtesa në Vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)".
Në vijim, me shkresën nr. 482/4 prot., datë 03.06.2022, ASHSH ka dërguar për publikim pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare kërkesën për shpronësim.
Me shkresën nr. 482/5 Prot., datë 03.06.2022, Agjencia Shtetërore për Shpronësim ka dërguar njoftimin përkatës drejtuar subjekteve private dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar.
Me shkresën nr. 6708 Prot., datë 14.06.2022, e protokolluar në ASHSH me nr. 552/1 Prot., datë 16.06.2022, ARRSH ka dërguar dokumentacionin e rifreskuar të pronësisë për pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Zonën Kadastrale nr. 3976.
Me shkresën nr. 6982 Prot., datë 23.06.2022, e protokolluar në ASHSH me nr. 482/6 Prot., datë 27.06.2022, ARRSH ka dërguar dokumentacionin e rifreskuar të pronësisë për pasuritë e tjera.
Në këtë shkresë, ARRSH sqaron se, bazuar në konfigurimin e ri të pronës për pasurinë nr. 68/32, ka rezultuar një ndryshim i sipërfaqes së përfshirë në procesin e shpronësimit, e cila kalon nga 1 590 m² në 1 072.3 m².
Me shkresën nr. . 7340 Prot., datë 05.07.2022, e protokolluar në ASHSH me nr. 482/7 Prot., datë 08.07.2022, ARRSH ka dërguar dokumentacionin e rifreskuar të pronësisë për pasurinë me nr. 5/321, ZK 8170.
Me shkresën nr. 5437/1 Prot., datë 07.07.2022, e protokolluar në ASHSH me nr. 482/8 Prot., datë 13,07.2022, ARRSH përcjell për përfshirje në procesin e shpronësimit pasurinë me nr. 7/66, ZK 8110. Kjo pasuri nuk është përfshirë në kërkesën fillestare të paraqitur nga ARRSH për shpronësim.
Nëpërmjet procesverbalit nr. 2, të mbajtur më datë 19.07.2022, si dhe shkresës nr. 482/9 Prot., datë 20.07.2022, KPSH i është drejtuar ARRSH me një kërkesë zyrtare për plotësimin e dokumentacionit të domosdoshëm. Ndër të tjera, në këtë komunikim theksohet se pasuria me nr. 7/66, Zona Kadastrale 8110, nuk është përfshirë në kërkesën fillestare të paraqitur për shpronësim.
Me shkresat e protokolluara në ASHSH me nr. 644 Prot., datë 02.08.2022; nr. 482/10 Prot., datë 08.08.2022; dhe nr. 482/11 Prot., datë 08.08.2022, pronarët e pasurive private (bashkëpronarët Kokonozi, Bardhul Cani dhe bashkëpronarët Aga) kanë paraqitur ankesat e tyre, duke renditur pretendimet përkatëse në lidhje me procesin e shpronësimit.
Nisur nga sa më sipër, nëpërmjet procesverbalit nr. 3, të mbajtur më datë 24.08.2022, si dhe shkresave nr. 644/2 Prot., datë 24.08.2022; nr. 482/13 Prot., datë 25.08.2022; dhe nr. 482/14 Prot., datë 25.08.2022, KPSH u është përgjigjur ankesave të paraqitura nga pronarët e pasurive private të sipërcituar. Në këto përgjigje, Komisioni bën me dije se vlerësimi i pasurive është kryer në zbatim të plotë të ligjit nr. 8561, datë 22.11.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme në përdorim për interes publik" i ndryshuar.
ARRSH, me shkresën nr. 7812/1 Prot., datë 23.08.2022, e protokolluar në ASHSH me nr. 482/12 prot., datë 23.08.2022, ka përcjellë dokumentacioni e kërkuar në procesverbalin nr. 2, të mbajtur më datë 19.07.2022, dërguar me shkresën nr. 482/9 Prot., datë 20.07.2022 të KPSH.
Me shkresën nr. 661/3 Prot., datë 08.09.2022, ASHSH i është drejtuar subjektit privat, z. Ismail Skeja, në përgjigje të ankesës së tij. Në këtë komunikim, ASHSH bën me dije se vlerësimi i

pasurive është kryer në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 8561, datë 22.11.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme në përdorim për interes publik", i ndryshuar.
Me anë të procesverbalit nr. 4, datë 22.02.2022, KPSH pranë ASHSH, pas përfundimit të afatit 15-ditor nga publikimi i kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, si dhe pas trajtimit të ankesave, në përfundim vendosi:

- **Miratimin e propozimit për shpronësim për interes publik, për pasuritë pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)" me vlerë totale të shpronësimit 143,632,865.70 lekë**

Me shkresën nr. 482/18 prot., datë 19.09.2022, ASHSH i dërgon MIE propozimin për projektvendimin e shpronësimit, të shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës
Me shkresat nr. 482/21 Prot., datë 29.09.2022, nr. 482/23 Prot., datë 10.10.2022, nr. 482/26 Prot., datë 26.10.2022, nr. 482/27 Prot., datë 04.11.2022 ASHSH i është drejtuar subjekteve private, në përgjigje të ankesave së tyre. Në këtë komunikim, ASHSH bën me dije se vlerësimi i pasurive është kryer në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 8561, datë 22.11.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme në përdorim për interes publik", i ndryshuar, si dhe në disa raste dhe të drejtën e tyre për ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni.
Më datë 29.12.2022, **Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 896, datë 29.12.2022, "Për shpronësim për interes publik, për pasuritë pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)'".**
Me shkresën nr. 48 prot., datë 09.01.2023, ASHSH i përcjell ARRSH, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 896, datë 29.12.2022.
Me shkresën nr. 48/1 prot., datë 09.01.2023, ASHSH njofton ARRSH dhe subjektin privat, z. Besim Ramis Valteri, lidhur me shpërblimin për shpronësimin.
Me shkresën nr. 2495/2 Prot., datë 01.02.2023, Bashkia Tiranë ka njoftuar ASHSH dhe ARRSH për kryerjen e afishimit publik në funksion të njoftimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe rikualifikimi i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)".

Konkluzion:

1. Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, "*Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore*", ku parashikohet se:

"Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse."

2. Vendimmarrja për pranimin e kërkesës sipas procesverbalit nr.1 të mbajtur më datë 24.05.2022 e KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 2 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, ku parashikohet se në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë, ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij sipas këtij neni, duke caktuar edhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.
Nga auditimi i procedurës së shpronësimit është konstatuar se KPSH ka pranuar kërkesën për shpronësim dhe ka vijuar me veprime të mëtejshme procedurale, ndonëse në mungesë të

dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë. Statusi juridik i rifreskuar i dokumenteve të pronësisë është i domosdoshëm për të garantuar saktësinë, përditësimin dhe vlefshmërinë ligjore të të dhënave, duke shmangur gabimet dhe kontestimet në procesin e shpronësimit. Kjo situatë ka ndodhur në një kohë kur kërkesa për shpronësim duhej t'i ishte kthyer subjektit për plotësimin e dokumentacionit përkatës.

3. Aktmarrëveshja e lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH nuk ka të bashkëlidhur dokumentacionin që shoqëron kërkesën për shpronësim, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pika 4, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

"Aktmarrëveshja është e pavlefshme në rast se në çastin e nënshkrimit të saj nuk i bashkëlidhen dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim sipas këtij ligji."

4. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon ARRSH realizimin e njoftimit të tij, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM-së nr.127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

5. ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon ARRSH realizimin e njoftimit të tij, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, pika 1, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar.

6. Nga auditimi i dosjes së shpronësimit u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell ASHK vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, në kundërshtim me nenin 11, pika 5, nënpika c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, e cila si pasojë sjell moszbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit, si dhe të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe ARRSH.

Sipas akt-marrëveshjes së sipërcituar, në nenin 3 "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6, parashikohet se Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe legjislacionin në fuqi.

Praktika e shpronësimit u përgatit nga: **Znj. Egra Ibrahimi** me detyrë ish Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH, në cilësinë e Kryetarit të KPSH dhe anëtarët e KPSH **Z. Albian Marku** me detyrë arkitekt, në cilësinë e anëtarit të KPSH; **Z. Besnik Hysa**, me detyrë inxhinier, **Znj. Sidorela Qato**, me detyrë ekonomist, **Znj. Ilirjana Hasanllari**, me detyrë jurist.

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/30 prot; datë 02.03.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH-së, me anë të shkresës nr. 274/2 prot; datë 27.02.2026, si më poshtë vijon:

1.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi protokollimin e procesverbaleve** të KPSH, ASHSH shprehet se: "*Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtuara nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin"*

me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast"

1.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se neni 18 i Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

2.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin e vendimmarrjes për pranim kur kërkesa për shpronësim nuk paraqitet e plotësuar, ASHSH shprehet se: *"Sqarojmë se, dokumentacioni përkatës është plotësuar nëpërmjet shkresës nr. 6708 prot., datë14.06.2022, protokolluar në ASHSH me nr.552/1 prot., date 16.06.2022, ku nga ana e subjektit kërkues ARRSH janë përcjellë të gjitha kartelat dhe HTR e pasurive objekt shpronësimi, në bazë të të cilave janë vijuar ndjekja e procedurave për miratimin e kërkesës për shpronësim, për interes publik."*

2.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se pranimi i kërkesës për shpronësim pa dokumentacion të rifreskuar të pronësisë nuk garanton sigurinë juridike për statusin e këtyre pasurive. Në këtë kuadër, neni 13 i ligjit përcakton se, pas kryerjes së të gjitha verifikimeve të nevojshme dhe respektimit të procedurave të parashikuara në nenin 12, vetëm nëse kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues janë plotësisht të mbështetur në kushtet dhe kriteret e ligjit, ASHSH vendos për pranimin e kërkesës, duke njoftuar menjëherë me shkrim subjektin kërkues në favor të të cilit kërkohet të bëhet shpronësimi.

Për rrjedhojë, çdo vendimmarrje për pranimin e kërkesës duhet të bazohet në dokumentacion të plotë, të saktë dhe të përditësuar, në mënyrë që të garantohet siguria juridike dhe respektimi i procedurave ligjore në fuqi.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

3.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me **konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit bashkëlidhur Aktmarrëveshjes**, ASHSH shprehet se: *"KPSH i qëndron të njëjtit mendim të pasqyruar sikurse Ju është bërë me dije me shkresën Nr. 1144/1 Prot., datë 7.11.2025. Theksojmë se dokumentacioni që shoqëron kërkesën për shpronësim në çdo rast bëhet pjesë integrale e dosjes së shpronësimit dhe duke qënë se ky dokumentacion depozitohet pranë ASHSH nga ana e subjektit kërkues të dyja palët nënshkruese të marrëveshjes së shpronësimit e disponojnë kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pasi vetë subjekti kërkues e harton dhe e depoziton kërkesën së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë ASHSH ndërsa kjo e fundit e shqyrton dhe verifikon ligjshmërinë e tij në përmbushje të detyrimeve ligjore. Rrjedhimisht kërkesa së bashku me dokumentacionin shoqërues është pjesë e pandarë e aktmarrëveshjes së lidhur mes palëve.*

Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se, në vijim të ndjekjes dhe realizimit të procedurave të shpronësimit, kjo gjetje e KLSH do të reflektohet në praktikat që do të mbahen në vijim pranë ASHSH.".

3.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se dokumentacioni i përmendur prej jush nuk shoqëron akt-marrëveshjen, por është pjesë e dosjes së plotë të shpronësimit, e cila administrohet në arkivën tuaj. Aktmarrëveshja ka funksionin të ribashkëngjisë dokumentet e dosjes, si dhe të formalizojë dakordësinë ndërmjet palëve mbasi gjithë dokumentacioni i kërkuar nga legjislacioni për shpronësimin është dorëzuar dhe verifikuar më parë. Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

4.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të njoftuar subjektin privat që shpronësohet**, ASHSH shprehet se: *"Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.*

Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar".

4.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim ligjor i përcaktuar qartë në aktet në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, në mungesë të adresës, të ezaurohet nga subjekti kërkues, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura.

Konfirmimi me observacion që do të reflektohet në praktikat në vijim përkon me sa trajtuar në projektraport.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

5.1. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin **që lidhet me detyrimin e ASHSH për të përcjellë VKM-në shpronësimit pranë ASHK**, ASHSH shprehet se: *"KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim.*

Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit.

ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023.

Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 218, datë 13.4.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit"

5.2. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari: Referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve, përfshirë fazën e pas-shpronësimit dhe bashkërendimin me institucionet përgjegjëse.

Së dyti: sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila është kërkesë ligjore, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti, nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja Sqarimi se ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit, nuk përkon me gjetjen pasi në asnjë moment nuk është konkluduar se ASHSH duhet të kryejë aplikimet përkatëse pranë ASHK shërbime të cilat kërkojnë pagesë.

Përsa i përket pretendimit tuaj dhe faktit se në këtë fazë nuk keni paraqitur fakte të reja, sa më sipër, **argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

XXVI. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore Tirana Agrikulturë (status i finalizuar)" finalizuar me VKM nr. 504 datë 30.08.2023.

Projekti dhe argumentimi ligjor nga ana e Bashkisë Tiranë

Me shkresën nr. 47260/1 prot., datës 25.11.2021 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, z. Erlis Hereni me kërkesën për shpronësim me objekt "Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore (Tiranë Agrikulturë)".

Shpronësimi kërkohet për shkak të realizimit të investimit të Bashkisë Tiranë në interes dhe në shërbim të qytetarëve të Tiranës, në përputhje me përcaktimin e Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 8, shkronja ç, e cila parashikon se: *"Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës"* .

Ky projekt është miratuar me vendimin nr. 14/3 datë 22.06.2021 të Këshillit Teknik, të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike të Bashkisë Tiranë.

Llogaritjet paraprake dhe çmimi i përcaktuar janë bazuar në VKM-në nr. 89 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, për llojin e pasurisë "Arë, vresht, pemëtore" e cila ***për zonën kadastrale 1604 është 448 lekë/m2***.

Ngritja e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit

Me shkresën nr. 611/1 prot. të datës 26.11.2021, është lëshuar Urdhri nr. 182 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH z.Erlis Hereni, për krijimin e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

Komision i përbërë nga: (Kryetar – z. Erlis Hereni me detyrë Drejtor i Përgjithshëm; Anëtar – znj.Denada Dosti me detyrë juriste; Anëtar – z. Ermal Bala me detyrë inxhinier; Anëtare – znj. Entela Bytyçi me detyrë inxhiniere; Anëtare – znj. Areda Koçi me detyrë ekonomiste).

Hapat e marra nga Bashkia Tiranë

Me kthim-përgjigjen nr. 611/2 prot. të datës 13.12.2021 Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin i ASHSH pas shqyrtimit, i drejtohet Bashkisë Tiranë me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Me shkresën nr. 51654 prot. të datës 28.12.2021 (protokolluar në ASHSH me nr.611/3 datë 30.12.2021) z.Alban Dokushi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Pasurive të Paluajtshme pranë Bashkisë Tiranë ka vënë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm të ASHSH se i është drejtuar z.Ardian Tufa, Administrator i Njësisë Administrative Farkë, duke kërkuar dokumentacionin shoqërues të kërkesës.

Me shkresën nr. 51653 prot. të datës 28.12.2021 (protokolluar në ASHSH me nr.611/4 datë 30.12.2021) z.Alban Dokushi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Pasurive të Paluajtshme pranë Bashkisë Tiranë ka vënë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm të ASHSH se i është drejtuar z.Dritan Domi, Administrator i ASHK, Tirana Rurale 1, duke kërkuar dokumentacionin shoqërues të kërkesës për shpronësim.

Kërkesa e Komisionit të Posaçëm për Shpronësim

Me shkresën nr. 218 prot. të datës 03.02.2022 vë në dijeni Bashkinë Tiranë se ka vonesa të tej zgjatura në plotësimin e dokumentacionit të munguar referuar shkresës nr.611/2 prot. të datës 13.12.2021. i kërkohet Bashkisë të procedojë me plotësimin e dokumentacionit **brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor, nga mbërritja e kësaj shkrese.**

Me shkresën nr. 8459 prot. të datës 28.02.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.218/1 datë 28.02.2022) z.Alban Dokushi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Pasurive të Paluajtshme pranë Bashkisë Tiranë ka vënë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm të ASHSH se i është drejtuar z.Vangjush Stavro, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke kërkuar dokumentacionin shoqërues të kërkesës për shpronësim si më poshtë:

-Lista e pronarëve

-Pasuritë private të cilat shpronësohen për këtë projekt

-Adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve

Me shkresën nr. 8792 prot. të datës 02.03.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.218/2 datë 02.03.2022) z.Alban Dokushi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Pasurive të Paluajtshme pranë Bashkisë Tiranë ka vënë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm të ASHSH z.Erlis Hereni duke e vënë në dijeni për ndryshimet përkatëse dhe plotësimin e dokumentacionit mungues referuar shkresës nr.611/2 prot. të datës 13.12.2021.

Me shkresën nr. 5768/1 prot. të datës 02.03.2022 i janë drejtuar Drejtorit të përgjithshëm të ASHK, z.Artan Lame, ku kërkohet një konfirmim zyrtar për saktësimin e pozicionit gjeografik të pasurive nr. 404/2 dhe nr. 404/38, pasi rezultoi se është krijuar një mbivendosje.

Me shkresën nr. 218/5 prot. të datës 18.03.2022 ASHSH vë në dijeni Bashkinë Tiranë se ka vonesa të tej zgjatura në plotësimin e dokumentacionit të munguar referuar shkresës nr.218/2 prot. të datës 02.03.2022. I kërkohet Bashkisë të procedojë me plotësimin e dokumentacionit **brenda një afati 50 (pesëdhjetë) ditor, nga mbërritja e kësaj shkrese.**

Me shkresën nr. 8792/2 prot. të datës 01.04.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.218/6 datë 04.04.2022) z.Dritan Domi, Administrator i ASHK, Tirana Rurale 1, duke kërkuar dokumentacionin shoqërues të kërkesës për shpronësim si më poshtë:

-Harta treguese për secilën pasuri, ku të evidentohet qartë dhe dukshëm kufiri i pronës për pasuritë 404/52, 678/1, 678/2, 863 në ZK 1604.

Me shkresën nr. 8792/4 prot. të datës 12.04.2022 (protokolluar në ASHSH me nr.218/7 datë 12.04.2022) z.Alban Dokushi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Pasurive të Paluajtshme pranë Bashkisë Tiranë ka vënë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm të ASHSH

z.Erlis Hereni duke e vënë në dijeni për ndryshimet përkatëse dhe plotësimin e dokumentacionit mungues referuar shkresës nr. 218/5 prot. të datës 18.03.2022.
Me shkresën nr. 218/8 prot. të datës 21.04.2022 ASHSH i drejtohet Drejtorisë Qendrore të ASHK me kërkesë për përmirësim-përditësimin në zonën kadastrale 1604, të blloqeve kadastrale nr.404 dhe nr.678.
Plotësimi i dokumentacionit ka ardhur me shkresën nr. 15792 prot. datë 20.04.2023 (protokolluar në ASHSH me nr.426 datë 20.04.2023).

Ndryshim i Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit

Me shkresën nr. 426/1 prot. të datës 24.04.2023, është lëshuar Urdhri nr. 65 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH znj.Egra Ibrahimi, për ndryshimin e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.
Komision i përbërë nga: (Kryetar – znj. Egra Ibrahimi; Anëtar – znj. Denada Dosti; Anëtar – z. Albian Marku; Anëtare – znj. Entela Bytyçi; Anëtare – znj.Sidorela Qato).

Pranimi i kërkesës për shpronësim

Me shkresën nr. 462/2 prot. të datës 02.05.2023, Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH njofton Bashkinë Tiranë për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik, për projektin "Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë e pakicë i produkteve ushqimore Tirana-Agrikulturë, **me vlerë totale të shpronësimit 3,434,215.68 lekë.**
Ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Tiranë është lidhur më datë 02.05.2023 akt-marrëveshja ndërinstitucionale për realizimin e projektit, me përfaqësues znj.Egra Ibrahimi, Drejtoreshë e Përgjithshme e ASHSH dhe z. Erjon Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë (akti i firmosur nga Keti Luarasi).
Me shkresën nr. 426/4 prot. të datës 04.05.2023 ASHSH i drejtohet Qendrës së Botimeve Zyrtare (QBZ) për publikimin e kërkesës për shpronësimin publik.
Me shkresën nr. 426/5 prot. të datës 04.05.2023 ASHSH njofton pronarët e pronave private që preken nga projekti për shpronësim publik.

* Dashamir Besim Leci, Naile Sefer Leci, Xhevrije Murat Leci me pronë private nr. 404/89 e llojit "arë" në ZK nr. 1604 (114.87 m2 x 448 lekë/m2 [9]) vlera e shpronësimit : **51,461.76 lekë**
* Banka "Credins" sh.a me pronë private nr.404/33 e llojit "arë" në ZK nr. 1604 (827m2 x 448lekë/m2) vlera e shpronësimit: **370,496 lekë**
* Banka "Credins" sh.a me pronë private nr.404/44 e llojit "arë" në ZK nr. 1604 (1285.49m2 x 448lekë/m2) vlera e shpronësimit: **575,899.52 lekë**
* Banka "Credins" sh.a me pronë private nr.404/49 e llojit "arë" në ZK nr. 1604 (152.8m2 x 448lekë/m2) vlera e shpronësimit: **68,454 lekë**
* Flora Mehmet Zenelaj, Petrit Mehmet Leci me pronë private nr. 404/41 e llojit "arë" në ZK nr. 1604 (1400 m2 x 448 lekë/m2) vlera e shpronësimit : **627,200 lekë**
* Ramazan Seit Leci me pronë private nr. 404/2 e llojit "arë" në ZK nr. 1604 (3885.5 m2 x 448 lekë/m2) vlera e shpronësimit : **1,740,704 lekë**

Nga ASHSH shpallet kërkesa për Shpronësim Publik botuar në Fletoren Zyrtare me nr. 74 datë 08.05.2023.
Nga Bashkia Tiranë është kryer afishimi në stendat e lajmërimeve për njoftimin e publikut, referuar shkresës nr. 17467/2 prot. datë 24.05.2023 (protokolluar në ASHSH me shkresën nr.426/6 prot. datë 25.05.2023). Më datë 30.05.2023 nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësim është mbajtur proces-verbali për miratimin e projektit dhe vijueshmërinë e procedurave të mëtejshme për shpronësim në bashkëpunim me Drejtorinë e Negocimit dhe Asistencës Ligjore.

---

[9] çmimi i përcaktuar është bazuar në VKM-në nr. 89 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, për llojin e pasurisë "Arë, vresht, pemëtore"

Me shkresën nr. 426/7 prot. i datës 09.06.2023 ASHSH i dërgon MIE propozimin e projekt-vendimit për shpronësim.
Më datë 30.08.2023 nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet shkresa nr.3834/1 prot. (protokolluar në ASHSH me nr. 426/11 datë 01.09.2023) e cila përmban Vendimin nr. 504 të Këshillit të Ministrave *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë e pakicë i produkteve ushqimore Tirana-Agrikulturë""*.
Me shkresën nr. 426/12 prot. datë 01.09.2023 ASHSH i dërgon VKM nr. 504 datë 30.08.2023 subjektit kërkues për shpronësim, Bashkisë Tiranë.
Me shkresën nr. 426/13 prot. datë 01.09.2023 ASHSH i specifikon Bashkisë Tiranë, për pagesën e anëtarëve të KPSH.
Me shkresën nr. 426/14 prot. datë 01.09.2023 ASHSH vë në dijeni subjektet e prekura për shpronësim për VKM nr. 504 datë 30.08.2023.

Konkluzion:

Nga auditimi i dosjes së këtij projekti u konstatuan problematikat si më poshtë vijon:

Së pari, është konstatuar se nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, neni 11, pika 5, germa d e cila parashikon se *"ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban"*.
Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen.
Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* e cila parashikon se *"Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, **duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, sqaron se, nëpërmjet observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1141/1 Prot., datë 07.11.2025, kemi paraqitur qëndrimin tonë në lidhje me procedurat e negocimit në përputhje me nenin 11, pikën 5, gërma d), të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në të cilin parashikohet se: "d) ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban". Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit

të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative. Konkretisht sikurse kemi sqaruar, në interpretim të kësaj dispozite, ASHSH ka të drejtë, por jo domosdoshmërish detyrim të negocioj në çdo rast me subjektet që shpronësohen, përsa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së saj. Për sa i përket qëndrimit Tuaj ku citoni se, "Nga momenti i themelimit të ASHSH, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj Agjencie dhe Ministrisë së linjës", Ju informojmë se, nga ana e ASHSH në mungesë të një akti nënligjor lidhur me rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara, janë ndërmarrë veprime lidhur me nevojën për ndryshime ligjore, konkretisht nëpërmjet Memos Nr. 874/2/Prot., datë 13.11.2023, "Mbi problemet e hasura në praktikë nga legjislacioni në fuqi në fushën e shpronësimit për interes publik", ASHSH ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për mundësinë e ndryshimit të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe ndryshimin/përditësimin e akteve nënligjore përkatëse, duke evidentuar edhe nevojën për hartimin e një akti normativ mbi ndjekjen e procedurave përkatëse të negocimit. Procesi i diskutimit dhe përpunimit të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore vazhdon në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të finalizuar përmirësimet dhe përditësimet e nevojshme.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëndrimin e grupit të auditimit, shpreh gatishmërinë që në vijim të marrë masa për hartimin e një draft- VKM për ndjekjen e procedurave të negocimit, duke e përcjellë pranë institucionit epror propozimin për hartimin e aktit përkatës mbi procedurat e negocimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga ana e ASHSH **është pranuar kjo gjetje dhe do procedohet me zbatimin e saj.**

Së dyti, konstatohet se në shkresat nr. 218 prot. të datës 03.02.2022 dhe nr. 218/5 prot. të datës 18.03.2022 ASHSH ka përcaktuar si afat kohor, për të njoftuar për mungesa dokumentacioni subjektin Bashkia Tiranë afatet 30 ditore dhe më pas 50 ditore.

Veprim ky i bazuar, në Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* neni 12, pika 2 ku citohet se *"Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij, **duke caktuar dhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse**.*

Megjithatë, një veprim i tillë vjen në kundërshtim me nenin 12 pika 3 të këtij ligji ku parashikohet se *"Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar **në afatin e caktuar** ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga ministria dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të Shpronësimit"*.

Po ashtu, konstatohet se ka një hapësirë kohore prej 1(një) viti ndërmjet shkresave nr. 218/8 prot. të datës 21.04.2022 ku ASHSH i drejtohet Drejtorisë Qendrore të ASHK dhe marrjes së përgjigjes me shkresën nr. 15792 prot. datë 20.04.2023.

Ky afat kaq i gjate prej 365 ditësh pritjeje është në kundërshtim të plotë me bazën ligjore të sipërpërmendur[10].

[10] Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* neni 12, pika 2

Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës të një akti normativ i cili duhet të përcaktojë një afat konkret të pranueshëm për kohën që i duhet subjektit kërkues që të paraqesë dokumentet e sakta ose të munguara.
Në gjykimin e grupit të auditimit, një akt i tillë do kishte karakter shtrëngues ndaj subjektit që kërkon shpronësimin si dhe do respektonte ligjin nr. 44/2015 "Kodit të Procedurave administrative", neni 18, pika 2 për parimin e deburokratizimit dhe efiçencës ku parashikohet se: "*Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.*"
Realizimi i procesit të shpronësimit në rastin konkret sjell shpronësimin e pronarëve jo në kohë reale (ku në disa raste prishen objekte pa u zbardhur shpronësimi).

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit.
Sqarojmë për KLSH se korrespondencat vijuese midis ASHSH dhe subjektit kërkues në çdo rast janë mbështetur në pikën 2 të nenit 12 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar. 104 Arsyetimi KLSH se, nuk jemi në kushtet e pikës 2 të nenit 12, por në kushtet e pikës 3 të këtij neni, komisioni e kundërshton për arsye se vetë pika 2 e nenit 12 nuk ka të përcaktuar detyrim mbi numrin apo sasinë e korrespondencave që duhet të mbajmë me subjektin kërkues apo të jetë specifikuar që domosdoshmërish vetëm një korrespondencë shkresore të mbahet me subjektin kërkues. Gjithashtu sqarojmë se, pika 3 e nenit 12 përcakton rastet e refuzimit kur mungon shkaku apo kushti i shpronësimit ose kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar. Ndërkohë në rasti konkret, kërkesa për shpronësim i plotëson kushtet dhe shkakun ligjor për realizimin e shpronësimit për interes publik, si dhe subjekti kërkues ka mbajtur korrespondenca vijues brenda afateve të përcaktuara nga ASHSH, si dhe ASHSH ka qenë në komunikim shkresore të vazhdueshme me subjektin kërkues dhe ASHK.
Qëndrimi i grupit të auditimit.
Nga dokumentacioni që përmban dosja e projektit të mësipërm, përveç shkresave nr. 218/8 prot. të datës 21.04.2022 ku ASHSH i drejtohet Drejtorisë Qendrore të ASHK dhe marrjes së përgjigjes me shkresën nr. 15792 prot. datë 20.04.2023, nuk ka asnjë komunikim të mëtejshëm ndërinstitucional për zgjidhjen e problematikës, ku realizimi i projektit të kryhet me efiçencë dhe efektivitet.
Bazuar në vetë ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 12, pika 2, ku përcaktohet afati i posaçëm për dorëzimin e dokumentacionit grupi i auditimit shprehet sërish se pavarësisht vonesës në këtë rast nga Bashkia Tiranë dhe vonesa e pajustifikuar nga ASHK, vetë ASHSH duhej të kishte vepruar bazuar në ligjin e mësipërm duke u bazuar te neni 12, pika 3 pra të kishte refuzuar e kthyer pas kërkesën për shpronësim.
Për këtë arsye ***pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.***

Së treti, është konstatuar se në relacionin bashkangjitur shkresës nr. 426/7 prot. të datës 09.06.2023 nga ASHSH drejtuar MIE, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve. Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues Bashkia Tiranë dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen

detyrimet e Bashkisë Tiranë përmendet dhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore "*Bashkia Tiranë duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore*", por në asnjë shkresë si në kërkesën fillestare të bërë nga Bashkia për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje dhe as në relacionin e mësipërm nuk përmendet një afat i qartë.

Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 10, pika 1, germa dh, në të cilën parashikohet se: "*Subjekti në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë pranë ASHSH kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, **si dhe afatet përkatëse**.*"

Si dhe në kundërshtim me nenin 20, pika 1, germa a, e cila parashikohet se: "*Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*

*Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, **afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve** ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilën citohen dhe dokumentet që kërkohen nga shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 10 të këtij ligji.*"

Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sikurse ju kemi parashtruar në observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1141/1 prot., datë 10.11.2025, ju kemi sqaruar se: "në dosjen e shpronësimit, rezulton se, bashkëlidhur kërkesës për shpronësim është shkresa nr. 39721/1 prot., datë 12.10.2021, e Bashkisë Tiranë, në të cilën citohet se: "Pranë drejtorisë së Investimeve të Punëve Publike, ka ardhur për zbatim projekti me objekt: "Ndërtim i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë), miratuar me VKT. Nr. 14/3, datë 22.06.2021 dhe do të zbatohet nga bashkimi i operatorëve "Kacdedja" shpk & "Everest" shpk, bazuar në kontratën e sipërmarrjes me nr. 30109/5, datë 28.09.2021, me afat të përfundimit të punimeve 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës." Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative.

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në relacionin shoqërues të projektvendimit do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.
Qëndrimi i grupit të auditimit.
Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH e pasqyron afatin e përfundimit të punimeve, megjithatë theksojmë se akti përfundimtar nga ju si institucion ku përcaktohet afati është Akt-marrëveshja e lidhur mes jush dhe subjekti kërkues, në këtë rast Bashkia Tiranë. Ky akt është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për të dyja palët.
Në çdo rast duhej të shkruhej afati i parashikuar
Duke qenë se. ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj.**

Së katërti, konstatohet se në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH lidhur me, likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar.
Vetë Agjencia Shtetërore për Shpronësimin nuk ka dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, në të cilat ato nuk janë përcaktuar si përgjegjëse për likuidimin.
Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 23, në të cilën parashikohet se "*Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar brenda afatit në shkronjën "c" të nenit 21 të këtij ligji dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës*".
Neni 1 i Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm", i ndryshuar, përcakton se objekti i këtij ligji është jo vetëm rregullimi i së drejtës së shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, por edhe mbrojtja e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës.
Pika 3 e nenit 26 përcakton se, shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji nuk është kryer pagesa ose vënia në dispozicion të masës së shpërblimit, sipas këtij ligji, për llogari të pronarëve të shpronësuar, si dhe të pronarëve e personave të tretë të dëmtuar për shkak të shpronësimit.
Ky veprim po ashtu vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç e cila parashikon se: "*ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi*"
Bazuar në këtë nen dhe pasi në dosje nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me shpërblimin e dhënë, grupi i auditimit e ka të pamundur të dalë me një konstatim përfundimtar nëse shpërblimi është dhënë në masën dhe në afatet e duhura ligjore.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit.
Sqarojmë për KLSH se, referuar listëpagesës për shpronësimet bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 7, datë 7.5.2007 "Për përdorimin e fondit të shpronësimeve", të ndryshuar, ku specifikohet se,

për ndjekjen e procedurave të likuidimit ngarkohen personat e autorizuar për likuidim. Në rastin konkret grupi i punës së likuidimit ngrihet me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe procedurat përkatëse të likuidimit ndiqen nga ky grup i caktuar nga titullari i institucionit i cili është i njëjti grup me të njëjtët anëtarë gjatë gjithë vitit dhe ndjek dhe realizon procedurat përkatëse referuar vitit përkatës. Gjithashtu sqarojmë për KLSH se nuk është përcaktuar asnjë bazë ligjore që hapat e ndjekur për likuidimin të jenë pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit. Sikurse kemi sqaruar observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1141/1 Prot., datë 07.11.2025, vlera e shpronësimit për realizimin e këtij projekti do të mbulohet nga vet subjekti kërkues, për rrjedhojë në pikën 4, 5, 7 dhe 8 të vendimit nr. 504, datë 30.8.2023 për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore (Tirana agrikulturë)"

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 434 215.68 (tre milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë. 108 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

Sa më sipër, procedurat e likuidimit për këtë kërkese për shpronësim nuk ndiqen dhe realizohen nga ASHSH por nga subjekti kërkues

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, megjithatë duhet theksuar se ju si institucion jeni agjenci e cila duke u marrë me shpronësimin e pronarëve, duhet gjithashtu edhe të mbajë të dhëna dhe të pasqyrojë me transparencë të plotë gjithë procedurën e shpërblimit që jepet. Po ju rikujtojmë, Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç e cila parashikon se: " ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"

Për këtë arsye, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim si në projekt raport, për këtë arsye **pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit**.

Së pesti, konstatohet se në dosjen e projektit procesverbalet e mbledhjeve të KPSH, në të gjitha rastet, janë pa numër protokolli.

Ky veprim është në mospërputhje me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18 i cili parashikon se: "*Procesverbale te mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshëm. **Ato protokollohen**.*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në vijim të argumentimit tuaj sqarojmë se, neni 18 i Urdhrit nr.72, datë 13.02.2013 detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit.

Duke qenë se. ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj.**

Së gjashti, konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, Bashkisë Tiranë realizimin e njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim.

Veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, germa e, e cila parashikon se: *"Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë*

pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, ***si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës.*** *"*

Si dhe, në kundërshtim me VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: *"Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim,* ***e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet standarde****, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.".*

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.

Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e

titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i 110 Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.
Qëndrimi i grupit të auditimit.
Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura.
Duke qenë se, ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj.**

Së shtati, u konstatua se nga ASHSH nuk ka të dokumentuar asnjë shkresë përcjellë ASHK, vendimin e KM, për shpronësimin, në kundërshtim me Nenin 3, pika 6 e aktmarrëveshjes së lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Tiranë, si dhe pengon në zbatimin e nenit 25 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30-ditëve nga data e marrje së vendimit. Bazuar në akt-marrëveshjen e cituar më sipër, në nenin 3 përcaktohen "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6... e cila specifikon se : "*Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet që të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Legjislacionin në fuqi*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga anëtarët e KPSH, z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1141/1 prot.,datë 10.11.2025, protokolluar në KLSH me nr.277/21, datë 11.11.2025, në lidhje me akt konstatimin nr. 8, datë 30.10.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit.
Sikurse ju kemi parashtruar në observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1141/1 prot., datë 10.11.2025, KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 111 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me

daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 504, datë 30.8.2023. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 504, datë 30.8.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit. Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari: referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.

Së dyti: sipas akt-marrëveshjes me subjektin kërkues, nga e cila krijohen të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti: nga verifikimi në fazën e terrenit rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave. Ky mosveprim përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga akt-marrëveshja. Për sa më sipër pretendimi juaj **nuk merret në konsideratë dhe do trajtohet si i tillë në materialin e auditimit.**

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1. Z. Erlis Hereni, me detyrë, ish-Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e KPSH.
2. Znj. Egra Ibrahimi me detyrë, ish-Drejtoreshë e Përgjithshme, në cilësinë e kryetarit të KPSH.
3. Znj. Denada Dosti me detyrë, juriste, në cilësinë e anëtares së KPSH.
4. Znj. Entela Bytyçi, me detyrë inxhiniere, në cilësinë e anëtarit të KPSH.
5. Z. Albian Marku, me detyrë arkitekt, në cilësinë e anëtarit të KPSH.
6. Znj. Sidorela Qato, me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KPSH.

XXVII. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Projekt Ndërtim i Objektit 6 kate+1 kat parkim nën tokë në truallin në pronësi të Entit të Banesave (status i refuzuar)".

Projekti dhe argumentimi ligjor nga ana e Bashkisë Lushnjë

Me shkresën nr. 5521/1 prot., datë 04.07.2024 Kryetarja e Bashkisë Lushnjë, znj. Eriselda Sefa i është drejtuar ASHSH, me kërkesën për shpronësim me objekt "Ndërtim i Objektit 6 kate+1 kat parkim nën tokë në truallin në pronësi të Entit të Banesave".

Shpronësimi do të realizohet për pasurinë e pronës private, verifikuar nga ASHK DV-Lushnjë (pasuria nr.13/102, ZK 8572, lloji i pasurisë "truall" me sipërfaqe 3263 m2, në pronësi të znj. Valbona Rushan Bekaj.

Shpronësohen 207 m^2 truall.

Ky shpronësim kërkohet në përputhje me përcaktimin e Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 8, shkronja ç, e cila parashikon se: *"Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës"*.

Bashkangjitur shkresës, Bashkia Lushnjë ka dërguar edhe dokumentacionin ligjor që kërkohet për të proceduar me shpronësimin.
Ky projekt është miratuar me vendimin nr. 45 datë 25.04.2024 të Këshillit Bashkiak Lushnjë ku është përllogaritur se **vlera e shpronësimit është 1,853,478 lekë** dhe do përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnje.
Ngritja e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit
Me shkresën nr. 932/1 prot. të datës 10.07.2024, është lëshuar Urdhri nr. 143 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH z.Kastriot Gurra, për krijimin e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.
Komision i përbërë nga: (Kryetar – z. Kastriot Gurra me detyrë Drejtor i Përgjithshëm; Anëtar – znj. Orlanda Murati me detyrë juriste; Anëtar – znj. Blerina Gjonaj me detyrë juriste; Anëtare – znj. Entela Bytyçi me detyrë inxhiniere; Anëtare – znj. Mirela Omeri me detyrë ekonomiste).
Refuzimi i kërkesës për shpronësim
Me shkresën nr. 932/2 prot., datë 12.09.2024 është mbajtur nga KPSH procesverbali mbi refuzimin e kërkesës për realizimin e projektit "Ndërtim i Objektit 6 kate+1 kat parkim nën tokë në truallin në pronësi të Entit të Banesave".
Refuzimi ka ardhur për arsye të mungesës së dokumentacionit si dhe paqartësisë së kërkesës për realizim projekti, si më poshtë:
-nga ana e subjektit kërkues duhet të riformulohet kërkesa për shpronësim pasi rezulton e paqartë se kërkohet shpronësim për pasurinë pronë private, ndërkohë që është parashikuar se objekti do bëhet në truallin në pronësi të Entit Kombëtar të Banesave.
-në argumentimin juridik Bashkia Lushnjë duhej të kryente një interpretim më të gjerë të interesit publik në funksion të realizimit të këtij projekti, si dhe nevoja për kryerjen e shpronësimit të pasurisë pronë private të prekur nga realizimi i këtij projekti.
-të sqarohet nga ana e subjektit kërkues nëse ka të nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Lushnjë dhe EKB me qëllim për zbatimin e programit për ndërtimin e banesave sociale, si dhe të përcaktohet nëse është parashikuar ndërtimi i objektit në favor të EKB mbi truallin në pronësi të pronarit privat që kërkohet të shpronësohet.
-në listën paraprake të shpronësimit duhet të reflektohen të gjitha pasuritë që preken nga projekti i shpronësimit (pronë private/pronë shtetërore)
-kartela e pronësisë ka shënimin *"Kartelë provizore, jo përfundimtare"*. Nga ana e Bashkisë Lushnjë të vendoset në dispozicion kartela e pasurisë e 3-muajve të fundit lëshuar nga ASHK DV-Lushnjë e cila të ketë shënimin që të konfirmojë se kjo kartelë është e vlefshme për efekt shpronësimi.
-HTR e pasurisë nr. 13/102 është e paqartë e nuk dallohen kufijtë e pronës.
-në planimetrinë e shpronësimit të hidhet vija e shpronësimit në përputhje me vijën e projektit.
-mungojnë lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit, në përputhje me natyrën dhe llojin e projektit që kërkohet të realizohet (Leje infrastrukture/Leje Zhvillimore)
Me shkresën nr. 932/3 prot. të datës 12.09.2024 Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH i drejtohet Bashkisë Lushnjë duke argumentuar arsyet dhe konfirmuar refuzimin e kërkesës për shpronësim.
Nga auditimi i dosjes së këtij projekti nuk u konstatua ndonjë problematikë. Komisioni i Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurës së shpronësimit ka kryer në mënyrë korrekte verifikimet e nevojshme.

XXVIII. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së plazhit të Durrësit, nga ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës", finalizuar me VKM nr. 508 datë 01.08.2024.

Projekti dhe argumentimi ligjor nga ana e Bashkisë Durrës

Me shkresën nr. 3236 prot., datë 29.03.2023 Kryetarja e Bashkisë Durrës, znj. Emirjana Sako i është drejtuar ASHSH, me kërkesën për shpronësim me objekt "Ndërtimin e shëtitores së plazhit të Durrësit, nga ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës".

Shpronësimi kërkohet për shkak të realizimit të investimit të Bashkisë Durrës në interes dhe në shërbim të qytetarëve të Durrësit, në përputhje me përcaktimin e ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 8, shkronja ç, e cila parashikon se: *"Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës"* .

Ky projekt është miratuar me vendimin nr. 58 datë 28.02.2023 të Këshillit Bashkiak Durrës.

Sipas këtij vendimi, **vlera financiare e shpronësimit është 26,570,000 lekë**, për 9 pasuri, pronë private e llojit tokë, Truall.

Financimi realizohet me fondet e buxhetit të shtetit, ku njësi zbatuese është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Dëmshpërblimi paguhet nga buxheti i Bashkisë Durrës për vitin 2023.

Ngritja e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit

Me shkresën nr. 388/1 prot., datë 30.03.2023, është lëshuar Urdhri nr. 58 nga ana e Drejtorit të Përgjithshme të ASHSH, znj. Egra Ibrahimi, për krijimin e KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

Komision i përbërë nga: (Kryetar – znj.Egra Ibrahimi me detyrë Drejtoreshë e Përgjithshme; Anëtar – znj.Sidorela Qato me detyrë ekonomiste; Anëtar – znj.Blerina Gjonaj me detyrë juriste Anëtare – znj.Entela Bytyçi me detyrë inxhiniere; Anëtar – z.Kristi Qorri me detyrë inxhinier).

Me shkresën nr. 388/6 prot., datë 12.09.2023, është lëshuar Urdhri nr. 118 nga Drejtori i Përgjithshme i ASHSH, znj. Egra Ibrahimi ku zëvendësohet anëtari z. Kristi Qorri me z. Albian Marku.

Hapat e marra nga Bashkia Durrës

Me kthim-përgjigjen nr. 388/2 prot., datë 14.04.2023 KPSH i ASHSH pas shqyrtimit, i drejtohet Bashkisë Durrës me kërkesë për plotësim dokumentacioni duke iu përcaktuar një afat prej 40 ditësh nga marrja në dijeni.

Me shkresë nr. 388/3 prot. të datës 15.05.2023 Bashkia Durrës i ridrejtohet ASHSH me dokumentacionin plotësues.

Me shkresë nr. 388/4 prot., datës 08.06.2023 ASHSH i ridrejtohet Bashkisë Durrës me një afat të ri prej 40 ditësh, për arsye se u konstatuan mangësi të mëtejshme të dokumentacionit të kërkuar.

Në shkresën nr. 388/5 prot., datë 12.09.2023 Bashkia Durrës i kthen përgjigje ASHSH me ndryshimet e kërkuara dhe dokumentacionet shtesa të vënë në dispozicion (bazuar mbi kërkesën nr. 388/4 prot., datë 08.06.2023.)

Vihet re që në këtë shkresë është bërë një rillogaritje e vlerës së shpronësimit, për arsye se bazuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" çmimi për metër katror të pasurisë e llojit "truall" për ZK 8518, është **19,336** lekë.

Kjo përllogaritje, ka sjellë dhe ndryshimin e vlerës së përgjithshme të shpronësimit e cila bëhet 25,687,876 lekë.

Në shkresën nr. 388/7 prot., datë 29.09.2023 drejtuar Bashkisë Durrës nga ana e ASHSH, Drejtoria e Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit, si dhe procesverbalit nr. 3 të mbajtur nga ana e tyre i jepet një afat shtesë prej 40 ditësh Bashkisë Durrës për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar si dhe paraqitja e VKB për ndryshimin e vlerës së shpronësimit.

Me shkresat nr. 388/8 prot., datë 09.11.2023, 388/9 prot., datë 10.11.2023 dhe 388/10 e datës 20.11.2023 Bashkia Durrës njofton ASHSH për ndryshimet e bëra, paraqet dokumentacionet shtesë të kërkuara si dhe rillogarit vlerën përfundimtare të shpronësimit nga ***26,570,000 lekë në 26,298,893 lekë,*** bazuar kjo në VKM nr. 89, datë 03.02.2016 si dhe ndryshimin e vlerës së shpronësimit për pasurinë me nr. 10/32, ZK 8518, ndryshim i cili vjen nga shtimi i sipërfaqes që prek projekti, që është 108.6 m^2.

Nga ana e ASHSH me shkresën nr. 388/11 prot., datë 24.11.2023 u rikërkohet Bashkisë dokumentacion shtesë, dhe u rijepet një afat shtesë 40 ditor për paraqiten e tyre nga momenti i marrjes në dijeni.

Bashkia Durrës ka paraqitur dokumentacionin pranë ASHSH me shkresën nr. 388/12 prot., datë 18.12.2023.

Në shkresën nr. 388/13 prot., datë 21.12.2023 ASHSH pasi konstatoi mangësi në dorëzimin e dokumentacionit i jep një afat 40 ditor Bashkisë Durrës nga marrja në dijeni.

Mbështetur mbi shkresën e mësipërme, Bashkia Durrës me dokumentin nr. 349/1 prot., datë 24.01.2024, protokolluar pranë ASHSH me nr. 223 prot., datë 26.01.2024 ka paraqitur dokumentacionet shtesë të kërkuara.

Pranimi i kërkesës për shpronësim

ASHSH ka njoftuar Bashkinë Durrës për pranimin me kusht të kërkesës për shpronësim me interes publik, bazuar mbi shkresën nr. 223/1 prot., datë 31.01.2024. Në shkresën nr. 223/2 prot. e po kësaj date i rikërkohet Bashkisë Durrës të konfirmojë ndryshimet e fundit dhe të paraqesë dokumentacionin plotësues për problematikat si më poshtë:

-Saktësimi i kartelës së pasurisë me nr. 3/82 ZK 8518, ku të vendoset emri i pronarit.

-Konfirmimi zyrtar nga ASHK Durrës mbi emrin e pronarit të pasurisë me nr. 27/112.

-Saktësimi i kartelës së pasurisë me nr. 27/106 ZK 8518, ku të vendoset emri i bashkëpronares Vera Nuredini në kartelën e pasurisë.

Këto dokumente plotësuese duhet të paraqiten brenda afatit ligjor të publikimit të kërkesës për shpronësim, në të kundërt përjashtohen nga e drejta për tu shpronësuar.

Ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Durrës është lidhur më datë 31.01.2024 (*me nr. 223/3 prot., datë 31.01.2024 për ASHSH dhe nr. 349/5 prot., datë 01.02.2024 për Bashkinë Durrës*) akt-marrëveshja ndërinstitucionale për realizimin e projektit, me përfaqësues z. Kastriot Gurra, Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH dhe znj. Emiriana Sako, Kryetare e Bashkisë Durrës.

Me shkresën 223/5 prot., datës 09.02.2024 Bashkia Durrës i paraqet ASHSH ndryshimet e kërkuara në shkresën nr. 223/2 prot.

Me shkresën nr. 223/6 prot., datë 09.02.2024 ASHSH i drejtohet Qendrës së Botimeve Zyrtare (QBZ) për publikimin e kërkesës për shpronësimin publik.

Me shkresën nr. 223/7 prot. të datës 09.02.2024 ASHSH njofton pronarët e pronave private që preken nga projekti për shpronësim publik.

* Ermal Rifat Kapllani me pronë private nr. 27/357 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (130 m^2 x 19336 lekë/m2 [11]) vlera e shpronësimit : **2,513,680 lekë.**

* Rexhep Mehmet Mehmeti, Emanuela Fatmir Mehmeti me pronë private nr. 27/317 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (108.3 m^2 x 19,336 lekë/m^2) vlera e shpronësimit: **2,094,088.8 lekë.**

* Mereme Kila me pronë private nr.4 /50 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (34.6 m^2 x 19336 lekë/m^2) vlera e shpronësimit: **669,025.6 lekë.**

* Dilaver Mizini me pronë private nr. 4/49 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (12.2 m^2 x 19,336 lekë/m^2) vlera e shpronësimit: **235,899.2 lekë.**

* Gëzim Zija Hoxha, Dashurie Zija Hoxha, Zenel Hasan Korbi, Reshit Hasan Korbi, Rahim Hasan Korbi, Behixhe Hasan Fortuzi, Shpresa Hasan Rexhimi, Dhurata Hasan Zela, pronë

---

[11] çmimi i përcaktuar është bazuar në VKM-në nr. 89 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, për llojin e pasurisë "Arë, vresht, pemëtore"

private nr. 8/110 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (138.2 m^2 x 19,336 lekë/m^2) vlera e shpronësimit : **2,672,235.2 lekë.**

* Zaralanda Skrat Kopali pronë private nr. 10/32 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (108.6 m^2 x 19,336 lekë/m^2) vlera e shpronësimit : **2,099,889.6 lekë.**

* Landi Sotir Rexha, Pulie Sotir Ciku, Mitrush Sotir Rexha, Andrea Sotir Rexha, Dafina Sotir Rexha, Kristaq Sotir Rexha, Lefka Sotir Cekani, Loreta Gole Puleshi, Mantola Gole Puleshi me pronë private nr. 10/33 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (352.8 m^2 x 19,336 lekë/m^2) vlera e shpronësimit : **6,821,740.8 lekë.**

* Naim Sadri Kapiti pronë private nr. 27/112 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (195 m^2 x 19,336 lekë/m^2) vlera e shpronësimit : **3,770,520 lekë.**

* Abdullah Dervishi, Nurije Seferi, Feride Kraja, Muharrem Dervishi, Dylbere Nuredini, Sovjet Keçi, Afërdita Keçi, Agron Keçi, Diamada Dervishi, Dhurata Kamedani, Fatbardh Dervishi, Servete Gjyzeli, Shqipe Sula, Mimoza Islamaj, Fiqiri Dervishi me pronë private nr. 27/106 e llojit "truall" në ZK nr. 8518 (280.4 m^2 x 19,336 lekë/m^2) vlera e shpronësimit : **5,421,814.4 lekë.**

Me shkresën nr. 223/9 prot., datë 09.04.2024 ASHSH i dërgon MIE propozimin e projekt-vendimit për shpronësim.

Shkresa nr. 223/10 prot., datë 29.05.2024 nga ana e MIE për ASHSH ka kthyer pas projektvendimin e dërguar drejt Këshillit të Ministrave me arsye, mospërputhje me tabelën e shpronësimeve.

Me kërkesën nr. 223/11 prot., datë 07.06.2024 ASHSH i drejtohet Bashkisë Durrës për sqarimet përkatëse.

Bazuar në shkresën nr. 223/12 prot., datë 21.06.2024 Bashkia Durrës kthen përgjigje konfirmuese me sqarimet e kërkuara si dhe saktësimin e tabelës së shpronësimeve.

Më datë 06.08.2024 nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet shkresa nr. 4062/1 prot. (protokolluar në ASHSH me nr. 223/14 datë 06.08.2024) e cila përmban Vendimin nr. 508 të Këshillit të Ministrave *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Shëtitores së plazhit të Durrësit, nga ura e Dajlanit deri në godinën e Konvalishencës""*.

Me shkresën nr. 223/15 prot., datë 09.08.2024 ASHSH i dërgon VKM nr. 508 datë 01.08.2024 subjektit kërkues për shpronësim, Bashkisë Durrës.

Me shkresën nr. 223/16 prot., datë 09.08.2024 ASHSH vë në dijeni subjektet e prekura për shpronësim për VKM nr. 508, datë 01.08.2024.

Me shkresën nr. 223/17 prot., datë 09.08.2024 ASHSH i specifikon Bashkisë Durrës, për pagesën e anëtarëve të KPSH.

Konkluzion:

Nga auditimi i dosjes së këtij projekti u konstatuan problematikat si më poshtë vijon:

Së pari, është konstatuar se nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, neni 11, pika 5, germa d e cila parashikon se *"ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban"*.

Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen.

Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* e cila parashikon se *"Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj,* ***duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, sqaron se, nëpërmjet observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1141/1 Prot., datë 07.11.2025, kemi paraqitur qëndrimin tonë në lidhje me procedurat e negocimit në përputhje me nenin 11, pikën 5, gërma d), të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në të cilin parashikohet se: "d) ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban". Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative. Konkretisht sikurse kemi sqaruar, në interpretim të kësaj dispozite, ASHSH ka të drejtë, por jo domosdoshmërish detyrim të negocioj në çdo rast me subjektet që shpronësohen, përsa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së saj. Për sa i përket qëndrimit Tuaj ku citoni se, "Nga momenti i themelimit të ASHSH, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj Agjencie dhe Ministrisë së linjës", Ju informojmë se, nga ana e ASHSH në mungesë të një akti nënligjor lidhur me rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara, janë ndërmarrë veprime lidhur me nevojën për ndryshime ligjore, konkretisht nëpërmjet Memos Nr. 874/2/Prot., datë 13.11.2023, "Mbi problemet e hasura në praktikë nga legjislacioni në fuqi në fushën e shpronësimit për interes publik", ASHSH ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për mundësinë e ndryshimit të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe ndryshimin/përditësimin e akteve nënligjore përkatëse, duke evidentuar edhe nevojën për hartimin e një akti normativ mbi ndjekjen e procedurave përkatëse të negocimit. Procesi i diskutimit dhe përpunimit të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore vazhdon në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të finalizuar përmirësimet dhe përditësimet e nevojshme.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëndrimin e grupit të auditimit, shpreh gatishmërinë që në vijim të marrë masa për hartimin e një drafi- VKM për ndjekjen e procedurave të negocimit, duke e përcjellë pranë institucionit epror propozimin për hartimin e aktit përkatës mbi procedurat e negocimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga ana e ASHSH **është pranuar kjo gjetje dhe do procedohet me zbatimin e saj.**

Së dyti, konstatohet se në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH lidhur me, likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar.
Vetë ASHSH nuk ka dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, në të cilat ato nuk janë përcaktuar si përgjegjëse për likuidimin.
Ky veprim vjen në kundërshtim me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 23, në të cilën parashikohet se "*Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar brenda afatit në shkronjën "c" të nenit 21 të këtij ligji dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës*".
Neni 1 i ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm", i ndryshuar, përcakton se objekti i këtij ligji është jo vetëm rregullimi i së drejtës së shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, por edhe mbrojtja e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës.
Pika 3 e nenit 26 përcakton se, shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji nuk është kryer pagesa ose vënia në dispozicion të masës së shpërblimit, sipas këtij ligji, për llogari të pronarëve të shpronësuar, si dhe të pronarëve e personave të tretë të dëmtuar për shkak të shpronësimit.
Ky veprim po ashtu vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç e cila parashikon se: "*ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi*"
Bazuar në këtë nen dhe pasi në dosje nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me shpërblimin e dhënë, grupi i auditimit e ka të pamundur të dalë me një konstatim përfundimtar nëse shpërblimi është dhënë në masën dhe në afatet e duhura ligjore.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit.
Sqarojmë për KLSH se, referuar listëpagesës për shpronësimet bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 7, datë 7.5.2007 "Për përdorimin e fondit të shpronësimeve", të ndryshuar, ku specifikohet se, për ndjekjen e procedurave të likuidimit ngarkohen personat e autorizuar për likuidim. Në rastin konkret grupi i punës së likuidimit ngrihet me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe procedurat përkatëse të likuidimit ndiqen nga ky grup i caktuar nga titullari i institucionit i cili është i njëjti grup me të njëjtët anëtarë gjatë gjithë vitit dhe ndjek dhe realizon procedurat përkatëse referuar vitit përkatës. Gjithashtu sqarojmë për KLSH se nuk është përcaktuar asnjë bazë ligjore që hapat e ndjekur për likuidimin të jenë pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit.
Sikurse kemi sqaruar observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1141/1 Prot., datë 07.11.2025, vlera e shpronësimit për realizimin e këtij projekti do të mbulohet nga vet subjekti kërkues, për rrjedhojë në pikën 4, 5, 7 dhe 8 të vendimit nr. 504, datë 30.8.2023 për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që

preken nga realizimi i projektit "ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore (tirana agrikulturë)"
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 434 215.68 (tre milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë. 108 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.
8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
Sa më sipër, procedurat e likuidimit për këtë kërkese për shpronësim nuk ndiqen dhe realizohen nga ASHSH por nga subjekti kërkues
.**Qëndrimi i grupit të auditimit.**
Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, megjithatë duhet theksuar se ju si institucion jeni agjenci e cila duke u marrë me shpronësimin e pronarëve, duhet gjithashtu edhe të mbajë të dhëna dhe të pasqyrojë me transparencë të plotë gjithë procedurën e shpërblimit që jepet. Po ju rikujtojmë, Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç e cila parashikon se: " ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"
Për këtë arsye, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim si në projekt raport, **pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit**

Së treti, konstatohet se në shkresat nr. 388/2 prot., datë 14.04.2023, nr. 388/4 prot., datë 08.06.2023 dhe 388/7 të datës 29.09.2023, ASHSH ka përcaktuar si afat kohor, për të njoftuar për mungesa dokumentacioni subjektin Bashkia Durrës në të treja rastet afate 40 ditore.
Veprim ky i bazuar, në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* neni 12, pika 2 ku citohet se *"Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij, **duke caktuar dhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse**.*
Megjithatë, një veprim i tillë vjen në kundërshtim me nenin 12 pika 3 të këtij ligji ku parashikohet se *"Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar **në afatin e caktuar** ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga ministria dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të Shpronësimit"*.
Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës të një akti normativ i cili duhet të përcaktojë një afat konkret të pranueshëm për kohën që i duhet subjektit kërkues që të paraqesë dokumentet e sakta ose të munguara.
Në gjykimin e grupit të auditimit, një akt i tillë do kishte karakter shtrëngues ndaj subjektit që kërkon shpronësimin si dhe do respektonte ligjin nr. 44/2015 "Kodit të Procedurave administrative", neni 18, pika 2 për parimin e deburokratizimit dhe efiçencës ku parashikohet se: *"Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm."*.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sqarojmë për KLSH se korrespondencat vijuese midis ASHSH dhe subjektit kërkues në cdo rast janë mbështetur në pikën 2 të nenit 12 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar. 104 Arsyetimi KLSH se, nuk jemi në kushtet e pikës 2 të nenit 12, por në kushtet e pikës 3 të këtij neni, komisioni e kundërshton për arsye se vetë pika 2 e nenit 12 nuk ka të përcaktuar detyrim mbi numrin apo sasinë e korrespondencave që duhet të mbajmë me subjektin kërkues apo të jetë specifikuar që domosdoshmërish vetëm një korrespondencë shkresore të mbahet me subjektin kërkues. Gjithashtu sqarojmë se, pika 3 e nenit 12 përcakton rastet e refuzimit kur mungon shkaku apo kushti i shpronësimit ose kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar. Ndërkohë në rasti konkret, kërkesa për shpronësim i plotëson kushtet dhe shkakun ligjor për realizimin e shpronësimit për interes publik, si dhe subjekti kërkues ka mbajtur korrespondenca vijues brenda afateve të përcaktuara nga ASHSH, si dhe ASHSH ka qenë në komunikim shkresore të vazhdueshme me subjektin kërkues dhe ASHK.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Bazuar në vetë ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 12, pika 2, ku përcaktohet afati i posaçëm për dorëzimin e dokumentacionit grupi i auditimit shprehet sërish se pavarësisht vonesës në këtë rast nga Bashkia Durrës dhe vonesa e pajustifikuar nga ASHK, vetë ASHSH duhej të kishte vepruar bazuar në ligjin e mësipërm duke u bazuar te neni 12, pika 3 pra të kishte refuzuar e kthyer pas kërkesën për shpronësim.

Për këtë arsye pretendimi juaj **nuk do të merret në konsideratë.**

Së katërti, konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, Bashkisë Durrës realizimin e njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim.

Veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, germa e, e cila parashikon se: "*Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë*

*pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, **si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës.**"*

Si dhe, në kundërshtim me VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit I bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: "*Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, **e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet standarde**, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2

prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marrë përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.

Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i 110 Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditimi të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura.

Duke qenë se, ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj**.

Së pesti, është konstatuar se në kërkesën fillestare për realizimin e projektit nga ana e Bashkisë Durrës drejtuar ASHSH, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve. Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues Bashkia Durrës dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Durrës përmendet dhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore "*Bashkia Durrës duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore*", por në asnjë shkresë si në kërkesën fillestare të bërë nga Bashkia për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje nuk përmendet një afat i qartë.

Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 10, pika 1, germa dh, në të cilën parashikohet se: "*Subjekti në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë pranë ASHSH kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, **si dhe afatet përkatëse**.*"

Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për rxjerrje apo miratim të akteve normative.

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në relacionin shoqërues të projektvendimit do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH e pasqyron afatin e përfundimit të punimeve, megjithatë theksojmë se akti përfundimtar nga ju si institucion ku përcaktohet afati është Akt-marrëveshja e lidhur mes jush dhe subjekti kërkues, në këtë rast Bashkia Tiranë. Ky akt është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për të dyja palët.

Në çdo rast duhej të shkruhej afati i parashikuar

Duke qenë se. ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj.**

Së gjashti, bazuar mbi shkresën nr. 223/1 prot., datë 31.01.2024 ku ASHSH i drejtohet Bashkisë Durrës konstatohet një fenomen i ri, ai i pranimit me kusht të kërkesës.

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" në asnjë rast nuk parashikohet pranimi me kusht i një kërkese. Në lidhje me vendimmarrjen e ASHSH ligji shprehet qartë në nenin 12 "Kthimi pa veprim dhe refuzimi i kërkesës" dhe nenin 13 "Pranimi i kërkesës" ku specifikohen qartazi arsyet dhe kushtet për secilin rast.

Pra, kemi dy përfundime nga ana e kësaj Agjencie për kërkesat, ose pranohet dhe procedohet me hapat e mëtejshëm të parashikuara nga ligji, ose refuzohet dhe ndërpritet si procedurë.

Ky veprim, i pranimit me kusht nuk gjen vend dhe vjen në kundërshtim me nenin 12 dhe 13 të ligjit të mësipërm dhe konsiderohet si tejkalim i kompetencave ligjore nga ana e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj.

Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot., datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr. 277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë

Pretendimi i subjektit.

Në lidhje me vendimmarrjen e KPSH referuar pranimit me kusht, ASHSH sqaron se, duke qenë një institucion relativisht i ri dhe në fazë konsolidimi të procedurave të saj administrative, ajo është në dispozicion për të marrë në konsideratë gjetjen e këtij konstatimi.

Sa më sipër, lidhur me pikën e vendimmarrjes së konstatuar, si dhe pas verifikimit të dosjes së shpronësimit, Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin ka konstatuar se, me shkresën Nr. 922/7 Prot., datë 19.7.2024, ASHSH ka njoftuar subjektin kërkues të shpronësimit ARRSH, mbi pranimin me kusht të kërkesës për shpronësim për interes publik, si dhe me shkresën Nr. 922/6 Prot., datë 19.7.2024, ARRSH i është komunikuar kushti që të risillet dokumentacioni kadastral i rifreskuar për pasuritë e cituara në këtë shkresë deri në fazën e publikimit të kërkesës për shpronësim, me qëllim për të garantuar mbrojtjen e interesave dhe të drejtave pasurore, për të gjithë pronarët privatë pasuritë e të cilëve preken si pasojë e shpronësimit. Konkretisht, kushti i sipërcituar është realizuar i përmbushur brenda afatit ligjor 15 ditor të publikimit të kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare duke u konsideruar kështu i ezauruar.

Në vijim, Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin, në lidhje me pikën e vendimmarrjes të sipërcituar, shprehet se, është në disponibilitetin e plotë mbi gjetjen e këtij konstatimi, ku në vijim do të marrë të gjitha masat e nevojshme për përcaktimin e afatit kohor, për sa i përket dokumentacionit plotësues që duhet të përmbushet për një kërkesë për shpronësim, i cili duhet të konsiderohet i ezauruar përpara realizimit të pranimit të kërkesës për shpronësim me interes publik.

Sa më sipër, ASHSH sqaron se, jemi duke marrë masat e nevojshme për zbatimin me përpikëri të çdo rekomandimi të lënë nga KLSH.

- *Bashkëngjitur shkresa me Nr.223/2 prot., datë 31.01.2024*
- *Shkresa Nr.223/1 Prot., datë 31.1.2024*

Qëndrimi i grupit të auditimit.

ASHSH e ka pranuar këtë konstatim dhe do marrë masat e nevojshme për mos përsëritjen e këtij veprimi dhe zbatimin me korrektësi të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik".

Duke qenë se. ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj**

Së shtati, u konstatua se nga ASHSH nuk ka të dokumentuar asnjë shkresë përcjellë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vendimin e Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, në kundërshtim me Nenin 3, pika 6 e aktmarrëveshjes së lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Durrës, si dhe pengon në zbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrje së vendimit. Bazuar në akt-marrëveshjen e cituar më sipër, ne nenin 3 përcaktohen "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6... e cila specifikon se : "*Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet që të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Legjislacionin në fuqi*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj.

Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sikurse ju kemi parashtruar në observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1141/1 prot., datë 10.11.2025, KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 111 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 504, datë 30.8.2023. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 504, datë 30.8.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit. Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari: referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.

Së dyti: sipas akt-marrëveshjes me subjektin kërkues, nga e cila krijohen të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti: nga verifikimi në fazën e terrenit rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave. Ky mosveprim përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga akt-marrëveshja.

Për sa më sipër pretendimi juaj **nuk merret në konsideratë dhe do trajtohet si i tillë në materialin e auditimit**.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Znj. Egra Ibrahimi me detyrë, ish-Drejtoreshë e Përgjithshme, në cilësinë e kryetarit të KPSH.
2) Znj. Entela Bytyçi, me detyrë inxhiniere, në cilësinë e anëtarit të KPSH.
3) Z. Albian Marku, me detyrë arkitekt, në cilësinë e anëtarit të KPSH.
4) Znj. Sidorela Qato, me detyrë ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KPSH.
5) Znj. Blerina Gjonaj, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të KPSH.

Z. Kristi Qorri, me detyrë inxhinier, në cilësinë e anëtarit të komisionit i hiqet përgjegjësia për arsye se në periudhën e kryerjes së projektit nuk ka qene pjesë e komisionit.

XXIX. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Projekt zgjerimi i Varrezave Publike, qyteti Përmet" finalizuar me VKM nr. 687, datë 06.11.2024.

Me shkresën nr.1129 prot., datë 25.04.2024 Kryetarja e Bashkisë Përmet, znj. Alma Hoxha i është drejtuar ASHSH, me kërkesën për shpronësim për interes publik, me objekt "Zgjerimi i Varrezave Publike Qyteti i Përmetit".

Shpronësimi kërkohet për shkak të realizimit të investimit të Bashkisë Përmet në interes dhe në shërbim të qytetarëve të Përmetit, në përputhje me përcaktimin e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 8, shkronja ç, e cila parashikon se: "*Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës*" .

Bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 10, shkronja c , e cila parashikon se: "*Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ASHSH kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet dhe me dokumentacionin lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë dhe ato të shpronësimit apo të vlerësimit*".

Llogaritjet paraprake dhe çmimi i përcaktuar janë bazuar në VKM-në nr. 89 datë 03.02.2016 "*Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*", për llojin e pasurisë "Arë, vresht, pemëtore" e cila ***për zonën kadastrale 1589 është 112 lekë/m² nga ku totali është përllogaritur të jetë 940,800 lekë*** .

Ngritja e KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit

Me shkresën nr. 730/1 prot., datë 30.04.2024, është lëshuar Urdhri nr. 103 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH z. Erlis Hereni, për krijimin e KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

Komision i përbërë nga: (Kryetar – z. Kastriot Gurra me detyrë Drejtor i Përgjithshëm; Anëtar – z. Albian Marku me detyrë inxhinier; Anëtare – znj. Blerina Gjonaj me detyrë juriste; Anëtar – z. Nurion Sula me detyrë jurist; Anëtar – z. Spartak Kodra me detyrë ekonomist).

Hapat e marra nga Bashkia Përmet

Me kthim-përgjigjen nr.730/2 prot., datë 22.05.2024 Bashkia Përmet, ka paraqitur plotësim dokumentacioni drejtuar KPSH pranë ASHSH.

Pranimi i kërkesës për shpronësim

Me shkresën nr. 730/3 prot., datë 05.06.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH njofton Bashkinë Përmet për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik, për projektin "Zgjerimi i Varrezave Publike Qyteti i Përmetit", **me vlerë totale të shpronësimit 940,800 lekë.**

Ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Përmet është lidhur më datë 05.06.2024 akt-marrëveshja ndërinstitucionale për realizimin e projektit nr. 730/4 Prot., datë 05.06.2024, me përfaqësues z. Kastriot Gurra, Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH dhe znj. Alma Hoxha, Kryetare e Bashkisë Përmet.

Me shkresën nr. 730/6 prot., datë 13.06.2024 ASHSH i drejtohet Qendrës së Botimeve Zyrtare (QBZ) për publikimin e kërkesës për shpronësimin publik.

Me shkresën nr. 730/7 prot., datë 13.06.2024 ASHSH njofton pronarët e pronave private që preken nga projekti për shpronësim publik.

* Dritë Ismail Ibrahimi, Ilirjan Sotir Ibrahimi, Andrea Syrja Ranga, Anila Kristul Dhimitri, Maria Sotir Nikolla, Merjeme Syrja Marku, Robert Syrja Ibrahimi, Valentina Syrja Jace me

pronë private nr. 26/10 e llojit "arë" në ZK nr. 1589 (2854 m^2 x 112 lekë/m^2 [12]) vlera e shpronësimit : **319,648 lekë.**

* Mitore Ibrahim Memishaj, Zubide Ibrahim Bejtja, Gëzim Halil Mancellari, Ermira Halil Muka, Shpëtim Halil Mancellari me pronë private nr.26/12 e llojit "arë" në ZK nr. 1589 (2056 m^2 x 112 lekë/m2) vlera e shpronësimit: **230,272 lekë.**

Me shkresat nr. 730/8 prot., datë 28.06.2024, 730/9 prot., datë 02.07.2024, 730/10 prot. e datës 01,07,2024 si dhe 730/11 prot., datë 08.07.2024 pronarët e pronave të shpronësuara Gëzim Mehdi Ibrahimi dhe Kapllan Mehdi Ibrahimi kanë paraqitur ankimim pranë ASHSH me pretendimin se çmimi 112 lekë/m^2 nuk është i drejtë pasi konsiderohet më i ulët se i 8 viteve më parë dhe të rishikohet ose të kryhet shkëmbim me prona të cilat Bashkia Përmet mund të disponojë.

Më shkresën 730/12 prot., datë 08.07.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH i dërgon Bashkisë Përmet për trajtim ankesat e mësipërme duke bashkangjitur edhe procesverbalin e mbajtur nga KPSH.

Bashkia Përmet i kthen përgjigje ASHSH dhe pronarëve të mësipërm me shkresat 730/13,14,15,16 duke u dhënë dhe sqarimet e kërkuara palëve.

Me shkresën nr. 730/18 prot., datë 02.05.2023, Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH njofton Bashkinë Përmet për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik, për projektin "Zgjerimi i varrezave publike të qytetit Përmet, **me vlerë totale të shpronësimit 940,800 lekë.**

Me shkresën nr. 730/19 prot., datë 09.08.2024 ASHSH i dërgon MIE propozimin e projekt-vendimit për shpronësim.

Më datë 07.11.2024 nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet shkresa nr. 6034/1 prot., (protokolluar në ASHSH me nr. 730/20 prot., datë 08.11.2024) e cila përmban VKM nr. 687 *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike, qyteti Përmet"".*

Me shkresën nr. 730/21 prot., datë 08.11.2024 ASHSH i dërgon VKM nr. 687, datë 06.11.2024 subjektit kërkues për shpronësim, Bashkisë Përmet.

Me shkresën nr. 730/22 prot., datë 08.11.2024 ASHSH vë në dijeni subjektet e prekura për shpronësim për VKM nr. 687, datë 06.11.2024.

Me shkresën nr. 266 prot., datë 05.02.2025 ASHSH i specifikon Bashkisë Përmet, për pagesën e anëtarëve të KPSH.

Konkluzion:

Nga auditimi i dosjes së këtij projekti u konstatuan problematikat si më poshtë vijon:

Së pari, është konstatuar se nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, neni 11, pika 5, germa d e cila parashikon se *"ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban".*

Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen.

Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në*

[12] çmimi i përcaktuar është bazuar në VKM-në nr. 89 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, për llojin e pasurisë "Arë, vresht, pemëtore"

përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" e cila parashikon se *"Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj,* ***duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, sqaron se, nëpërmjet observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1141/1 Prot., datë 07.11.2025, kemi paraqitur qëndrimin tonë në lidhje me procedurat e negocimit në përputhje me nenin 11, pikën 5, gërma d), të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në të cilin parashikohet se: "d) ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban". Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për rxjerrje apo miratim të akteve normative. Konkretisht sikurse kemi sqaruar, në interpretim të kësaj dispozite, ASHSH ka të drejtë, por jo domosdoshmërish detyrim të negocioj në çdo rast me subjektet që shpronësohen, përsa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së saj. Për sa i përket qëndrimit Tuaj ku citoni se, "Nga momenti i themelimit të ASHSH, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj Agjencie dhe Ministrisë së linjës", Ju informojmë se, nga ana e ASHSH në mungesë të një akti nënligjor lidhur me rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara, janë ndërmarrë veprime lidhur me nevojën për ndryshime ligjore, konkretisht nëpërmjet Memos Nr. 874/2/Prot., datë 13.11.2023, "Mbi problemet e hasura në praktikë nga legjislacioni në fuqi në fushën e shpronësimit për interes publik", ASHSH ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për mundësinë e ndryshimit të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe ndryshimin/përditësimin e akteve nënligjore përkatëse, duke evidentuar edhe nevojën për hartimin e një akti normativ mbi ndjekjen e procedurave përkatëse të negocimit. Procesi i diskutimit dhe përpunimit të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore vazhdon në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të finalizuar përmirësimet dhe përditësimet e nevojshme.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëndrimin e grupit të auditimit, shpreh gatishmërinë që në vijim të marrë masa për hartimin e një draft- VKM për ndjekjen e procedurave të negocimit, duke e përcjellë pranë institucionit epror propozimin për hartimin e aktit përkatës mbi procedurat e negocimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga ana e ASHSH **është pranuar kjo gjetje dhe do procedohet me zbatimin e saj.**

Së dyti, konstatohet se në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH lidhur me, likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar.
Vetë ASHSH nuk ka dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, në të cilat ato nuk janë përcaktuar si përgjegjëse për likuidimin.
Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* neni 23, në të cilën parashikohet se *"Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar brenda afatit në shkronjën "c" të nenit 21 të këtij ligji dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës".*
Neni 1, i Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm", i ndryshuar, përcakton se objekti i këtij ligji është jo vetëm rregullimi i së drejtës së shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, por edhe mbrojtja e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës.
Pika 3 e nenit 26 përcakton se, shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji nuk është kryer pagesa ose vënia në dispozicion të masës së shpërblimit, sipas këtij ligji, për llogari të pronarëve të shpronësuar, si dhe të pronarëve e personave të tretë të dëmtuar për shkak të shpronësimit.
Ky veprim po ashtu vjen në kundërshtim me ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç e cila parashikon se: *" ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"*
Bazuar në këtë nen dhe pasi në dosje nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me shpërblimin e dhënë, grupi i auditimit e ka të pamundur të dalë me një konstatim përfundimtar nëse shpërblimi është dhënë në masën dhe në afatet e duhura ligjore.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit.
Sqarojmë për KLSH se, referuar listëpagesës për shpronësimet bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 7, datë 7.5.2007 "Për përdorimin e fondit të shpronësimeve", të ndryshuar, ku specifikohet se, për ndjekjen e procedurave të likuidimit ngarkohen personat e autorizuar për likuidim. Në rastin konkret grupi i punës së likuidimit ngrihet me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe procedurat përkatëse të likuidimit ndiqen nga ky grup i caktuar nga titullari i institucionit i cili është i njëjti grup me të njëjtët anëtarë gjatë gjithë vitit dhe ndjek dhe realizon procedurat përkatëse referuar vitit përkatës. Gjithashtu sqarojmë për KLSH se nuk është përcaktuar asnjë bazë ligjore që hapat e ndjekur për likuidimin të jenë pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit.
Sa më sipër, procedurat e likuidimit për këtë kërkesë për shpronësim nuk ndiqen dhe realizohen nga ASHSH por nga subjekti kërkues.
Qëndrimi i grupit të auditimit.
Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, megjithatë duhet theksuar se ju si institucion jeni agjenci e cila duke u marrë me

shpronësimin e pronarëve, duhet gjithashtu edhe të mbajë të dhëna dhe të pasqyrojë me transparencë të plotë gjithë procedurën e shpërblimit që jepet. Po ju rikujtojmë, Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç e cila parashikon se: " ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"
Për këtë arsye, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim si në projekt raport, për këtë arsye **pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimi**.

Së treti, konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, Bashkisë Përmet realizimin e njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim.
Veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, germa e, e cila parashikon se: "*Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë*
pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, ***si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës.***"
Si dhe, në kundërshtim me VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: "*Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim,* ***e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet standarde****, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit.
Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.
Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të

nënshkruhet nga Drejtori i 110 Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.
Qëndrimi i grupit të auditimit.
Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura.
Duke qenë se, ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj**.

Së katërti, është konstatuar se në kërkesën fillestare për realizimin e projektit nga ana e Bashkisë Përmet drejtuar ASHSH, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve. Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues Bashkia Përmet dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Përmet përmendet dhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore "*Bashkia Përmet duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore*", por në asnjë shkresë si në kërkesën fillestare të bërë nga Bashkia për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje nuk përmendet një afat i qartë.
Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 10, pika 1, germa dh, në të cilën parashikohet se: "*Subjekti në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë pranë ASHSH kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, **si dhe afatet përkatëse**.*"
Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit.

Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për rxjerrje apo miratim të akteve normative.

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në relacionin shoqërues të projektvendimit do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH e pasqyron afatin e përfundimit të punimeve, megjithatë theksojmë se akti përfundimtar nga ju si institucion ku përcaktohet afati është Akt-marrëveshja e lidhur mes jush dhe subjekti kërkues, në këtë rast Bashkia Tiranë. Ky akt është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për të dyja palët.

Në çdo rast duhej të shkruhej afati i parashikuar

Duke qenë se. ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj**.

Së pesti, u konstatua se nga ASHSH nuk ka të dokumentuar asnjë shkresë përcjellë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vendimin e Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, në kundërshtim me Nenin 3, pika 6 e aktmarrëveshjes së lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Përmet, si dhe pengon në zbatimin e nenit 25 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30-ditëve nga data e marrje së vendimit. Bazuar në akt-marrëveshjen e cituar më sipër, ne nenin 3 përcaktohen "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6... e cila specifikon se : *"Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet që të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Legjislacionin në fuqi"*.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sikurse ju kemi parashtruar në observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1141/1 prot., datë 10.11.2025, KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 111 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me

daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 504, datë 30.8.2023. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 504, datë 30.8.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit. Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari: referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.

Së dyti: sipas akt-marrëveshjes me subjektin kërkues, nga e cila krijohen të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti: nga verifikimi në fazën e terrenit rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave. Ky mosveprim përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga akt-marrëveshja.

Për sa më sipër pretendimi juaj **nuk merret në konsideratë dhe do trajtohet si i tillë në materialin e auditimit**.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Z. Kastriot Gurra me detyrë, Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit të KPSH.
2) Z. Albian Marku, me detyrë arkitekt, në cilësinë e anëtarit të KPSH.
3) Znj. Blerina Gjonaj, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të KPSH.
4) Z. Nurion Sula, me detyrë jurist , në cilësinë e anëtarit të KPSH.
5) Z. Spartak Kodra, me detyrë ekonomist, në cilësinë e anëtarit të KPSH.

XXX. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Projekt Ndërtimi i kopshtit nr. 37, Tiranë" finalizuar me VKM nr. 504 datë 30.08.2023.

Me shkresën nr. 10464/1 prot., datës07.03.2024 Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj i është drejtuar ASHSH, me kërkesën për shpronësim me objekt "Ndërtimi i kopshtit nr. 37".
Shpronësimi kërkohet për shkak të realizimit të investimit të Bashkisë Tiranë në interes dhe në shërbim të qytetarëve të Tiranës, në përputhje me përcaktimin e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 8, shkronja ç, e cila parashikon se: *"Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës"* .
Ky projekt është miratuar me vendimin nr. 1/15 datë 12.01.2022 të Këshillit Teknik, të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike të Bashkisë Tiranë.
Bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 10, shkronja c , e cila parashikon se: *"Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ASHSH kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet dhe me dokumentacionin lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë dhe ato të shpronësimit apo të vlerësimit"*, Bashkia Tiranë i është drejtuar

Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar me shkresën nr. 2538 prot., datë 18.01.2024 duke kërkuar garantimin e fondeve për shpronësim lidhur me vlerën e shpronësimit për projektin në fjalë.
Llogaritjet paraprake dhe çmimi i përcaktuar janë bazuar në VKM-në nr. 89, datë 03.02.2016 *"Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, për llojin e pasurisë "Truall" e cila ***për zonën kadastrale 8380 është 66,969 lekë/m²***.

Ngritja e KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit
Me shkresën nr. 444/1 prot., datë 12.03.2024, është lëshuar Urdhri nr. 63 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH z. Kastriot Gurra, për krijimin e KPSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.
Komision i përbërë nga: (Kryetar – z. Kastriot Gurra, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm; Anëtar – z. Albian Marku, me detyrë arkitekt; Anëtar – znj. Selmina Varfi, me detyrë juriste; Anëtare – znj. Fabjona Cenaj, me detyrë inxhiniere; Anëtare – z. Spartak Kodra, me detyrë ekonomist).
Hapat e marra nga Bashkia Tiranë dhe ASHSH
Me shkresën nr. 444/2 prot., datë 20.03.2024, ASHSH i drejtohet Bashkisë Tiranë me kërkesën për plotësim dokumentacioni.
Me kthim përgjigjen nr. 444/3 prot., datë 12.04.2024, Bashkia Tiranë i vë në dispozicion ASHSH dokumentacionin e kërkuar për plotësim.
Pranimi i kërkesës për shpronësim
Me shkresën nr. 444/4 prot., datë 15.04.2024, Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH njofton Bashkinë Tiranë për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik, për projektin "Ndërtimi i Kopshtit Nr.37", **me vlerë totale të shpronësimit 25,247,313 lekë.**
Ndërmjet ASHSH dhe Bashkisë Tiranë është lidhur më datë 16.04.2024 akt-marrëveshja ndërinstitucionale për realizimin e projektit nr. 444/5 prot., datë 16.04.2024, me përfaqësues z. Kastriot Gurra, Drejtor i Përgjithshëm i ASHSH dhe z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.
Publikimi i kërkesës për shpronësim publik është shpallur me shkresën nr. 444/6 prot., datë 22.04.2024 pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
Me shkresën nr. 444/7 prot., datës 22.04.2024 ASHSH njofton pronarin e pronës private që preket nga projekti për shpronësim publik.
* Alfred Robert Gjata me pronë private nr. 3/144 e llojit "truall" në ZK nr. 8380 (377 m^2 x 66,969 lekë/m2 [13]) vlera e shpronësimit : **25,247,313 lekë.**
Me shkresën nr. 444/9 prot., datë 05.06.2024 ASHSH i dërgon MIE propozimin e projekt-vendimit për shpronësim.
Më datë 11.07.2024 nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet shkresa nr.3704/1 prot. (protokolluar në ASHSH me nr. 444/10 datë 12.11.2024) e cila përmban Vendimin nr. 454 të Këshillit të Ministrave *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i kopshtit Nr.37, Bashkia Tiranë"*.
Me shkresën nr. 444/11 prot., datë 12.07.2024 ASHSH i dërgon VKM nr. 454, datë 10.07.2024 subjektit kërkues për shpronësim, Bashkisë Tiranë.
Me shkresën nr. 444/12 prot., datë 12.07.2024 ASHSH vë në dijeni subjektin e prekur për shpronësim për VKM nr. 454, datë 10.07.2024.
Me shkresën nr. 444/13 prot., datë 12.07.2024 ASHSH i specifikon Bashkisë Tiranë, për pagesën e anëtarëve të KPSH.
Konkluzion:
Nga auditimi i dosjes së këtij projekti u konstatuan problematikat si më poshtë vijon:

[13] çmimi i përcaktuar është bazuar në VKM-në nr. 89 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, për llojin e pasurisë "Arë, vresht, pemëtore"

Së pari, është konstatuar se nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", neni 11, pika 5, germa d e cila parashikon se "*ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban*". Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen. Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" e cila parashikon se "*Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj,* ***duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot., datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, sqaron se, nëpërmjet observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1141/1 Prot., datë 07.11.2025, kemi paraqitur qëndrimin tonë në lidhje me procedurat e negocimit në përputhje me nenin 11, pikën 5, gërma d), të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në të cilin parashikohet se: "d) ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban". Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative. Konkretisht sikurse kemi sqaruar, në interpretim të kësaj dispozite, ASHSH ka të drejtë, por jo domosdoshmërish detyrim të negocioj në çdo rast me subjektet që shpronësohen, përsa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së saj. Për sa i përket qëndrimit Tuaj ku citoni se, "Nga momenti i themelimit të ASHSH, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj Agjencie dhe Ministrisë së linjës", Ju informojmë se, nga ana e ASHSH në mungesë të një akti nënligjor lidhur me rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara, janë ndërmarrë veprime lidhur me nevojën për ndryshime ligjore, konkretisht nëpërmjet Memos Nr. 874/2/Prot., datë 13.11.2023, "Mbi problemet e hasura në praktikë nga legjislacioni në fuqi në fushën e shpronësimit për interes publik", ASHSH ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për mundësinë e ndryshimit të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për

shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe ndryshimin/përditësimin e akteve nënligjore përkatëse, duke evidentuar edhe nevojën për hartimin e një akti normativ mbi ndjekjen e procedurave përkatëse të negocimit. Procesi i diskutimit dhe përpunimit të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore vazhdon në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të finalizuar përmirësimet dhe përditësimet e nevojshme.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëndrimin e grupit të auditimit, shpreh gatishmërinë që në vijim të marrë masa për hartimin e një drafi- VKM për ndjekjen e procedurave të negocimit, duke e përcjellë pranë institucionit epror propozimin për hartimin e aktit përkatës mbi procedurat e negocimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga ana e ASHSH **është pranuar kjo gjetje dhe do procedohet me zbatimin e saj**.

Së dyti, konstatohet se në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH lidhur me, likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar.

Vetë Agjencia Shtetërore për Shpronësimin nuk ka dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, në të cilat ato nuk janë përcaktuar si përgjegjëse për likuidimin.

Ky veprim vjen në kundërshtim me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 23, në të cilën parashikohet se "*Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar brenda afatit në shkronjën "c" të nenit 21 të këtij ligji dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës*".

Neni 1 i ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm", i ndryshuar, përcakton se objekti i këtij ligji është jo vetëm rregullimi i së drejtës së shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, por edhe mbrojtja e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës.

Pika 3 e nenit 26 përcakton se, shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji nuk është kryer pagesa ose vënia në dispozicion të masës së shpërblimit, sipas këtij ligji, për llogari të pronarëve të shpronësuar, si dhe të pronarëve e personave të tretë të dëmtuar për shkak të shpronësimit.

Ky veprim po ashtu vjen në kundërshtim me ligjin nr. 11, datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç e cila parashikon se: " *ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi*"

Bazuar në këtë nen dhe pasi në dosje nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me shpërblimin e dhënë, grupi i auditimit e ka të pamundur të dalë me një konstatim përfundimtar nëse shpërblimi është dhënë në masën dhe në afatet e duhura ligjore.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sqarojmë për KLSH se, referuar listëpagesës për shpronësimet bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 7, datë 7.5.2007 "Për përdorimin e fondit të shpronësimeve", të ndryshuar, ku specifikohet se, për ndjekjen e procedurave të likuidimit ngarkohen personat e autorizuar për likuidim. Në rastin konkret grupi i punës së likuidimit ngrihet me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm dhe procedurat përkatëse të likuidimit ndiqen nga ky grup i caktuar nga titullari i institucionit i cili është i njëjti grup me të njëjtët anëtarë gjatë gjithë vitit dhe ndjek dhe realizon procedurat përkatëse referuar vitit përkatës. Gjithashtu sqarojmë për KLSH se nuk është përcaktuar asnjë bazë ligjore që hapat e ndjekur për likuidimin të jenë pjesë e pandarë e dosjes së shpronësimit.

Sa më sipër, procedurat e likuidimit për këtë kërkesë për shpronësim nuk ndiqen dhe realizohen nga ASHSH por nga subjekti kërkues.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, megjithatë duhet theksuar se ju si institucion jeni agjenci e cila duke u marrë me shpronësimin e pronarëve, duhet gjithashtu edhe të mbajë të dhëna dhe të pasqyrojë me transparencë të plotë gjithë procedurën e shpërblimit që jepet. Po ju rikujtojmë, Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç e cila parashikon se: " ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"

Për këtë arsye, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim si në projekt raport, për këtë arsye **pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimi**.

Së treti, konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, Bashkisë Tiranë realizimin e njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim.

Veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, germa e, e cila parashikon se: "*Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë*

pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, ***si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve, dhe personave të tretë përkatës.***"

Si dhe, në kundërshtim me VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: "*Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim,* ***e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr. 1 dhe dokumentet standarde****, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se sikurse Ju kemi bërë me dije dhe më sipër në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marrë përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.

Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i 110 Përgjithshëm, dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit</u>.

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura.

Duke qenë se, ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj**.

Së katërti, është konstatuar se në kërkesën fillestare për realizimin e projektit nga ana e Bashkisë Tiranë drejtuar ASHSH, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve. Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues Bashkia Tiranë dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Tiranë përmendet dhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore "*Bashkia Tiranë duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore*", por në asnjë shkresë si në kërkesën fillestare të bërë nga Bashkia për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje nuk përmendet një afat i qartë.

Ky veprim vjen në kundërshtim me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 10, pika 1, germa dh, në të cilën parashikohet se: "*Subjekti në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë pranë ASHSH kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion: dh) Aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, **si dhe afatet përkatëse.**"*

Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara*

në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për rxjerrje apo miratim të akteve normative.

Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në relacionin shoqërues të projektvendimit do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH e pasqyron afatin e përfundimit të punimeve, megjithatë theksojmë se akti përfundimtar nga ju si institucion ku përcaktohet afati është Akt-marrëveshja e lidhur mes jush dhe subjekti kërkues, në këtë rast Bashkia Tiranë. Ky akt është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për të dyja palët.

Në çdo rast duhej të shkruhej afati i parashikuar

Duke qenë se. ASHSH garanton për përmirësimin e kësaj praktike **kjo gjetje është pranuar dhe do procedohet me zbatimin e saj**.

Së pesti, u konstatua se nga ASHSH nuk ka të dokumentuar asnjë shkresë përcjellë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vendimin e Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, në kundërshtim me Nenin 3, pika 6 e aktmarrëveshjes së lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Tiranë, si dhe pengon në zbatimin e nenit 25 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30-ditëve nga data e marrje së vendimit. Bazuar në akt-marrëveshjen e cituar më sipër, ne nenin 3 përcaktohen "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6... e cila specifikon se : "*Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet që të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Legjislacionin në fuqi*".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Sikurse ju kemi parashtruar në observacionet e paraqitura me shkresën nr. 1141/1 prot., datë 10.11.2025, KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 111 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 504, datë 30.8.2023. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 504, datë 30.8.2023, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit. Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se:

Së pari: referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve.

Së dyti: sipas akt-marrëveshjes me subjektin kërkues, nga e cila krijohen të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara.

Së treti: nga verifikimi në fazën e terrenit rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave. Ky mosveprim përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga akt-marrëveshja.

Për sa më sipër pretendimi juaj **nuk merret në konsideratë dhe do trajtohet si i tillë në materialin e auditimit**.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1) Z. Kastriot Gurra me detyrë, Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit të KPSH.
2) Z. Albian Marku, me detyrë arkitekt, në cilësinë e anëtarit të KPSH
3) Znj. Selmina Varfi, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të KPSH
4) Znj. Fabjona Cenaj, me detyrë inxhiniere, në cilësinë e anëtarit të KPSH
5) Z. Spartak Kodra, me detyrë ekonomist, në cilësinë e anëtarit të KPSH

XXXI. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Arbanë", Bashkia Tiranë" finalizuar me VKM nr. 181, datë 27.03.2024 në shumën 423,129.70 lekë.

Projekti dhe argumentimi ligjor nga ana e Bashkisë Tiranë.

Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSHin (në vijim ASHSH), z. Kastriot Gurra, me kërkesën për shpronësim me objekt: "Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare "Arbanë".
Shpronësimi kërkohet për shkak të realizimit të investimit të Bashkisë Tiranë, në interes dhe në shërbim të qytetarëve të Tiranës, në përputhje me përcaktimin e Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 8, shkronja ç, e cila parashikon se: *"Në funksion të interesit publik, shpronësimi mund të bëhet për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës"* .
Ky projekt është miratuar me Vendimin nr. 18/7, datë 23.11.2018 të Këshillit Teknik, të Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, të Bashkisë Tiranë.
Bazuar në ligjin e mësipërm, Bashkia Tiranë i është drejtuar ASHK-së, (Agjencisë Shtetërore të Kadastrës), Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, me shkresën nr. 61706 prot., datë 22.12.2023, me anë të së cilës është kërkuar konfirmimi i statusit juridik, të pasurive që preken nga ky projekt.
Me kthim-përgjigje, nga ana e ASHK-së, u krye evidentimi i sipërfaqeve të prekura, të pasqyruara në projektin e shpronësimit dhe u hartua tabela e llogaritjeve paraprake. Rezultoi se dy pasuritë që preken nga projekti, konkretisht pasuritë me nr. 102/7 dhe nr. 102/20, ZK 1032, janë në pronësi të Bashkia Tiranë, ku është pozicionuar kopshti dhe shkolla ekzistuese-Arbanë.
Nga llogaritja paraprake, vlera e shpronësimit të projektit është në shumën 423,129.70 lekë.
Bazuar në Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 10, shkronja c, e cila parashikon se: *"Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ASHSH kërkesën për shpronësim. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë dhe ato të shpronësimit apo të vlerësimit"*, Bashkia Tiranë i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar me shkresën nr. 145 prot. datë 03.01.2024, duke kërkuar garantimin e fondeve për shpronësim lidhur me vlerën e shpronësimit për projektin në fjalë. DPMF nga ana e saj ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 145/1 prot. të datës 05.01.2024, ku shprehet se vlera e shpronësimit për këtë projekt do të përfshihet në mbledhjen e parë të ndryshimit të buxhetit për Vitin 2024.
Llogaritjet paraprake dhe çmimi i përcaktuar janë bazuar në VKM-në me nr. 89 datë 03.02.2016 *"Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"*, për llojin e pasurisë "Truall" e cila ***për zonën kadastrale 1032 është 490 lekë/m2***.

Ngritja e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit
Me shkresën nr. 146/1 prot., e datës 22.01.2024, është lëshuar Urdhri me nr. 27 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH-së, z. Kastriot Gurra, për krijimin e Komisionit të Posaçëm, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.
Komisioni është i përbërë nga: [Kryetar – Z. Kastriot Gurra, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm; Anëtar – Z. Albian Marku, me detyrë arkitekt; Anëtare – Zj. Ilirjana Hasanllari, me detyrë juriste; Anëtare – Znj. Sidorela Qato, me detyrë ekonomiste; Anëtare – Z. Spartak Kodra, me detyrë ekonomist].

Hapat e marra nga Bashkia Tiranë

Me kthim-përgjigjen nr. 146/2 prot., datë 01.02.2024, KPSH i ASHSH-së pas shqyrtimit, i drejtohet Bashkisë Tiranë me kërkesë për plotësim dokumentacioni.
Me shkresën nr. 2552/5 prot. të datës 01.02.2024 (protokolluar në ASHSH me nr. 146/3 datë 01.02.2024) z. Alban Dokushi, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Pasurive të Paluajtshme pranë Bashkisë Tiranë ka vënë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm të ASHSH-së, se i është drejtuar për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesës, Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, si struktura përgjegjëse për miratimin dhe garantimin e fondeve financiare për shpronësimin.
Me shkresën me nr. prot., 2552/4, datë 01.02.2024, DPMF bën me dije se Bashkia Tiranë do të përballojë me fondet e veta financiare shpronësimin e projektit të sipërcituar dhe përfshirjen në Buxhetin e Vitit 2024.

Miratimi i kërkesës për shpronësim
Me shkresën me nr.146/4 prot., datë 02.02.2024, ASHSH i njofton Bashkisë Tiranë pranimin e kërkesës për shpronësim publik.
Me shkresën me Nr. 146/5 prot., datë 2552/7 prot., datë 05.02.2024, është lidhur marrëveshja mes palëve, ASHSH në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për zhvillimin e procedurës dhe Bashkisë së Tiranës, në cilësinë e subjektit kërkues.
Me shkresën me nr.146/6 prot., datë 05.02.2024, ASHSH dërgon pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, kërkesën "Publikim për shpronësim për interes publik".
Me shkresën me Nr. 146/7 prot., datë 06.02.2024, "Njoftim për shpronësim pubik", ASHSH, njofton subjektet privatë: Fatime Duro, Fatbardha Pepa, Meliha Celkavaja, Makbule Toska, Sanije Allamani, Ardit Allamani, Mehmet Allamani, Bledar Allamani, Shefqet Preza, Elizabeta Preza, Nafie Kurti, Asllan Hysenaj, Adtrit Hysenaj dhe Arjan Hysenaj, që brenda 15 ditëve, nëse kanë pretendime mbi shpronësimin e pasurisë për interes publik, të paraqiten pranë Bashkisë Tiranë dhe ASHSH-së.
Me shkresën me Nr. 5895 prot., datë 16.02.2024, administruar në ASHSH me Nr.146/8 prot., datë 19.02.2024, Bashkia Tiranë vë në dijeni edhe ASHSH-në se është kryer afishimin në stendat për publikimin e njoftimit të shpronësimit.
Me shkresën me Nr. 146/9 prot., datë 06.03.2024, ASHSH i drejtohet MIE, me propozimin e projektvendimit për shpronësimin për interes publik (bashkëlidhur praktika).
Me shkresën e datës 1711/1 prot., datë 28.03.2024, e administruar në ASHSH me nr. 146/10 prot., datë 29.03.2024, Këshilli i Ministrave ka dërguar bashkëlidhur **Vendimin nr. 181, datë 27.03.2024**, *"Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Arbanë", Bashkia Tiranë.*
Me shkresën nr. 146/11 prot. datë 02.04.2024 ASHSH i dërgon VKM-në me nr. 181, datë 27.03.2024 subjektit kërkues për shpronësim, Bashkisë Tiranë.
Me shkresën nr. 146/12 prot., datë 02.04.2024, ASHSH vë në dijeni subjektet e prekura për shpronësim për VKM-në me nr. 181, datë 02.04.2024.
Me shkresën nr. 146/13 prot. datë 02.04.2024 ASHSH i specifikon Bashkisë Tiranë, për pagesën e anëtarëve të KPSH.
Konstatim:
- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, për procedurën e shpronësimit, për interes publik, "Kërkesën për shpronësim me objekt: "Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare "Arbanë", u konstatuan problematikat si më poshtë:
Së pari, nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme, lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të*

pasurisë pronë private për interes publik", neni 11, pika 5, gërma d e cila parashikon se: "*ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban*".

Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen.

Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" e cila parashikon se: "*Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj,* ***duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr.prot., pa datë, si më poshtë vijon:

1. Pretendimi i subjektit: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, sqaron se, nëpërmjet observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1142/1 Prot., datë 07.11.2025, kemi paraqitur qëndrimin tonë në lidhje me procedurat e negocimit, në përputhje me nenin 11, pikën 5, gërma d), të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në të cilin parashikohet se: "d) ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban".

Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "*Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin*", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative. Sikurse kemi sqaruar, në interpretim të kësaj dispozite, ASHSH ka të drejtë, por jo domosdoshmërisht detyrim të negocioj në çdo rast me subjektet që shpronësohen, përsa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së saj. Për sa i përket qëndrimit tuaj ku citoni se... "*Nga momenti i themelimit të ASHSH, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj Agjencie dhe Ministrisë së linjës*", informojmë se, nga ana e ASHSH në mungesë të një akti nënligjor lidhur me rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara, janë ndërmarrë veprime lidhur me nevojën për ndryshime ligjore, konkretisht nëpërmjet Memos Nr. 874/2/Prot., datë 13.11.2023, "*Mbi problemet e hasura në praktikë nga legjislacioni në fuqi në fushën e shpronësimit për interes publik*", ASHSH ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për mundësinë e ndryshimit të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", i ndryshuar, si dhe ndryshimin/përditësimin e akteve nënligjore përkatëse, duke evidentuar edhe nevojën për hartimin e një akti normativ mbi ndjekjen e procedurave përkatëse të negocimit. Procesi i diskutimit dhe përpunimit të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore vazhdon në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës

dhe Energjisë, për të finalizuar përmirësimet dhe përditësimet e nevojshme. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëndrimin e grupit të auditimit, shpreh gatishmërinë që në vijim të marrë masa për hartimin e një draft- VKM-je, për ndjekjen e procedurave të negocimit, duke e përcjellë pranë institucionit epror propozimin për hartimin e aktit përkatës mbi procedurat e negocimit.

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se konstatimi i mësipërm i referohet dokumentacionit të plotë që duhet të shoqërojë kërkesën për shpronësim sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Fakti që mes ASHSH dhe subjektit kërkues ka një korrespondencë të përsëritur për plotësim dokumentacioni konfirmon qëndrimin e grupit të auditimit.

Për sa më sipër, argumentimi juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit, duke qenë se nuk kemi të bëjmë me dokumentacion dhe fakt të ri provues.

Së dyti, në relacionin e përpiluar nga ASHSH drejtuar MIE, nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve. Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues Bashkia Tiranë dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen detyrimet e Bashkisë Tiranë përmendet edhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore "*Bashkia Tiranë duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore*", por në asnjë shkresë si në kërkesën fillestare të bërë nga Bashkia për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje dhe as në relacionin e mësipërm nuk përmendet një afat i qartë.

Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 20, pika 1, germa a e cila parashikohet se: "*Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*

Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, ***afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve*** *ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilën citohen dhe dokumentet që kërkohen nga shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 10 të këtij ligji.*"

Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet, për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit 3-mujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të së cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit*".

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr.prot., pa datë, si më poshtë vijon:

2. Pretendimi i subjektit: Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "*Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin*", Kreu III, pika 5,

gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetëorer për shpronësimin *"Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin"*, në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative. Në strukturën organizative të ASHSH-së, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje, apo miratim të akteve normative. Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar, ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm, por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast, në relacionin shoqërues të projektvendimit si dhe akt-marrëveshjen e lidhur midis palëve do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.

2.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se: Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues Bashkia Tiranë dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen detyrimet e Bashkisë Tiranë përmendet dhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore... *"Bashkia Tiranë duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore"*, por në asnjë shkresë si në kërkesën fillestare të bërë nga Bashkia për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje dhe as në relacionin e mësipërm nuk përmendet një afat i qartë.

Për sa më sipër, argumentimi juaj nuk merret në konsideratë, pasi nuk përbën fakt të ri.

Së treti, konstatohet se në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument, ose e dhënë në lidhje me hapat e ndjekur nga ASHSH, në lidhje me likuidimin e pronarëve të pronës private të shpronësuar.

Vetë Agjencia Shtetërore për Shpronësimin nuk ka dijeni mbi situatën e likuidimit të proceseve të shpronësimit publik, në të cilat ato nuk janë përcaktuar si përgjegjëse për likuidimin.

Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* neni 23, në të cilën parashikohet se... *"Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar brenda afatit në shkronjën "c" të nenit 21 të këtij ligji dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës"*.

Neni 1 i Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm", i ndryshuar, përcakton se objekti i këtij ligji, është jo vetëm rregullimi i së drejtës së shtetit për të shpronësuar, ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, por edhe mbrojtja e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës.

Pika 3 e nenit 26 përcakton se, shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji nuk është kryer pagesa ose vënia në dispozicion e masës së shpërblimit, sipas këtij ligji, për llogari të pronarëve të shpronësuar, si dhe të pronarëve e personave të tretë të dëmtuar, për shkak të shpronësimit.

Ky veprim, po ashtu vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, neni 6, pika 3, gërma ç, e cila parashikon se: *"ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"*. Bazuar në këtë nen dhe pasi në dosje nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me shpërblimin e dhënë, grupi i auditimit e ka të pamundur të dalë me një konstatim përfundimtar nëse shpërblimi është dhënë në masën dhe në afatet e duhura ligjore.

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot., datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:

3. Pretendimi i subjektit: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, sikurse Ju ka informuar edhe nëpërmjet observacioneve të dërguara me shkresën nr. 1142/1 Prot., datë 07.11.2025,

procedurat e likuidimit e sipas VKM Nr. 181/2024, "Për shpronësimin për interes publik, për realizimin e projektit *"Ndërtimi i Shkollës 9-Vjeçare Arbanë", Bashkia Tiranë*, konkretisht sipas pikave 4, 6, 7 dhe 8, janë procedura që ndiqen nga Bashkia Tiranë. Për sa më sipër, gjetja juaj konsiston ne aktin normativ te shpronësimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ku detyrimin ligjor për kryerjen e procedurave të likuidimit, sipas përcaktimeve të VKM-së, e ka Bashkia Tiranë.

3.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH i është vënë në dispozicion grupit të auditimit, megjithatë duhet theksuar se ju si institucion jeni agjenci e cila duke u marrë me shpronësimin e pronarëve, duhet gjithashtu edhe të mbajë të dhëna dhe të pasqyrojë me transparencë të plotë gjithë procedurën e shpërblimit që jepet. Ju rikujtojmë, Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, neni 6, pika 3, germa ç, e cila parashikon se: " ASHSH përveç detyrave të tjera të përcaktuara në ligj kryen edhe detyrat e mëposhtme:...krijon bazën e të dhënave për të gjitha shpronësimet dhe likuidimet e çdo shpronësimi"

Për këtë arsye dhe sa sqaruam më sipër, pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë.

Së katërti, konstatohet se në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument në lidhje me burimin dhe garantimin e fondeve financiare, të nevojshme për financimin e projektit, po ashtu edhe me burimin e fondeve për shpronësimin e pronarëve.

Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, neni 10, pika 1, germa c, e cila parashikon se: *"Kërkesa për shpronësim duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion:....**Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit**.*

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 127, datë 23.03.2000 *"Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* pika 1 e cila parashikon se: *" Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, **e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet standarde**, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.*

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:

4. Pretendimi i subjektit: *Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit e kundërshton qëndrimin e grupit të auditimit, pasi sqarojmë se bazuar në germën c), pika 1, të Nenit 10, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm te pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit". Gjithashtu, në pikën 2, të nenit 10, të Ligjit Nr. 8561/1999, të ndryshuar, parashikohet se, **"Në rastet kur kërkues i shpronësimit është një organ shtetëror ose institucion shtetëror i krijuar me ligj të posaçëm, nuk paraqiten dokumentet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "c" të këtij neni".** Në rastin konkret sqarojmë se, kërkues i shpronësimit për realizmin e projektit "Ndërtimi i Shkollës 9-Vjeçare Arbanë", është Bashkia Tiranë.*

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana Juaj, marrjen në konsideratë të observacionit tonë...

4.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se konstatimi i mësipërm i referohet dokumentacionit të plotë që duhet të shoqërojë kërkesën për shpronësim sipas përcaktimeve të nenit 10, pika 1 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000 "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999" dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Fakti që mes ASHSH dhe subjektit kërkues ka një korrespondencë të përsëritur për plotësim dokumentacioni konfirmon qëndrimin e grupit të auditimit dhe *observacioni nuk merret parasysh.*

Së pesti, konstatohet se në dosjen e projektit procesverbalet e mbledhjeve të KPSH, në të gjitha rastet, janë pa numër protokolli.

Ky veprim është në mospërputhje me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18 i cili parashikon se: "*Procesverbale të mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshëm. **Ato protokollohen**.*"

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:

5. Pretendimi i subjektit: *Përsa i përket protokollimit të procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, ASHSH ka marrë masat për ngritjen e urdhrit "Për protokollimin e procesverbaleve të mbajtura nga Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin" me Nr. 148 Prot., datë 16.07.2024 dhe në vijim të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka vijuar me protokollimin e tyre në çdo rast.*

5.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se neni 18 i Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, detyron protokollimin e procesverbaleve të mbledhjeve që përbëjnë dokumente të brendshme zyrtare me funksion administrativ edhe pse në vijim vendimmarrja e këtij procesverbali i komunikohet përmes shkresës së veçantë drejtuar subjektit. **Për sa më sipër, argumentimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Së gjashti, konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, Bashkisë Tiranë realizimin e njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim.

Veprim që bie në kundërshtim me kërkesat e ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, gërma e, e cila parashikon se: "*Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, **si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës.***"

Si dhe në kundërshtim me VKM-në me nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: "*Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, **e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr. 1 dhe dokumentet standarde**, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.*".

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:

6. Pretendimi i subjektit: *Sa i përket qëndrimit të grupit të auditimit shprehemi se... sikurse Ju kemi bërë me dije edhe më sipër në lidhje me shënimin... "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo edhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta. Ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marri përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu, sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit, por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrit të titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Kastriot Gurra dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin". Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.*

6.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. **Sa më sipër, argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**.

Së shtati: Nga auditimi i dosjes, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë përcjellë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vendimin e Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, në kundërshtim me Nenin 3, pika 6 e aktmarrëveshjes së lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Tiranë, si dhe pengon në zbatimin e Nenit 25 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se, regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30-ditëve nga data e marrje së vendimit. Bazuar në akt-marrëveshjen e cituar më sipër, ne nenin 3 përcaktohen "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6... "Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet që të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Legjislacionin në fuqi".

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:

7. Pretendimi i subjektit: *KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se: KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit, për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM-në në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet*

e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM-së i kërkohet zyrtarisht edhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM Nr. 181/2024. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM Nr. 181/2024, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.

7.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se: Së pari, referuar nenit 11, pika 5, gërma "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve. Së dyti, sipas Aktmarrëveshjes me subjektin kërkues, e cila krijon të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara. Së treti, nga verifikimi rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave, çka përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga aktmarrëveshja. Nga ana e grupit të auditimit theksohet se pavarësisht shkresave të dërguara drejt MIE, konstatohet se nuk ka asnjë ndryshim nga momenti i themelimit të ASHSHin e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë bashkëpunimi mes kësaj agjencie dhe Ministrisë së linjës. **Për sa më sipër, argumentimi juaj nuk merret në konsideratë**.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. Kastriot Gurra, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e Kryetarit të KPSH
2. Z. Albian Marku, me detyrë arkitekt në cilësinë e anëtarit të KPSH.
3. Zj. Ilirjana Hasanllari, me detyrë juriste në cilësinë e anëtarit të KPSH.
4. Znj. Sidorela Qato, me detyrë ekonomiste në cilësinë e anëtarit të KPSH.
5. Z. Spartak Kodra, me detyrë ekonomist në cilësinë e anëtarit të KPSH.

XXXII. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe-Tiranë", Bashkia Tiranë" finalizuar me VKM nr. 896, datë 29.12.2022 në shumën 37,677,789.70 lekë.

Projekti dhe argumentimi ligjor nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar

Me anë të shkresës nr. 4906 Prot., datë 02.07.2024, (protokolluar në ASHSH me nr. 47 prot., datë 26.02.2021), ARRSH paraqet kërkesën për shpronësim, (për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022), "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës, nga "Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri" dhe rikualifikimi i "Unazës Lindore për lotët 4,5,6 (fazn 2)", bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues.

Bazuar në Nenin 8, pika c, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për realizimin e projekteve dhe të investimeve, që paraqesin interes ose shtrirje territoriale kombëtare, ose vendore në fushën

e transporteve të çdo lloji të energjetikes, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut".
Ky projekt është miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të ARRSH-së me nr. 26, datë 15.07.2021, me objekt: "Mbi projektin e zbatimit për kontratën: "Studim-projektim rikualifikim i Unazës Lindore Tiranë, për lotet 4, 5, 6, faza 2".
Nga Bashkia Autoriteti Rrugor Shqiptar, nëpërmjet aplikimit "on-line", për shërbimet kadastrale në modulin e posaçëm të ASHK-së për institucionet shtetërore është administruar dokumentacioni mbi pasuritë e përfshira në këtë kërkesë për shpronësim, dërguar nga DVASHK, Rurale 1 dhe Tirana Veri. Pasuritë që preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor, janë të llojit "Truall", "Arë" dhe "Ndërtesë".
Pasuritë janë vlerësuar në zbatim të VKM-së me Nr. 138, datë 20.03.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimi të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, i ndryshuar".
Për pasuritë e llojit "Truall" dhe "Arë", vlerësimi është kryer në zbatim të VKM-së me nr. 89, datë 03.02.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", kurse për pasurinë e llojit "ndërtesë", me funksion banimi, me shkresën nr.1901/1 prot., datë 10.03.2022 të dërguar nga DVASHK Tirana Rurale 1, nr.1993/1 prot., datë 07.09.2022 të dërguar në DVASHK Tiranë Veri, janë ndërmarrë çmimet të shitblerjes së 3-mujorit të fundit për objektet me funksion banimi, në ZK 3976, ZK 8110.
Financimi i këtij objekti bëhet në bazë të Nenit 10, pika 2 e ligjit 8561, datë 22.12.1999, nga fondet për shpronësim të Ministrisë së Financave.
Për projektin "Rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4,5,6, nga KKT është miratuar Leja e Zhvillimit nr.03, datë 13.07.2021.

Ngritja e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit

Me shkresën nr. 922/1 prot., e datës 03.07.2024, është lëshuar Urdhri nr. 139 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, z. Kastriot Gurra, për krijimin e Komisionit të Posaçëm, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

Komisioni është i përbërë nga:[Kryetar – Z. Kastriot Gurra, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm; Anëtar – Z. Albian Marku, me detyrë arkitekt; Anëtare – Zj. Ilirjana Hasanllari, me detyrë juriste; Anëtare - Znj. Entela Bytyçi, me detyrë inxhiniere; Anëtare – Znj. Klodiana Lika, me detyrë ekonomiste; Anëtare- Znj. Orlanda Murati, me detyrë juriste; Anëtare – Znj. Fabjan Cenaj, me detyrë ekonomist].

Hapat e marra nga Autoriteti Rrugor Shqiptar

Me shkresën me Nr. 922/2 prot., datë 12.07.2024, Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin, i ASHSH-së pas shqyrtimit, i drejtohet Autoritetit Rrugor Shqiptar, me kërkesë për plotësim dokumentacioni. Siç argumentohet nga komisioni janë konstatuar problematika si vijon:

1. *Dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës për shpronësim është përcjellë fotokopje (duhet origjinal, ose i njehsuar).*
2. *Në tabelën e shpronësimit duhet që të korrigjohet lloji i pasurisë, nga lloji "truall ndërtese", në llojin "truall", sipas zërit kadastral të përcaktuar në kartelën e pasurisë, konkretisht për pasuritë Nr.136/375, Nr.35/22, Nr.7/66, Nr.136/365 dhe Nr.5/321.*
3. *Në tabelën e shpronësimit duhet që të pasqyrohet në një kolonë të veçantë sipërfaqja që propozohet si shtesë në VKM-në 896/2022, si dhe vlera totale shtesë, me diferencën përkatëse nga VKM-ja bazë, me qëllim që të evidentohet efekti financiar shtesë në vlerën e shpronësimit (për 10 pasuri).*
4. *Në planimetrinë e shpronësimit, të reflektohen sipërfaqet që preken nga VKT Nr.25, datë 25.09.2023.*

5. *Në pasurinë Nr.136/365 në HTR rezulton të ketë objekt, të reflektohet sipas HTR-së në planimetrinë e shpronësimit të objektit dhe të sqarohet nga subjekti kërkues nëse preket ose jo.*

Dokumentacioni plotësues sa më sipër, duhet që të paraqitet në ASHSH, për shqyrtim brenda 30-ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Me shkresën me Nr. 5222/1 prot., datë 16.07.2024, e administruar në ASHSH me Nr. 922/3 prot., datë 17.07.2024, ARRSH i kthen përgjigje ASHSH-së, bashkëlidhur edhe dokumentacioni i kërkuar.

Me shkresën me Nr. 4906/1 prot., datë 17.07.2024, e administruar në ASHSH me Nr. 922/4 prot., datë 19.07.2024, ARRSH, i dërgon shkresën "plotësim dokumentacioni" ASHSH-së, (bashkëlidhur edhe dokumentacionin e dërguar ASHK Rurale 1 dhe kopje e aplikimit nr.12932, datë 26.04.2024, për dokumentacionin hipotekor të munguar, për pasuritë sipas aplikimit bashkëlidhur shkresës).

Drejtoria e Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit në ASHSH, i është drejtuar ARRSH-së, me kërkesën me nr. 922/6 prot., datë 19.07.2024 "Për plotësim dokumentacioni", pasi komisioni ka konstatuar se:

- Kartelat e pasurive me Nr. 35/22, 136/50, 35/53, 68/23, 68/17, 136/365, 68/32 ZK 3976, janë jashtë afatit, Komisioni vendosi pranimin e kërkesës së subjektit kërkues ARRSH dhe vijimin me procedurat për shpronësim, me kushtin që të risillet dokumentacionin kadastral i rifreskuar për pasuritë e sipërcituara, deri në fazën e publikimit të kërkesës për shpronësim.

Miratimi i kërkesës për shpronësim

Me shkresën me nr. 922/7 prot., datë 19.07.2024, "Njoftim për pranimin me kusht të kërkesës për shpronësim me interes publik", Drejtoria e Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit në ASHSH i është drejtuar ARRSH-së, për pranimin e kërkesës me kusht, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në me nr.896, datë 29.12.2022 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të "Unazës së Madhe", Tiranë nga "Sheshi Shqiponja", -"Bulevardi i Ri" dhe "Rikualifikimi i "Unazës Lindore" për lotët 4,5,6 (faza 2), me vlerë totale paraprake të shpronësimit **37,677,789.70** lekë. Personi i autorizuar nga ana juaj, duhet që brenda 10-ditëve të paraqitet në ASHSH, nga marrja e njoftimit për lidhjen e Akt-marrëveshjes, duke u njohur me të drejtat dhe detyrimet që lidhen me procesin e shpronësimit të pasurive, që preken nga ky projekt.

Më datë 19.07.2024, mes ASHSH-së, në cilësinë e autoritetit përgjegjës dhe ARRSH-së, në cilësinë e subjektit kërkues është lidhur akt-marrëveshja e administruar në ASHSH me Nr. 922/8 prot dhe në ARRSH me Nr. 5383 prot.

Me shkresën me Nr. 922/9 prot., datë 22.07.2024, ASHSH dërgon pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, kërkesën "Publikim për shpronësim, për interes publik".

-Me shkresën me Nr. 922/10 prot., datë 25.07.2024 janë njoftuar shtetasit Flogert Shyqyr Suejmani dhe Elton Shyqyr Sulejmani, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme pronë private me numër 136/375, e llojit "truall+ndërtesë", ndodhur në zonën kadastrale me nr.3976...

Sipërfaqja e truallit që shpronësohet është 130 m2 x 479 lekë/m2 = 62,270 lekë;

Sipërfaqja e ndërtesës që shpronësohet është 332.7 m2 x 61,167 lekë/m2 = 20,350,260.90 lekë;

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 20,412,530.90 lekë.

-Me shkresën me Nr. 922/10 prot., datë 25.07.2024 është njoftuar shtetasi Haki Xhelo Canollari, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 35/22, e llojit "truall+ndërtesë", e ndodhur në zonën kadastrale me nr.39/76;

Sipërfaqja e truallit që do të shpronësohet është 33m2 x 479 lekë/m2=15,807 lekë;

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 15,807 lekë.

-Me shkresën me Nr. 922/10 prot., datë 25.07.2024 është njoftuar shtetasi Veladin Nuredin Balla, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 136/50, e llojit "arë", e ndodhur në zonën kadastrale me nr.376;
Sipërfaqja e tokës arë që shpronësohet është 135m2 x 448 lekëm2=60,480 lekë;
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 60,480 lekë;
-Me shkresën me Nr. 922/10 prot., datë 25.07.2024 është njoftuar shtetasi Jorgo Xhevat Biba, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 35/53, e llojit "arë", ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3976;
Sipërfaqja e tokës arë që do të shpronësohet është 14.6 m2 x 448 lekë/m2=6,540 lekë;
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 6,540 lekë;
- Me shkresën me Nr.922/10 prot., datë 25.07.2024 janë njoftuar shtetasit, Mira Maliq Aga, Algert Nuredin Aga, Igli Nuredin Aga, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 68/23, e llojit "arë", ndodhur në zonën kadastrale 3976.
Sipërfaqja totale e tokës arë që do të shpronësohet është 92m2 x 448 lekëm2=41,216 lekë;
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 41,216 lekë.
-Me shkresën me Nr. 922/10 prot., datë 25.07.2024 është njoftuar shtetasi Hajri Gani Dauti, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 68/17, e llojit "arë", ndodhur në zonën kadastrale 3976;
Sipërfaqja e tokës "arë" që shpronësohet është 118,5m2 x 448 lekë/m2 = 53,088 lekë.
Vlera totale paraprake e shpronësimit është = 53,088 lekë.
-Me shkresën me Nr.922/10 prot., datë 25.07.2024 është njoftuar shtetasi Lulëzim Hatem Duro, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 136/365, e llojit truall+ndërtesë, ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3976.
Sipërfaqja e truallit që do të shpronësohet është 11.7m2 x 479 lekë/m2=5,604.30 lekë;
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5,604.30 lekë;
- Me shkresën me Nr. 922/10 prot., datë 25.07.2024 është njoftuar shtetasi Gëzim Mustafa Laçi, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 5/321, e llojit "truall+ndërtesë", ndodhur në zonën kadastrale me nr.8170;
Sipërfaqja e truallit që do të shpronësohet është 66.8m2 x 32,878 lekë/m2=2,196,250.40 lekë.
Vlera totale e shpronësimit është 2,196,250.40 lekë;
- Me shkresën me Nr. 922/10 prot., datë 25.07.2024 është njoftuar shtetasi Ismail Kasem Spaja, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 68/32, e llojit "arë", e ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3976.
Sipërfaqja e tokës "arë" që shpronësohet është 612.5m2 x 448 lekë m2=274,400 lekë.
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 274,400 lekë.
- Me shkresën me Nr.922/10 prot., datë 25.07.2024 është njoftuar shtetasi Mustafa Ibrahim Avdiu, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 7/66, e llojit "truall+ndërtesë", ndodhur në zonën kadastrale me nr. 8110;
Sipërfaqja e ndërtesës që shpronësohet është 239.7m2 x 60,959 lekë/m2 = 14,611,872.30 lekë;
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 14,611,872.30 lekë.
ARRSH ka dërguar shkresën me Nr.5390/1 prot., e administruar në ASHSH me Nr. 922/11 prot., datë 31.07.2024, "kthim përgjigje për plotësim dokumentacioni", bashkëlidhur dokumentacionin e rifreskuar të dërguar ng Drejtoria Vendore e ASHK-së, Tirana Rurale 1, për pasuritë nr.35/22, 136/50, 35/53, 68/23,68/17, 136/365, 68/32 ZK 3976, si dhe u saktësuan tabela sipas dokumentacionit të rifreskuar, për pasurinë nr.68/32 ZK 3976, në kolonën "shënime".
Në ASHSH është paraqitur "Ankesë", nga shtetasi Mustafa Avdiu, e datës 29.07.2024, e administruar në institucion me nr.922/12 prot., datë 01.08.2024, i cili ka pretendime për vlerën e përllogaritur të pasurisë së tij, objekt shpronësimi, duke konstatuar pasaktësi dhe se duhej përllogaritur në një vlerë më të lartë.

Bazuar në shkresën me Nr. 922/13 prot., datë 02.08.2024, për shqyrtimin e ankesës është mbledhur Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit.
Me shkresën me Nr. 922/14 prot., datë 02.08.2024, ASHSH i kthen përgjigje ankuesit Mustafa Avdiu, duke vënë dijeni edhe Autoritetin Rrugor Shqiptar.
Me shkresën me Nr. 922/15 prot., datë 26.08.2024, Komisioni i Posaçëm për Shpronësim në ASHSH, i cili pas përfundimit të afatit 15-ditor dhe trajtimit të ankesave, vendosi "Miratimin e propozimit për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në me nr. 896, datë 29.12.2022, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të "Unazës së Madhe", Tiranë, nga "Sheshi Shqiponja" – "Bulevardi i Ri", "Rikualifikimi i Unazës Lindore", për lotët 4,5,6, (Faza 2), me vlerë totale të shpronësimit 37,677,789.70 lekë.
Referuar shkresës me Nr. 922/16 prot., datë 27.08.2024, ASHSH ka dërguar Propozimin e projektvendimit për shpronësim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me relacionin shpjegues bashkëlidhur.
Me "ankesën" e administruar në ASHSH me Nr. 922/17 prot., datë 02.09.2024, shtetasi Ramazan Avdiu kërkon ***korrigjim të procedurave të shpronësimit, përllogaritje të pjesës së mbetur të truallit prej 161.6 m² nga sipërfaqja totale e truallit prej 410,5 m².***
Me shkresën me Nr. 922/18 prot., datë 04.09.2024 është mbajtur procesverbal nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit në ASHSH, për shqyrtimin e ankesës së paraqitur më datë 02.09.2024 nga z. Ramazan Avdiu, lidhur me pretendimin për përllogaritjen jo të saktë të vlerës së shpronësimit.
Me shkresën me Nr.922/19 prot., datë 4.09.2024, ASHSH i kthen përgjigje, ankuesit Z. Ramazn Avdiu, duke vënë në dijeni edhe ARRSH-në.
Bazuar në shkresën me Nr.922/20 prot., datë 02.10.2024 Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit ka shqyrtuar kërkesën e Departamentit të Kryeministrisë, të përcjellë në mënyrë elektronike në ASHSH, lidhur me saktësimin e tabelës së dërguar në MIE, ku kërkohet një azhurnim i vlerës totale që kompensohet nga shpronësimet.
Me kartelën shoqëruese, e datës 5269/3 prot., datë 10.10.2024, e administruar në ASHSH me Nr. 922/21 prot., datë 14.10.2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përcjellë Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 620, datë 10.10.2024... "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.896, datë 29.12.2022", të këshillit të ministrave... "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve, të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor *"Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdueshëm të Unazës së Madhe të Tiranës nga sheshi Shqiponja-Bulevardi i ri"* dhe *"Rikualifikim i Unazës Lindore për lotët, 4,5,6" (faza 2).*
Me shkresën me Nr. 922/22 prot., datë 15.10.2024, ASHSH i dërgon vendimin Nr. 620, datë 10.10.2024 të Këshillit të Ministrave Autoritetit Rrugor shqiptar, ku i bën me dije se kërkesa për shpronësim është finalizuar me VKM-në me Nr. 620, datë 10.10.2024.
Me shkresën Nr. 922/24 prot., datë 15.10.2024, ASHSH i drejtohet ARRSH-së, "mbi pagesën e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit".
Nga auditimi i dosjes së këtij projekti u konstatuan problematikat si më poshtë vijon:
Së pari, është konstatuar se nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, neni 11, pika 5, gërma d, e cila parashikon se *"ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban".*

Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen.

Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* e cila parashikon se *"Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj,* ***duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën me nr. – prot., datë --- dhe me nr. 274/2 prot., datë 27.02.2026 (protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026 dhe nr. 277/30 prot., datë 02.03.2026), është observuar nga funksionarët e ASHSH, me pretendimet, si më poshtë vijon:

1. Pretendimi i subjektit: *KPSH, sqaron se, nëpërmjet observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1142/1 Prot., datë 07.11.2025, kemi paraqitur qëndrimin tonë në lidhje me procedurat e negocimit në përputhje me nenin 11, pikën 5, gërma d), të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në të cilin parashikohet se: "d) ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban".*

Bazuar në VKM-në me nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, muk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje apo miratim të akteve normative.

Konkretisht sikurse kemi sqaruar, në interpretim të kësaj dispozite, ASHSH ka të drejtë, por jo domosdoshmërisht detyrim të negocioj në çdo rast me subjektet që shpronësohen, përsa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së saj.

Për sa i përket qëndrimit Tuaj ku citoni se: "Nga momenti i themelimit të ASHSH, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj Agjencie dhe Ministrisë së linjës", Ju informojmë se, nga ana e ASHSH në mungesë të një akti nënligjor lidhur me rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara, janë ndërmarrë veprime lidhur me nevojën për ndryshime ligjore, konkretisht nëpërmjet Memos Nr. 874/2/Prot., datë 13.11.2023, "Mbi problemet e hasura në praktikë nga legjislacioni në fuqi në fushën e shpronësimit për interes publik", ASHSH ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për mundësinë e ndryshimit të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe ndryshimin/përditësimin e akteve nënligjore përkatëse, duke evidentuar edhe nevojën për hartimin e një akti normativ mbi ndjekjen e procedurave përkatëse të negocimit. Procesi i diskutimit dhe përpunimit të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore vazhdon në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të finalizuar përmirësimet dhe përditësimet e nevojshme.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëndrimin e grupit të auditimit, shpreh gatishmërinë që në vijim të marrë masa për hartimin e një draft- VKM për ndjekjen e procedurave të

negocimit, duke e përcjellë pranë institucionit epror propozimin për hartimin e aktit përkatës mbi procedurat e negocimit.

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e grupit të auditimit theksohet se pavarësisht shkresave të dërguara drejt MIE, konstatohet se nuk ka asnjë ndryshim nga momenti i themelimit të ASHSHin, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj agjencie dhe Ministrisë së linjës. **Për sa argumentuam, pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë nga grupi i auditimit.**

Së dyti, konstatohet se në shkresat nr. 922/2 prot. të datës 12.07.2024 dhe nr. 922/4 prot. të datës 19.07.2024 dhe 922/6, datë 19.07.2024, ASHSH ka përcaktuar si afat kohor, për të njoftuar për mungesa dokumentacioni subjektin ARRSH, afatet 30 ditore.

Veprim ky i bazuar, në Ligjin nr.8 561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 12, pika 2 ku citohet se "*Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij,* ***duke caktuar edhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.***

Megjithatë, një veprim i tillë vjen në kundërshtim me nenin 12 pika 3 të këtij ligji ku parashikohet se "*Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar* ***në afatin e caktuar,*** *ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut, ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga ministria dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të Shpronësimit*".

Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës të një akti normativ, i cili duhet të përcaktojë një afat konkret të pranueshëm, për kohën që i duhet subjektit kërkues që të paraqesë dokumentet e sakta ose të munguara.

Në gjykimin e grupit të auditimit, një akt i tillë do kishte karakter shtrëngues ndaj subjektit që kërkon shpronësimin, si dhe do respektonte ligjin nr. 44/2015 "Kodit të Procedurave administrative", neni 18, pika 2 për parimin e deburokratizimit dhe eficencës, ku parashikohet se: "*Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.*".

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën me nr. ---prot., datë --- dhe me nr. 274/2 prot., datë 27.02.2026 (protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026 dhe me nr. 277/30 prot., datë 02.03.2026), është observuar nga funksionarët e ASHSH, me pretendimet, si më poshtë vijon:

2. Pretendimi i subjektit: *Fillimisht sqarojmë se, sikurse ju kemi parashtruar me observacionet e paraqitura përmes shkresës nr. 1142/1 Prot., datë 07.11.2025, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, nëpërmjet korrespondencave vijuese midis ASHSH dhe subjektit kërkues në rastin konkret Autoriteti Rrugor Shqiptar, në çdo rast janë mbështetur në pikën 2 të nenit 12 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar. Ndërkohë në rastin konkret, kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues është paraqitur brenda afatit të caktuar, si dhe kërkesa për shpronësim i plotëson kushtet dhe shkakun ligjor për realizimin e shpronësimit për interes publik. Gjithashtu sqarojmë se, pika 3 e nenit 12 përcakton rastet e refuzimit kur mungon shkaku apo kushti i shpronësimit ose kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar në afatin e caktuar.*

2.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Bazuar në vetë ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 12, pika 2, *ku përcaktohet afati i posaçëm për dorëzimin e dokumentacionit grupi i auditimit shprehet sërish se pavarësisht vonesës në këtë rast nga Bashkia Tiranë dhe vonesa*

e pajustifikuar nga ASHK, vetë ASHSH duhej të kishte vepruar bazuar në ligjin e mësipërm duke u bazuar te neni 12, pika 3 pra të kishte refuzuar e kthyer pas kërkesën për shpronësim.
Për këtë arsye pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë.

Së treti, është konstatuar se në relacionin e hartuar nga ASHSH nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve. Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues ARRSH dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen detyrimet e ARRSH-së, përmendet dhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore "Autoritetit Rrugor Shqiptar *duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore*". Por në asnjë shkresë, si në kërkesën fillestare të bërë nga ARRSH për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje dhe as në relacionin e mësipërm nuk përmendet një afat i qartë.
Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 20, pika 1, germa a e cila parashikohet se: "*Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*
*Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, **afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve** ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilën citohen dhe dokumentet që kërkohen nga shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 10 të këtij ligji."*
Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell edhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se: "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit 3-mujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve, apo realizimit të qëllimit të shpronësimit*".

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:
3. Pretendimi i subjektit: *Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, sikurse ka sqaruar nëpërmjet shkresës për dërgimin e observacioneve lidhur me këtë projekt, në rastin konkret, procedura për shpronësim është një shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 896, datë 29.12.2022, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të 'Unazës së madhe' Tiranë nga 'Sheshi Shqiponja' – 'Bulevardi i ri' dhe 'Rikualifikimi i 'Unazës lindore' për lotet 4,5,6", (faza 2), pra nuk jemi në një kërkesë për shpronësim që inicion lëvizjen e Këshillit të Ministrave në një Vendim të ri, por propozojmë ndryshimin e një vendimi bazë. Në këto kushte, nuk ka sesi të jetë përcaktuar afati dhe fillimi i punimeve në rastin konkret, kur kjo kërkesë ezaurohet në VKM-në bazë. Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar, ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në realcionin shoqërues të projektvendimit si dhe aktmarrëveshjen e lidhur midis palëve do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.*

3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Dokumentacioni mbështetës i paraqitur nga ASHSH e pasqyron afatin e përfundimit të punimeve, megjithatë theksojmë se akti përfundimtar nga ju si institucion ku përcaktohet afati është Akt-marrëveshja e lidhur mes jush dhe subjekti kërkues, në këtë rast ARRSH. Ky akt është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për të dyja palët. Në çdo rast duhej të shkruhej afati i parashikuar.
Për këtë arsye pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë.

Së katërti, konstatohet se në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument në lidhje me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për financim të projektit, po ashtu dhe me burimin e fondeve për shpronësimin e pronarëve.
Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, neni 10, pika 1, germa c, e cila parashikon se: *"Kërkesa për shpronësim duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion:....**Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit**.*
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 127, datë 23.03.2000 *"Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* pika 1 e cila parashikon se: *" Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, **e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet standarde**, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.*

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:
4. Pretendimi i subjektit: *Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit e kundërshton qëndrimin e grupit të auditimit, pasi sqarojmë se bazuar në germën c), pika 1, të Nenit 10, të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm te pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, parashikohet se, "Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit". Gjithashtu, në pikën 2, të nenit 10, të Ligjit Nr. 8561/1999, të ndryshuar, parashikohet se, "**Në rastet kur kërkues i shpronësimit është një organ shtetëror ose institucion shtetëror i krijuar me ligj të posaçëm, nuk paraqiten dokumentet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "c" të këtij neni".** Në rastin konkret sqarojmë se, kërkues i shpronësimit për realizmin e projektit "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të 'Unazës së madhe' Tiranë nga 'Sheshi Shqiponja' – 'Bulevardi i ri' dhe 'Rikualifikimi i 'Unazës lindore' për lotet 4,5,6", (faza 2), është Autoriteti Rrugor Shqiptar.*
4.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në Ligjin Nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, konkretisht në nenin 3, të tij, ku thuhet se: "Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore". **Sa më sipër observacioni juaj nuk do të merret në konsideratë.**

Së pesti, konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, ARRSH-së procedurën e realizimin të

njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim.

Veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, germa e, e cila parashikon se: *"Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasurisë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasurinë*

pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, ***si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës.*** *"*

Si dhe në kundërshtim me VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: *"Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim,* ***e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr. 1 dhe dokumentet standarde****, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.".*

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:

5. Pretendimi i subjektit: *Sa i përket qëndrimit të grupit të auditimit, shprehemi se: për Kontrollin e Lartë të Shtetit se: Sikurse ju kemi bërë me dije edhe më sipër, në lidhje me shënimin "Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij", është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite përpara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrëveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues, ku subjekti kërkues pranon të marrë përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara.*

Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga komisioni i posaçëm i shpronësimit, por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrin e titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "korrespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin". Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.

5.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private, që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", apo... "kërkojmë nga ana e subjekti kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij...", bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura.

Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

Së gjashti, bazuar mbi shkresën nr. 922/7 prot., datë 19.07.2024, ku ASHSH i drejtohet ARRSH-së konstatohet një fenomen i ri, ai i pranimit me kusht të kërkesës.
Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* në asnjë rast nuk parashikohet pranimi me kusht i një kërkese. Në lidhje me vendimmarrjen e ASHSH-së, ligji shprehet qartë në nenin 12 "Kthimi pa veprim dhe refuzimi i kërkesës" dhe nenin 13 "Pranimi i kërkesës", ku specifikohen qartazi arsyet dhe kushtet për secilin rast.
Pra, kemi dy përfundime nga ana e kësaj Agjencie për kërkesat, ose pranohet dhe procedohet me hapat e mëtejshëm të parashikuara nga ligji, ose refuzohet dhe ndërpritet si procedurë.
Ky veprim, i pranimit me kusht nuk gjen vend dhe vjen në kundërshtim me nenin 12 dhe 13 të ligjit të mësipërm dhe konsiderohet si tejkalim i kompetencave ligjore që ka ky institucion.

Së shtati: Nga auditimi i dosjes, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vendimin e Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, në kundërshtim me Nenin 3, pika 6 e aktmarrëveshjes së lidhur mes ASHSH dhe ARRSH-së, si dhe pengon në zbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30-ditëve nga data e marrje së vendimit. Bazuar në akt-marrëveshjen e cituar më sipër, ne nenin 3 përcaktohen "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6... "Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet që të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Legjislacionin në fuqi".

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.; datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:
7. Pretendimi i subjektit: *KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje duke arsyetuar se, KPSH e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket inicimit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucion i detyruar për zbatimin e këtij vendimi Sikurse ngarkohet edhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM-së Nr. 662, datë 13.10.2022, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut i të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin" ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit. Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.*
7.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se: Së pari, referuar nenit 11, pika 5, germa "c" të ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar, ASHSH ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ecurinë e procesit të shpronësimeve. Së dyti, sipas akt-marrëveshjes me

subjektin kërkues, nga e cila krijohen të drejta dhe detyrime për palët, ASHSH ka detyrimin të sigurojë që ASHK të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, pas ndryshimit të statusit juridik dhe konfiguracionit të pasurive të shpronësuara. Së treti, nga verifikimi në fazën e terrenit rezultoi se ASHSH nuk i ka përcjellë ASHK-së VKM-në e shpronësimit, për hedhjen e gjurmës së projektit në hartat kadastrale dhe ndryshimin e kartelave. Ky mosveprim përbën mosrespektim të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe nga akt-marrëveshja. **Për sa më sipër pretendimi juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit**.

Praktika e shpronësimit u përgatit nga: Z. Kastriot Gurra, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e Kryetarit të KPSH dhe anëtarët e KPSH Z. Albian Marku, me detyrë arkitekten, Zj. Ilirjana Hasanllari, me detyrë juriste, Znj. Entela Bytyçi, me detyrë inxhiniere, Znj. Klodiana Lika, me detyrë ekonomiste, Znj. Orlanda Murati, me detyrë juriste, Znj. Fabjan Cenaj, me detyrë ekonomist.

XXXIII. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në me Nr. 795, datë 22.09.2015, Unaza Lindore, Tiranë Loti 2, Viti 2023", Bashkia Tiranë" finalizuar me VKM nr. 726, datë 16.09.2020 në shumën 15,280,707 lekë.

Projekti dhe argumentimi ligjor nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar

Me anë të shkresës nr. 6810/1 prot., datë 03.12.2022, (protokolluar në ASHSH, me nr. 8461 Prot., datë 04.12.2020), ARRSH, (këtu e në vazhdim ARRSH) paraqet kërkesën për shpronësim, (për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 726, datë 04.12.2020), "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i objektit "Unaza Lindore Tiranë Loti 2" (disa ndryshime dhe shtesa, VKM nr.726, datë 16.09.2020).

Bazuar në Nenin 8, pika c, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për realizimin e projekteve dhe të investimeve, që paraqesin interes ose shtrirje territoriale kombëtare, ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji të energjetikes, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut".

Ngritja e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit

Me shkresën nr. 13 prot., e datës 22.01.2021, është lëshuar Urdhri nr. 5 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, z. Erlis Hereni, për krijimin e Komisionit të Posaçëm, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

Komisioni është i përbërë nga: [Kryetar – Z. Erlis Hereni, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm; Anëtar – Znj. Etleva Malile, me detyrë juriste; Anëtare – Znj. Aleksandra Tona, me detyrë juriste; Anëtare- Znj. Besmira Nuredini, me detyrë ekonomiste; Anëtare – Znj. Vjollca Bazaiti, me detyrë inxhiniere].

Hapat e marra nga Autoriteti Rrugor Shqiptar

Me shkresën me nr. 13/1 prot., datë 19.02.2021, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit në ASHSH, i është drejtuar ARRSH-së, për "Plotësim dokumentacioni", pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i këtij projekti janë konstatuar mangësitë si vijon:

- Mungon projekti i zbatimit i miratuar;
- Mungojnë lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit;
- Gjithë dokumentacioni bashkëlidhur shkresës së sipërcituar është i pavulosur nga subjekti kërkues;

- Nuk është argumentuar se përse kërkohen të bëhen këto shtesa dhe ndryshime dhe përse nuk janë bërë me VKM-në me nr.726, datë 16.09.2020;
- Mungojnë konfirmimet nga ASHK (kartelat, HTR, anekset e kartelave, pasi në dosje janë dokumentacioni i ardhur nga qytetarët);
- Nuk ka argumentim ligjor përse kjo kërkesë ka ardhur tani edhe ose VKT është i vitit 2018;
- Për pasurinë nr. 40/7/1, që i korrespondon nr. 7 në tabelën e shpronësimit, sipas relacionit të ARRSH konfirmohet, se për këtë pasuri është shpronësuar me VKM-në me nr. 795, datë 22.09.2015. Nga sa rezulton, konstatohet nga kjo VKM se, Fadil Fahri Selmanllari, është shpronësuar për pasurinë nr. 40/70, për 117 m2 banesë, sipas tabelës nr.4, me nr. rendor 5, si dhe për pasurinë nr. 40/7/1, është shpronësuar për 250 m^2, "truall", sipas tabelës nr.3, me nr. rendor 9. Pra, sipas këtij konstatimi rezultoi se janë dy pasuri të ndryshme, për të cilat subjekti është shpronësuar që në Vitin 2015. Pasuria që ka paraqitur subjekti kërkues (ARRSH), mban datë lëshimi 17.08.2017, datë për të cilën pronar për këtë pronë rezulton pronari "shtet"... Të hiqet nga tabela e shpronësimit:
- Për pasuritë me nr. 236/129 si dhe nr.868/15, 185/35 kartelat duhen të 3-muajve të fundit nga momenti i kërkesës për shpronësim.
- Për pasurinë me nr. 236/129 sipas kërkesës së kartelës së pasurisë rezulton me sipërfaqe totale prej 275 m^2 dhe rezulton të jetë shpronësuar me VKM me nr.795, datë 22.09.2015, për 172 m^2, ndërkohë që sipas tabelës së shpronësimit vjen edhe për 129m2.Të verifikohet dhe të saktësohet.
- Për pasurinë me nr. 868/3, që i korrespondon nr. 2 në tabelën e shpronësimit, rezultoi se është shpronësuar për këtë pasuri për 973m^2 me VKM nr.795, datë 22.09.2015, ndërkohë që tani vjen për 657 m^2. Të sqarohet nëse është sipërfaqe shtesë.
- Për pasurinë me Nr.165/9, që i korrespondon nr.4 n tabelën e shpronësimit, me sipërfaqe totale prej 3400m2, rezulton të jetë shpronësuar me VKM-në me nr.795, datë 22.09.2015 për 2175m^2, ndërkohë që sipas tabelës së shpronësimit vjen edhe për 3400m^2.Të verifikohet dhe saktësohet.
- Në relacionin bashkëlidhur kërkesës për shpronësim, subjekti kërkesës ARRSH shprehet se kërkon shtesa dhe ndryshime në VKM-në me nr.795, datë 22.09.2015, ku kërkon shpronësimin shtesë për 7 pasuri nga të cilat, rezultoi se janë plotësuar me konfirmimin e dokumentacionit të pronësisë nga ASHK Tirana Rurale 1, vetë 3 pasuri (868/15, nr.40/7/1 ndodhur në ZK 1604 nr. 236/129 në ZK 39760 dhe 4 pasuri të tjera (nr.185/35, nr.868/3, nr.165/9 dhe 170/1 janë në provës konfirmimi).

Rezultoi se subjekti kërkues vjen me kërkesë për ndryshimin e VKM-së për shpronësim, shumë kohë pasi ka dalë VKM fillestare e Vitit 2015, si dhe pa dokumentacionin e plotë të pronësisë, të pasurive pronë private, në të cilat shprehet se janë prekur nga projekti i sipërcituar, ose pa e argumentuar përse këto shtesa vijnë pas një afati kohor relativisht të gjatë.

Dokumentacioni plotësues sa më sipër, duhet që të paraqitet në ASHSH, për shqyrtim brenda 30-ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Nuk ka afat për plotësimin e dokumentacionit dhe kthimin

Me shkresën me Nr. 1941/1 prot., datë 17.05.2021, e administruar në ASHSH me Nr. 13/2 prot., datë 13.05.2021, ARRSH i kthen përgjigje ASHSH-së, bashkëlidhur edhe dokumentacioni i kërkuar.

Urdhri me Nr. 61, datë 18.05.2021, ka një ndryshim në Urdhrin Nr. 5, datë 22.01.2021 të Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.726, datë 16.09.2020 "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga projekti "Unaza Lindore Tiranë, Loti 2".

Me shkresën me Nr. 13/4 prot., datë 18.06.2021, ASHSH i drejtohet sërish ARRSH me kërkesë për "Plotësim dokumentacioni".

Me shkresën me Nr. 6483 prot., datë 05.07.2021, e administruar në ASHSH me Nr. 13/5 prot., datë 08.07.2021, ARRSH I kthen sërish përgjigje ASHSH-së, bashkëlidhur edhe dokumentacioni i kërkuar.
Me shkresat me Nr.13/6 prot., datë 21.09.2021 dhe 13/7, datë 27.10.2021, i kërkon ARRSH-së plotësimin e dokumentacionit, duke i lënë edhe një afat 30-ditor, nga marrja në dijeni e shkresës së fundit, për vënien në dispozicion të praktikës së kërkuar.
Me shkresën me Nr. 9541 prot., datë 22.10.2021, e administruar në ASHSH me Nr. 13/8, datë 28.10.2021 ARRSH i kthen përgjigje ASHSH-së, duke vënë në dispozicion edhe dokumentacionin e kërkuar.

Miratimi i kërkesës për shpronësim

Me shkresën me Nr. 13/9 prot., datë 03.11.2021, *"Njoftim për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik"*.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është në shumën 15,280,707 lekë.

Mes ASHSH-së, në cilësinë e autoritetit përgjegjës dhe ARRSH-së, në cilësinë e subjektit kërkues është lidhur aktmarrëveshje e protokolluar në ASHSH me Nr. 13/10 prot. dhe e nënshkruar mes palëve më datë 05.11.2021.
Me shkresën me Nr. 13/11 prot., datë 15.11.2021, ASHSH i drejtohet Qendrës së Publikimeve Zyrtare, me kërkesën për "publikim kërkese për shpronësim".
-Me shkresën me Nr. 13/12 prot., datë 15.11.2021 është njoftuar shtetasi Zenel Hajdar Balla, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme, pronë private, numër 165/9, e llojit "tokë Arë", ndodhur në zonën kadastrale me nr. 3550;
Sipërfaqja e truallit që do të shpronësohet është 1225m2 x 230 lekë/m2 = 281,750 lekë.
Vlera totale e shpronësimit është 281,750 lekë;
-Me shkresën me nr. 13/12 prot., datë 15.11.2021 është njoftuar shtetasi Ejup Rexhep Iskurti, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme pronë private, numër 170/16-ND, lloji "ndërtesë", ZK nr. 3976.
Sipërfaqja e ndërtesës që shpronësohet është 212 m2 x 66,500 lekë m2 = 14,098,000 lekë.
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 14,098,000 lekë.
- Me shkresën me nr. 13/12 pot., datë 15.11.2021 është njoftuar shtetasi Hasan Musa Qordja, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme pronë private me nr. 170/3, lloji "Tokëtruall", ZK nr.3550;
Sipërfaqja e tokës "truall" që shpronësohet është 53 m^2 x 457lekë m^2 = 24,221 lekë.
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 24,221 lekë.
- Me shkresën me nr. 13/12 pot., datë 15.11.2021 është njoftuar shtetasi Hasan Musa Qordja, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme pronë private me nr. 170/2, lloji "Tokë Arë", ZK nr. 3550;
Sipërfaqja e tokës truall që shpronësohet është 642 m^2 x 448lekë m^2 = 287,616 lekë.
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 287,616 lekë.
-Me shkresën me nr. 13/12 pot., datë 15.11.2021 është njoftuar shtetasi Bajram Haxhi Zhllima, për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme pronë private me nr. 868/15, lloji "TokëArë", ZK nr. 1604;
Sipërfaqja e tokës Arë që shpronësohet është 1315 m^2 x 448 lekë/m^2 = 589,120 lekë.
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 589,120 lekë.
- Me shkresën me Nr. 129 prot., datë 24.01.2022, ASHSH i dërgon *"propozimin për projektvendimin për shpronësim"* MIE, së bashku me relacionin shpjegues.
VKM me Nr. 221 datë 13.04.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 795, datë 22.09.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor unaza lindore Tiranë (lotët 1,2), të ndryshuar".

Me shkresën me Nr. 129/2 prot., datë 19.04.2021, ASHSH i kërkon ARRSH-së, marrjen e masave për njoftimin e pronarëve të shpronësuar sipas VKM-së.
Me shkresën me Nr.129/3 prot., datë 19.04.2022, ASHSH njofton ARRSH-në dhe subjektet që preken nga shpronësimi:
- Ejup Rexhep Iskurti, me vlerën totale të shpronësimit, në shumën 14,098,000 lekë;
- Bajram Haxhi Zhllima, me vlerën totale të shpronësimit, në shumën 589,120 lekë;
- Hasan Musa Qordja, me vlerën totale të shpronësimit, në shumën 287,616 lekë;
- Hasan Musa Qordja, me vlerën totale të shpronësimit, në shumën 24,221 lekë;
- Zenel Hajdar Balla, me vlerën totale të shpronësimit, në shumnën 28,175 lekë;

Me shkresën nr. 129/4 prot. datë 27.04.2022 ASHSH i specifikon ARRSH-së, për pagesën e anëtarëve të KPSH.

Nga auditimi i dosjes së këtij projekti u konstatuan problematikat si më poshtë vijon:
Së pari, është konstatuar se nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", neni 11, pika 5, germa d e cila parashikon se "*ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban*".
Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen.
Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" e cila parashikon se "*Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj,* ***duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

Së dyti, konstatohet se në shkresat nr. 922/2 prot. të datës 12.07.2024 dhe nr. 922/4 prot. të datës 19.07.2024 dhe 922/6, datë 19.07.2024, ASHSH ka përcaktuar si afat kohor, për të njoftuar për mungesa dokumentacioni subjektin ARRSH, afatet 30 ditore.
Veprim ky i bazuar, në Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 12, pika 2 ku citohet se "*Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nga kërkuesi nuk është i plotë ose i saktë ASHSH i kthen menjëherë pa veprim kërkuesit të shpronësimit kërkesën e shpronësimit dhe dokumentacionin shoqërues të tij,* ***duke caktuar dhe afat të posaçëm për plotësimet përkatëse.***
Megjithatë, një veprim i tillë vjen në kundërshtim me nenin 12 pika 3 të këtij ligji ku parashikohet se "*Kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten të plotësuar* ***në afatin e caktuar*** *ose gjenden të pambështetur, për mungesë të shkakut ose të kushteve të shpronësimit sipas këtij ligji, kërkesa refuzohet nga ministria dhe i njoftohet menjëherë kërkuesit të Shpronësimit*".
Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës të një akti normativ i cili duhet të përcaktojë një afat konkret të pranueshëm, për kohën që i duhet subjektit kërkues që të paraqesë dokumentet e sakta ose të munguara.

Në gjykimin e grupit të auditimit, një akt i tillë do kishte karakter shtrëngues ndaj subjektit që kërkon shpronësimin si dhe do respektonte ligjin nr. 44/2015 "Kodit të Procedurave administrative", neni 18, pika 2 për parimin e deburokratizimit dhe eficencës, ku parashikohet se: "*Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.*"

<u>Së treti,</u> është konstatuar se në relacionin e hartuar nga ASHSH nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve. Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues ARRSH dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen detyrimet e ARRSH-së, përmendet dhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore "Autoritetit Rrugor Shqiptar *duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore* ", por në asnjë shkresë si në kërkesën fillestare të bërë nga ARRSH për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje dhe as në relacionin e mësipërm nuk përmendet një afat i qartë.
Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" neni 20, pika 1, germa a e cila parashikohet se: "*Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*
Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, ***afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve*** *ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilën citohen dhe dokumentet që kërkohen nga shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 10 të këtij ligji.*"
Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se "*Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit*".

<u>Së katërti,</u> konstatohet se në dosjen e projektit nuk përmbahet asnjë dokument në lidhje me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për financim të projektit, po ashtu dhe me burimin e fondeve për shpronësimin e pronarëve.
Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 11 datë 12.02.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", i ndryshuar, neni 10, pika 1, germa c, e cila parashikon se: "*Kërkesa për shpronësim duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion:....****Dokumentacioni lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit.***
Veprim në kundërshtim me VKM nr. 127, datë 23.03.2000 "*Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" pika 1 e cila parashikon se: "*Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse*

*kërkesën për shpronësim, **e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr.1 dhe dokumentet standarde**, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.*

Së pesti, konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, ARRSH-së procedurën e realizimin të njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim.
Veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, germa e, e cila parashikon se: "*Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë*
*pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, **si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës**.*"
Si dhe, në kundërshtim me VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: "*Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim, **e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr. 1 dhe dokumentet standarde**, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.*".

Së gjashti, konstatohet se në dosjen e projektit procesverbalet e mbledhjeve të KPSH, në të gjitha rastet, janë pa numër protokolli.
Ky veprim është në mospërputhje me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18 i cili parashikon se: "*Procesverbale te mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshëm. **Ato protokollohen**.*".

Së shtati: Nga auditimi i dosjes, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjellë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vendimin e Këshillit të Ministravë, për shpronësimin, në kundërshtim me Nenin 3, pika 6 e akt-marrëveshjes së lidhur mes ASHSH dhe ARRSH-së, si dhe pengon në zbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30-ditëve nga data e marrje së vendimit. Bazuar në akt-marrëveshjen e cituar më sipër, ne nenin 3 përcaktohen "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6... "Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet që të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Legjislacionin në fuqi".
Praktika e shpronësimit u përgatit nga: Z. Erlis Hereni, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e anëtarit të KPSH dhe anëtarët e KPSH **Znj. Etleva Malile**, me detyrë juriste, **Znj. Aleksandra Tona**, me detyrë juriste, **Znj. Besmira Nuredini**, me detyrë ekonomiste, **Znj. Vjollca Bazaiti**, me detyrë inxhiniere.

XXXIV. Dosja e procedurës së shpronësimit për interes publik me objekt "Përmirësimi i shtresave rrugore, rruga "Andrea Stathi", Bashkia Korçë" finalizuar me VKM nr. 758, datë 13.12.2024 në shumën *1,545,197 lekë*.

Projekti dhe argumentimi ligjor nga ana e Bashkisë Korçë

Me anë të shkresës nr. 2217 Prot., datë 12.03.2024, (protokolluar në ASHSH, me nr. 492 Prot., datë 20.03.2024), Bashkia Korçë paraqet kërkesën për shpronësim, të pronave të paluajtshme që preken nga realizimi i projektit "Përmirësimi i shtresave rrugore, Rruga "Andrea Stathi", Korçë. Bazuar në Nenin 8, pika ç, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për realizimin e projekteve dhe të investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, infrastrukturës, në shërbim e në interes të publikut".
Ky projekt është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak, me nr. 131, datë 28.09.2023, me objekt: "Për fillimin e procedurave për të kërkuar shpronësimin për interes publik të pasurive që preken nga realizimi i projektit sistemim i rrugës "Andrea Stathi".

Ngritja e Komisionit të Posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit

Me shkresën nr. 492/1 prot., e datës 21.03.2024, është lëshuar Urdhri nr. 66, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH-së, z. Kastriot Gurra, për krijimin e Komisionit të Posaçëm, për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.
Komisioni është i përbërë nga: [Kryetar – Z. Kastriot Gurra, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm; Anëtar – Z. Albian Marku, me detyrë arkitekt; Anëtare – Zj. Ilirjana Hasanllari, me detyrë juriste; Anëtare- Znj. Blerina Gjonaj, me detyrë juriste; Anëtare – Z. Spartak Kodra, me detyrë ekonomist].

Hapat e marra nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me shkresën me nr. 492/2 prot., datë 15.04.2024, ASHSH, i është drejtuar Bashkisë Korçë, me kërkesën për "Plotësim dokumentacioni", pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i këtij projekti janë konstatuar mangësitë si vijon:
- Në kërkesën për shpronësim të evidentohet saktë emri i projektit, pasi në VKB-në me Nr. 131, datë 29.09.2023 është miratuar projekti "Sistemim i rrugës Andrea Stathi", ndërsa në kërkesën për shpronësim është cituar "Përmirësimi i shtresave rrugore", "Andrea Stathi".
- HTR është jashtë afatit. Të risillet HTR dhe kartela brenda 3-mujorit të fundit.
- Mungon burimi i garantimit të fondeve.
- Duhet të shpreheni nëse ndërtesa me Nr. 17/1277 N.D. preket nga shpronësimi si dhe të pasqyrohet ky shënim në tabelën paraprake për shpronësim.
- Të sqarojë nëse ka pasuri të tjera që preken nga gjurma e rrugës, duke përfshirë edhe pasuritë shtet, shoqëruar me dokumentet nga ASHK. Nëse ka të përfshihen në listën dhe planimetrinë e shpronësimit.
Dokumentacioni plotësues duhet që të paraqitet në ASHSH, brenda 30-ditëve nga momenti i marrjes së kësaj shkrese.
Me shkresën me nr. 2217/2 prot., datë 28.05.2024, e administruar në ASHSH me Nr.492/3 prot., datë 03.06.2024, Bashkia Korçë i kthen përgjigje "Plotësim dokumentacioni" ASHSH-së, bashkëlidhur edhe dokumentacioni.
Me shkresën me nr. 2217/3 prot., datë 28.05.2024, Bashkia Korçë i është drejtuar ASHSH-së, me "Kërkesën për shpronësimin për interes publik të pronave të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemimi i rrugës" Andrea Stathi".
Me shkresën me Nr. 2217/3 prot., e administruar me nr. 492/4, datë 18.06.2024, Bashkia Korçë i është drejtuar ASHSH-së, me kthim përgjigje, "plotësim dokumentacioni", duke vënë në dispozicion: *"Dokumentet e pronësisë të rifreskuara dhe përkatësisht, kartelën e pasurisë së paluajtshme dhe HYR fragment i hartës kadastrale për pasurinë me nr. 7/292 e ndodhur në zonën kadastrale me nr.8564."*
Me "e-mailin" e datës 24.06.2024, e administruar në ASHSH me nr. 492/5 prot., datë 24.06.2024, listën e objekteve, skanimin e tabelës së shpronësimeve.

Miratimi i kërkesës për shpronësim

Me shkresën me Nr. 492/6 prot., datë 24.06.2024, ASHSH i drejtohet Bashkisë Korçë, me "Njoftimin për pranimin e kërkesës për ***1,545,197 lekë*** shpronësimin me interes publik".
Vlera totale e shpronësimit është në shumën 1,545,197 lekë.
Mes ASHSH-së, në cilësinë e autoritetit përgjegjës dhe Bashkisë Korçë, në cilësinë e subjektit kërkues është lidhur akt-marrëveshje e protokolluar në ASHSH me Nr. 492/7 prot. dhe në Bashkinë Korçë me Nr. 5635/1 prot., datë 26.06.2024 dhe nënshkruar mes palëve më datë 24.06.2024.
Me shkresën me Nr. 492/9 prot., datë 05.07.2021, ASHSH i drejtohet Qendrës së Publikimeve Zyrtare, me kërkesën për "publikim kërkese për shpronësim".
Me shkresën me Nr. 492/10 prot., datë 05.07.2024, "Njoftim për shpronësim publik", ASHSH u është drejtuar shtetasve: Migena Jorgji Demirxhiu, Viollanda Enver Sutniko, Fatiko Enver Hamzai, Alfred Enver Hamzai, për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: "Përmirësimi i shtresave rrugore, rruga: "Andrea Stathi", vlerësimi për llojin "Truall", si më poshtë vijon:
- Zona kadastrale, nr.8564, numër pasurie 7/292 sipas kartelës së pasurisë:
- Truall llogaritur 181m2 x 8537 = 1,545,197 lekë;
Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,545,197 lekë.

Shtetasit Migena Demirxhiu, Viollanda Sutniko, Fatiko Hamzai, Alfred Hamzai, i janë drejtuar me ankimin e administruar në ASHSH me Nr. 492/11 prot., datë 18.07.2024, ku pretendojnë se përmes projektit janë prekur të drejtat e pronësisë së tyre.
Bazuar në procesverbalin e administruar në ASHSH me Nr. 492/12 prot., datë 02.08.2024 është mbledhur Komisioni i Posaçëm për Shpronësimin, lidhur me pretendimin që kanë hasur shtetasit e mësipërm, duke i orientuar që t'i drejtohen për zgjidhje të problematikës Bashkisë Korçë.
Me shkresën me Nr. 492/13 prot., datë 02.08.2024, ASHSH i ka kthyer përgjigje lidhur me pretendimin shtetases Migena Demirxhiu, duke vënë në dijeni Bashkinë Korçë, ndërsa me shkresën me Nr. 492/14 prot., datë 09.08.2024, ASHSH, nisur nga fakti që znj. Migena Demirxhiu nuk ka marrë njoftim, i është drejtuar Bashkisë Korçë, për të bërë të mundur njoftimin dhe marrjen e masave.
Me procesverbalin me Nr. 492/15 prot., datë 19.08.2024, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, pas përfundimit të afatit 15 ditor të publikimit të kërkesës, pas trajtimit të ankesës së shtetases Migena Demirxhiu, vendosi: Miratimin e propozimit, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, "Sistemimi i rrugës", "Andrea Stathi", Bashkia Korçë, me vlerë totale të shpronësimit 1,545,197 lekë.
Me shkresën me Nr.492/16, datë 19.08.2024, ASHSH i dërgon propozimin e projektvendimit për shpronësim MIE, bashkëlidhur edhe relacioni.
Me procesverbalin e Nr. 492/17 prot., datë 25.10.2024, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, është zhvilluar mbledhja për shqyrtimin e kërkesave të lëna nga kryeministria, mbi projektin, ku komisioni vendosi që të marrë në konsideratë komentet e lëna, dhe të miratojë tabelën për shpronësim pa shënimet përkatëse.
VKM-ja me Nr.758, datë 13.12.2024 "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit "Sistemim i rrugës "Andrea Stathi", Bashkia Korçë", e cila është administruar në ASHSH me nr. 492/18 prot. datë 17.12.2024.
Me shkresën përcjellëse me Nr. 492/19 prot., datë 18.12.2024, ASHSH i ka dërguar VKM-në me Nr. 758, datë 13.12.2024 Këshillit të Ministrave.
Me shkresën me Nr. 492/20 prot., datë 18.12.2024, ASHSH u ka dërguar VKM-në shtetasve të shpronësuar Migena Demirxhiu, Viollanda Sutniko, Fatiko Hamzai, Alfred Hamzai,

Me shkresën nr. 492/21 prot. datë 18.12.2024, ASHSH i specifikon Bashkisë Korçë, për pagesën e anëtarëve të KPSH.

Nga auditimi i dosjes së këtij projekti u konstatuan problematikat si më poshtë vijon:

Së pari, është konstatuar se nga ana e Sektorit të Negocimit, pjesë e Drejtorisë së Asistencës Ligjore dhe Negocimit, ka mungesë në përcaktimin e rregullave të hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara. Ky sektor vepron vetëm brenda kornizave të ligjit nr.8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", neni 11, pika 5, germa d e cila parashikon se "*ASHSH ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban*".

Ky fenomen ka ardhur si pasojë e mungesës së një akti normativ të miratuar, që të përcaktojë rregullat e hollësishme lidhur me mënyrën e negocimit ndërmjet ASHSH dhe pronarëve që shpronësohen.

Mungesa e negocimit nga ana e ASHSH ndaj pronarëve që shpronësohen ka ardhur në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" e cila parashikon se "*Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, **duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.***

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot.,datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr.prot., pa datë, si më poshtë vijon:

1. Pretendimi i subjektit: *Komisioni i Posacëm i Shpronësimeve, sqaron se: Nëpërmjet observacioneve të depozituara me shkresën nr. 1142/1 Prot., datë 07.11.2025, kemi paraqitur qëndrimin tonë në lidhje me procedurat e negociimit në përputhje me nenin 11, pikën 5, gërma d), të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në të cilin parashikohet se: "d) ka të drejtë të hyjë në negociata me subjektet që shpronësohen, për sa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së kësaj vlere. Rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban". Bazuar në VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerje apo miratim të akteve normative.*

Konkretisht sikurse kemi sqaruar, në interpretim të kësaj dispozite, ASHSH ka të drejtë, por jo domosdoshmërisht detyrim të negocioj në çdo rast me subjektet që shpronësohen, përsa i përket vlerës së shpronësimit dhe afatit të shlyerjes së saj. Për sa i përket qëndrimit tuaj ku citoni se, "Nga momenti i themelimit të ASHSH, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj Agjencie dhe Ministrisë së linjës". Ju informojmë se, nga ana e ASHSH në mungesë të një akti nënligjor lidhur me rregullat e hollësishme për mënyrën e negocimit me subjektet e shpronësuara, janë ndërmarrë veprime lidhur me nevojën për ndryshime ligjore, konkretisht nëpërmjet Memos Nr.

874/2/Prot., datë 13.11.2023, "Mbi problemet e hasura në praktikë nga legjislacioni në fuqi në fushën e shpronësimit për interes publik", ASHSH ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për mundësinë e ndryshimit të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe ndryshimin/përditësimin e akteve nënligjore përkatëse, duke evidentuar edhe nevojën për hartimin e një akti normativ mbi ndjekjen e procedurave përkatëse të negociimit. Procesi i diskutimit dhe përpunimit të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore vazhdon në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të finalizuar përmirësimet dhe përditësimet e nevojshme. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë qëndrimin e grupit të auditimit, shpreh gadishmërinë që në vijim të marrë masa për hartimin e një draft- VKM për ndjekjen e procedurave të negociimit, duke e përcjellë pranë institucionit epror propozimin për hartimin e aktit përkatës mbi procedurat e negocimit.

1.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga ana e grupit të auditimit theksohet se pavarësisht shkresave të dërguara drejt MIE, konstatohet se nuk ka asnjë ndryshim nga momenti i themelimit të ASHSH-së, e deri në momentin e periudhës objekt auditimi. Ky fakt tregon se ka një mungesë të thellë bashkëpunimi mes kësaj agjencie dhe Ministrisë së linjës. *Për këtë arsye pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë.*

Së dyti, është konstatuar se në relacionin e hartuar nga ASHSH nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve. Në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues ARRSH dhe ASHSH, në nenin 4 pika 3, ku parashikohen detyrimet e ARRSH-së, përmendet dhe realizimi i projektit brenda afateve ligjore "Autoriteti Rrugor Shqiptar *duhet të fillojë dhe të përfundojë punimet për projektin dhe investimin, për realizimin e qëllimit të shpronësimit, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore"*, por në asnjë shkresë si në kërkesën fillestare të bërë nga ARRSH për nisjen e projektit, as në akt-marrëveshje dhe as në relacionin e mësipërm nuk përmendet një afat i qartë.

Ky veprim vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* nr.8561 datë 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"* neni 20, pika 1, germa a e cila parashikohet se: *"Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin i paraqet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:*

Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, ***afatin e fillimit e të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve*** *ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në të cilën citohen dhe dokumentet që kërkohen nga shkronjat "a" deri në "dh" të nenit 10 të këtij ligji."*

Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, sjell dhe pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", ku citohet se *"Në rastet kur subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, brenda 3 muajve nga data e mbarimit të afateve përkatëse të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nuk fillon apo përfundon punimet për projektet dhe investimet ose për realizimin e qëllimit për shkak të të cilit është kryer shpronësimi, ky shpronësim quhet i pavlefshëm. Brenda afatit tremujor të lartpërmendur, kryesisht apo me kërkesë të argumentuar të subjektit në favor të të cilit është bërë shpronësimi, Këshilli i Ministrave mund të vendosë shtyrjen e afatit të fillimit dhe përfundimit të punimeve apo realizimit të qëllimit të shpronësimit".*

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 271/26 prot., datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:

2. Pretendimi i subjektit: *Bazuar në VKM-në me nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin", Kreu III, pika 5, gërma "e", parashikohet se: Agjencia Shtetërore për shpronësimin "Mbështet ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban në hartimin e akteve ligjore apo nënligjore për shpronësimin", në respektim të këtij parashikimi ASHSH* ndihmon Ministrinë përgjegjëse në hartimin e akteve normative, pasi edhe në strukturën organizative të ASHSH, nuk ka një strukturë përgjegjëse për nxjerrje, apo miratim të akteve normative. Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar, ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm, por garantojmë se do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast në realcionin shoqërues të projektvendimit, si dhe aktmarrëveshjen e lidhur midis palëve do të përcaktohet afati për fillimin dhe mbarimin e punimeve.

2.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Dokumentacioni mbështetës i paraqitur na ASHSH e pasqyron afatin e përfundimit të punimeve. Megjithatë theksojmë se, akti përfundimtar nga ju si institucion ku përcaktohet afati është Akt-marrëveshja e lidhur mes jush dhe subjekti kërkues, në këtë rast ARRSH. Ky akt është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për të dyja palët. Në çdo rast duhej të shkruhej afati i parashikuar. *Për këtë arsye pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë.*

Së treti, konstatohet se ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues, Bashkisë Korçë procedurën e realizimin të njoftimit. Kjo vjen si pasojë e mungesës së verifikimit të paraqitjes së këtyre adresave së bashku me kërkesën për shpronësim.

Veprim në kundërshtim me kërkesat e ligjit 8561, datë 22.12.1999 (i ndryshuar), nenit 10, pika 1, germa e, e cila parashikon se: *"Lista e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, lista e pronarëve, pasuritë private të të cilëve zhvlerësohen për shkak të shpronësimit, si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë*

pronë private që kërkohet të shpronësohen, së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre, me parashikimet përkatëse për vlerësimin e këtyre pasurive dhe të drejtave, ***si dhe adresat dhe vendbanimi më i fundit i njohur i pronarëve dhe personave të tretë përkatës.***"

Si dhe, në kundërshtim me VKM nr.127, datë 23.03.2000, pika 1 si dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, e cila parashikon se: *"Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë përkatëse kërkesën për shpronësim,* ***e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin e parashikuar në formularin nr. 1 dhe dokumentet standarde****, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.".*

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot., datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:

3. Pretendimi i subjektit: Sa i përket qëndrimit të auditimit shprehim për KLSH se, sikurse kemi bërë me dije edhe më sipër në lidhje me shënimin *"Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij"*, është një praktikë pune e gjetur dhe e mbartur ndër vite pëprara krijimit të ASHSH, kjo dhe për arsyen e problematikave të sistemit adresor që ka në vendin tonë, të cilat jo gjithmonë janë të sakta, ndaj ky shënim është përcaktuar edhe në marrveshjen e lidhur midis ASHSH dhe subjektit kërkues. Subjekti kërkues pranon të marrë përsipër procedurat e njoftimit të subjekteve të shpronësuara. Gjithashtu sqarojmë se, shkresat mbi njoftimin e subjekteve të shpronësuara nuk hartohen nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit por përgatiten nga sekretaria teknike në zbatim të pikës 13, 14, 15 të Vendimit nr. 147, datë 31.3.2000 "Për

rregullat dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", si dhe në pikën 4 të urdhrit të titullarit të institucionit "Për krijimin e komisionit të posaçëm të shpronësimit" përcaktohet se, "*korespondenca që do mbahet për realizimin e kësaj procedure shpronësimi, do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe mbi nënshkrimin e tij, do të vendoset vula e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin*".
Pavarësisht sa më sipër, sikurse kemi cituar më sipër ASHSH nuk ka kaluar auditim të mëparshëm dhe nuk është njohur më parë me këtë gjetje, por në çdo rast në vijim të punës së mëtejshme do e përmirësojmë këtë praktikë dhe në çdo rast njoftimet do të bëhen sipas adresës së pronarit të shpronësuar.
3.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se mënyra e njoftimit të subjekteve private që preken nga procesi i shpronësimit është një detyrim i përcaktuar qartë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përgjegjësia për kryerjen e njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarëve të shpronësuar nuk mund të delegohet tek subjekti kërkues. Praktika e lënies së shënimit që njoftimi, "në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar", kërkojmë nga ana e subjektit kërkues marrjen e masave për njoftimin e tij, bie ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe me detyrimin e organit publik përgjegjës për procedurën e shpronësimit, për të garantuar informimin e plotë dhe korrekt të palëve të prekura. *Për sa më sipër, observacioni juaj nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

Së katërti: Nga auditimi i dosjes, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjellet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vendimin e Këshillit të Ministrave, për shpronësimin, në kundërshtim me Nenin 3, pika 6 e aktmarrëveshjes së lidhur mes ASHSH dhe Bashkisë Korçë dhe pengon në zbatimin e nenit 25 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30-ditëve nga data e marrje së vendimit. Bazuar në akt-marrëveshjen e cituar më sipër, në nenin 3 përcaktohen "Të drejtat dhe detyrimet e ASHSH", pika 6... "Agjencia Shtetërore e Kadastrës duhet që të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale pas ndryshimit të konfiguracionit dhe statusit juridik të pasurive të shpronësuara. Gjithashtu, këto pasuri duhet të regjistrohen në emër të subjektit kërkues, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Legjislacionin në fuqi".

Lidhur me gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 277/26 prot., datë 25.02.2026, është observuar nga funksionarët e ASHSH, me anë të shkresës pa nr. prot., pa datë, si më poshtë vijon:
4. Pretendimi i subjektit: KPSH e kundërshton përsëri këtë gjetje, me arsyetimin se, e përfundon punën e saj me miratimin e procedurës së shpronësimit. Sa i përket iniciemit të kërkesës nga ASHSH drejtuar ASHK, vetë ASHK në respektim të nenit 25 të Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, i ndryshuar është institucioni i detyruar për zbatimin e këtij vendimi sikurse ngarkohet dhe në dispozitiv të vendimit të shpronësimit për ndjekje dhe zbatim. Institucioni që miraton VKM në rastin konkret Këshilli i Ministrave dërgon pranë ASHSH shkresërisht njohjen dhe zbatimin e vendimit, por të njëjtën procedurë ndjek edhe për të gjithë institucionet e ngarkuara në dispozitiv. Pra, nga ana e Këshillit të Ministrave dërgohet për zbatim dhe ndjekje të vendimit të shpronësimit ASHSH, ASHK subjekti kërkues, si dhe çdo institucioni të ngarkuar për zbatimin e vendimit. ASHK njihet zyrtarisht nga Këshilli i Ministrave me shkresat përkatëse. Në çdo rast ASHK ka dijeni zyrtarisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo VKM-je shpronësimi. Përpos shkresës nga Këshilli i Ministrave, ASHK me daljen e VKM i kërkohet zyrtarisht dhe nga subjekti kërkues zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 10, 11 dhe 12 të VKM Nr. 758/2024. Sqarojmë se, aplikimi pranë ASHK mbi përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 10, 11 dhe 12 të VKM Nr. 758/2024, është një shërbim që realizohet kundrejt pagesave zyrtare të ASHK dhe vetë ASHSH në zbatim të pikës 4, të kreut i të

Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 395, datë 13.05.2020 *"Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin"* ASHSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, Sa më sipër, në mungesë të fondeve përkatëse ky shërbim kërkohet nga subjekti kërkues, i cili është dhe përfituesi i procedurës së shpronësimit.

4.1 Qëndrimi i grupit të auditimit: Dokumentacioni mbështetës i paraqitur na ASHSH e pasqyron afatin e përfundimit të punimeve, megjithatë theksojmë se akti përfundimtar nga ju si institucion, ku përcaktohet afati është Akt-marrëveshja e lidhur mes jush dhe subjekti kërkues, në këtë rast Bashkia Korçë. Ky akt është titull ekzekutiv dhe ka fuqinë e ligjit për të dyja palët.

Në çdo rast duhej të shkruhej afati i parashikuar. *Për këtë arsye observacioni juaj nuk do të merret në konsideratë nga grupi i auditimit.*

Praktika e shpronësimit është kryer nga: Z. Kastriot Gurra, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e Kryetarit të KPSH dhe anëtarët **Z. Albian Marku**, me detyrë arkitekt, **Zj. Ilirjana Hasanllari**, me detyrë juriste , **Znj. Blerina Gjonaj**, me detyrë juriste, **Z. Spartak Kodra**, me detyrë ekonomist.

2.2. Të ndryshme, që do të dalin gjatë auditimit.

2.2.1. Zhvillimi i procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjet e prokurimit si dhe aksesit në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), konstatohet se:

Për Vitin 2021.

Më urdhërin me Nr. 51, datë 05.05.2021, titullari i autoritetit kontraktor ka urdhëruar "ngritjen e komisionit për prokurimet me vlerë të vogël", i përbërë nga:

- Znj. Alma Allkja, kryetar, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- Znj. Sidorela Qato, anëtar, me detyrë Specialiste, Sektori i Kontrollit të Dokumentacionit.
- Znj. Ilirjana Hasanllari, anëtar, me detyrë Specialist, Sektori i Negocimit dhe Asistencës Ligjore.

Urdhëri me Nr. 51, datë 05.05.2021, është ndryshuar fillimisht me Urdhërin me Nr. 128, datë 10.09.2021, ku Znj. Sidorela Qato, (Anëtare) zëvendësohet me Znj. Orlanda Murati. Kurse Znj. Ilirjana Hasanllari zëvendësohet nga Znj. Aleksandra Tona, ku siç argumentohet në pikën 2, të urdhrit, se zëvendësimi është bërë në mënyrë të përkohshme, për shkak se kanë rezultuar pozitiv me virusin "Covid-19".

Urdhëri me Nr. 128, datë 10.09.2021 është ndryshuar sërish me urdhërin me Nr. 134, datë 16.09.2021 nga titullari i autoritetit kontraktor, me përbërje si më poshtë:

- Znj. Alma Allkja, Kryetare, Përgjegjës, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Znj. Denada Dosti, anëtare, përgjegjës, Sektori i Asistencës ligjore;
- Znj. Sidorela Qato, anëtare, Specialiste, Sektori i Kontrollit të dokumentacionit;

Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve me vlerë të vogël.

Për periudhën e auditimit, 01.01.2021 - 31.12.2021, titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 140 prot., datë 19.05.2021, me lëndë: "Raportim mbi regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për Vitin 2021 për ASHSH-në", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë. Bazuar në shkresën sa më sipër, janë parashikuar ***në total 11 procedura "prokurimi me vlerë të vogël"***, me një shumë totale të parashikuar në vlerën 2,325,000 lekë pa TVSH.

- Me anë të Memos me Nr. 140/1 prot., datë 15.07.2021, Znj. Alma Allkja, kryetar komisioni, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, i është

Në total, për periudhën e audituar, Viti 2021 bazuar mbi shkresën me Nr. 140/7 prot., datë 25.12.2021, Titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, me lëndën: "Raportim mbi Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike, për Vitin 2021", ku janë zhvilluar **17** procedura me fond limit prej 6.120.000 lekësh pa TVSH, nga ku janë lidhur kontrata me vlerë 5,247,653 lekë pa TVSH ose 85.7% e Fondit Limit (***Pasqyruar në Aneksin Nr. 2, Tabela nr. 1***).
Nga auditimi i procedurave të prokurimit "blerje me vlerë të vogël", grupi i auditimit përzgjodhi mbi bazë risku, që të auditojë dosjet fizike si vijon.

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: *"Blerje bojra printeri/fotokopjesh".*
Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në ASHSH ka hartuar kërkesën me Nr. 454 prot., datë 23.09.2021, për "Pajisje të institucionit me tonera dhe printera", drejtuar Drejtorit të Përgjithshën të institucionit, Z. Erlis Hereni, duke kërkuar edhe nisjen e procedurës.
Me shkresën e datës 05.10.2021 është mbajtur procesverbal për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit "për bojra printer/fotokojesh/tonera", nga grupi i punës i përbërë nga Znj. Alma Allkja, kryetar Znj. Sidorela Qato, anëtar Znj. Denada Dosti. Janë marrë 3 oferta nga komisioni i prokurimit për blerjet e vogla, pas studimit të tregut nga Operatorët ekonomikë, si më poshtë vijon:
1. OE "READ 2000" SHPK., me NIPT L12321011H, në vlerën totale prej 662,000 lekë pa TVSH.
2. OE "ADASTRA" SHPK., me NIPT K81503063 B, në vlerën totale prej 678,520 lekë pa TVSH.
3. OE "Elda Dedja" PF tregëtar me NIPT J61820021C, në vlerën totale prej 694,500 lekë pa TVSH.
Sa më sipër, Komisioni për blerjet e vogla sugjeron se fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje bojëra printer/fotokopjesh", për ASHSH-në të jenë në vlerën 678,340 lekë pa TVSH.
Me Urdhrin e Prokurimit me Nr.151, datë 07.10.2021, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor ka miratuar procedurën e prokurimit, me objekt: "Blerje bojëra printer/fotokopjesh".
Me proces verbalin e datës 07.10.2021, nga AK Agjencia Shtetërore për Shpronësim është hartuar proces verbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimin për procedurën sa më sipër.
Me proces verbalin e datës 11.10.2021, Komisioni për prokurimet me vlerë vogël, lidhur me vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël "Blerje bojra printer/fotokopje", nga 24 operatorë ekonomikë pjesëmarrës, në klasifikimin përfundimtar janë renditur 15 operatorë ekonomikë, duke qenë se 9 prej tyre pas verifikimit në APP janë skualifikuar, me arsyen se rezultojnë se OE janë të përjashtuar nga prokurimet publike, apo oferta ekonomike në vlerën 50% më të ulët se fondi limit, apo kanë paraqitur vlerë më të lartë se fondi limit i përllogaritur nga AK. (Në dosjen fizike rezulton edhe buletini i Njoftimeve pubike me Nr.148, datë 11.10.2021).
Në përfundim të procedurës së vlerësimit, nga OE u kualifikuan 15 operatorë eknomikë, ku OE "Fatmira Hoxha" PF Tregtar me NUIS L46309801A, në vlerën 450,000 lekë pa TVSH renditet i pari në klasifikim në procedurën e prokurimit me vlera të vogëla me objekt "Blerje bojra printera/fotokopjesh".
Në faqen e APP është bërë edhe Njoftim fituesi PF "Fatmira Hoxha", por rezulton bazuar në procesverbalin e datës 13.10.2021, se ky operator është skualifikuar nga Komisioni i Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël", për shkak se në dokumentacionin e paraqitur dhe të verifikuar nga komisioni mungojnë:
- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, bashkëlidhur ftesës për ofertë;

drejtuar titullarit të institucionit (autoritetit kontraktor), me kërkesë për ndryshim të regjistrit të prokurimeve publike të ASHSH, për vitin 2021. Zërat që sugjeron për anulim janë:
a) "Furnizime me material të përgjthshme", kontratë mallrash, me fond limit 100,000 (njëqind një) lekë pa TVSH;
b) "Shërbime të riparimit dhe mirëmbajtjes për pajisje zyrash", kontratë shërbimi, me fond limit 100,000 (njëqind një) lekë pa TVSH.
c) "Blerje të materialeve dhe pajisjeve elektrike", kontratë mallarash, me fond limit 100,000 (njëqind një) lekë pa TVSH;
d) "Shërbime të ndryshme për zyrat", kontratë shërbimi, me fond limit 100,000 (njëqind një) lekë pa TVSH.
Referuar "Memos" anulimi është kërkuar, pasi institucioni ka pasur të nevojshme programet "Soft-ëare auto-cad" 2022 dhe "Civil 3 d 2022", bazuar në kërkesën e bërë me Memon nr. 302 prot., datë 15.07.2021, nga Sektori i Kontrollit të Dokumentacionit në ASHSH.
Në buxhetin e ASHSH-së është alokuar fondi për pajisjet elektronike dhe mobiljet e zyrave (sipas shkresës me Nr. 3985/3 prot., datë 25.06.2021 të Ministrisë së Infratsrukturës dhe Energjisë), është kërkuar që në regjistrin e parashikimeve të shtohen zërat me objekt prokurimi si më poshtë:

a) *"Blerje të pajisjeve hardëare TIK", kontratë mallrash, me fond limit 800,000 (tetëqindmijë) lekë pa TVSH.*
b) *"Blerje të pajisjeve të zyrës (mobilje, karrike), kontratë mallrash, me fond limit 800,000 (tetëqind mijë) lekë pa TVSH.*
c) *"Blerje të programeve "softëare" kontratë mallrash/shërbimesh, me fond limit 500,000 (pesëqind mijë) lekë pa TVSH.*

Titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 140/2 prot., datë 21.07.2021, me lëndë: "Dërgimi i Regjistrit të ndryshuar, të parashikimeve të prokurimeve publike për Vitin 2021 për ASHSH-në", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë. Bazuar në shkresën sa më sipër, janë parashikuar në total 10 procedura "prokurimi me vlerë të vogël", me një shumë totale të parashikuar në vlerën 4,025,000 lekë pa TVSH.
Me shkresën me Nr. 415 prot., datë 08.09.2021, Titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, me lëndën: "Raportim mbi Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike, për 4-mujorin e dytë Viti 2021".
Titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 140/3 prot., datë 13.10.2021, me lëndë: "Dërgim i Regjistrit të ndryshuar, të parashikimeve të prokurimeve publike, për Vitin 2021 për ASHSH-në", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, ku është shtuar zëri "Blerje karburanti".
Titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 140/4 prot., datë 08.11.2021, me lëndë: "Dërgim i Regjistrit të ndryshuar, të parashikimeve të prokurimeve publike, për Vitin 2021 për ASHSH-në", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, me në total 16 zëra, me një vlerë 5,120,000 lekë pa TVSH.
Për arsye të nevojave të Autoritetit Kontraktor bazuar në fushën e veprimtarisë së institucionit është bërë ndryshim dhe Titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 140/5 prot., datë 13.12.2021, me lëndë: "Dërgim i Regjistrit të ndryshuar, të parashikimeve të prokurimeve publike për Vitin 2021 për ASHSH-në", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, me në total 17 zëra, me një vlerë 6,120,000 lekë pa TVSH.
Me shkresën me Nr. 140/6 prot., datë 25.12.2021, Titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, me lëndën: "Raportim mbi Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike, për 4-mujorin e tretë, Viti 2021".

- Vërtetim që konfimon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike;
- Çertifikata ISO 9001:2005 (sisteme të menaxhimit të cilësisë);

Më datë 13.10.2021 është mbajtur nga Komisoni i prokurimt të "blerjeve me vlerë të vogël", procesverbal për kalimin tek operatori ekonomik i radhës.

Rezultoi se OE fitues "ADASTRA", me përfaqësues Adenis Kastrati, për ofertën me vlerë 477,980 pa TVSH, ka dorëzuar dokumentacionin, i cili është marrë në shqyrtim nga komisioni dhe më datën 14.10.2021 është mbajtur procesverbali i kualifikimit, ku OE "Adenis Kastrati-Kastrati PF" me NUIS L51611004I, ka përmbushur të gjitha kriteret, referuar dokumentacionit të dorëzuar duke u shpallur fitues.

Mes AK ASHSH dhe OE "Adenis Kastrati" PF tregëtar është lidhur kontrata për blerje mallarash me Nr. 454/6 prot., datë 19.10.2021 me vlerë 477,980 pa TVSH dhe 573,468 lekë me TVSH.

Bazuar në Urdhrin me Nr. 69, datë 27.05.2021 "Për ngritjen e komisioit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve", më datën 19.10.2021 komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga: Zj. Besmira Nuredini, kryetare, Zj. Areda Koçi Anëtare dhe Zj. Sara Bardhoku anëtare, kanë marrë në dorëzim mallrat sipas kontratës së lidhur mes AK ASHSH dhe OE "Adenis Kastrati" PF. (Bashkëlidhur edhe fletë-hyrje me Nr. 6, datë 19.10.2021 dhe faturë elektronike e lëshuar nga OE, e datës 19.10.2021, ora 15:00).

Për këtë procedurë nuk ka pasur ankesa pas njoftimit të fituesit. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, OE fitues ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuar në dokumentet standarte të tenderit.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt*: Blerje materiale kancelarie*

Me shkresën nr. 133 prot. e datës 14.05.2021, Spec. i Burimeve Njerëzore në ASHSH, Znj. Sara Bardhoku i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH-së, Z. Erlis Hereni, për pajisje të institucionit me materiale kancelarie.

Me shkresën pa nr. prot., datë 25.05.2021 është mbajtur proces verbal, për hartimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit "Për blerje materiale kancelarie", nga grupi i punës i përbërë nga Znj. Alma Allkja, kryetar, Znj. Sidorela Qato anëtar, Znj. Ilirjana Hasanllari, anëtar.

Janë marrë 3 oferta nga komisioni i prokurimit për blerjet e vogla, pas studimit të tregut nga Operatorët ekonomik si më poshtë vijon:

1. OE "IT STORE SHPK"READ 2000" SHPK., me NIPT L12321011H, në vlerën totale prej 754,276.1 lekë pa TVSH.

2. OE "EURO OFICE" SHPK me NIPT K81503063 B, në vlerën totale prej 799,147.2 lekë pa TVSH.

3. OE "G-Complex" SHPK, në vlerën totale prej 845,362.0 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, Komisioni për blerjet e vogëla, bazuar në ofertat dhe përllogaritjen e kryer, del në konkluzion se, fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje material kancelarie", të jetë në vlerën 799,595 lekë pa TVSH.

Me ane të "Memo-s", datë 26.05.2021, Znj. Alma Allkja, në cilësinë e kryetarit të komisionit për prokurimet me vlerë të vogël, i është drejtuar me kërkesë Z. Erlis Hereni, Drejtor i Përgjithshëm, për nxjerrjen e urdhrit të prokurimit.

Me Urdhërin e Prokurimit me Nr. 1, datë 26.05.2021, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje materialesh kancelarie" dhe ftesën për ofertë.

Me procesverbalin "për vlerësimin e ofertave ekonomike", mbajtur më datë 28.05.2021 (pa nr.prot.), Komisioni për prokurimet, blerje me vlerë vogël, lidhur me vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit "Blerje bojra printer/fotokopje", nga 24 operatorë ekonomikë pjesëmarrës, në klasifikimin përfundimtar janë renditur 18 operatorë

ekonomikë. 17 operatorë janë kualifikuar, kurse 1 prej tyre është skualifikuar, konkretisht OE "ANI-print" shpk, me arsyen se në ekstraktin e QKB-së nuk kishte të përfshirë tregëtimin e kancelarive në veprimtarinë e tij tregtare.
Në përfundim të procedurës së vlerësimit, komisioni konstatoi se OE "EUROPRINTY GROUP" SHPK u rendit i pari në klasifikim, në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje materialesh kancelarie".
Në faqen e APP-së është bërë edhe Njoftim fituesi për OE "Europrinty Group" SHPK". Rezultoi se ka një njoftim për tërheqje nga gara, nga OE edhe në faqen e APP-së me objekt "Tërheqje".
Më datë 31.05.2021 është mbajtur nga Komisoni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, procesverbal për skualifikimin e OE "Europrinty Group" SHPK dhe kalimin tek operatori ekonomik i radhës.
Komisoni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, ka mbajtur procesverbal më datë 31.05.2021, për kalimin tek operatori ekonomik i radhës.
Me procesverbalin e datës 31.05.2021, (pa nr.prot.), ASHSH i është drejtuar me njoftim për shpallje fituesi OE ekonomik të renditur në vendin e dytë, Eldi Qafmolla, i cili ka konfirmuar nëpërjet "sms" elektronik kryerjen e procedurës.
Më datë 01.06.2021 është mbajtur procesverbal skualifikimi, ku OE "Eldi Qafmolla" është tërhequr për ofertim të gabuar dhe në të tilla kushte AK procedoi me OE e radhës, duke mbajtur procesverbal "Për kalimin tek operatori ekonomik i radhës", më datë 02.06.2021.
Në faqen e APP-së është bërë Njoftim fituesi për OE "Marketing & Distribution" SHPK, por rezultoi se nga procesverbali i mbajtur më datë 03.06.2021, (pa nr.prot.,), komisioni i prokurimit me vlerë të vogël e ka skualifikuar, me arsyen se nuk ka *Skedë teknike të letrës A4. Letra e paraqitur nuk përmbushte specifikimet teknike.*
Në të tilla kushte komisioni vendosi skualifikimin e OE të renditur në vendin e tretë "Marketing & Distribution" SHPK .
Më datë 03.06.2021 është mbajtur procesverbali për kalimin tek operatori ekonomik i radhës dhe vijimin e procedurës.
Në faqen e APP-së, më datë 03.06.2021, është bërë njoftim fituesi për OE e renditur në vendin e 4, "Librari Dyrrahu", që konfirmon pjesëmarrjen dhe pasi kanë konfiruar marrjen e njoftimit si fitues.
Më datë 04.06.2021 është mbajtur procesverbal skualifikimi për OE "Librari Dyrrahu", me arsyen se: *Skeda e letrës ishte në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe.*
Në të tilla kushte, komsioni vendosi skualifikimin dhe vijimin e procedurës me OE e radhës, bazuar në procesverbalin e datës 07.06.2021.
Në faqen e APP-së është bërë Njoftim fituesi për OE e radhës "Printing Oportunity" SHPK, por rezultoi se nga procesverbali i mbajtur më datë 08.06.2021 (pa nr.prot.,) operatori nuk u paraqit pranë AK, sipas detyrimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Më datë 08.06.2021, komisioni mbajti procesverbal për vijimin e procedurës, për kalimin tek operatori ekonomik i radhës.
Në faqen e APP-së, është bërë njoftim fituesi për OE-në, e renditur në vendin e 6, "Infosoft Office". Nëpërmjet shkresës pa nr. prot., pa datë OE "Infosoft Office" SHPK ka dërguar një shkresë pranë AK, ku njofton tërheqjen nga gara për këtë procedurë, me arsyetimin se kanë kryer gabim përllogaritjen e ofertës.
Më procesverbalin e datës 09.06.2021 është mbajtur nga komisioni procesverbali për skualifikimin e OE "Infosoft Office" SHPK.
Më datë 09.06.2021 nga komisioni është bërë vijimi i procedurës për OE e radhës.
Në faqen e APP-së, është bërë njoftim fituesi për OE e renditur në vendin e 7-të, "IT Gjergji kompjuter".

Më procesverbalin e datës 09.06.2021 nga Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël janë marrë në dorëzim monstrat e mallrave/material kancelarie (bashkëlidhur akt-dorëzimi i datës 09.06.2021, sipas kërkesës në ofertë.
Me procesverbalin e datës 10.06.2021, OE "IT Gjergji Kompjuter", pas verifikimit të dokumentacionit nga KPVV është kualifikuar dhe ka vijuar procedura më tej.
Nëpërmjet procesverbalit, pa nr. prot., datë 14.06.2021, duke qenë se OE ka përmbushur kërkesën në përputhje me ftesën për ofertë, komisioni për marrjen në dorëzim ka vendosur të pranojë marrjen e mallrave/materialeve të kancelarisë, *(bashkëlidhur formular i konfliktit të interesit nënshkruar nga komisioni dhe akt-dorëzimi i datës 14.06.2021).*
OE "IT Gjergji Kompjuter" është likuiduar në vlerën prej 836,400 lekë, bazuar në Faturën tatimore të shitjes nr. 59/2021. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjeve nr.1, datë 14.06.2021 (0001561, 0001562, 0001563, 0001564, 0001565, 0001566, 0001567). Mes OE "IT Gjergji Kompjuter" dhe AK është lidhur kontratë me Nr. 133/1prot., datë 14.06.2021.
(Në kundërshtim me Nenin 3 të kontratës dhe në kriteret e vendosura në parashkimet e specifikimeve teknike, në ftesën për ofertë).
Ky veprim është në kundërshtim me shkresën nr. 738/4 prot., datë 03.10.2023 të ASHSH, Ftesa për Ofertë, ku specifikohet se:"Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës: ***do të jetë brenda 3 (tre) ditëve duke filluar nga momenti i konfirmimit si fitues në sistemin elektronik****. Mospërmbushja e të paktën një prej kërkesave përbën kusht për skualifikim dhe kalim tek operatori ekonomik vijues."*
Veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 18 ku specifikohet se: Kur ofertuesi fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor të përcaktuar në Ftesën për Ofertë, ***ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti/enti Kontraktor në Ftesën për Ofertë****, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave e kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë.*
Për rrjedhojë, OE "Marketing Distribution" duhej të ishte skualifikuar dhe AK ASHSH duhej të kishte proceduar me OE të radhës...

Për Vitin 2022.
Më urdhrin me Nr. 6, datë 05.01.2022, titullari i autoritetit kontraktor ka urdhëruar "Ngritjen e komisionit për prokurimet me vlerë të vogël", i përbërë nga:
- Znj. Denada Dosti, kryetar me detyrë Përgjegjës, Sektori i Asistecës ligjore.
- Znj. Arlinda Drenovci, anëtar, me detyrë Përgjegjës Sektori i Buxhetit dhe Financës.
- Znj. Lisarta Nufi, anëtar, me detyrë Specialiste, Sektori i Buxhetit dhe Financës.

Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve me vlerë të vogël
Për periudhën e auditimit, 01.01.2022 - 31.12.2022, titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 262 prot., datë 15.02.2022, me lëndë: "Dërgohet regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike për Vitin 2022 për ASHSH-në", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë. Bazuar në shkresën sa më sipër, janë parashikuar në total 13 procedura "prokurimi me vlerë të vogël", me një shumë totale të parashikuar në vlerën 3,180,000 lekë pa TVSH.
Titullari i ASHSH, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 262/1 prot., datë 20.04.2022, me lëndë: "Dërgim i Regjistrit të ndryshuar, të parashikimeve të prokurimeve publike për Vitin 2022 për ASHSH-në", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë. Bazuar në shkresën sa më sipër, janë parashikuar në total 16 procedura "prokurimi me vlerë të vogël", me një shumë totale të parashikuar në vlerën 4,530,900 lekë pa TVSH.

Me shkresën me Nr.4/2 prot., datë 02.09.2022, ASHSH ka dërguar informacion pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, për një ndryshim në Urdhërin Nr.4, datë 05.01.2022, "Për caktimin e personit përgjegjës për prokurimin", të ndryshuar me Urdhërin me Nr.111, datë 01.09.2022, ku bëhet ndryshim në pikën 1,a, si më poshtë: *"Znj. Lisarta Nufi, me detyrë specialist, Sektori i Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Financës dh Shërbimeve Mbështetëse, zëvendësohet me paragrafin... "Znj. Adela Duni, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërimeve të Brendshme".*

Titullari i ASHSH, Znj. Egra Ibrahimi, me shkresën me nr. 683 prot., datë 12.09.2022, me lëndë: "Dërgohet raportim mbi regjistrin e realizimit të prokurimeve publike për 4-mujorin e parë të vitit 2022 për Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, janë zhvilluar 4 pocedura me vlerë të vogël.

Titullari i ASHSH, Znj. Egra Ibrahimi, me shkresën me nr. 683/1 prot., datë 12.09.2022, me lëndë: "Dërgohet raportim mbi regjistrin e realizimit të prokurimeve publike për 4-mujorin e dytë të vitit 2022, për Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, ku bazuar në shkresën sa më sipër rezultojnë se janë zhvilluar 6 pocedura me vlerë të vogël.

Titullari i ASHSH, Znj. Egra Ibrahimi, me shkresën me nr. 697/1 prot., datë 26.09.2022, me lëndë: "Dërgohet raporti mbi realizimi e projekteve të investimeve buxhetore dhe shepnzimeve operative", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë.

Titullari i ASHSH, Znj. Egra Ibrahimi, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 716 prot., datë 29.09.2022, me lëndë: "Dërgim i Regjistrit të ndryshuar, të parashikimeve të prokurimeve publike për Vitin 2022 për ASHSH-në, muaji shtator 2022", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë. Bazuar në shkresën sa më sipër, janë parashikuar në total 12 procedura "prokurimi me vlerë të vogël", me një shumë totale të parashikuar në vlerën 4,621,000 lekë pa TVSH.

Titullari i ASHSH, Znj. Egra Ibrahimi, në cilësinë e autoritetit kontraktor, i është drejtuar me shkresën me Nr. 716/1 prot., datë 17.10.2022, me lëndë: "Dërgim i Regjistrit të ndryshuar, të parashikimeve të prokurimeve publike për Vitin 2022 për ASHSH-në, muaji tetor 2022", MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë. Bazuar në shkresën sa më sipër, janë parashikuar në total 13 procedura "prokurimi me vlerë të vogël", me një shumë totale të parashikuar në vlerën 4,025,000 lekë pa TVSH. (Bashkëlidhur shkresa "justifikim për regjistrin", ku për nevoja të Autoritetit kontraktor është kërkuar krijimi i zërit të ri në regjisstrin e parashikimeve, "blerje biletë transporti ajror", me fond limit 235,470 lekë pa TVSH.

Titullari i ASHSH, Znj. Egra Ibrahimi, me shkresën me nr. 683/1 prot., datë 12.09.2022, me lëndë: "Dërgohet raportim mbi regjistrin e realizimit të prokurimeve publike për vitin 2022, për Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, MIE dhe Degës së Thesarit, Tiranë, ku bazuar në shkresën sa më sipër rezultojnë se: Në total për Vitin 2022 janë zhvilluar 13 procedura me vlerë të vogël, me fond limit 4,856,470 lekë pa TVSH, ku janë lidhur kontrata me vlerë 3,979,102.5 lekë pa TVSH, ose 81.9% e fondit limit (***Pasqyruar në Aneksin Nr. 2, Tabela nr. 2***).

Bazuar në tabelën e regjistrit të realizimeve dhe të dhënave në sistemin e SPE, grupi i auditimit përzgjodhi mbi bazë risku, të auditojë dosjet e mëposhtme:

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "*Blerje pajisjesh TIK*".

Me shkresën nr. 707/1 prot. e datës 26.09.2022, Spec. i Burimeve Njerëzore në ASHSH, Znj. Sara Bardhoku i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH-së, Znj.Egra Ibrahimi, për pajisje të institucionit me pajisje TIK.

Me kërkesën me Nr.707/2 prot., datë 26.09.2022, komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i është drejtuar AKSH-it, me "kërkesë për miratimin e specifikimeve teknike për pajisjet TIK".

Me kthim-përgjijen me nr.6053/1 prot., datë 14.10.2022, AKSH-i i drejtohet ASHSH-së, se… *"për vijimin dhe realizimin e procedurës duhet që të plotësohet aneksi 3, për blerjen e pajisjeve hardëare TIK dhe më pas ta sjellë për miratim pranë AKSH-it"*.
Me shkresën me nr.707/4 prot., datë 21.10.2022, Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pranë ASHSH-së, i drejtohet me kërkesë *"për miratimin e specifikimeve teknike për pajisjet TIK"*, AKSHI-t, bashkëlidhur edhe Aneksi 3.
Në kthim-përgjigjen me nr.6797/2 prot., datë 31.10.2022. AKSH-i i kthen përgjigje ASHSH-së, duke vënë në dijeni edhe Drejtorinë e Buxhetit pranë Minstrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku shprehet pozitivisht, duke mundësuar bërjen efektiv të fondit prej 216,620 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 707/6 prot., datë 02.11.2022 është mbajtur procesverbali nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, për specifikimet teknike dhe përllogaritjen e Fondit Limit, ku mbështetur në çmimet e dhëna nga AKSHI dhe specifikimet teknike standarte për Vitin 2022, të pasqyruara nga kjo Agjenci në faqen zyrtare, komisioni ka sugjeruar që fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt "blerje pajisje elektronike, kompjuterike për nevojat e institucionit", për ASHSH-në, të jetë në vlerën 241,000 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 707/8 prot., datë 02.11.2022 është lëshuar Urdhri nr. 157 i Drejtorit të përgjithshëm për nisjen e procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 707/9 prot., datë 02.11.2022 është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë, ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.
Me shkresën nr. 707/10 prot., datë 02.11.2022 është mbajtur edhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
Me shkresën nr. 707/11 prot., datës 02.11.2022 është lëshuar edhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj. Adela Duni në cilësinë e kryetares që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).
Me procesverbalin nr.707/12 prot., datë 02.11.2022 si dhe në sistemin online të APP-së, rezultoi se kanë shprehur interes 14 OE, prej së cilës u pranuan 5 ofertat e mëposhtme:

OE "EURO INFORM"	124,900 lekë pa TVSH
OE "C.C.S"	185,000 lekë pa TVSH
OE "PC STORE"	189,000 lekë pa TVSH
OE "INSTANT.AL"	195,600 lekë pa TVSH
OE "Introvus Solutions"	222,875 lekë pa TVSH

Referuar klasifikimit në sistemin elektronik të prokurimeve elektronike (SPE), të APP-së, në vend të parë është klasifikuar operatori ekonomik "Euro Inform" SHPK, me ofertën ekonomike me vlerën 124,900 lekë pa TVSH.
Me procesverbalin konfirmim fituesi, me nr. 707/14 prot., datë 04.11.2022, komisioni pasi konstatoi se OE plotësonte detyrimet në lidhje me dokumentacionin dhe specifikimet teknike, detyrimet të parashikuara në ftesën për ofertë, vendosi që të konfirmojë fitues OE "Euro Inform" SHPK.
Me shkresën me nr. 707/15., datë 04.11.2022, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në ASHSH i është drejtuar me "kërkesë për suport" Agjencisë Kombëtare të Informacionit, pasi në strukturën e saj institucioni nuk ka punonjës IT dhe kërkon suportin për marrjen e mallit në dorëzim.
Me procesverbalin, me nr.707/16 prot., datë 08.11.2022, i mbajtur nga komisioni, rezultoi se, pas pritjes 2-ditore nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit për "Blerjen pajisje elektronike, kompjuterike për nevojat e institucionit".
Me shkresën me nr. 7068/1 prot, datë 11.11.2022, AKSHI i kthen përgjigje ASHSH-së, ku autorizon z. Armelino Shema, si pjesë e komisionit për marrjen në dorëzim të pajisjeve objekt prokurimi.

Me shkresën nr. 707/18 prot., datë 11.11.2022 është lëshuar Urdhri me nr. 158, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve, me përbërje si më poshtë: [Z. Besnik Hysaj, kryetar; Z. Aremlino Shema, anëtar; Znj. Ueda Brahimllari, anëtar].
Me shkresën nr. 707/19 prot., datë 11.11.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave, ku edhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit, u konstatua se malli është në përputhje me specifikimet teknike.
OE është likujduar nëpërmjet faturës 1290/2022, datë 11.11.2022, në shumën 149.880 lekë me TVSH.
Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 18, datë 11.11.2022.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: *"Blerje pajisje për programin "softëare-ik "AutoCad dhe Civil 3D 2022"*
Me shkresën nr. 678 prot. e datës 07.09.2022, Spec./Sektori i kontrollit të dokumentacionit, Znj. Entela Bytyçi, i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH-së, Znj. Egra Ibrahimi, për Blerje pajisje për programin softëare-ik "AutoCad dhe Civil 3D 2022".
Me procesverbalin me Nr. 678/1 prot., datë 21.09.2022, komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, pasi kërkoi informacion nga ëeb, kreu studimet e tregut duke pyetur operatorët ekonomikë, duke u marrë 3 ofertat si vijon:

1. OE "Gjergji Kompjuter" sh.p.k. (AutoCad 2022 - 302,434 lekë pa TVSH, Civil 3D 2022 -204,000 lekë pa TVSH). **Vlera totale 506,434 lekë pa TVSH.**
2. OE "Infosoft System" sh.p.k. (AutoCad 2022 – 328,910 lekë pa TVSH, Civil 3D 2022 – 206,751 lekë pa TVSH). **Vlera totale 535.661 lekë pa TVSH.**
3. OE "Synapse ATS sh.p.k. (AutoCad 2022 – 311,076 lekë pa TVSH, Civil 3D 2022 – 209,829 pa TVSH). **Vlera totale 520,905 lekë pa TVSH.**

Për sa më sipër, fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje të programeve softëare "AutoCad 2022" dhe "Civil 3D 2022" është 521,000 lekë pa TVSH.
Me shkresën me nr. 678/2 prot., datë 21.09.2022 komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH-së, Znj.Egra Ibrahimi, për nxjerrjen e urdhrit, për vijimin e mëtejshmë të procedurës.
Me shkresën me nr. 678/3 prot., datë 21.09.2022 është nxjerrë Urdhri me nr. 131 i Drejtorit të përgjithshëm për nisjen e procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 678/4 prot., datë 21.09.2022 është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë, ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.
Me shkresë nr. 678/5 prot., datë 21.09.2022 është mbajtur edhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
Me shkresën nr. 678/6 prot., datë 21.09.2022 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për Znj. Adela Duni, në cilësinë e kryetares së komisionit, që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).
Me procesverbalin nr. 678/7 prot., datë 22.09.2022, si dhe në sistemin online të APP, rezultoi se kanë shprehur interes 8 OE, prej së cilës u pranuan 7 ofertat e mëposhtme:

1- OE "Infosoft Systems"- Oferta e paraqitur është në vlerën 444, 396 lekë pa TVSH;
2- OE "Info Busines Solutions"- Oferta e paraqitur është në vlerën 459,003 lekë pa TVSH;
3- OE "Information Busines Systems-IBS"- Oferta e paraqitur është në vlerën 470,000 lekë pa TVSH;
4- OE "Hbgroup Construction" - Oferta e paraqitur është në vlerën 478,900 lekë pa TVSH;
5- OE "Arlind Dogjani" - Oferta e paraqitur është në vlerën 516,667 lekë pa TVSH;
6- OE "Oni Trade" - Oferta e paraqitur është në vlerën 520,000 lekë pa TVSH;
7- OE "Jupiter Group" – Oferta e paraqitur është në vlerën 521,000 lekë pa TVSH;

Nuk u kualifikua operatori ekonomik: "Future Block Group", pasi vlera e ofertuar është më e lartë se fondi limit i përllogaritur.
Në bazë të sistemit elektronik të prokurimeve (SPE), të APP-së, në vend të parë është klasifikuar operatori ekonomik "Infosoft Systems" shpk, i cili u njoftua elektronikisht përmes "Njoftimit të fituesit", për të paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas ftesës për ofertë.
Me procesverbalin konfirmim fituesi, me nr. 678/9 prot., datë 23.09.2022, komisioni pasi konstatoi se OE plotësonte detyrimet, në lidhje me dokumentacionin dhe specifikimet teknike, detyrimet të parashikuara në ftesën për ofertë, vendosi që të konfirmojë fitues OE "Euro Inform" SHPK.
Me procesverbalin, me nr. 678/10 prot., datë 26.09.2022, i mbajtur nga komisioni rezultoi se pas pritjes 2-ditore nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit për "Blerjen të programeve Softëare AutoCad 2022 dhe Civil 3D 2022".
Rezultoi se është plotësuar formulari i deklarimit të konfliktit të interesit, dt. 27.09.2022 nga antëarët e komisionit.
Me shkresën nr. 678/11 prot., datë 27.09.2022 është lëshuar Urdhri nr. 835, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimev, me përbërje si më poshtë: [Z. Albian Marku, kryetar; Z. Besnik Hysaj, anëtar; Znj. Entela Bytyçi, anëtar].
Me shkresën me nr. 678/12 prot., datë 28.09.2022 është lidhur kontrata mes ASHSH-së dhe OE fitues subjekti "Infosoft Systems" SHPK.
Me shkresën me nr. 678/13 prot., datë 29.09.2022 është nënshkruar plani i zbatimit të kontratës mes ASHSH-së dhe OE fitues subjekti "Infosoft Systems" SHPK.
Me shkresën nr. 678/15 prot., datë 03.10.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave, ku edhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit u konstatua se malli është në përputhje me specifikimet teknike.
Nga auditimi i kësaj procedure:
Konstatohet se në komision nuk ka specialistë të fushës, në kundërshtim me pikën 43 të UMF-së me Nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Bazuar në shkresën me nr. 678/16 prot., datë 18.10.2022 "Procesverbal mbi aktivizimin e licencës së "AutoCad 2022 dhe Civil 3D 2022", komisioni i marrjes në dorëzim verifikoi se subjekti ekonomik "Infosoft Systems" SHPK, kreu aktivizimin e licencave në pajisjet hardëare të ASHSH-së.
OE është likujduar nëpërmjet faturës 1701/2022, datë 03.10.2022, në shumën 533.275,20 lekë me TVSH. *Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që artikujt/ shërbimi të jetë marrë në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: "Blerje mobilje për zyra"
Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (KPVV) ka marrë kërkesë për blerje malli "Blerje mobilje për zyra", me shkresën nr. 705 prot., datë 23.09.2022.
Është mbajtur procesverbali me nr. 705/1 prot., datë 16.11.202 për specifikimet teknike, por nuk ka të dhëna për mënyurën e llogaritjes së fondit limit.
Me kërkesën me nr. 705/2 prot. datë 16.11.2022 Komisioni i Prokurimeve me vlerë të vogël i është drejtuar me kërkesë dhe i ka propozuar Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH-së edhe vlerën e fondit limit në shumën 996,000 lekë pa TVSH, por pa dokumentuar se si ky komision ka kryer përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me Ligjin.
Me shkresën nr. 705/3 prot., datë 16.11.2022, Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 164, për procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.
Me shkresën nr. 705/4 prot., datë 16.11.2022 është lëshuar shkresa për "Ftesën për ofertë" ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.

Me shkresën nr. 705/5 prot., datë 16.11.2022 është mbajtur dhe procesverbali, për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
Me shkresën nr. 705/6 prot., datë 16.11.2022 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj. Adela Duni në cilësinë e kryetares, që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).
Me procesverbalin nr. 705/7 prot., datë 17.11.2022, si dhe në sistemin online të APP-së, rezultoi se kanë shprehur interes 19 OE, prej së cilëve u pranuan 16 ofertat e mëposhtme:

OPERATORI EKONOMIK	VLERA E OFRUAR
RO-AL	579,000 lekë
Arlind Dogjani	666,667 lekë
ONI TRADE	716,667 lekë
START-2022	750,000 lekë
SEELLS	750,000 lekë
JUPITER GROUP	783,333 lekë
TETEA	900,000 lekë
Lorena Çadri	919,000 lekë
SHAGA	940,000 lekë
Oltjan Hastoçi	944,000 lekë
EKM Konstruksion&teknologji	948,000 lekë
Naim Hysi	964,000 lekë
MARJO-MONDI	964,000 lekë
BILURBINA	966,600 lekë
HBGROUPCONSTRUCTION	967,000 lekë
Përparim Agimi	988,000 lekë
Telia Kurti	OE nuk e ka në fushën e veprimtarisë së tij objektin e prokurimit të AK-së. Faza: Vlerësim financiar
Sokol RROKAJ	OE nuk e ka në fushën e veprimtarisë së tij objektin e prokurimit të AK-së. Faza: Vlerësim financiar
AMI-ARLI	OE nuk e ka në fushën e veprimtarisë së tij objektin e prokurimit të AK-së. Faza: Vlerësim financiar

Në bazë të klasifikimit, referuar sistemit të prokurimeve elektronike (SPE), të APP-së, në vend të parë është klasifikuar operatori ekonomik "RO-AL", me ofertë ekonomike 579,000 lekë.
Me shkresën nr. 705/9 prot., datë 18.04.2022 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit OE "RO-AL" SHPK.
Me shkresën nr. 705/10 prot., datë 22.11.2022 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash, ku specifikohet se nuk ka pasur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.
Me shkresën nr. 705/11 prot., datë 01.12.2022 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për shtyrjen e afatit të marrjes në dorëzim të mallit, për në datën 5 dhjetor, pasi (*data 29 -29 Nëntor, festë zyrtare*), ku edhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit u konstatua se malli është në përputhje me specifikimet teknike.
Me shkresën me nr. 705/12, datë 02.12.2022 është lidhur kontrata mes ASHSH-së, në cilësinë e AK dhe "RO-AL" SHPK, në cilësinë e OE-së.
Me shkresën nr. 705/14 prot., datë 02.12.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave, ku dhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit u konstatua se malli është në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.
OE është likujduar nëpërmjet faturës 81/2022, datë 02.12.2022, në shumën 579,000 lekë, pa TVSH, ose 694,800 lekë me TVSH.
Mallrave u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 20, datë 02.12.2022.

4.* Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: *"Blerje programi financiar".
Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (KPVV) ka marrë kërkesë për blerje malli "Blerje programi financiar", me shkresën nr. 732 prot., datës 04.10.2022. Është mbajtur procesverbali

me nr. 732/2 prot., datë 04.10.2022 për specifikimet teknike dhe llogaritjen e fondit limit, por nuk ka të dhëna për mënyurën e llogaritjes së fondit limit. Bazuar në 3-ofertat e marra nga Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël dhe oefrtat e paraqitura si vijon:

1. OE "Tetra Solutions" ofertoi me vlerat si më poshtë:

Galaxy Enterprise Suite- 510,000 lekë pa TVSH.

2. OE "Infosoft Softare Developer" ofertoi me vlerat si më poshtë:

Programi F.5.0-200,000 lekë pa TVSH

3. OE "2RMLab shpk" ofertoi me vlerat si më poshtë:

i)Elif Kontabilitet Start - 40,000 lekë pa TVSH

Pasi kreu përllogaritjen e fondit limit, komisioni vendosi që ta përcaktojë në shumën 250,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 732/4 prot., datë 04.11.2022, Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 138, për procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

Me shkresë nr. 732/6 prot., datë 04.10.2022 është mbajtur edhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

Me shkresën nr. 732/7 prot., datë 04.10.2022 është lëshuar edhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për Znj. Adela Duni në cilësinë e kryetares, që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).

Bazuar në procesverbalin me Nr. 732/8 prot., datë 05.10.2022, "Për vlerësimin e ofertave ekonomike", rezultoi që kanë shprehur interes 2 OE si më poshtë:

1. "HB-Groupconstruction" 245,000 lekë;

2. "Infosoft Software Developer" 249,700 lekë;

Në bazë të klasifikimit referuar sistemit elektronik SPE të APP-së, në vend të parë është klasifikuar **OE "HB-Groupconstruction**, me ofertë ekonomike 245,000 lekëpa TVSH, i cili u njoftuar elektronikisht.

Komisioni ka mbajtur procesverbalin me Nr. 732/9 prot., datë 05.10.2022, drejtuar OE **"HB-Groupconstruction",** i cili është tërhequr nga gara për arsye të mosrealizimit në kohë të procedurës së prokurimit, çka e ka njoftuar edhe nëpërmjet sistemit të APP-së.

Rezultoi se në sistemin e APP-së, fitues është shpallur ofertuesi i dytë, **"Infosoft Software Developer",** me vlerën 249,700 lekë;

Me shkresën nr. 732/11 prot. e datës 06.10.2022 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit ***"Infosoft Software Developer",*** 249,700 lekë, pa TVSH;

Me shkresën nr. 732/12 prot., datë 11.10.2022 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash ku specifikohet se nuk ka pasur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.

Rezultoi se është plotësuar formulari i deklarimit të konfliktit të interesit nga antëarët e komisionit.

Me shkresën nr. 732/13 prot., e datës 14.10.2022 është lëshuar Urdhri nr. 148, për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, me përbërje si më poshtë: [Znj. Klodiana Lika, kryetar; Znj. Sara Bardhoku, anëtar; Znj. Ueda Brahimllari, anëtar].

Me shkresën nr. 732/14 prot., datë 14.10.2022 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit për në datën 5 dhjetor, pasi (*data 29 Nëntor, festë zyrtare*), ku dhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit u konstatua se ky program është në përputhje me specifikimet teknike, sipas përcaktimeve në ftesën për ofertë.

Me shkresën me nr. 732/15, datë 14.10.2022 është lidhur kontrata mes ASHSH-së, në cilësinë e AK dhe **"Infosoft Software DeveLOPER"**, në cilësinë e OE-së.

Me shkresën me nr. 732/16, datë 14.10.2022 është nënshkruar plani i zbatimit të kontratës mes AK, ASHSH-së dhe OE fitues subjekti "Infosoft Systems" SHPK.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SHTETËRORE PËR SHËRBIMET SEKRETARIA

Nga auditimi i kësaj procedure, *konstatohet se në komision nuk ka specialistë të fushës, në kundërshtim me pikën 43 të UMF-së me Nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*

OE është likujduar nëprëmjet faturës 5519/2022, datë 14.10.2022, në shumën 249,700 lekë pa TVSH, ose 299,640 lekë me TVSH. *Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që artikujt/ shërbimi të jetë marrë në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*

Mbi sa më sipër, nëpërmjet shkresës së administruar në KLSH, me nr. 277/30 prot., datë 02.03.2026, subjekti i audituar ka paraqitur observacionin, si vijon:

***I.* Pretendimi i subjektit:** Për sa i përket qëndrimit tuaj se, specialisti i fushës duhet të ishte pjesë e komisionit të përllogaritjes së fondit limit, ky pretendim nuk bazohet në ligjin e prokurimit publik nr.160/2020; në VKM nr.285/2021 dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik. Komisioni që ka bërë përllogaritjen e fondit limit është i njëjtë me komisionin e prokurimit me vlerë të vogël që ka zhvilluar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël. Veprimet e Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël janë në mbështetje të pikës 7 të udhëzimit nr. 5, datë .06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", ku citohet se: *"Përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit/ entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikitnet teknike/termat e referencës duhet të përllogatisë fondin për sasinë mallrave, shërbineve, punëve që do të prokurojë, në përputhje ne nonin 76 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme. Kjo përllogaritje do t'i shërbejë komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për të bërë krahasimin e ofertave të paraqitura gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit. Në rastet kur, në përllogaritjen e fondit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij procesi, por vetëm treguesit e çmimeve, të cilat dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël".*

Lidhur me qëndrimin e grupit të audititmit, sqarojmë se sipas kartelave të inventarit të personave të cilët kanë përdorur dhe përdorin këtë lloj licence, është lehtësisht e verifikueshme dhe e identifikueshme se përmbushet kriteri për garantimin e suportit të pajisjeve për instalimin e licensave perkatëse, duke krahasuar secilën pajisje.

Gjithashtu ritheksojmë, se personi që është pjesë e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të programit financiar është me profesion financier dhe është pjesë e Drejtorisë të Financës që përdor drejtpërdrejt këtë program në institucion, si dhe zotëron njohuritë e nevojshme profesionale për përdorimin e programit, si dhe aftësinë për të verifikuar nëse ky program përmbush kriteret e përcaktuara në Procesverbalin e Specifikimeve Teknike. Pra është lehtësisht e kuptueshme se ky person është me tagrat e specialistit të fushës. Znj. Klodiana Lika, specialist e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, pranë DFSHM iu nënshtrua trajnimit nga ana e kompanisë fituese OE "Infosoft Softëare Developer" dhe IT të OE të shpallur fitues, i cili ka ardhur në institucion për instalimin dhe konfigurimin e programit financiar. *Në mënyrë të përsëritur nga ana e ASHSH-së janë dërguar shkresa pranë instancave eprore për vendosjen në dispozicion të specilisteve IT, shtim strukture për pozicionin IT (sipas kërkesave shtesë në PBA respektive), por nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e ASHSH-së. Ndodhur në të tilla kushte kur institucioni është përballur në mënyrë sistematike me këto lloj pengesash është gjykuar vijimi i proceseve në bazë të strukturës së miratuar, si dhe personelit sipas fushës së njohurive të secilit prej tyre.*

Ndodhur në kushtet, kur në këtë rast merret në dorëzim një sistem, gjë e cila nuk e prek në mënyrë të drejtpërdrejtë gjendjen fizike të mallrave në magazinë, është gjykuar që komisioni të përbëhet vetëm nga punonjës me formim financiar, e cila do të bëjë të mundur edhe evidentimin e saktë dhe të drejtë të specifikave të sistemit.

1- Shkresë nr.118 prot., datë 21.01.2022 "Dërgohet për miratim DRAFT- struktura e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim"
2- Shkresa nr.517/4 prot., datë 03.10.2023 "Kërkesë për asistencë teknike"
3- Urdhër nr.148, datë 14.10.2022.
4- Procesverbal për marrje në dorëzim nr.732/14 prot., datë 14.10.2022.
Gjithashtu, sqarojmë për Kontrollin e Lartë të Shtetit që ky konstatim nuk është në tagrat dhe kompetancat e Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
1.1 Qendrimi i grupit të auditimit: Referuar pretendimit tuaj, të pasqyrar edhe në observacion, sqarojmë se: Specialisti i fushës duhet të ishte pjesë e Komisionit të përllogaritjes së fondit limit, por edhe të marrjes në dorëzim dhe të ofronte garanci që pajisja ka të njëjtat parametra me ato të kërkuara në momentin e hartimit të specifikimeve. Në kushtet kur Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të pajisjes, nuk është mundësuar gjurma e auditimit për të konkluduar se pajisja është me parametra të njëjtë dhe se ky testim është i mjaftueshëm. *Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.*

5. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje letër A4 e A3 dhe materiale kancelarie".

Me shkresën nr. 489 prot., e datës 16.05.2022, Spec. i Burimeve Njerëzore në ASHSH, Znj. Sara Bardhoku, i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH-së, Z. Erlis Hereni, për pajisje të institucionit me letër format A3 dhe A4, e materiale kancelarie.
Me shkresën me nr 489/1 prot., e datës 25.05.2021 është mbajtur procesverbal, për hartimin e argumentimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritja e fondit limit "për blerje materiale kancelarie", nga grupi i punës i përbërë nga Znj. Denada Dosti, kryetar, Znj. Arlinda Drenovci, anëtar, Znj. Lisarta Nufi, anëtar.
Janë marrë 3 oferta nga komisioni i prokurimit për blerjet e vogla, pas studimit të tregut nga Operatorët ekonomik si më poshtë vijon:

1. *OE "Infosoft Office" shpk, në vlerën totale prej 735.368,9 lekë pa TVSH.*
2. *OE "ADD Print" shpk në vlerën totale 806.255,0 lekë pa TVSH.*
3. *OE "MAGRIP BANA" PF, me emër tregëtar "Max Office Kancelari" në vlerën totale prej 858.325,0 lekë pa TVSH.*

Sa më sipër, Komisioni për blerjet e vogëla, bazuar në ofertat dhe përllogaritjen e kryer, del në konkluzion se fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje letër format A4 e A3 dhe material kancelarie", të jetë në vlerën 799,982 lekë pa TVSH.
Me anë të "Memo-s", datë 31.05.2021, Znj. Lisarta Nufi, në cilësinë e kryetarit të komisionit për prokurimet me vlera të vogla, i është drejtuar me kërkesë Z. Erlis Hereni, Drejtor i Përgjithshëm, për nxjerrjen e urdhrit të prokurimit.
Me Urdhërin e Prokurimit me Nr. 76, datë 01.06.2022, Z. Erlis Hereni, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje letër format A4 e A3 dhe materialiesh kancelarie" dhe ftesën për ofertë.
Me procesverbalin "për vlerësimin e ofertave ekonomike", me nr. 489/5 prot., datë 07.06.2022, Komisioni për prokurimet me vlerë vogël, lidhur me vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël "Blerje letër A4 e A3 dhe material kancelarie" bojra printer/fotokopje", nga 22 operatorë ekonomikë pjesëmarrës, në klasifikimin përfundimtar janë renditur të 22-operatorët ekonomikë.
Në përfundim të procedurës së vlerësimit, komisioni konstatoi se, në vend të parë është klasifikuar OE "Eldi Qafmolla", i cili është njoftuar elektronikisht nëpërmjet "Njoftim fituesi".
Rezultoi se OE "Eldi Qafmolla" nuk është paraqitur sipas afatit, brenda 2-ditëve pune për të dorëzuar mostrat.
Më datë 09.06.2022 është mbajtur nga Komisoni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, procesverbal për skualifikimin e OE "Eldi Qafmolla" dhe kalimin tek operatori ekonomik i radhës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIM SEKRETARIA

Komisoni i prokurimt të blerjeve me vlerë të vogël, ka mbajtur procesverbal më datë 31.05.2021, për kalimin tek operatori ekonomik i radhës, i cili është "Business Information Systems Software", që ka njoftuar tërheqjen nga procedura, me arsyen: "Për aryse të ndryshme të kostove të shpeshta në treg", publikuar edhe në faqen e APP-së.
Me procesverbalin e datës 10.06.2022, **(pa nr.prot)**, AK procedoi me OE e radhës, duke mbajtur procesverbal "Për kalimin tek operatori ekonomik i radhës", më datë 02.06.2021. Në këtë mënyrë është vijuar me OE të radhës, ku në faqen e APP-së është publikuar
Me shkresën e datës 10.06.2022, e administruar në ASHSH me nr. 489/9 prot, datë 13.06.2022, kompania "InfoSoft" shpk ka paraqitur "dorëzim dokumentacioni".
Me procesverbalin "për marrje mostrash", OE "InfoSoft Office" ka paraqitur pranë ASHSH-së, dorëzimin e mostrave, bashkëlidhur edhe akt-dorëzimi.
Me procesverbalin e mbajtur më datë 17.06.2022, nga Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi që të bëjë konfirmimin e fituesit, OE "Infosoft Office".
Nëpërmjet procesverbalit, **pa nr. prot.,** datë 23.06.2022, duke qenë se OE ka përmbushur kërkesën në përputhje me fitesën për ofertë, komisioni për marrjen në dorëzim ka vendosur të pranojë marrjen e mallrave/materialeve të kancelarisë, (bashkëlidhur formular i konfliktit të interesit nënshkruar nga komisioni).
OE "InfoSoft Office" është likuiduar në vlerën prej **599,000 lekë pa TVSH ose 718,800** lekë me TVSH bazuar në Faturën tatimore të shitjes, me nr. 8420/2022. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjeve nr.4, datë 23.06.2022 (0001535, 0001536, 0001537, 0001538).

Mbi sa më sipër, nëpërmjet shkresës së administruar në KLSH, me nr. 277/30 prot., datë 02.03.2026, subjekti i audituar ka paraqitur observacionin, si vijon:
1. Pretendimi i subjektit: *Sqarojmë se, në interpretim të Kodit të Procedurave Administrative si dhe nisur nga natyra, e vetë formatit, proces-verbalet nuk janë një akt-administrativ që kërkojnë domosdoshmërinë e protokollimit të tyre, por mjafton nënshkrimi i secilit prej anëtarëve të komisionit, mbi qëndrimin e pasqyruar në proces-verbal. Për me tepër, në zbatim të pikës 3 të nenit 2 të VKM 285/2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik", i ndryshuar, citohet se: "Dokumentimi i proceseve që zhvillohen në sistemin e prokurimit elektronik bëhet automatikisht në sistem", pra nga ana e Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël është zbatuar kjo pikë e VKM -së duke ndjekur hapat në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Sipas Akt-Konstatimit i referoheni pikës 36 të udhëzimit nr.30/2011, i ndryshuar, i cila citon se: "Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve." Të gjitha elemenët e kërkuar sipas kësaj pike janë të reflektuara në procesverbalet e praktikës së prokurimit.*
Gjithashtu, sqarojmë për Kontrollin e Lartë të Shtetit që ky konstatim nuk është në tagrat dhe kompetancat e Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga informacioni i vendosur në dispozicion grupit të auditimit, pretendimi juaj nuk merret në konsideratë, pasi gjatë fazës së auditimit në terren, apo dhe nga materiali shtesë bashkëlidhur observacioneve, nuk na është vendosur në dispozicion dokumentacion provues. Pretendimi juaj është në kundërshtim me pikën 36, të UMF-së Nr. 30, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik". *Sa më sipër, nuk përbën fakt të ri dhe observacioni* ***nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.***

Për sa më sipër, nga auditimi i këtyre procedurave dhe parregullsitë e konstatuara për periudhën 01.01.2021-31.12.2022, mbajnë përgjegjësi:
- Znj. Alma Allkja, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e Kryetarit të KVO, Blerje me Vlerë të Vogël.
- Znj. Sidorela Qato, anëtar, me detyrë Specialiste, Sektori i Kontrollit të Dokumentacionit.
- Znj. Arlinda Drenovci, anëtar, me detyrë Përgjegjës Sektori i Buxhetit dhe Financës.
- Znj. Lisarta Nufi, anëtar, me detyrë Specialiste, Sektori i Buxhetit dhe Financës.
- Znj. Adela Duni, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërimeve të Brendshme, në cilësinë e Kryetarit të KVO, Blerje me Vlerë të Vogël.
- Përfaqësuesit e Agjencia Shtetërore për Shpronësim sipas periudhës takuese, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, Z. Erlis Hereni dhe Znj. Egra Ibrahimi.

<u>Për vitin periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023.</u>

Ngritja e Komisionit për prokurimet me vlerë të vogël.

Me shkresën nr. 4 prot., datë 04.01.2023, Urdhri nr. 4 nga ana e drejtorit të përgjithshëm të ASHSH, Znj. Egra Ibrahimi është krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël i përbërë nga:[Znj. Adela Duni, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme; Znj. Orlanda Murati, me detyrë Specialiste e Sektorit të Negocimit; Z. Spartak Kodra, me detyrë Specialist i Sektorit të Kontrollit të Dokumentacionit].

Regjistrat e Parashikimit dhe realizimit të prokurimeve me vlerë të vogël

Autoriteti Kontraktor ka krijuar në SPE regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar, në Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 "Për hartimin e parashikimit të regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik".

Sa më sipër nuk rezulton të ketë një regjistër parashikimi të përgatitur sipas afatit të përcaktuar në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik", Kreu II, neni 3, pika 3 ku shprehet se:

"Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator–dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës" si dhe Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021 Për Hartimin e Regjistrit të parashikimeve të procedurave të Prokurimit Publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të Prokurimit Publik dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik, pika 3 ku citohet se "*Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit duhet të përgatitet nga AK jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës*".

Ligji nr. 84, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023" është botuar në fletoren zyrtare nr. 171 datë 21.12.2022.

Me shkresën nr. 7/1 prot., datë 04.04.2023 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit, për arsye të nevojave të Autoritetit Kontraktor bazuar në fushën e veprimtarisë së institucionit është bërë ndryshim në parashikimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël ku janë parashikuar **12** procedura prokurimi me vlerë të vogël, me një shumë totale prej 3,821,000 lekë pa TVSH. Gjithashtu është parashikuar dhe **1** procedurë prokurimi me vlerë të lartë me një shumë totale prej 2,916,000 lekë pa TVSH me objekt blerje mjet transporti-automjet.

Për 4 mujorin e parë bazuar mbi shkresën nr. 7/2 prot., datë 09.05.2024 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit janë zhvilluar **2** procedura me fond limit 700,000 lekë pa TVSH, nga ku janë lidhur kontrata me vlerë 264,981 lekë pa TVSH ose 37.8% e Fondit Limit.

Për arsye të nevojave të Autoritetit Kontraktor bazuar në fushën e veprimtarisë së institucionit është bërë ndryshim në parashikimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, me

shkresën nr. 7/3 prot., datë 07.09.2023 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit ku parashikohen **13** procedura me një shumë totale prej 3,921,000 lekë pa TVSH.
Për 4 mujorin e dytë bazuar mbi shkresën nr. 7/4 prot., datë 07.09.2023 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit janë zhvilluar **3** procedura me fond limit prej 1,200,000 lekë pa TVSH, nga ku janë lidhur kontrata me vlerë 763,647 lekë pa TVSH ose 63.6% e Fondit Limit.
-Në total për vitin 2023 bazuar mbi shkresën nr. 58 prot., datë 05.01.2024 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit janë zhvilluar **12** procedura me fond limit prej **3,821,000** lekë pa TVSH, nga ku janë lidhur kontrata me vlerë **2,992,199** lekë pa TVSH ose **78.3%** e Fondit Limit (***Pasqyruar në Aneksin Nr. 2, Tabela nr. 3***)..
Bazuar në tabelën e regjistrit të realizimeve dhe të dhënave në sistemin e SPE grupi i auditimit përzgjodhi mbi bazë risku, të auditojë dosjet e mëposhtme:

"Blerje letër A4, letër A3 dhe materiale kancelarie"	Dosje, Stilolapsa, Lapsa, Stilolapsa korrigjimi	500,000.00	360,000.00	MARKETING & DISTRIBUTION
Blerje Nafte (Gazoil D1)"	Naftë, Karburant diesel	500,000.00	498,666.00	"GEGA CENTER GKG"
"Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike"	Bateri, Pjesë dhe pajisje për automjetet dhe motorët e tyre, Frena dhe pjesë të frenave	500,000.00	464,000.00	Olsi Motors Motors
Blerje bileta transporti ajror	Bileta transporti	600,000.00	189,000.00 124,110.00 165,536.00	AMADEUS TRAËELL AND TOURS ARLO Travel-Blu Tour Operator
Blerje tonera per printera dhe fotokopje	Toner per printer lazer /makina fax , Toner për makinat fotokopjuese	500,000.00	247,500.00	InfoSoft Office
Lyerje e ambjenteve te ASHSH	Lyerje, Shërbime lyerjeje	250,000.00	125,500.00	CONSTRUCTION ALBANIA ALBANIA

1. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje letër A4, letër A3 dhe materiale kancelarie".
Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (Kpvv) ka marrë kërkesë për blerje malli " Blerje letër A4, letër A3 dhe materiale kancelarie" me shkresën nr. 738 prot., datë 16.09.2023.
Është mbajtur procesverbali me nr. 738/1 prot., për specifikimet teknike dhe llogaritja e fondit limit.
Vlera e përllogaritur për Fondin Limit është **497,000 lekë** pa TVSH. Përllogaritja vjen nga 3 ofertues ekonomikë (OE), përkatësisht:
Infosoft Office me çmimin 494,380 lekë pa TVSH
Gjergji Kompjuter me çmimin 499,036 lekë pa TVSH
Copier and Computer Center me çmimin 497,582 lekë pa TVSH
Me shkresën nr. 738/3 prot., datë 03.10.2023, Urdhri nr. 133 i Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur urdhri për prokurimin me vlerë të vogël "Blerje letër A4, letër A3 dhe materiale kancelarie".
Me nr.738/4 prot., është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.
Me shkresë nr. 738/5 prot., datë 03.10.2023 është mbajtur dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

Me shkresën nr. 738/6 prot., datës 03.10.2023 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj. Adela Duni në cilësinë e kryetares që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).
Me procesverbalin nr.738/7 prot., datë 04.10.2023 si dhe në sistemin online të APP, rezultoi se kanë shprehur interes 19 OE, prej së cilës u pranuan 13 ofertat e mëposhtme:
"Marketing Distribution" me vlerën e ofruar 360,000 lekë pa TVSH. (Fitues)
"Europrint Group" me vlerën 389,000 lekë pa TVSH
"Jueli" me vlerën 400.000 lekë pa TVSH
"Olsi Motors and Motors" me vlerën 440,000 lekë pa TVSH
"Megi Hajdari" me vlerën 440,000 lekë pa TVSH
"Marjo-Mondi" me vlerën 448,000 lekë pa TVSH
"Arlind Dogjani" me vlerën 450,000 lekë pa TVSH
"HEP-2012" me vlerën 450,000 lekë pa TVSH
"Eldi Qafmolla" me vlerën 460,667 lekë pa TVSH
"Jupiter Online Trade" me vlerën 466,667 lekë pa TVSH
"START-2022" me vlerën 483,333 lekë pa TVSH
"Oltjan Hastoçi" me vlerën 486,000 lekë pa TVSH
"Infosoft Office" me vlerën 487,000 lekë pa TVSH
Operatorët Ekonomikë të skualifikuar janë:
"Office Center" (për arsye se vlera e ofertuar është më e lartë se Fondi Limit) (nuk specifikohet sa)
"Librari Dyrrahu" (vlera e ofertuar është më e lartë se Fondi Limit) (nuk specifikohet sa)
"Magrip Bana" (vlera e ofertuar është më e lartë se Fondi Limit) (nuk specifikohet sa)
"Euro Office" (vlera e ofertuar është më e lartë se Fondi Limit) (nuk specifikohet sa)
"Paera" (në kushtet e konfliktit të interesit)
"Përparim Agimi" (në kushtet e konfliktit të interesit)
Me shkresën nr. 738/8 prot., datë 05.10.2023 OE fitues Marketing Distribution ka paraqitur pranë ASHSH dokumentacionin e kërkuar, konkretisht:[Përshkrimi i ofertës sipas formularit Nr.3 Ftesa për Ofertë; Deklarata e Transportit; Deklarata e Konformitetit; Vërtetimi për pagim detyrimesh tatimore; Vërtetimi për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; Ekstrakti i Regjistrit Tregtar ku përshkruhet objekti i prokurimit si pjesë e veprimtarisë tregtare; Vërtetimi nga OSHE Group (nr. 6589/1 prot., datë 26.09.2023) për shlyerjen e gjithë detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike; Kopje e Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe kopje për zgjidhjen softëare-ike në përdorim].
Me shkresën nr. 738/9 prot., datë 05.10.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit OE Marketing Distribution. I shpallur fitues në sistemin elektronik më datë 04.10.2023
Me shkresën nr. 738/10 prot., datë 09.10.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash ku specifikohet se nuk ka patur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.
Me shkresën nr. 738/11 prot., datë 12.10.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, ku dhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit u konstatua se malli është në përputhje me specifikimet teknike.
Me Fletë-Hyrjen nr. 5, datë 12.10.2023 (firmosur nga magazinieri, njëkohësisht edhe anëtar i komisionit znj. Sara Bardhoku) ka hyrë malli i prokuruar në ASHSH.
Nga Platforma Qendrore e Faturave më datë 12.10.2023 është lëshuar fatura tatimore nr. 8545/2023 për marrjen në dorëzim të mallit me shumë totale neto prej 359.999 lekë pa TVSH ose 431.999 lekë me TVSH.
Nga auditimi i kësaj praktike rezultoi se:

Nga data e shpalljes fitues në sistemin elektorinik të OE Marketing Distribution më datë 04.10.2023 e deri në datën e lëvrimit të mallit nga ana e këtij OE datë 12.10.2023 kanë kaluar 8 ditë kalendarike (6 ditë pune).

Ky veprim është në kundërshtim me shkresën nr. 738/4 prot., datë 03.10.2023 të ASHSH Ftesa për Ofertë, ku specifikohet se: "Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës: ***do të jetë brenda 3 (tre) ditëve duke filluar nga momenti i konfirmimit si fitues në sistemin elektronik.***

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit.

Malli objekt prokurimi është lëvruar brenda afatit 3-ditor të përcaktuar në Ftesën për Ofertë. 150 Në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", afati për lëvrimin e mallit fillon nga data e konfirmimit të shpalljes si fitues të operatorit ekonomik (OE), pas përfundimit të afatit 2-ditor të pritjes për paraqitjen e ankesave, në përputhje me pikën "c" të nenit 96, "Periudha e pritjes", dhe jo nga momenti i publikimit të fituesit në sistemin elektronik të prokurimeve. Pas përfundimit të këtij afati dhe konfirmimit të shpalljes fitues të operatorit ekonomik, është bërë e mundur lëvrimi i mallit/shërbimit objekt prokurimi. Konkretisht, më datë 09.10.2023 ka përfunduar afati i pritjes së ankesave nga operatorët ekonomikë, ndërsa më datë 12.10.2023 është kryer lëvrimi i mallit, brenda afatit 3-ditor të përcaktuar në Ftesën për Ofertë. Në datë 05.10.2023, në orën 15:29 (referuar pamjeve të sistemit të APP, që përkon me ditën pune e Enjte), që do të thotë dita e parë e ankimit ezaurohet në datën 06.10.2023, ditë e Premte.

Datat 07.10.2023 dhe 08.10.2023, përkojnë me ditët e Shtunë dhe e Djelë, ndaj dita e dytë e pritjes së ankesave është data 09.10.2023, dita e Henë, në orën 15:29, duke respektuar afatin të paktën 2 ditë të pritjes së ankesave. Pra sqarojmë dhe një herë se, Institucioni funksionon me orar zyrtar e hene – e enjte 08:00-16:30 dhe e premte 08:00-14:00, duke qënë se afati i pritjes se ankesave ka përfundur në datë 09.10.2023, ora 15:29, afati 3 ditor për lëvrimin e mallit fillon nga data 10.10.2023, duke marrë në konsideratë orarin zyrtar të funksionimit të institucionit. Në respektim të afatit të lëvrimit, malli është bërë hyrje në institucion në datë 12.10.2023 Në të njëjtën datë është prerë fatura tatimore dhe është lidhur kontrata me subjektin fitues, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Nga ana e grupit të auditimit theksohet se bazuar në shkresën e Ftesës për Ofertë nr. 738/4 prot., e datës 03.10.2023, vetë Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si moment i shpalljes fitues, çastin e konfirmimit në sistemin elektronik, pra datën 04.10.2023. Duke marrë parasysh afatin 2 ditor të pritjes së ankesave, me datë 06.10.2023 llogaritet shpallja e fituesit pas këtij afati. Malli i prokuruar duhej të hynte me datë 11.10.2023. sërish ka vonesë në afat të përcaktuar.

Për këtë arsye pretendimi juaj, **nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit**.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1. **Znj. Adela Duni**, në cilësinë e Kryetarit të KVO me Blerje të Vogla.
2. **Znj. Orlanda Murati**, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla.
3. **Znj. Spartak Kodra**, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla.

2. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje nafte (Gazoil D1)".

Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (Kpvv) ka marrë kërkesë për blerje karburanti me shkresën nr. 543 prot., datë 09.06.2023.
Është mbajtur procesverbali me nr. 543/1 prot., datë 12.06.2023 për specifikimet teknike dhe llogaritja e fondit limit.
Vlera e përllogaritur për Fondin Limit është **499,000 lekë** pa TVSH. Përllogaritja vjen nga 3 ofertues ekonomikë (OE), pasi është studiuar çmimi i tregut për karburant (naftë diesel), përkatësisht:
Përllogaritja e çmimit
"Eida Skënderi G" SHPK, me çmimin 147 lekë/litër pa TVSH
"Gega Center" SHPK me çmimin 147 lekë/litër pa TVSH
"EOS" sh.a me çmimin 146 lekë/litër pa TVSH
Çmimi mesatar 147 lekë/litër pa TVSH
Bazuar në regjistrin e parashikimit, ku është parashikuar një fond prej 500,000 lekësh pa TVSH për objektin "Blerje karburanti", komisioni përllogariti se me këtë çmim mesatar, sasia e naftës që do prokurohet është 3400 litra.
Përllogaritja e fondit limit
"Eida Skënderi G" SHPK, me çmimin 147 lekë/litër pa TVSH x 3400 litra – 499.800 lekë pa TVSH
"Gega Center" SHPK me çmimin 147 lekë/litër pa TVSH x 3400 litra – 499.800 lekë pa TVSH
"EOS" sh.a me çmimin 146 lekë/litër pa TVSH x 3400 litra – 496.400 lekë pa TVSH
Fondi limit : 499.000 lekë pa TVSH
Me shkresën nr. 543/3 prot., datë 15.06.2023, Urdhri nr. 32 i Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur urdhri për prokurimin me vlerë të vogël "Karburant Diesel EN 590 10 PPM".
Me nr.543/4 prot., datë 15.06.2023 është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë ku paraqiten specifikimet teknike dhe kriteret kualifikuese.
Me shkresë nr. 543/5 prot., datë 15.06.2023 është mbajtur dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.
Me shkresën nr. 543/6 prot., datë 15.06.2023 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj.Adela Duni në cilësinë e kryetares që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).
Me procesverbalin nr.738/7 prot., datë 16.06.2023 si dhe në sistemin online të APP, rezultoi se kanë shprehur interes 3 OE, prej së cilës u skualifikua 1 OE:
"DAS Oil" – skualifikuar për arsye se vlera e ofertuar nga OE është anomalisht më e ulët
"A&T" SHPK– vlera 482,800 lekë pa TVSH
"Gega Center GKG" – vlera 498,666 lekë pa TVSH
OE fitues u shpall "A&T" SHPK
Me shkresën nr. 543/8 prot., datë 16.06.2023 u mbajt procesverbali për kalimin te OE i radhës ku deklarohet se OE "A&T" SHPK për arsye subjektive tërhiqet nga gara.
Me shkresën nr. 543/9 prot., datë 19.06.2023 OE fitues "Gega Center GKG", ka paraqitur pranë ASHSH dokumentacionin e kërkuar.
Ekstrakti i Regjistrit Tregtar ku përshkruhet objekti i prokurimit si pjesë e veprimtarisë tregtare
Deklaratë e OE se është zotërues e mbi 84 stacionesh karburanti me shpërndarje në gjithë territorin e Republikës, së bashku me formularin e ofertës.
Vërtetimin nga ana e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial, se nuk ka asnjë masë administrative për shkelje të cilësisë së karburanteve.
Kopje e Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe kopje për zgjidhjen softëare-ike në përdorim.
Raport Testimi S SH EN 590:2022 (nr. 2807/2 prot., 2807/3 prot., 2807/4 prot., datë 14.04.2023) lëshuar nga Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial, Sektori i Laboratorit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI SHTETËROR PËR SHKELJET ADMINISTRATIVE
SEKRETARIA

Kontratë Bashkëpunimi
Konfirmimi i llogarisë bankare
Certifikata e pronësisë
Certifikata për sigurinë nga zjarri
Polica e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta (general liability insurance)
Vërtetimi teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në stacionet e tregtimit të karburanteve.
Me shkresën nr. 543/10 prot., datë 20.06.2023 është shpallur fitues në sistemin elektronik dhe është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit OE "Gega Center GKG".
Me shkresën nr. 543/11 prot., datë 20.06.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash ku specifikohet se nuk ka patur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.
Me shkresën nr. 543/12 prot., datë 20.06.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, ku dhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit u konstatua se malli është në përputhje me specifikimet teknike si dhe ngritja e Komisionit për Marrjen në Dorëzim me përbërje si më poshtë: [znj.Ilirjana Hasanllari; znj. Ueda Brahimllari (Përgjegjëse për magazinën); znj. Entela Bytyçi].
Konstatohet se shërbimi rezultoi në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e AK. Komisioni i Marrjes në Dorëzim ka plotësuar Deklaratat e Konfliktit të Interesit.
Me shkresën nr. 543/14 prot., datë 23.06.2023 është lidhur kontrata për Furnizim me Karburant mes ASHSH (Blerësi) dhe "Gega Center GKG" (Furnizuesi).
Me shkresën nr. 543/15 prot., datë 23.06.2023 është lidhur edhe plani i zbatimit të kontratës mes palëve.
Me Fletë-Hyrjen nr. 2, datë 23.06.2023 (firmosur nga magazinieri Ueda Brahimllari) ka hyrë malli i prokuruar në ASHSH (fotokopje e vulosur)
Më datë 23.06.2023 është lëshuar fatura tatimore nr. 388 për marrjen në dorëzim të mallit me shumë totale neto prej 498,665 lekë pa TVSH ose 598,399 lekë me TVSH.

3. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje bileta transporti ajror".

Me shkresën nr. 79 prot., datë 11.01.2023 nga ana e International Road Federation (Federata Ndërkombëtare e Rrugëve) vjen ftesa për trajnim drejtuar ASHSH, që do të zhvillohet në datat 23.02.2023 - 25.02.2023 dhe datat 13.04.2023 -15.04.2023 në Londër, Angli.
Nga ana e znj. Ueda Brahimllari me detyrë sekretare e Drejtorit të Përgjithshëm i drejtohet me shkresën nr. 79/1 prot., datë 13.01.2023 Drejtorit të Përgjithshëm znj. Egra Ibrahimi duke kërkuar përcaktimin e punonjësve pjesëmarrës në trajnimin e mësipërm.
Me shkresën nr. 79/2 prot., datë 17.01.2023 përcaktohet se grupi i parë me përfaqësues znj.Entela Bytyçi në datat 23.02.2023 - 25.02.2023.
Grupi i dytë me përfaqësues znj. Klodiana Guci, znj. Arlinda Drenofci, z. Besnik Hysaj, znj. Sidorela Qato, znj. Entela Bytyçi për datat 13.04.2023 - 15.04.2023.
Me shkresën nr. 79/6 prot., nga ana e grupit të trajnimit i kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm anulimi i paraqitjes në trajnim me arsyen e ngarkesës në punë dhe mos pajisja në kohë me viza për udhëtim.
Me shkresën nr. 79/7 prot., datë 28.03.2023 nga ana e Digital Construction Ëeek paraqitet kërkesa për pjesëmarrje në trajnimin me temë "Innovation in the built environment", pranë ASHSH e mbajtur në datat 17.05.2023 -18.05.2023 në Londër, Angli.

Me shkresën nr. 79/8 prot., datë 28.03.2023 nga ana e grupit të shërbimit/trajnimit i paraqitet kërkesë Drejtoreshës së Përgjithshme për përcaktimin e punonjësve që do marrin pjesë në këtë trajnim.
Me shkresën nr. 79/8 prot., datë 28.03.2023 Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse konfirmon grupin për pjesëmarrjen në këtë trajnim me përfaqësues: znj. Entela Bytyçi, znj. Arlinda Drenofci, z. Besnik Hysaj, znj. Sidorela Qato, znj. Adela Duni.
Nisja nga Tirana paradite, në datën 16.05.2023 dhe kthimi në Tiranë në darkë datë 18.05.2023.
Me shkresën nr. 79/10 prot., datë 30.03.2023 miratohet Urdhri nr. 59 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm për përfaqësuesit që do marrin pjesë në këtë trajnim.

Procedura e prokurimit

Me shkresën nr. 79/11 prot., datë 04.05.2023 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, kërkohet miratimi dhe nisja e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje transporti ajror".
Nga ana e komisionit të prokurimit me blerje të vogla janë plotësuar deklaratat e konfliktit të interesit.
Me shkresën nr. 79/12 prot., datë 04.05.2023, miratohet Urdhri nr. 68 i Titullarit të Autoritetit Kontraktor konfirmimi për prokurimin e biletave të transportit ajror ndërkombëtar si më poshtë:
Tiranë-Londër 5 (pesë) copë
Londër-Tiranë 4 (katër) copë
Është mbajtur procesverbali me nr. 79/14 prot., datë 04.05.2023 për specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta.
Me shkresën nr. 79/16 prot., datë 04.05.2023 është mbajtur procesverbali për vlerësimin e ofertave ekonomike. Bazuar në këtë procesverbal si dhe në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) kanë shfaqur interes 3 ofertues ekonomikë (OE),përkatësisht:
"Arlo Travel-Blue Tour Operator" - 165,536 lekë pa TVSH
"Amadeus Travel and Tours" - 194,900 lekë pa TVSH
"Explorer Travel and Tours" - 224,000 lekë pa TVSH
Fitues është shpallur OE "Arlo Travel-Blue Tour Operator" me vlerën 165,536 lekë pa TVSH.
Janë mbajtur deklaratat e konfliktit të interesit të komisionit prokurimit me vlerë të vogël (në këtë rast të cilësuar edhe si Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave) për operatorin ekonomik fitues.
Me procesverbalin nr. 79/17 prot., datë 04.05.2023 është konfirmuar fitues OE "Arlo Travel-Blue Tour Operator".
Bazuar në Platformën Qendrore të Faturave datë 04.05.2023 është lëshuar fatura nr. 671/2023 me shumë totale 165,536 lekë pa TVSH.
Bletat e prera nga ane e OE "Arlo Travel-Blue Tour Operator" me kompaninë "Ëizz Air".

Ftesa për Trajnim

Me shkresën nr. 962 prot., datë 30.11.2023 nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tregjeve të Brendshme, vjen ftesa për trajnim drejtuar ASHSH, që do të zhvillohet në datën 06.12.2023 në Bruksel, Belgjikë.
Nga ana e znj. Arlinda Drenofci me detyrë Drejtoreshë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i drejtohet me shkresën nr. 962/1 prot., datë 30.11.2023 Drejtorit të Përgjithshëm znj. Egra Ibrahimi ku përcaktohen numërat e punonjësve pjesëmarrës në trajnimin e mësipërm.
Përkatësisht:
Znj. Arlinda Drenofci, znj. Adela Duni, znj. Klodjana Lika, znj. Orlanda Murati, znj. Ilirjana Hasanllari, znj. Sidorela Qato.

Procedura e prokurimit

Me shkresën nr.962/2 prot., i po kësaj date kërkohet fillimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje bileta për transport ajror".

Me shkresën nr. 962/3 prot., datë 01.12.2023 lëshohet Urdhri nr. 164 i Titullarit të Autoritetit Kontraktor për prokurimin e blerjen e biletave me destinacion si më poshtë:
Tiranë-Bruksel 6 (gjashtë) copë
Bruksel-Tiranë 6 (gjashtë) copë
Në shkresën nr. 962/4 prot., datë 01.12.2023 paraqitet Ftesa për Ofertë dhe me procesverbalin nr. 962/5 prot., argumentohen specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.
Me shkresën 962/6 prot., autorizohet znj. Adela Duni si person përgjegjës për kryerjen e veprimeve në sistemin elektronik të APP.
Komisioni i prokurimit me blerje të vogla ka plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit.
Me shkresën nr. 962/7 prot., datë 01.12.2023 është mbajtur procesverbali për vlerësimin e ofertave ekonomike. Bazuar në këtë procesverbal si dhe në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) kanë shfaqur interes 5 ofertues ekonomikë (OE),përkatësisht: "Arlo Travel-Blue Tour Operator" - 114,900 lekë pa TVSH/ "Spirit Travel and Tours" - 127,823 lekë pa TVSH/ "Kelvin Travel" - 138,000 lekë pa TVSH/ "Amadeus Travel and Tours" – 189,000 lekë pa TVSH/ "Explorer Travel and Tours" – 315,190 lekë pa TVSH
Fitues është shpallur OE "Arlo Travel-Blue Tour Operator" me vlerën 114,900 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 962/8 prot., është mbajtur procesverbali për skualifikimin e OE fitues "Arlo Travel-Blue Tour Operator", për arsye nuk plotëson një nga kriteret e veçanta të kualifikimit të parashikuara në procesverbalin nr. 962/5 prot., konkretisht pikën 4 të Kreut II ku shprehet se *"Për efekt të mos cenimit të udhëtimit deri në destinacion për shkak të vonesave të linjave ajrore, është kryer që udhëtimi të kryhet me linjë direkte me të njëjtin kompani fluturimi."*
Kalohet te OE radhës .
Me shkresën nr. 962/9 mbahet procesverbali për tërheqjen nga gara të OE të radhës Spirit Travel and Tours për arsye të ndryshimit të çmimit të biletës.
Kalohet te OE radhës .
Me shkresën nr. 962/10 mbahet procesverbali për tërheqjen nga gara të OE të radhës "Kelvin Travel" për arsye të ndryshimit të çmimit të biletës.
Kalohet te OE radhës.
Fitues është shpallur OE "Amadeus Travel and Tours" me vlerën 189,000 lekë pa TVSH.
Nga ana e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël është mbajtur deklarata për konfliktin e interesit.
Me shkresën nr. 962/11 prot., datë 01.12.2023 OE "Amadeus Travel and Tours" ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë pranë ASHSH.
Me shkresën nr. 962/12 prot., datë 01.12.2023 nga komisioni i prokurimit për blerje të vogla është mbajtur procesverbali për konfirmim fituesi, duke i plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara në ftesën për ofertë.
Bazuar në Platformën Qendrore të Faturave datë 01.12.2023 është lëshuar fatura nr. 1283/2023 me shumë totale 189,000 lekë pa TVSH.

Ftesa për Trajnim

Me shkresën nr. 979 prot., datë 13.12.2023 nga ana e znj. Blerina Gjonaj, specialiste pranë Sektorit të Kontrollit, Drejtoria e Kontrollit të Dokumentacionit dhe Vlerësimit, vjen ftesa për trajnim me temë "European Science Diplomacy conference toëards a european approach to science and democarcy" drejtuar ASHSH, që do të zhvillohet në datën 19.12.2023 në Madrid, Spanjë.
Me shkresën nr. 979/1 prot., datë 13.12.2023 kërkohet lëshimi i urdhrit konfirmues nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm për pjesëmarrjen në këtë konferencë.
Me shkresën nr. 979/2 prot., datë 13.12.2023, Urdhri 169 miraton në këtë pjesëmarrje znj. Denada Dosti, znj. Selmina Varfi, znj. Blerina Gjonaj, znj. Areda Koçi.

Procedura e prokurimit

Me shkresën nr. 979/3 prot., datë 14.12.2023 hartohet memo drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm për fillimin e procedurës prokurimit "Blerje bilete për transport ajror" me fond limit të mbetur nga dy udhëtimet e kryera për 2023. **Total - 245.464 lekë.**
Me shkresën nr. 979/4 prot., datë 14.12.2023 lëshohet Urdhri nr. 170 i Titullarit të Autoritetit Kontraktor për prokurimin e blerjen e biletave me destinacion si më poshtë:
Tiranë-Madrid 4 (katër) copë
Madrid-Tiranë 4 (katër) copë
Në shkresën nr. 979/5 prot., datë 14.12.2023 paraqitet Ftesa për Ofertë dhe me procesverbalin nr.979/6 prot., argumentohen specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim.
Komisioni i prokurimit me blerje të vogla ka plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit.
Me shkresën nr. 979/8 prot., datë 14.12.2023 është mbajtur procesverbali për vlerësimin e ofertave ekonomike. Bazuar në këtë procesverbal si dhe në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) kanë shfaqur interes 5 ofertues ekonomikë (OE) dhe është skualifikuar 1 (një) ofertues, përkatësisht:
"Amadeus Travel and Tours" - 124.110 lekë pa TVSH
"2 Feleqi" - 199,500 lekë pa TVSH
"Kelvin Travel" - 228,000 lekë pa TVSH
"Odisea Travel and Tours" – 189,000 lekë pa TVSH
OE i skualifikuar "Explorer Travel and Tours" (për arsye se vlera e ofertuar mbi Fondin Limit)
Fitues është shpallur OE "Amadeus Travel and Tours" me vlerën 124,110 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 979/10 prot., datë 14.12.2023 nga komisioni i prokurimit për blerje të vogla është mbajtur procesverbali për konfirmim fituesi, duke i plotësuar të gjitha kushtet e parashikuara në ftesën për ofertë.
Bazuar në Platformën Qendrore të Faturave datë 15.12.2023 është lëshuar fatura nr. 1336/2023 me shumë totale 124.110 lekë pa TVSH.

4. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje Tonerash për fotokopje dhe printera".
Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (Kpvv) ka marrë kërkesë për blerje malli "Blerje tonerash për fotokopje dhe printera" me shkresën nr. 737 prot., datë 18.09.2023.
Është mbajtur procesverbali me nr. 737/1 prot., datë 27.09.2023 për specifikimet teknike dhe llogaritja e fondit limit.
Vlera e përllogaritur për Fondin Limit është **495,000 lekë** pa TVSH. Përllogaritja vjen nga 3 ofertues ekonomikë (OE), përkatësisht:
"Infosoft Office" me çmimin 489,800 lekë pa TVSH
"Gjergji Kompjuter" me çmimin 497,900 lekë pa TVSH
"Copier and Computer Center" me çmimin 497,300 lekë pa TVSH
Me shkresën nr. 737/3 prot., datë 02.10.2023, Urdhri nr. 132 i Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur urdhri për prokurimin me vlerë të vogël "Blerje tonerash për fotokopje dhe printera"
Me nr.738/4 prot., datë 02.10.2023 është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.
Me shkresë nr. 737/5 prot., datë 02.10.2023 është mbajtur dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
Me shkresën nr. 737/6 prot., datë 02.10.2023 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj.Adela Duni në cilësinë e kryetares që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).
Me procesverbalin nr.737/7 prot., datë 04.10.2023 si dhe në sistemin online të APP, rezultoi se kanë shprehur interes 21 OE, prej së cilës u pranuan 15 ofertat e mëposhtme:
"Infosoft Office" me vlerën 247,500 lekë pa TVSH

"Adastra" me vlerën 250,000 lekë pa TVSH
"ADD Print" me vlerën 250,000 lekë pa TVSH
"BluePrint Technologies" me vlerën 250,000 lekë pa TVSH
"Ervin Luzi" me vlerën 289,000 lekë pa TVSH
"IT Gjergji Kompjuter" me vlerën 310,000 lekë pa TVSH
"Read 2000" me vlerën 325,000 lekë pa TVSH
"Boa Sorte" me vlerën 389,000 lekë pa TVSH
"Arlind Dogjani" me vlerën 416,667 lekë pa TVSH
"Oltjan Hastoçi" me vlerën 448,000 lekë pa TVSH
"JUPITER online trade" me vlerën 450,000 lekë pa TVSH
"Olsi motors and motors" me vlerën 464,000 lekë pa TVSH
"Start 2022" me vlerën 466,667 lekë pa TVSH
"HB Groupconstruction" me vlerën 469,000 lekë pa TVSH
"Colombo" me vlerën 489,000 lekë pa TVSH
Operatorët Ekonomikë të skualifikuar janë:
"Marjo Mondi" (për arsye se vlera e ofertuar është më e lartë se Fondi Limit) (nuk specifikohet sa)
"Librari Dyrrahu" (vlera e ofertuar është nën 50% të Fondit Limit) (nuk specifikohet sa)
"K.E.B" SHPK (objekti i aktivitetit nuk përputhet me objektin e prokurimit)
"Marketing and Distribution" (vlera e ofertuar është nën 50% të Fondit Limit) (nuk specifikohet sa)
"Jueli" (objekti i aktivitetit nuk përputhet me objektin e prokurimit)
"Eldi Qafmolla" (vlera e ofertuar është nën 50% të Fondit Limit) (nuk specifikohet sa)
Me shkresën nr. 737/8 prot., datë 05.10.2023 OE fitues Infosoft Office- ka paraqitur pranë ASHSH dokumentacionin e kërkuar: [Certifikatë fiskalizimi "Infosoft Office SHPK"; Certfiikatë fiskalizimi "IBS"; Kontratë fiskalizimi; Vërtetimet gjyqsore dhe penale; Vërtetime tatimore; Vërtetim OSHE; Deklaratë Origjine; Deklaratë për specifikime teknike; QKB + status aktiv; Shtojca nr.1 formular oferte; IBAN].
Me shkresën nr. 737/9 prot., datë 05.10.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit OE "Infosoft Office". I shpallur fitues në sistemin elektronik më datë 04.10.2023.
Me shkresën nr. 737/10 prot., datë 09.10.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash ku specifikohet se nuk ka patur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.
Me shkresën nr. 737/11 prot., datë 12.10.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, ku dhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit u konstatua se malli është në përputhje me specifikimet teknike.
Nga ana e Komisionit për marrjen në dorëzim janë plotësuar deklaratat e konfliktit të interesit.
Me shkresën nr. 737/12 prot., datë 10.10.2023 është lidhur mes OE "Infosoft Office" dhe AK ASHSH kontrata për blerje mallrash, për objektin që prokurohet.
Me Fletë-Hyrjen nr. 4 datë 10.10.2023 (firmosur nga magazinieri, njëkohësisht edhe anëtar i komisionit znj. Sara Bardhoku) ka hyrë malli i prokuruar në ASHSH.
Nga Platforma Qendrore e Faturave më datë 10.10.2023 është lëshuar fatura tatimore nr.14358/2023 për marrjen në dorëzim të mallit me shumë totale neto prej 247,500 lekë pa TVSH ose 297,000 lekë me TVSH.

5. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Lyerje e ambjenteve të ASHSH-së".

Me Memon nr. 895 prot., datë 31.10.2023 znj. Arlinda Drenofci i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH znj. Egra Ibrahimi me kërkesën për lyerjen e ambjenteve të institucionit.
Me shkresën nr. 895/1 prot., datë 23.11.2023 lëshohet Urdhri nr. 159 nga Drejtori i Përgjithshëm për ngritjen e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike.
Ky komision përbehet nga: z. Albian Marku, znj. Sidorela Qato, znj. Entela Bytyçi.
Me shkresën nr. 895/2 prot., datë 23.11.2023 Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike ka hartuar specifikimet e nevojshme bazuar në manuale ligjore dhe libra këshillues.
Me shkresën nr. 895/3 prot., datë 24.11.2023 është mbajtur procesverbali nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, për specifikimet teknike dhe përllogaritjen e Fondit Limit, ku mbështetur në çmimet e tregut aktual dhe parashikimit të fondit bazuar në Regjistrin e Parashikimit për vitin 2023 sugjerohet që Fondi Limit të jetë në vlerën 250,000 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 895/5 prot., datë 24.11.2023 është lëshuar Urdhri nr. 160 i Drejtorit të përgjithshëm për nisjen e procedurës së prokurimit.
Me nr. 895/6 prot., datë 24.11.2023 është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.
Me shkresë nr. 895/7 prot., datë 24.11.2023 është mbajtur dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
Me shkresën nr. 895/8 prot., datë 02.10.2023 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj. Adela Duni në cilësinë e kryetares që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).
Me procesverbalin nr. 895/9 prot., datë 30.11.2023 si dhe në sistemin online të APP, rezultoi se kanë shprehur interes 42 OE, prej së cilës u pranuan 20 ofertat e mëposhtme: "Construction Albania" me vlerën 125,500 lekë pa TVSH/ "Alfred Bënja" me vlerën 134,300 lekë pa TVSH/ "K.E.B" SHPK me vlerën 159,000 lekë pa TVSH/ "Martini Construction" me vlerën 174,500 lekë pa TVSH/ "MENI" me vlerën 176,914 lekë pa TVSH/ "APIS Construction" me vlerën 200,000 lekë pa TVSH/ "Olsi Motors and Motors" me vlerën 200,000 lekë pa TVSH/ "ATOPI" me vlerën 219,900 lekë pa TVSH/ "ENI" SHPK me vlerën 220,000 lekë pa TVSH/ "EA Engineering" me vlerën 220,417 lekë pa TVSH/ "Ervin Zenelaj" me vlerën 225,000 lekë pa TVSH/ "3E Complex" me vlerën 230,000 lekë pa TVSH/ "ALB PRO" me vlerën 230,000 lekë pa TVSH/ "3V Asllani" me vlerën 232.000 lekë pa TVSH/ "START-2022" me vlerën 233,333 lekë pa TVSH/ "AMI ARLI" me vlerën 235,900 lekë pa TVSH/ "I2A" me vlerën 244,900 lekë pa TVSH/ "HEP-2012" me vlerën 245,000 lekë pa TVSH/ "NDREGJONI" me vlerën 249,998 lekë pa TVSH/ "ALBSTRUKTUR" me vlerën 250,000 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 895/10 prot., datë 01.12.2023 OE fitues "Construction Albania" - ka paraqitur pranë ASHSH dokumentacionin e kërkuar.
Me shkresën nr. 895/11 prot., datë 01.12.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit OE "Construction Albania". I shpallur fitues në sistemin elektronik më datë 30.11.2023.
Me shkresën nr. 895/12 prot., datë 05.12.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash ku specifikohet se nuk ka patur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.
Me shkresën nr. 895/13 prot., datë 05.12.2023 është lidhur mes OE Construction dhe AK ASHSH kontrata për blerje mallrash, për objektin që prokurohet.
Me shkresën nr. 895/15 prot., datë 11.12.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për kryerjen e shërbimit, ku dhe shprehet puna e kryer brenda afateve kohore dhe në përputhje me specifikimet e kërkuara.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA KOMBËTARE PËR SHOQËRINË · SEKRETARIA

Nga Platforma Qendrore e Faturave më datë 11.12.2023 është lëshuar fatura tatimore nr. 45/2023 për kryerjen e shërbimit me shumë totale neto prej 125,500 lekë pa TVSH ose 150,600 lekë me TVSH.

Nga auditimi i kësaj dosjeje nuk është konstatuar ndonjë problematikë.

6. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje pjesësh këmbimi për materiale profilaktike".

Me shkresën nr. 489 prot., datë 22.05.2023 shoferi i institucionit të ASHSH Armando Kaçeli i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse mbi konstatimin e problematikave të hasura në automjetin e punës, me markë Hyundai, tip GDH, modeli I30 i vitit 2014.

Me shkresën nr. 489/1 prot., datë 18.09.2023 ASHSH i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me kërkesën për vënien në dispozicion të një inxhinieri mekanik për zgjidhjen e problematikës.

Me shkresën nr. 489/2 prot., datë 09.11.2023 Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, në moskthimin e përgjigjes nga DPSHTRR, procedimin me kontrollin e makinës në një pikë servisi.

Me procesverbalin me nr. 489/9 prot., datë 10.11.2023 nga ana e mekanikut Erald Kordha u konstatuan problematikat e mjetit si dhe nevoja e pjesëve për ndërrim të menjëhershëm.

Me shkresën nr. 489/4 prot., datë 16.11.2023 është mbajtur procesverbali nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, për specifikimet teknike dhe përllogaritjen e Fondit Limit, ku mbështetur në çmimet e tregut aktual pas ofertave të marra nga 3 servise të ndryshme sugjerohet që vlera e përllogaritur për Fondin Limit të jetë 478,402 lekë pa TVSH. Përllogaritja vjen nga 3 ofertues ekonomikë (OE), përkatësisht:

"Leonard Muhameti" me çmimin 416,666 lekë pa TVSH

"Albanian Motors" SHPK me çmimin 560,208 lekë pa TVSH

"Myslym Baboqi" me çmimin 458,333 lekë pa TVSH

Me shkresën nr. 489/6 prot., datë 21.11.2023 është lëshuar Urdhri nr. 157 i Drejtorit të përgjithshëm për nisjen e procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 489/7 prot., datë 21.11.2023 është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.

Me shkresë nr. 489/8 prot., datë 21.11.2023 është mbajtur dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

Me shkresën nr. 489/9 prot., datë 21.11.2023 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj.Adela Duni në cilësinë e kryetares që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).

Me procesverbalin nr. 489/10 prot., datë 22.11.2023 si dhe në sistemin online të APP, rezultoi se kanë shprehur interes 14 OE, prej së cilës u pranuan 7 ofertat e mëposhtme: "Compi Tel" me vlerën 247,000 lekë pa TVSH/ "Sorgiena Agaj" me vlerën 395,000 lekë pa TVSH/ "ATOPI" me vlerën 448,800 lekë pa TVSH/ "Olsi Motors" me vlerën 464,000 lekë pa TVSH/ "K.E.B" SHPK me vlerën 465,000 lekë pa TVSH/ "3V Asllani" me vlerën 465,000 lekë pa TVSH/ "O&A" me vlerën 470,500 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 489/11 prot., datë 23.11.2023 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka kaluar në OE e radhës Sorgiena Agaj, pasi OE fitues "CompiTel" nuk u paraqit për të dorëzuar dokumentacionin.

Me shkresën nr. 489/12 prot., datë 24.11.2023 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka kaluar në OE e radhës "ATOPI", pasi OE fitues Sorgiena Agaj nuk u paraqit për të dorëzuar dokumentacionin.

Me shkresën nr. 489/13 prot., datë 30.11.2023 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka kaluar në OE e radhës Olsi Motors, pasi OE fitues ATOPI nuk u paraqit për të dorëzuar dokumentacionin.
Me shkresën nr. 489/14 prot., datë 01.12.2023 OE fitues Olsi Motors - ka paraqitur pranë ASHSH dokumentacionin e kërkuar.
Me shkresën nr. 489/15 prot., datë 01.12.2023, është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit OE Construction Albania. I shpallur fitues në sistemin elektronik më datë 30.11.2023.
Me shkresën nr. 489/16 prot., datë 05.12.2023 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash ku specifikohet se nuk ka patur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.
Me shkresën nr. 489/17 prot., datë 05.12.2023 është lidhur mes OE Construction dhe AK ASHSH kontrata për blerje mallrash, për objektin që prokurohet.
Me shkresën nr. 489/18 prot., datë 06.12.2023 është lëshuar nga Urdhri nr. 166 nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH për caktimin e personit përgjegjës për dorëzimin dhe marrjen e automjetit dhe mbikëqyrjen e kontratës. Personi përgjegjës u caktua Xhuljano Tota, i cili plotësoi edhe formularin e deklarimit të konfliktit të interesit.
Me shkresën nr. 489/20 prot., është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave.
Nga Platforma Qendrore e Faturave më datë 12.12.2023 është lëshuar fatura tatimore nr.45/2023 për kryerjen e shërbimit me shumë totale neto prej 464.000 lekë pa TVSH ose 556.800 lekë me TVSH.
Nga auditimi i kësaj procedure u konstatuan problematikat e mëposhtme:
Pasi janë parë dokumentat e sjellë nga OE fitues "Olsi Motors", janë konstatuar se mungojnë dokumentet e mëposhtme:
Pika 12 e Kritereve për Kualifikim sipas Fteses për Ofertë – Deklarata se pjesët e këmbimit që do të përdoren përiparimin e automjeteve do jenë të reja dhe origjinale
Pika 14 e Kritereve për Kualifikim sipas Ftesës për Ofertë- Të ketë leje mjedisore lëshuar nga QKL (Qendra Kombëtare e Licensimit) për "Servis makinash", në fuqi sipas kërkesave të ligjit.
Sic është theksuar në Ftesën për Ofertë "mospërmbushja e të paktën një prej kërkesave përbën kusht për skualifikim dhe kalim te OE vijues."
Veprimi vjen në kundërshtim me shkresën nr 489/7 prot., datë 21.11.2023 Ftesa për Ofertë si dhe me *Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 të APP "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 18 ku shprehet se: " Kur ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor të përcaktuar në Ftesën për Ofertë,* ***ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor në Ftesën për Ofertë****, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e fundit të mbetur në klasifikim.*
Për rrjedhojë AK ASHSH, duhej të kishte skualifikuar OE fitues "Olsi Motors" dhe të procedonte me OE e radhës, në këtë rast "K.E.B" SHPK.
Në procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve specifikohet vetëm afati i zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit, në asnjë paragraf nuk shprehet nëse pjesët e këmbyera i përshtaten standardeve të parashikuara Ftesën për Ofertë, konkretisht Kapitullit të Specifikimeve Teknike.
Veprim në kundërshtim me *Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 të APP "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 18, paragrafi dytë ku shprehet se: " Kur ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor të përcaktuar në Ftesën për Ofertë,* ***ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor në Ftesën për Ofertë****, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i*

dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e fundit të mbetur në klasifikim.
Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, nëpërmjet një procesverbali i mbajtur për këtë qëllim."
Veprim në kundërshtim me *Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" pika 45 ku shprehet se: "Kur ka mospërputhje ndërmjet sasive të mallrave të shënuara në fletëdalje, në faturat ose në dokumentet e tjera shoqëruese dhe sasive efektive që gjenden brenda ambalazhit,* ***si dhe në cilësi, llojshmëri, qënien e plotë dhe markën e prodhimit, komisioni ndërpret verifikimin*** *dhe lajmëron shitësin që të paraqitet brenda një afati kohor te përcaktuar (në varësi te vendndodhjes brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike ne marrëdhënie me furnitorin).*
Për rrjedhojë, personi i autorizuar për marrjen në dorëzim të mallit/shërbimit nuk ka konfirmuar nëse zëvendësimi i pjesëve mekanike në automjet është bërë me materiale sipas standardeve të parashikuara ose jo.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr. 277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit:

OE ka paraqitur Kontratë Bashkëpunimi me shoqërinë Garant Auto sh.p.k e cila i ka të gjitha licensat dhe certifikimet si dhe punonjësit e specializuar. Në këto kushte AK e ka shpallur fitues OE duke marrë në konsideratë Kontratën e bashkëpunimit, nëpërmjet së cilës është mbuluar dhe përmbushur kriteri për disponimin e lejes mjedisore nga Qendra Kombëtare e Licensimit për "Servis makinash". Punonjësi i ngarkuar me urdhër të titullarit të institucionit, me urdhër nr.166, datë 06.12.2023, ka konfirmuar me anë të procesverbalit të marrjes në dorëzim nr.489/20 prot., datë 12.12.2023 se të gjitha shërbimet janë kryer në përputhshmëri të procedurës dhe nuk është vërejtur asnjë mangësi nga standarti apo specifikimet teknike sipas ftesës për ofertë. Marrja në dorëzim presupozon që të gjitha shërbimet janë kryer konform specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. 152 Gjithashtu, sqarojmë për Kontrollin e Lartë të Shtetit që ky konstatim nuk është në tagrat dhe kompetancat e Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, por të Komisionit të Marrjes në Dorëzim. Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur:
Urdhër nr.166, datë 06.12.2023
Procesverbal për marrje në dorëzim të shërbimeve/mallrave nr.489/20 prot., datë 12.12.2023. Kontratë bashkëpunimi.

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga ana e grupit të auditimit theksohet se me paraqitjen e Deklaratës së OE për pjesët e këmbimit të OE fitues, ajo do të merret parasysh.
Për sa i përket mungesës së lejes mjedisore të lëshuar nga QKL (Qendra Kombëtare e Licencimit) si një nga dokumentacionet që duhen paraqitur nga ana e OE fitues, grupi i auditimit i qëndron konstatimit të mëparshëm se ky OE duhej të ishte skualifikuar dhe të procedohej me OE të radhës.
Kjo ngelet përgjegjësi e Komisionit të Blerjeve të Vogla.
Gjithashtu, procesverbali i marrjes në dorëzim është shqyrtuar në fazë terreni nga ana e grupit të auditimit. Specifikohet vetëm afati i zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit, në asnjë paragraf nuk shprehet nëse pjesët e këmbyera i përshtaten standardeve të parashikuara Ftesën për Ofertë, konkretisht Kapitullit të Specifikimeve Teknike.
Përgjegjësia në këtë rast i bie grupit të marrjes në dorëzim.

Për këtë arsye pretendimi juaj **nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit**.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
Grupi i marrjes në dorëzim.

Për vitin 2024.

Ngritja e Komisionit për prokurimet me vlerë të vogël.

Me shkresën nr. 40 Prot., i datës 04.01.2024, Urdhri nr.5 nga ana e drejtorit të përgjithshëm të Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Egra Ibrahimi është krijuar komisioni për prokurimin me vlerë të vogël i përbërë nga: Znj. Denada Dosti, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Negocimit dhe Asistencës ligjore; Znj. Adela Duni, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme; Znj. Denisa Biba, me detyrë Specialiste e Sektorit të Buxhetit dhe Financës.

Me shkresën nr. 40/3 Prot., datë 30.04.2024, Urdhri nr. 104 nga ana e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit, Kastriot Gurra është bërë një ndryshim në përbërjen e komisionit për prokurimin me vlerë të vogël si më poshtë: Znj. Denada Dosti, me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Negocimit dhe Asistencës ligjore ; Znj. Adela Duni, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme; Znj. Erlinda Kordha, me detyrë Specialiste e Sektorit të Buxhetit dhe Financës

Regjistrat e Parashikimit dhe Realizimit të prokurimeve me vlerë të vogël

Për periudhën e audituar 2024, me shkresën nr. 58/2 Prot., datë 13.02.2024 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit, janë parashikuar 8 procedura prokurimi me vlerë të vogël, me një shumë totale prej 1,950,000 lekëpa TVSH.

Për 4 mujorin e parë bazuar mbi shkresën nr. 58/5 prot., datë 09.05.2024 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit janë zhvilluar 2 procedura me fond limit 200,000 lekësh pa TVSH, nga ku janë lidhur kontrata me vlerë 196,850 lekë pa TVSH ose 98.4% e Fondit Limit.

Për arsye të nevojave të Autoritetit Kontraktor bazuar në fushën e veprimtarisë së institucionit është bërë ndryshim në parashikimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, me shkresën nr. 58/7 prot., datë 07.06.2024 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit ku parashikohen 11 procedura me një shumë totale prej 3,021,000 lekë pa TVSH.

Për 4 mujorin e dytë bazuar mbi shkresën nr. 58/8 prot., datë 06.09.2024 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit janë zhvilluar **4** procedura me fond limit prej **1,300,000** lekë pa TVSH, nga ku janë lidhur kontrata me vlerë 1,229,183 lekë pa TVSH ose 94.5% e Fondit Limit.

Me shkresën nr. 58/9 prot., datë 16.10.2024 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit është bërë një ndryshim i dytë në parashikimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, ku parashikohen **12** procedura me një shumë totale prej **3,121,000** lekë, pa TVSH.

Në total për periudhën e audituar 2024 bazuar mbi shkresën nr. 28/1 prot., datë 15.01.2025 drejtuar MIE si dhe Degës së Thesarit janë zhvilluar **10** procedura me fond limit prej **2,721,000** lekësh pa TVSH, nga ku janë lidhur kontrata me vlerë 2,185,183 lekë pa TVSH ose 80.3% e Fondit Limit. (***Pasqyruar në Aneksin Nr. 1, Tabela nr. 4***).

Bazuar në tabelën e regjistrit të realizimeve dhe të dhënave në sistemin e SPE grupi i auditimit përzgjodhi mbi bazë risku, të auditojë dosjet e mëposhtme:

Nr.	Blerje tonera për printera dhe fotokopje	Toner per printer lazer /makina fax	400,000.00	150,000.00	InfoSoft Office
1	"Blerje pjesë këmbimi për	Lubrifikantët, Bateri, Goma për automjete të	500,000.00	437,000.00	Blerim Ajdinaj

Nr.	Blerje tonera për printera dhe fotokopje	Toner per printer lazer /makina fax	400,000.00	150,000.00	InfoSoft Office
	automjete, për shërbimet profilaktike per automjetet ne perdorim te ASHSH".	lehta, Goma për makina motorike, Filtra të naftës, benzinës ??dhe ajrit , Filtra vaji, Filtra nafte			

1. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje Tonerash për fotokopje dhe printera".

Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël (Kpvv) ka marrë kërkesë për blerje malli " Blerje tonerash për fotokopje dhe printera" me shkresën nr. 1208 prot., datë 22.10.2024.

Është mbajtur procesverbali me nr. 1208/1 prot., datë 22.10.2024 për specifikimet teknike dhe llogaritja e fondit limit.

Vlera e përllogaritur për Fondin Limit është **262,004 lekë** pa TVSH. Përllogaritja vjen nga 3 ofertues ekonomikë (OE), përkatësisht:

"Aurel Bozi" SHPK. me çmimin 249,990 lekë pa TVSH

"CCS Office" me çmimin 286,333 lekë pa TVSH

"Copier and Computer Center" me çmimin 249,690 lekë pa TVSH

Me shkresën nr. 1208/3 prot., date 22.10.2024, Urdhri nr. 175 i Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur urdhri për prokurimin me vlerë të vogël "Blerje tonerash për fotokopje dhe printera"

Me nr.1208/4 prot., datë 22.10.2024 është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.

Me shkresë nr. 1208/5 prot., datë 22.10.2024 është mbajtur dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

Me shkresën nr. 1208/6 prot., datë 22.10.2024 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj. Adela Duni në cilësinë e kryetares që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).

Me procesverbalin nr.1208/7 prot., datë 23.10.2024 si dhe në sistemin online të APP, rezultoi se kanë shprehur interes 23 OE, prej së cilës u pranuan 8 ofertat e mëposhtme: "Infosoft Office" me vlerën 150,000 lekë pa TVSH/ "BluePrint Technologies" me vlerën 197,500 lekë pa TVSH/ "Boa Sorte" me vlerën 199,400 lekë pa TVSH/ "IT Gjergji Kompjuter" me vlerën 200,000 lekë pa TVSH/ "Elvis Hajdëraj" me vlerën 200,000 lekë pa TVSH/ "Colombo" me vlerën 200,000 lekë pa TVSH

"ADD Group" me vlerën 200,000 lekë pa TVSH/ "KetaElite" me vlerën 248,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 1208/8 prot., datë 24.10.2024 OE fitues "Infosoft Office" ka paraqitur pranë ASHSH dokumentacionin e kërkuar: [Certifikatë Regjistrimi + ekstrakt i QKB + Statusi aktiv; Vërtetimi tatime; Vërtetimi OSHEE; Vërtetimi Gjyqësor; Kontrata e Fiskalizimit; Certifikata e Fiskalizimit "Infosoft" SHPK; Certifikata e Fiskalizimit "IBS"; Vetëdeklarimi i OE; Shtojca 2 formular oferte].

Me shkresën nr. 1208/9 prot., datë 24.10.2024 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit OE "Infosoft Office". I shpallur fitues në sistemin elektronik më datë 23.10.2023.

Me shkresën nr. 1208/10 prot., datë 29.10.2024 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash ku specifikohet se nuk ka patur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.

Me shkresën nr. 1208/11 prot., datë 31.10.2024 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, ku dhe shprehet se nga verifikimi i shërbimit u konstatua se malli është në përputhje me specifikimet teknike.
Me shkresën nr. 1208/12 prot., datë 31.10.2024 është lidhur mes OE "Infosoft Office" dhe AK ASHSH kontrata për blerje mallrash, për objektin që prokurohet.

Nga auditimi i kësaj procedure u konstatuan problematikat e mëposhtme:
Nga data e shpalljes fitues të OE "Infosoft Office" (në sistemin SPE) më datë 23.10.2024 e deri në datën e lëvrimit të mallit nga ana e këtij OE datë 31.10.2024 kanë kaluar 8 ditë kalendarike (6 ditë pune).
Ky veprim është në kundërshtim me shkresën nr. 1208/4 prot., datë 22.10.2024 të ASHSH Ftesa për Ofertë, ku specifikohet se:"Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës: ***do të jetë brenda 3 (tre) ditëve duke filluar nga momenti i konfirmimit si fitues në sistemin elektronik.*** *Mos përmbushja e të paktën një prej kërkesave përbën kusht për skualifikim dhe kalim tek operatori ekonomik vijues."*
Veprim në kundërshtim me Kontratën nr. 1208/12 prot., datë 31.10.2024, neni 3, pika 1 ku specifikohet se: "Afati i kryerjes së lëvrimit të mallit pranë Autoritetit Kontraktor (blerësit) është ***brenda 3 (tre) ditëve pune****.....)*

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit

Malli objekt prokurimi është lëvruar brenda afatit 3 ditor të përcaktuar në ftesën për ofertë. Ky afat fillon nga data e shpalljes si fitues të OE, pas përfundimit të afatit të ankesave (afat të paktën 2 ditor të pritur nga ana e AK), jo që në momentin e publikimit të fituesit në system, në bazë të Manualit Teknik "Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në Sistemin e Prokurimit Elektronik", faqe 36, bashkëlidhur udhëzimit nr. 5, datë .06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Pas përfundimit të këtij afati dhe konfirmimit të shpalljes fitues të OE, mund të bëhët lëvrimi i mallit/shërbimit objekt prokurimi, pra në datën 29.10.2024 ka mbaruar afati i pritjes së ankesave nga ana e OE dhe në datë 31.10.2024 është bërë lëvrimi i mallit, brenda afatit 3 ditor të përcaktuar në Ftesën për oferte. Në po këtë ditë është prerë fatura tatimore. Më detajisht shpjegojmë se, në datë 24.10.2024, që përkon me datën e konfirmimit të fituesit, ditë pune e Enjte, dita e parë e pritjes së ankesave përkon me datën 25.10.2024 (ditë pune e Premte), ndërsa datat 26.10.2024 dhe 27.10.2024, janë ditët e Shtunë dhe e Djelë, ndaj dita e dytë e pritjes së ankimit përkon në datën 28.10.2024. Duke filluar nga data 28.10.2024, operatori sipas ftesës për ofertë ka të drejtë dhe detyrim të lëvrojë mallin e prokuruar, brena 3 ditëve (Dita e parë – datë 29.10.2024, dita e dytë - 154 30.10.2024, dita e tretë 31.10.2024), e cila përkon me datën 31.10.2024 në rastin konkret operatori ekonomik e ka lëvruar mallin në datë 31.10.2024..

***1.1.* Qëndrimi i grupit të auditimit**

Nga ana e grupit të auditimit theksohet se bazuar në shkresën e Ftesës për Ofertë nr. 1208/4 prot., e datës 22.10.2024, vetë Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si moment i shpalljes fitues, çastin e konfirmimit në sistemin elektronik. Vetë AK bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në Ftesën për ofertë. Për këtë arsye **pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.**

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:
1. Znj. Denada Dosti, në cilësinë e Kryetarit të KVO me Blerje të Vogla.
2. Znj. Adela Duni, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla.
3. Znj. Erlinda Kordha, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla.

2. Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje pjesësh këmbimi për materiale profilaktike".
Me shkresën nr. 724 prot., datë 26.04.2024 shoferi i institucionit të ASHSH Marjon Kushi i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse mbi konstatimin e problematikave të hasura në automjetin e punës, me markë Mitsubishi CËO Outlander, i vitit prodhimit 2017.
Me shkresën 724/1 prot., datë 03.05.2024 ASHSH i drejtohet MIE, me kërkesën për vënien në dispozicion të një inxhinieri mekanik për zgjidhjen e problematikës.
Me shkresën nr. 724/2 prot., datë 10.05.2024 Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm të ASHSH, në moskthimin e përgjigjes nga MIE, procedimin me kontrollin e makinës në një pikë servisi.
Me procesverbalin me nr. 742/3 prot., datë 10.05.2024 nga ana e mekanikut Erald Shehu i servis KADIU sh.a, u konstatuan problematikat e mjetit si dhe nevoja e pjesëve për ndërrim të menjëhershëm.
Me shkresën nr. 724/4 prot., datë 13.05.2024 është mbajtur procesverbali nga Komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël, për specifikimet teknike dhe përllogaritjen e Fondit Limit, ku mbështetur në çmimet e tregut aktual pas ofertave të marra nga 3 servise të ndryshme sugjerohet që vlera e përllogaritur për Fondin Limit të jetë 491,767 lekë pa TVSH. Përllogaritja vjen nga 3 ofertues ekonomikë (OE), përkatësisht:
"KADIU" sh.a me çmimin 595,440 lekë pa TVSH
"Albanian Motors" SHPK me çmimin 502,920 lekë pa TVSH
"Auto Servis JANI" me çmimin 672,000 lekë pa TVSH
Me shkresën nr. 724/6 prot., datë 13.05.2024 është lëshuar Urdhri nr. 112 i Drejtorit të përgjithshëm për nisjen e procedurës së prokurimit.
Me shkresën nr. 724/7 prot., datë 13.05.2024 është lëshuar shkresa për Ftesën për ofertë ku paraqiten dhe kriteret kualifikuese.
Me shkresë nr. 724/8 prot., datë 13.05.2024 është mbajtur dhe procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim. Janë plotësuar formularët e deklarimit për çdo anëtar të Komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.
Me shkresën nr. 724/9 prot., datë 13.05.2024 është lëshuar dhe autorizimi nga ana e anëtarëve të komisionit për znj. Adela Duni në cilësinë e kryetares që të kryejë veprimet e nevojshme në sistemin elektronik të APP (Agjencisë së Prokurimit Publik).
Me procesverbalin nr. 724/10 prot., datë 15.05.2024 si dhe në sistemin online të APP, rezultoi se kanë shprehur interes 12 OE, prej së cilës u pranuan 12 ofertat e mëposhtme: "Besnik Meçi" me vlerën 247,800 lekë pa TVSH/ "Auto Manoku Servis" me vlerën 358,000 lekë pa TVSH/ "Sorgiena Agaj" me vlerën 395,000 lekë pa TVSH/ "Blerim Ajdinaj" me vlerën 437,000 lekë pa TVSH/ "Jueli" me vlerën 444,000 lekë pa TVSH/ "ATOPI" me vlerën 455,000 lekë pa TVSH/ "AMI-ARLI" me vlerën 469,990 lekë pa TVSH/ "ANADEA" me vlerën 470,000 lekë pa TVSH/ "Olsi Motors" me vlerën 472,000 lekë pa TVSH/ "HB-GroupConstruction" me vlerën 475,000 lekë pa TVSH/ 3V Asllani me vlerën 482,000 lekë pa TVSH.
"KADIU" sh.a. me vlerën 490,000 lekë pa TVSH
Me shkresën nr. 724/11 prot., datë 15.05.2024 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka kaluar në OE e radhës Auto Manoku Servis, pasi OE fitues Besnik Meçi tërhiqet për arsye të kalkulimit gabim të ofertës.

Me shkresën nr. 724/12 prot., datë 15.05.2024 OE fitues Auto Manoku Servis- ka paraqitur pranë ASHSH dokumentacionin e kërkuar.
Me shkresën nr. 724/13 prot., datë 17.05.2024 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka kaluar në OE e radhës Sorgiena Agaj, pasi OE fitues Auto Manoku Servis është skualifikuar me arsyen se nuk plotëson kushtin e pikës 2 të Ftesës për Ofertë, ku kërkohet që OE ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Në këto kushte OE skualifikohet për mungesë dokumentacioni.
Me shkresën nr. 724/14 prot., datë 17.05.2024 OE i skualifikuar Auto Servis Manoku i është drejtuar ASHSH me ankesë duke kundërshtuar vendimin e skualifikimit.
Me shkresën nr. 724/15 prot., datë 20.05.2024 ASHSH ka kthyer përgjigje me argumentin se: nga ana e OE nuk është paraqitur dokumenti munguar shtesë si dhe ankesa është bërë jashtë afateve të përcaktuara në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" neni 116, pika 1.
Me shkresën nr. 724/16 prot., datë 20.05.2024 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka kaluar në OE e radhës Blerim Ajdinaj, pasi OE fitues Sorgiena Agaj tërhiqet për arsye të një gabimi në ofertim.
Me shkresën nr. 724/17 prot., datë 21.05.2024 OE fitues Blerim Ajdinaj- ka paraqitur pranë ASHSH dokumentacionin e kërkuar.
Me shkresën nr. 724/18 prot., datë 21.05.2024, është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali i konfirmimit të fituesit OE Blerim Ajdinaj. I shpallur fitues në sistemin elektronik më datë 20.05.2024.
Me shkresën nr. 724/19 prot., datë 21.05.2024 ka ardhur kthim-përgjigjja negative nga MIE referuar problematikës së përshkruar në shkresën 724/1 prot., datë 03.05.2024.
Me shkresën nr. 724/20 prot., datë 24.05.2024 është mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, procesverbali për pritje ankesash ku specifikohet se nuk ka patur asnjë ankesë nga OE pjesëmarrës.
Me shkresën nr. 724/21 prot., datë 24.05.2024 është lëshuar autorizimi nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHSH për caktimin e personit përgjegjës për dorëzimin dhe marrjen e automjetit dhe mbikëqyrjen e kontratës. Personi përgjegjës u caktua Marjo Kushi.
Me shkresën nr. 724/22 prot., datë 24.05.2024 është lidhur mes OE Blerim Ajdinaj dhe AK ASHSH kontrata për blerje mallrash, për objektin që prokurohet.
Me shkresën nr. 724/23 prot., datë 28.05.2024 është lëshuar Urdhri nr.127 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të automjetit, me përbërje si më poshtë: [Z. Marjo Kushi; Z. Spartak Kodra; Znj. Sara Bardhoku].
Me shkresën nr. 724/24 prot., është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave.
Nga auditimi i kësaj procedure u konstatuan problematikat e mëposhtme:
Në procesverbalin për marrjen në dorëzim të shërbimeve/mallrave specifikohet vetëm afati i zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit, si dhe detyrimin nga ana e OE fitues për realizimin dhe kryerjen e montimit dhe balancimit të gomave.
Në asnjë paragraf nuk shprehet nëse pjesët e këmbyera (gomat) i përshtaten standardeve të parashikuara Ftesën për Ofertë, konkretisht Kapitullit të Specifikimeve Teknike, ku përshkruhen cilësia, garancia, indeksi i shpejtësisë, indeksi i peshës, lloji.
Po ashtu, komisioni i marrjes në dorëzim në këtë procesverbal nuk shprehet në asnjë paragraf nëse shërbimet profilaktike të kryera janë në përputhje me standardet e kërkuara në Ftesën për Ofertë.
Veprim në kundërshtim me *Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 të APP "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 18, paragrafi dytë ku shprehet se: " Kur ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor të përcaktuar në Ftesën për Ofertë,* ***ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga***

***autoriteti/enti kontraktor në Ftesën për Ofertë**, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e fundit të mbetur në klasifikim. Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, nëpërmjet një procesverbali i mbajtur për këtë qëllim."*

Veprim në kundërshtim me *Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në njësinë e sektorit publik" pika 45 ku shprehet se: "Kur ka mospërputhje ndërmjet sasive të mallrave të shënuara në fletëdalje, në faturat ose në dokumentet e tjera shoqëruese dhe sasive efektive që gjenden brenda ambalazhit, **si dhe në cilësi, llojshmëri, qënien e plotë dhe markën e prodhimit, komisioni ndërpret verifikimin** dhe lajmëron shitësin që të paraqitet brenda një afati kohor te përcaktuar (në varësi te vendndodhjes brenda ose jashtë juridiksionit ku ushtron veprimtarinë njësia publike ne marrëdhënie me furnitorin).*

Personi i autorizuar për marrjen në dorëzim të mallit/shërbimit nuk ka konfirmuar nëse shërbimet profilaktike dhe zëvendësimi i gomave në automjet është bërë me materiale sipas standardeve të parashikuara ose jo.

Nga auditimi i kësaj dosjeje prokurimi, konstatohet se mungon fatura tatimore për kryerjen e shërbimit. Në dosje ndodhet një faturë tatimore e gabuar me një shumë dhe objekt që nuk korrespondon me objektin e prokuruar.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të auditimit, nga anëtarët e Komisionit të Posaçëm për Shpronësimin z. Kastriot Gurra, z. Albian Marku, z. Spartak Kodra, znj. Selmina Varfi, znj. Fabjona Cenaj, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 274/2 prot.,datë 27.02.2026, protokolluar në KLSH me nr.277/30, datë 02.03.2026, në lidhje me Projekt Raportin e KLSH, datë 30.01.2026, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit

Punonjësit e ngarkuar me urdhër të titullarit të institucionit, me urdhër nr.127, datë 28.05.2024, kanë konfirmuar me anë të procesverbalit të marrjes në dorëzim nr.724/24 prot., datë 30.05.2024 që të gjitha shërbimet janë kryer në përputhshmëri të procedurës dhe nuk është vërejtur asnjë mangësi nga standarti apo specifikimet teknike sipas ftesës për ofertë. Marrja në dorëzim e automjetit pas kryerjes së shërbimit prezupozon se janë kryer të gjitha shërbimet sipas ftesës për ofertë. Personi i ngarkuar me urdhër, pavarësisht se nuk e ka formimin e nevojshëm, ka ndjekur kryerjen e të gjitha shërbimeve të realizuara nga pika e servisit, për të garantuar se janë kryer të gjitha shërbimet. Për sa i përket qëndrimit tuaj se nuk shprehet nëse pjesët e këmbimit I përshtaten standarteve të parashikuara në ftesën për ofertë, konkretisht kapitulli i specifikimeve teknike, ku përshkruen cilësia, garancia, indeksi i shpejtësisë, indeksi I peshës, lloji, ky pretendim nuk bazohet në ligjin e prokurimit publik nr.160/2020; në VKM nr.285/2021 dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik, udhëzimit nr. 5, datë .06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga ana e grupit të auditimit theksohet se kjo gjetje gjen mbështetje në *Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në njësinë e sektorit publik" pika 45 ku shprehet se: "Kur ka mospërputhje ndërmjet sasive të mallrave të shënuara në fletëdalje, në faturat ose në dokumentet e tjera shoqëruese dhe sasive efektive që gjenden brenda ambalazhit, **si dhe në cilësi, llojshmëri, qënien e plotë dhe markën e prodhimit....si dhe me kushtin e përcaktuar në Ftesën për Ofertë (shkresa nr. 724/7 prot., datë 13.05.2024).***

Vetë AK bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në Ftesën për ofertë.

Për këtë arsye **pretendimi juaj nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit**.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

1. Znj. Denada Dosti, në cilësinë e Kryetarit të KVO me Blerje të Vogla.

2. Znj. Adela Duni, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla.
3. Znj. Denisa Biba, në cilësinë e anëtarit të KVO me Blerje të Vogla.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë rekomandimet si vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACION

1. Gjetje nga auditimi: Në procesin e zbatimit të kuadrit ligjor që rregullon fushën e shpronësimit për interes publik, gjatë auditimit është konstatuar se ekziston një mospërputhje dhe kontradiktë midis disa ligjeve e akteve nënligjore në fuqi. Fenomeni që në jurisprudence njihet si " *ndotje legjislative*" dhe sjell konfuzion në aplikimin e legjislacionit për shkak të rregullimeve me disa norma ligjore të një fushe të caktuar, është i dukshëm në Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve. Këtij konstatimi i shtohet dhe fakti se në këtë institucion pavarësisht insistimit nga strukturat e brendshme nuk janë miratuar nga organet eprore (MIE) aktet nënligjore të relatuara e propozuara nga struktura e audituar. Vlen të theksohet se miratimi i tyre nuk do të zgjidhte problemin tërësisht, por do të shmangte përplasjen e zbatimit në legjislacion për të njëjtin proces nga institucionet në të ardhmen. Konkretisht ndërhyrjet që propozohen: Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar; Ligji nr. 7980, datë 27.5.1995, "Për shitblerjen e tokave në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Ligjin Nr. 10018, Datë 13.11.2008 :Për Avokaturën e Shtetit" ndryshuar me ligjin nr. 86/2018 Nenin 7.
Këto ligje materiale trajtojnë situata të ngjashme, por me qasje dhe zgjidhje ligjore të ndryshme, duke krijuar pasiguri juridike, zvarritje në procedura dhe mungesë efikasiteti në realizimin e projekteve me interes publik.
Ligji për avokaturën e Shtetit ka një rregullim për rolin e Avokatit të Shtetit në proceset e shpronësimit shumë në përgjithësi, duke mos konsideruar faktin se bëhet fjalë për realizim të projekteve strategjike me rëndësi kombëtare dhe me impakt të lartë si në financat shtetërore (Kontratat e Huasë dhe Koncesionare) por dhe të drejtën private.
Nisur nga ky impakt pjesëmarrja e Avokatit të Shtetit vlerësojmë se duhet të parashikohet që në fazën e fillimit të procesit të shpronësimit me qëllim vlerësimin sa më profesional të procedurës dhe marrjen përsipër të hetimit administrativ nga ana e tij për të gjitha efektet krahas përfaqësuesit të ASHSH.
Përfitimet ligjore do të ishin disa dimensionale por më të rëndësishmet do të parandalonin një dëm efektiv të mundshëm nga arbitrazhet ose Gjykatat Ndërkombëtare në buxhetin e shtetit për dëmshpërblime të të shpronësuarave jo me vlerën e tregut për pronat e tyre. Aktualisht është në fazat fillestare procesi, gjykatat vendase kanë dhënë vendimet e para duke treguar probabilitetin se shpërblimi i pronarëve privatë do të duhet të konsiderohet me vlerën e tregut për pronat e shpronësuara si në rastet e zbatimit të projekteve të huaja. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqet 81-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministrinë e Drejtësisë, Avokaturën e Shtetit, Ministrinë e Financave, si dhe me Agjencinë Shtetërore të Planifikimit e Zhvillimit të Territorit, të marrë masat për përgatitjen e projekt-studimit përkatës sipas problematikave të konstatuara gjatë aplikimit të ligjit ekzistues me qëllim: *Sigurimin e një qasje të unifikuar dhe të konsoliduar për çështjet që lidhen me shpronësimet*;
Parandalimin e konflikteve ligjore dhe përfaqësimin profesional ligjor në proceset gjyqësore që mund të iniciohen.
Përshpejtimin dhe rritjen e efikasitetit në zbatimin e projekteve të zhvillimit me interes publik.

Implementimin e harmonizuar të planeve të zhvillimit urban të qyteteve që miratohen në bazë të studimeve afatgjata dhe reflektimin e ndryshimit në regjistrat kadastrale të pasojave që prodhojnë në zërat kadastrale të pasurive të paluajtshme.

Brenda 30.09.2026

B. MASAT ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpronësimin e pronave për interes publik të realizuara në Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve (ASHSH), në objektet: - *"Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6"*; - *"Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër"*; - *"Ndërtim kopshti dhe çerdhe integruar nr. 42, Bashkia Tiranë"*; - *"Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi, Bashkia Pogradec"*; - *"Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë"*, rezultoi se:

- Në të gjitha projektet e shpronësimit të audituara rezultojnë mungesa të rregullave të hollësishme për mënyrën e negocimit të ASHSH me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët, në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 11, pika 5, germa d.
- Në relacionin e përpiluar nga ASHSH drejtuar subjekteve kërkuese për shpronësim (*MEI dhe Bashkitë Shkodër, Vlorë dhe Pogradec*), nuk parashikohen afatet për fillimin dhe mbarimin e shpronësimit, si dhe afatet për fillimin dhe mbarimin e punimeve, gjë e cila nuk rezulton të jetë parashikuar dhe në akt-marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektit kërkues dhe ASHSH, veprim i cili vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" neni 20, pika 1, shkronja (a);
- Vendimmarrja sipas procesverbalit të KPSH në ASHSH është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pikës 3 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" (i ndryshuar), pasi kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues nuk paraqiten te plotësuar ne afatin e caktuar ose gjenden të pambështetur;
- Akt-marrëveshja e lidhur nuk ka të bashkëlidhur dokumentet që shoqërojnë kërkesën për shpronësim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 13, pikës 4 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar;
- Në dosjen e projektit procesverbalet e mbledhjeve të KPSH, në të gjitha rastet, janë pa numër protokolli, në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 18 i cili parashikon se: "*Procesverbale te mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshëm. Ato protokollohen.*"
- ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare të subjektit privat që shpronësohet dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar në realizimin e "*Njoftim për shpronësim publik*", është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 14, pika 1 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik" i ndryshua, pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM nr.127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi, pasi ky njoftim është kryer përtej afatit 10 ditor nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit;

- Në dosjen e shpronësimit, u konstatua se nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë që i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHSH) për regjistrimin e pronës së shpronësuar, në kundërshtim të nenit 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur, të nenit 11, pika 5/c, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit të sipërcituar, i cili përcakton se regjistrimi duhet të kryhet nga ASHK brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqen 18-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëveprim me subjektet kërkuese të projekteve që shpronësohen për interes publik, të marrë masat për:

- Standardizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor;
- Të siguruar që çdo vendimmarrje për pranimin e kërkesave për shpronësim të merret vetëm pasi dokumentacioni shoqërues të jetë i plotë, i saktë dhe i verifikuar, dhe në rastet kur ky dokumentacion paraqitet i paplotë ose jashtë afatit të përcaktuar, duhet të zbatojë detyrimisht procedurën e refuzimit të kërkesës dhe njoftimit të menjëhershëm të subjektit kërkues, në përputhje me përcaktimet ligjore;
- Të siguruar që çdo aktmarrëveshje e lidhur me subjektet kërkuese të jetë e shoqëruar detyrimisht me të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, në momentin e nënshkrimit të saj;
- Të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen;
- Të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale;
- Të hartuar dhe miratuar një akt normativ që përcakton rregullat e detajuara për procesin e negocimit;
- Të hartuar dhe miratuar një akt normativ që përcakton afate të qarta dhe konkrete për plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesit, si dhe të sigurohet zbatimi rigoroz i detyrimeve ligjore për kthimin ose refuzimin e kërkesave në rast të mos përmbushjes së afateve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i objektit: "*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendodhje në Bashkinë Shkodër*", dhe "*Studim projektim i mbikalimit të Fllakës*", u konstatua që në dokumentacionin e pronësisë disa kartela pasurie dhe harta treguese nuk ishin të përditësuara, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2018 datë 7.2.2019, për "Kadastrën", neni 17, pika 4 dhe neni 12 dhe 13, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH".

(Më hollësisht trajtuar në faqen 21-34; 63-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH), përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të verifikojë të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara dhe të marrë miratimet/ konfirmimet nga institucionet përkatëse për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i objektit: "*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendodhje në Bashkinë Shkodër*", u konstatua se sipërfaqet e miratuara për shpronësim, nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit në dŵg. Ndryshimi dhe rritja e sipërfaqes së pasurive që marrin pjesë në shpronësim, ndikon edhe në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit. Gjithashtu ndikon në cenimin e pasurive kufizuese, ndër të cilat disa prej tyre janë edhe pasuri shtet. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimit të listës përfundimtare për shpronësim, në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH", veprime të cilat kanë çuar në efekte negative në buxhetin e shtetit për vlerën 16,528,362 lekë, kjo si rezultat i shpronësimit të një sipërfaqe më të madhe se sa duhej të shpronësohej nga matjet në dŵg, pasurinë e llojit "truall", me nr. 18/71, volumi 14, faqe 194, në ZK.8591, me sipërfaqe totale 11.200 m^2, në pronësi të Fatmir Muça, sipërfaqja e përcaktuar për shpronësim nuk përputhet me sipërfaqen e verifikuar nga projektit në dŵg.
(Më hollësisht trajtuar faqet 155-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH) pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim (ASHSH), përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryhej të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues. Gjithashtu të verifikohen të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara, të konfirmohen të gjitha sipërfaqet që preken nga shpronësimi nga projekti i miratuar (*edhe në version elektronik dŵg*) dhe nga verifikimi në terren, duke shmangur efektet negative në buxhetin.
Të merren masa për verifikimin e të gjitha pasurive që marrin pjesë në shpronësim dhe përputhshmërinë e tyre me projektin përfundimtar, rishikimin e sipërfaqeve që preket nga projekti (referuar DWG-së), sipas konstatimeve të diferencës së sipërfaqeve të evidentuara nga grupi i auditimit. Pas rivlerësimit të situatës, KPSH, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

Menjëherë

3.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, në lidhje me nismën ligjore për ndryshimin e VKM-së, të vijojë me procesin për rishikimin dhe ndryshimin e sipërfaqes së shpronësuar në mënyrën e gabuar, deri në miratimin e VKM-së të ndryshuar, në të cilën të reflektohet ndryshimi i sipërfaqes së shpronësimit sipas rekomandimit të grupit të auditimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: "*Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë*", u konstatua që sipërfaqet që janë miratuar për shpronësim, nuk përkojnë me sipërfaqet sipas projektit të miratuar të dokumentuar në dosje, por bazohen në rishikimet e projektit, në të cilin sipërfaqet e disa pasurive të konstatuara nuk përkojnë me dokumentacionin e pronësisë.

Ndryshimi dhe rritja e sipërfaqes së pasurive që marrin pjesë në shpronësim, ndikon edhe në rritjen e sipërfaqes që preket nga projekti dhe në rritjen e vlerës së shpronësimit, veprime të cilat kanë çuar në efekte negative në buxhetin e shtetit për vlerën 32,295,977.20 lekë.
Gjithashtu ndikon në cenimin e pasurive kufizuese, ndërtime të cilat disa prej tyre janë edhe pasuri shtet. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimit të listës për shpronësim. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik"*, i ndryshuar, si dhe me nenin 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH".
(Më hollësisht trajtuar në faqen 48-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimit nëpërmjet Komisionit të Posaçëm për Shpronësim, të marrë masa si vijon:
- Përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimi të listës përfundimtare të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryhen të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues, duke shmangur efektet negative në buxhetin.
- Të verifikojë të dhënat e dokumentacionit të pronësisë sipas kartelave/ hartave treguese të rifreskuara, të konfirmohen të gjitha sipërfaqet që preken nga shpronësimi nga projekti i miratuar dhe nga verifikimi në terren.
- Të gjitha pasurive që marrin pjesë në shpronësim dhe përputhshmërinë e tyre me projektin përfundimtar, duke rishikuar të gjitha sipërfaqet që preken nga projekti, në bazë të sipërfaqes të verifikuar nga dokumentacioni i pronësisë.

Menjëherë

4.2. Rekomandimi: Pas rivlerësimit të situatës, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

Menjëherë

5- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë: *"Studim projektim i mbikalimit të Fllakës"*, u konstatua që në listën e pronave të pasurive të paluajtshme, pronë private që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit është përfshirë e gjithë sipërfaqja e truallit dhe objektet e pasurisë 14/59, ndonëse është prekur vetëm një pjesë e truallit dhe objektet nuk janë prishur, duke mos cënuar funksionalitetin e njësisë ekonomike. Llogaritja e sipërfaqes së truallit e cila nuk preket nga projekti i realizuar, si dhe llogaritja me vlerën e preventivit të objekteve të cilat nuk janë prekur nga shpronësimi, ndikon në rritjen e vlerës totale të shpronësimit dhe likuidimin e saj në mungesë të ndërhyrjeve të përshkruara në kërkesën për shpronësim. Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka kryer verifikimet e nevojshme për subjektin kërkues, përpara pranimit të kërkesës dhe miratimit të listës për shpronësim. Sa më sipër, veprime në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe në bazë të nenit 16.2/a të Rregullores për funksionimin dhe organizimin e ASHSH, miratuar në zbatim të pikës 6 (nënndarja III), të VKM nr. 395, datë 13.5.2020 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të ASHSH". *(Më hollësisht trajtuar në faqen 63-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1- Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit (KPSH), përpara miratimit të kërkesës për shpronësim dhe miratimin e listës përfundimtare të pronave të pasurive të

paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik nga realizimi i projektit, të kryejë të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti kërkues. Nga KPSH, të merren masa për rishikimin e sipërfaqeve që preken nga projekti i realizuar dhe përjashtimin e objekteve të cilat nuk preken nga shpronësimi, referuar projektit dhe verifikimit në terren, sipas konstatimit të lënë nga grupi i auditimit.
Pas rivlerësimit të situatës, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të marrë nisma ligjore për ndryshimin e VKM-së të miratuar, në të cilën të reflektohen ndryshimet e mundshme.

Menjëherë

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dosjeve fizike të shpronësimit në **7 (shtatë) raste**, për akësisht për praktikat:
- "*Shpronësimi për realizimin e projektit të rishikuar për Lotet 4, 5, 6 Unaza Lindore*" Tiranë,
-" *Shpronësimi për realizimin e projektit Ndërtimi i Unazës Lindore Loti II*" Tiranë,
-"Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë-Vorë-Kashar".
-"Shpronësim për realizimin e projektit "Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik "Teda Tiranë"",
-"Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore,
-"Ndërtimi i Rrugës Shëngjin-Baks-Rrjoll",
-"Ndërtimi i nënstacionit 400 Kv Elbasan 3",
rezultoi se, nga KPSH, janë miratuar kërkesa për shpronësim në të cilat nuk përcaktohej afati i fillimit e përfundimit të punimeve, dhe/ose nuk vërtetohej me dokumentacion ligjor qëllimi shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar. Mungesa e përcaktimit të këtij afati, ndër të tjera, është shkak që prodhon me probabilitet absolut pasojën që rrjedh prej zbatimit të pikës 1 të nenit 26 " *Pavlefshmëri e shpronësimit*". Në raste të tjera mungon projekti i miratuar sipas ligjit, dhe/ ose aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, në kundërshtim me pikën b dhe pikën dh të nenit 10 të ligjit cituar.
Në disa prej praktikave, të trajtuara rast pas rasti më sipër, mungojnë njoftimi për pranimin e kërkesës drejtuar subjektit kërkues/ akt-marrëveshja për pranimin e kërkesës së subjektit, njoftimi i pronarëve/ bashkëpronarëve, publikimi i kërkesës për shpronësim të pronave, marrjen e Vendimit të shpronësimit përpara afatit njëmujor, të gjitha këto parregullësi vijnë në kundërshtim me nenet 13, 14, 15, 16 ,pika 1, 18 ,të Ligjit sipërcituar.
-KPSH në përfundim të shqyrtimit administrativ të kërkesës së subjektit për shpronësim me procesverbal ka pranuar kërkesën, duke vijuar me procedurat e tjera, në kundërshtim me nenin 13.1 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 sipër cituar. Dokumenti administrativ që sipas ligjit duhet të hartojë KPSH dhe që prodhon pasojë ligjore është "vendimi për pranimin e kërkesës për shpronësim". Ky vendim është akti bazë që prodhon Aktmarrëveshjen ligjore me pasoja juridike për subjektin kërkues dhe ASHSH.
-Janë lidhur Aktmarrëveshjen në mungesë të dokumentacionit ligjor shoqërues të saj. Ky devijim ligjor është me pasojë pavlefshmërinë juridike të shpronësimit. Në këtë kontekst të gjitha procedurat e shpronësimit të realizuara në këtë mënyrë janë të ekspozuara ligjërisht përballë goditjeve për pavlefshmëri në të ardhmen, si pasojë e neglizhencës dhe moskorrektesës nga ana e KPSH. Situata është me rrezikshmëri të theksuar kur subjekti kërkues është privat dhe Aktmarrëveshja duhet lidhet para noterit, por dhe pasojat e goditjes për pavlefshmëri janë më të rënda hipotetikisht. Institucioni ka detyrim të parashikojë dëmin në të ardhmen dhe pasojën në të ardhmen për çdo veprimtari në zbatim të ligjit. Veprim në kundërshtim me nenin 13, pika 4 e Ligjit 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të

përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqet 81-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësim Institucionit të marrë masat e domosdoshme që në përbërjen e KPSH të ketë specialistëve të trajnuar në fushën e përgjegjësisë dhe zbatimit të procedurave të shpronësimit me qëllim krijimin e standardeve të njëjta dhe aplikimin e tyre në çdo procedurë shpronësimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, në vazhdimësi të marrë masa për të vënë në funksion strukturën e Auditit të Brendshëm e cila nën monitorimin e tij të realizojë kontrollin e brendshëm për gjithë kohën e funksionimit të KPSH si mjetin efektiv për vetëkorrigjimin e punës së strukturës dhe vënien në efiçensë të sistemit të kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.3. Rekomandimi: Titullari i Agjencisë Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në varësi të marrë masa që të organizohen trajnime për stafin përgjegjës në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim lidhur me kërkesat ligjore dhe procedurale të shpronësimeve, implementimin e azhurnimeve e përmirësimeve ligjore si dhe praktikës gjyqësore të brendshme e ndërkombëtare në fushën e shpronësimeve. Në vëmendje të posaçme implementimin e praktikës ndërkombëtare në hartimin e akteve dhe zbatimin e standardeve për vlerësimin e pasurive objekt shpronësimi në të gjitha rastet që merren në shqyrtim nga Agjencia.

Në vijimësi

6.4. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të organizojë punën për evidentimin në çdo praktikë shpronësimi të realizuar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim që ka përfunduar procedurën përkatëse dhe të urdhërojë aty ku është e mundur plotësimin për ngritjen profesionale të punonjësve lidhur për procedurat e shpronësimit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **6 raste** u konstatua se:

- Nga KPSH nuk është përcaktuar afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar. Mungesa e përcaktimit të këtij afati, sjell ndër të tjera, pamundësinë e aplikimit të pikës 1 të nenit 26 "Pavlefshmëria e shpronësimit", të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"*. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit përkatësisht:

1- *"Unaza lindore Loti 3, Tiranë".*
2- *"Projektimi i Shkollës së Biçikletave për grupmoshat 7-10 vjeç Tiranë".*
3- *"Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare "Qazim Turdiu" Tiranë".*
4- *"Ndërtimi i qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço" Bashkia Lushnjë".*
5- *"Rikualifikim i akseve rrugore "Unaza Lindore Loti 2" Bashkia Tiranë.*
6- *"Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë".*

Sa më sipër është, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"*, i ndryshuar.

-Procesverbalet e KPSH (KPSH) nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse, veprim në kundërshtim me nenin 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, "Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore".

-ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues realizimin e njoftimit të shpronësimit, veprim në kundërshtim me nenin 14, pika 1, nenit 24, pika 1, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

- Nga ASHSH nuk është dokumentuar asnjë shkresë ku Agjencia Shtetërore për Shpronësim i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, për të bërë të mundur ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, veprime në kundërshtim me nenin 25, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe subjektit kërkues.

- Në të gjitha projektet e shpronësimit të audituara rezultojnë mungesa të rregullave të hollësishme për mënyrën e negocimit të ASHSH me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 11, pika 5, germa d). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 103-126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të sigurohet që në propozimin për shpronësim paraqitur ministrit përgjegjës për zhvillimin urban të jetë i përcaktuar afati i fillimit dhe mbarimit të shpronësimit si dhe afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve ose i realizimit të qëllimit të shpronësimit.

Menjëherë

7.2. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësim, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, të merren masa për standardizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor.

Menjëherë

7.3. Rekomandimi: Nga ana e ASHSH, të merren masa për të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen. Në mungesë të adresës zyrtare, Agjencia duhet të zbatojë format alternative të njoftimit të parashikuara në legjislacion, dhe jo ti delegojë këtë detyrim subjektit kërkues.

Menjëherë

7.4. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të merren masa për të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit

të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale.

7.5. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me ministrinë e linjës Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të hartojë dhe miratojë urgjentisht një akt normativ që përcakton rregullat e detajuara për procesin e negocimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **3 raste,** përkatësisht për praktikat e shpronësimit: (*"Rikualifikimi i akseve rrugore Unaza Lindore, Loti II dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit", "Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së plazhit të Durrësit, nga ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës", "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe-Tiranë", Bashkia Tiranë*"), Komisioni i Posaçëm të Shpronësimit (KPSH) ka vendosur pranimin me kusht të kërkesës për shpronësim në mungesë të kompetencave dhe pa parashikuar në aktet ligjore e nënligjore, në kundërshtim me përcaktimet e pikës "2" të nenit 12, dhe neni 13, të Ligjit 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", (i ndryshuar), pikës 1 të VKM nr. 127, datë 23.03.2000 dhe formularit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe [88], [166-165], [165-189] të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësimin në bashkëpunim me Komisionin e Posaçëm për Shpronësimin, duhet të ndalojë zbatimin e praktikës së pranimit me kusht të kërkesave dhe të zbatojë me rigorozitet procedurat për kthimin pa veprim dhe refuzimi i kërkesës si dhe pranimin e kërkesës për shpronësim, duke u siguruar që çdo kërkesë të jetë ose e pranuar ose e refuzuar siç parashikohet në kuadrin rregullator të shpronësimeve.

Menjëherë e në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në **2** projekte shpronësimi të audituara përkatësisht:

-Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore Tirana Agrikulturë (status i finalizuar).

-Projekt Ndërtim i Objektit 6 kate+1 kat parkim nën tokë në truallin në pronësi të Entit të Banesave (status i refuzuar), rezultoi se, ASHSH ka aplikuar afate të zgjatura dhe ka toleruar vonesa të pajustifikuara në procesin e plotësimit të dokumentacionit për shpronësim nga ana e subjektit kërkues, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 12, pika 3, i cili kërkon veprim të shpejtë (kthim ose refuzim) të kërkesave jo të plota brenda afatit të caktuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 156-175 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të hartojë dhe miratojë një akt normativ që përcakton afate të qarta dhe konkrete për plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesit privat për shpronësim, si dhe të sigurohet zbatimi rigoroz i detyrimeve ligjore për kthimin ose refuzimin e kërkesave në rast të mos përmbushjes së afateve.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në **5 raste,** projektet e shpronësimit të audituara përkatësisht:

- "Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore Tirana Agrikulturë (status i finalizuar)",
- "Projekt Ndërtim i Objektit 6 kate+1 kat parkim nën tokë në truallin në pronësi të Entit të Banesave (status i refuzuar)",

- "Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së plazhit të Durrësit, nga ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës",
- "Projekt zgjerimi i Varrezave Publike, qyteti Përmet",
- "Projekt Ndërtimi i kopshtit nr. 37, Tiranë",

rezultoi se ASHSH nuk ka përcaktuar afate të qarta për fillimin dhe përfundimin e shpronësimit, si dhe të punimeve, në relacionet dhe akt-marrëveshjet e lidhura, në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 10, pika 1, germa "dh" si dhe nenin 20, pika 1, germa "a".

- ASHSH nuk ka të dhëna apo dijeni për statusin e likuidimit të pronarëve të shpronësuar dhe nuk monitoron pagesat, në kundërshtim me Ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 1, neni 23, neni 26.
- Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit nuk ka protokolluar procesverbalet e mbajtura, veprim në kundërshtim me Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, në kundërshtim me nenin 18 Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar.
- ASHSH nuk siguron që adresat e fundit të njohura të subjekteve të shpronësuara të dorëzohen me kërkesën fillestare, duke çuar në delegimin e njoftimit te subjekti kërkues, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8561/1999, neni 10 dhe VKM nr. 127/2000.
- ASHSH nuk ka dokumentuar dërgimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin te ASHK, duke shkelur akt-marrëveshjen dhe penguar regjistrimin e pronave brenda afatit ligjor, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8561/1999, neni 25.
- Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurat e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime janë në kundërshtim me nenin 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, *"Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 156-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: ASHSH të sigurojë përcaktimin dhe dokumentimin e qartë të afateve të fillimit dhe përfundimit të shpronësimit dhe punimeve në të gjitha shkresat dhe akt-marrëveshjet përkatëse, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor të për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik.

Menjëherë

10.2. Rekomandimi: ASHSH duhet të dokumentojë dhe monitorojë në mënyrë të detajuar statusin e likuidimit të pronarëve të shpronësuar, duke krijuar dhe mbajtur një bazë të dhënash të plotë, si dhe të sigurojë që pagesat të kryhen brenda afateve ligjore për të shmangur pavlefshmërinë e shpronësimeve.

Menjëherë

10.3. Rekomandimi: Komisioni i Posaçëm të sigurojë që të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të protokollohen rregullisht, në përputhje me standardet arkivore.

Menjëherë

10.4. Rekomandimi: ASHSH duhet të zbatojë në mënyrë rigoroze kërkesat ligjore për sigurimin e adresave të fundit të njohura të subjekteve të shpronësuara që në fazën e kërkesës fillestare, për të shmangur delegimin e njoftimit dhe për të garantuar procesin e duhur.

Menjëherë

10.5. Rekomandimi: ASHSH duhet të sigurojë dhe dokumentojë dërgimin e rregullt të vendimeve të Këshillit të Ministrave për shpronësimin te ASHK, për të respektuar akt-marrëveshjet dhe për të garantuar regjistrimin e pronave brenda afatit ligjor.

Menjëherë

10.6. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësim, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, të merren masa për standartizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) procedura prokurimi përkatësisht për "*Blerje letër A4, A3 dhe materialesh kancelarike*" dhe "*Blerje tonerash për fotokopje*", u konstatuan vonesa në afatin e lëvrimit të mallit, nga momenti i shpalljes fitues të OE deri në momentin e marrjes nga grupi i marrjes në dorëzim, veprim në kundërshtim me *shkresën nr. 738/4 prot., datë 03.10.2023 të ASHSH Ftesa për Ofertë për "Blerje letër A4, A3 dhe materialesh kancelarike" dhe me Kontratën nr. 1208/12 prot., datë 31.10.2024 për "Blerje tonerash për fotokopje". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 189-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: ASHSH të vendosë një sistem të përforcuar monitorimi për të siguruar ndjekjen në kohë të afateve të lëvrimit në të gjitha procedurat e prokurimit, të dokumentojë çdo devijim dhe të aplikojë penalitete të parashikuara për vonesat e pajustifikuara si dhe vlera e penalitetit të përcaktohet në kontratat e lidhura ndërmjet Autoritetit Kontraktor (ASHSH) dhe operatorëve ekonomike të shpallur fitues të kontratave për të reduktuar rreziqet e tejkalimit të afateve dhe për të garantuar furnizime në përputhje me nevojat operacionale të institucionit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit për "*Blerje pjesësh këmbimi për materiale profilaktike*", mungon leja mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, si një nga dokumentacionet që duhen paraqitur nga ana e OE fitues, veprim në kundërshtim me shkresën nr. 489/7 prot., datë 21.11.2023 Ftesa për Ofertë si dhe me *Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 të APP "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 18. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 189-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve me vlerë të vogla, të shqyrtojë me vëmendje dokumentacionet e dërguara nga OE fitues, në mënyrë që mos të kualifikojë operatorë të cilët nuk plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në ftesat për ofertë.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) procedura prokurimi përkatësisht për "*Blerje pjesësh këmbimi, materiale profilaktike 2023*" dhe "*Blerje pjesësh këmbimi, materiale profilaktike 2024*", në procesverbalet e marrjes në dorëzim nuk shprehet nëse këto shërbime janë kryer sipas standardeve të përcaktuara në ftesën për ofertë, veprimet vijnë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në njësinë e sektorit publik" pika 45, si dhe me Udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 të APP "Mbi përdorimin e procedurës me

vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 18. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 189-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Komisioni i marrjes në dorëzim në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, të dokumentojë realizimin e kryerjes së shërbimeve të procedurave të llojit "Mallra dhe shërbime" sipas kërkesave të dokumenteve standardeve të procedurës së prokurimit.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **2 raste**, përkatësisht për praktikat:

- "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)",

-"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 122, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)", vendimmarrja për pranimin e kërkesës është miratuar në mungesë të dokumentacionit shoqërues dhe atë të kërkuar në përputhje me kuadrin ligjor. Në **1 rast**, përkatësisht për praktikën, "Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)", KPSH ka lejuar dorëzimin e përsëritur të dokumentacionit plotësues nga subjekti, megjithëse dispozitat ligjore parashikojnë refuzimin e menjëhershëm të kërkesës nëse dokumentacioni nuk paraqitet i plotë brenda afatit të caktuar. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime janë në kundërshtim me nenin 12, pika, 2, 3, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1 Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të sigurohet që çdo vendimmarrje për pranimin e kërkesave për shpronësim të merret vetëm pasi dokumentacioni shoqërues të jetë i plotë, i saktë dhe i verifikuar. Në rastet kur, pas kërkesës për plotësim dokumentacioni, dokumentet paraqiten të paplota ose jashtë afatit të përcaktuar, Agjencia duhet të zbatojë detyrimisht procedurën e refuzimit të kërkesës dhe njoftimit të menjëhershëm të subjektit kërkues, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **3 raste,** përkatësisht për praktikat:

-"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)",

-"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 122, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)",

-"Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2)",

vendimmarrja për pranimin e kërkesës është miratuar në mungesë të dokumentacionit që shoqëron kërkesën për shpronësim. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime në kundërshtim me nenin 13, pika 4, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar.

- ASHSH, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues realizimin e njoftimit të shpronësimit. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime në kundërshtim me nenin 14, pika 1, nenit 24, pika 1, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar, pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet", pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 23.03.2000, "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

- ASHSH nuk ka përcjell ASHK vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, për të bërë të mundur ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurën e shpronësimit finalizuar me: VKM-në nr. 279, datë 29.04.2022; VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023 dhe VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, veprime në kundërshtim me nenin 25, të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe subjektit kërkues.

- Procesverbalet e KPSH nuk janë hartuar dhe administruar në përputhje me normat teknike-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementet e dokumenteve të brendshme dhe protokollohen sipas rregullave përkatëse. Mangësitë e konstatuara janë evidentuar për procedurat e shpronësimit finalizuar me: Procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM-në me Nr. 181, datë 27.03.2024; Procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM-në me Nr. 620, datë 10.10.2024; Procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM me Nr. 221 datë 13.04.2022; Procedura e shpronësimit e finalizuar me VKM me Nr.758, datë 13.12.2024.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 18 të Urdhrit nr. 72, datë 13.02.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, "*Për miratimin e rregullores për krijimin, administrimin dhe përdorimin e dokumentacionit në arkivat e njësive arkivore*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 132-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin të sigurohet që çdo aktmarrëveshje e lidhur me subjektet kërkuese të jetë e shoqëruar detyrimisht me të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, në momentin e nënshkrimit të saj.

Në vijimësi

15.2. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të merren masa për të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen. Në mungesë të adresës zyrtare, Agjencia duhet të zbatojë format alternative të njoftimit të parashikuara në legjislacion, dhe jo t'ia delegojë këtë funksion subjektit kërkues.

Në vijimësi

15.3. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, të merren masa për të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale.

Në vijimësi

15.4. Rekomandimi: Nga Agjencia Shtetërore për Shpronësim, të merren të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, të merren masa për standartizimin dhe administrimin korrekt të procesverbaleve të KPSH, në përputhje me kërkesat tekniko-profesionale dhe normat e shërbimit arkivor.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të shpronësimit u konstatua se në **4 raste**, përkatësisht: ("Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Arbanë", Bashkia Tiranë", "Rishkimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe-Tiranë, Bashkia Tiranë", "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në me Nr. 795, datë 22.09.2015, Unaza Lindore, Tiranë Loti 2, Viti 2023", Bashkia Tiranë, Përmirësimi i shtresave rrugore, rruga "Andrea Stathi", Bashkia Korçë) u konstatua se:

- Vendimmarrja nga KPSH, për pranimin e kërkesës është miratuar në mungesë të dokumentacionit që shoqëron kërkesën për shpronësim, veprime në kundërshtim me nenin 13, pika 4, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik", i ndryshuar.
- Agjencia Shtetërore për Shpronësim, në mungesë të adresës zyrtare më të fundit të njohur të subjektit privat që shpronësohet, i kërkon subjektit kërkues realizimin e njoftimit të shpronësimit, veprime në kundërshtim me nenin 14, pika 1, nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, pikës 3 të VKM nr. 126, datë 23.03.2000, "*Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të Komisionit të Posaçëm për Shpronësimet*", pikave 2, 3 dhe 4 të VKM nr.127, datë 23.03.2000, "*Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*" dhe formularit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- Nuk është dokumentuar asnjë shkresë, ku Agjencia Shtetërore për Shpronësim, i përcjell Agjencisë Shtetërore të Kadastrës vendimin e Këshillit të Ministrave për shpronësim, për të bërë të mundur ndryshimet përkatëse në regjistrat dhe hartat kadastrale, veprime në kundërshtim me nenin 25, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private për interes publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 3, pika 6, të akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet ASHSH dhe subjektit kërkues.
- Mungesa të rregullave të hollësishme, për mënyrën e negocimit të ASHSH, me subjektet e shpronësuara, duke cenuar garancitë ligjore për pronarët, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", neni 11, pika 5, germa d.
- ASHSH nuk ka të dhëna apo dijeni për statusin e likuidimit të pronarëve të shpronësuar dhe nuk monitoron pagesat, duke shkelur nenet 1, 23 dhe 26 të ligjit nr. 8561/1999 dhe detyrimin, për të krijuar bazën e të dhënave të likuidimeve, gjë që mund të çojë në pavlefshmëri shpronësimesh. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 1, neni 23, neni 26. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 187-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, të merren masa për:

- Të siguruar që çdo aktmarrëveshje e lidhur me subjektet kërkuese të jetë e shoqëruar, detyrimisht me të gjithë dokumentacionin ligjor të kërkuar, në momentin e nënshkrimit të saj;
- Të siguruar në çdo rast njoftimin e drejtpërdrejtë të subjekteve private që shpronësohen. Në mungesë të adresës zyrtare, Agjencia duhet të zbatojë format alternative të njoftimit të parashikuara në legjislacion, dhe jo t'ia delegojë këtë funksion subjektit kërkues;

- Të garantuar dërgimin e menjëhershëm dhe të dokumentuar të çdo vendimi të Këshillit të Ministrave për shpronësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mënyrë që kjo e fundit të kryejë brenda afateve ligjore veprimet e regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve në regjistrat dhe hartat kadastrale.

16.2 Rekomandimi: ASHSH në bashkëpunim me ministrinë e linjës MIE, të hartojë dhe miratojë urgjentisht një akt normativ që përcakton rregullat e detajuara për procesin e negocimit.

Në vijimësi

16.3. Rekomandimi: ASHSH duhet të dokumentojë dhe monitorojë në mënyrë të detajuar statusin e likuidimit të pronarëve të shpronësuar, duke krijuar dhe mbajtur një bazë të dhënash të plotë, si dhe të sigurojë që pagesat të kryhen brenda afateve ligjore për të shmangur pavlefshmërinë e shpronësimeve.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në **2** projekte shpronësimi të audituara rezultoi se ASHSH ka aplikuar afate të zgjatura dhe ka toleruar vonesa të pajustifikuara në procesin e plotësimit të dokumentacionit për shpronësim nga ana e subjektit kërkues, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", neni 12, pika 3, i cili kërkon veprim të shpejtë (kthim ose refuzim) të kërkesave jo të plota brenda afatit të caktuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 185-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të hartojë dhe miratojë sa më shpejt një akt normativ, që përcakton afate të qarta dhe konkrete për plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesit, si dhe të sigurohet zbatimi rigoroz i detyrimeve ligjore për kthimin ose refuzimin e kërkesave në rast të mos përmbushjes së afateve.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave me vlerë të vogël u konstatua se në 7 procedura të audituara, u konstatuan parregullsi në 3 procedura me vlerë të fondit limit 1,571,000 lekë pa TVSH, si më poshtë:

- Në 1 rast, procedura me vlerë të vogël "Blerje letër A4 dhe A3 dhe materiale kancelarie, mungon numri i protokollit, në dokumentacionin e marrjes në dorëzim.
- Në 1 rast procedura me vlerë të vogël "Blerje programi financiar", komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka specialistë të fushës, *në kundërshtim me pikën 43 të UMF-së me Nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*
- Në 1 rast, procedura me vlerë të vogël "Blerje pajisje për programin software-ik "Auto-Cad" dhe Civil 3D 2022, është konstatuar se komisioni nuk ka specialistë të fushës;
- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që artikujt/ shërbimi të jetë marrë në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 43 të Udhëzimit të MF-së nr. 30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, dhe me përcaktimet e VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimin Nr.5, datë 25.06.2021 *"Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". (Më hollësisht trajtuar në faqet 189-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për Shpronësim, të marrë masa, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë, që në të ardhmen, për çdo procedurë prokurimi "blerje me vlerë të vogël", të zbatojë me përpikmëri Legjislacionin e prokurimit publik, përpos ligjit dhe VKM-së. Kuadri ligjor përbëhet edhe nga akte nënligjore të Agjencisë së Prokurimit Publik, si: Udhëzime,

Rekomandime, etj., që synojnë mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik. "*Rregulloret e aplikueshme*" janë të gjitha aktet nënligjore që rregullojnë prokurimin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga Auditimi: Gjatë Auditimit ka rezultuar se nuk është vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit duke mos marrë masa për të parandaluar ardhjen e dëmit ekonomik për buxhetin e shtetit ose efektin financiar negativ si rezultat i llogaritjes së gabuar të vlerës së shpronësimeve konstatuar nga gjykata në proceset gjyqësore të iniciuara nga të shpronësuarit, në masën 560,230,000 lekë. Kjo diferencë (*midis asaj që është llogaritur në fakt dhe asaj që Gjykata ka pranuar për të shpronësuarit*) vjen si shkak i mos aplikimit të vlerës së pronës së shpronësuar sipas standardit të vendosur nga Gjykata në zbatim të efekteve të vendimit të K.RR.T.SH nr.3 datë 16.12.2004 për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit Tiranë.
Ky vendim ka ndryshuar statusin juridik të pasurive sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.7980 datë 27.5.1995''Për shitblerjen e trojeve në RSH'', konkretisht nenit 1 të këtij ligji; ''truall quhet e gjithë toka që ndodhet brenda vijave kufizuese të qyteteve (Bashkive) pavarësisht nëse përdoret për ndërtim, kopësht, arë etj....''Vendimi i KRRTSH nuk është reflektuar në zërat kadastrale të pasurive me qëllim saktësimin e statusit juridik të secilës pasuri për të cilën është kërkuar shpronësimi. Siç dhe Bashkia si institucioni kompetent për menaxhimin e territorit të saj nuk ka reflektuar në kërkesat për ASHK dhe për ASHSH pasojat ligjore të vendimit të KRRTSH nr.3 datë 16.12.2004. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqet 80-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim, të marrë masat në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit që të kërkojë procedurialisht pranë Gjykatës së Lartë, unifikimin e praktikës gjyqësore, me qëllim implementimin e saj në procedurat e shpronësimeve në praktikën e punës dhe shmangien e konflikteve gjyqësore, pa cenuar të drejtat e pronarëve dhe lirinë e pronës.

1.2. Rekomandimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimit të kërkojë në Gjykatën e Lartë pezullimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për të shmangur ekzekutimin detyrimeve financiare në dëm të buxhetit të shtetit deri sa të unifikojë kjo Gjykatë praktikën Gjyqësore dhe çështja të marrë një zgjidhje përfundimtare ligjore.

Menjëherë

D. MASA DISIPINORE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15 germa c); Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 37 "*Masa disiplinore*" dhe Kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë Shtetërore të Shpronësimeve (ASHSH)** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

V. ANEKSE

Aneksi 2.1.

Tabela 1. Tabela Përmbledhëse e procedurave blerje me vlerë të vogël, për vitin 2021.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues
1	"Blerje pajisje matëse topografike GPS"	Pajisje topografie	1000,000.00	995,000.00	"LAND & CO."
2	Blerje bojra printeri / fotokopjesh	Toner për makinat fotokopjuese	800,000.00	477,890.00	"Adenis Kastrati"
3	Blerje gomash për makina	Goma për automjete të lehta, Goma për makina motorike	100,000.00	95,834.00	"ILMI HAXHIU"
4	Blerje karburanti	Naftë, Karburant diesel	415,000.00	341,250.00	"GEGA CENTER GKG"
5	Blerje karburanti	Karburante, Naftë	400,000.00	392,665.00	"GEGA CENTER GKG"
6	Blerje karta identifikimi (badge) për stafin dhe tabela identifikuese për zyrat	Pajisje të identifikimit personal, Tabela letre ose aksesorë, Bazha identifikimi, Produkte informacioni dhe promocioni	100,000.00	36,750.00	"Dhimitër Vasi"
7	Blerje kartëvizita dhe materiale përfaqësimi	Materiale të ndryshme të shtypura	60,000.00	57,700.00	"Dhimitër Vasi"
8	Blerje kuti te ndihmës së shpejtë	Kuti të ndihmës së shpejtë	15,000.00	11,209.00	"Donald Daja"
9	Blerje materiale kancelarie	Furnizime dhe pajisje të ndryshme zyre	800,000.00	697,000.00	"IT Gjergji Kompjuter"
10	Blerje materiale mbrojtëse për "Covid-19"	Pajisje dhe produkte të ndryshme mjekësore	50,000.00	50,000.00	"BLEDAR RUSMALI"
11	Blerje materiale pastrimi	Produkte pastrimi mobiljesh (përfshihen zyrat), elektroshtëpiakët (përjashtuar ndriçuesët)	100,000.00	97,840.00	"BLEDAR RUSMALI"
12	Blerje pajisje hardëare TIK	Pajisje elektronike	800,000.00	766,667.00	"JUPITER GROUP"
13	Blerje pajisje për zyrat (mobilje, karrike)	Karrige, Mobilje për zyra	800,000.00	613,000.00	"BUNA"
14	Blerje siguracion TPL	Shërbime për siguracion, Shërbime për siguracionin e detyrueshëm për automjetet	50,000.00	24,473.00	"Albsig"
15	Blerje të programeve softëare-ike"	Konfigurime kompjuteri, Paketa softëare analitike, shkencore, matematikore ose parashikuese, Mirëmbajtja e softëareve të teknologjisë së informacionit	500,000.00	464,000.00	"INFOSOFT SYSTEMS"
16	Shërbim lavazhi për makinat e institucionit	Shërbime larje makinash dhe të ngjashme	30,000.00	28,000.00	"Xhovan Gjini"
17	Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash	Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash, Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje për pjesë specifike automjetesh	100,000.00	98,375.00	"Lorenc Peti"

Burimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve

Tabela 2. Tabela Përmbledhëse e procedurave blerje me vlerë të vogël, për vitin 2022.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues
1	"Blerje leter A4, letër A3 dhe materiale kancelarie"	Dosje, Stilolapsa me majë të rrumbullakët, Stilolapsa, Lapsa, Rimbushje lapsash plumbi, Stilolapsa korrigjimi, Letër fotokopjuese, Lapsa vizatimi, Lapsa me ngjyra	800,000.00	599,000.00	"InfoSoft Office"
2	"Blerje programi financiar për regjistrimin e veprimeve kontabël të institucionit"	Konfigurime kompjuteri, Paketa softëare për sisteme financiare, Mirëmbajtja e softëareve të teknologjisë së informacionit	250,000.00	249,700.00	"INFOSOFT SOFTËARE DEVELOPER"
3	Blerje e programeve softëare AutoCad 2022 dhe Civil 3D 2022	Konfigurime kompjuteri, Paketa softëare dhe sisteme informacioni, Mirëmbajtja e softëareve të teknologjisë së informacionit	521,000.00	444,396.00	INFOSOFT SYSTEMS
4	Blerje mobiljesh për zyra	Karrige me rrota, Tavolina, dollapë, tavolina pune dhe rafte librash, Mobilje për zyra, Rafte për zyra, Komodina	1000,000.00	579,000.00	"RO - AL"
				297,000.00	"RO - AL"
5	Blerje pajisje elektronike, kompjuterike për nevojat e institucionit	Kompjutera portativ, Kompjutera desktop, Furnizues kompjuterike	1000,000.00	758,900.00	"EURO INFORM"
				124,900.00	"EURO INFORM"

Burimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve

Tabela 3. Tabela Përmbledhëse e procedurave blerje me vlerë të vogël, për vitin 2023.

Burimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues
1	"Blerje furnizimesh dhe materialesh të tjera elektrike/teknike dhe të përgjithshme"	Pajisje elektrike dhe aksesorë, Materiale elektrike	100,000.00	100,000.00	Ervin Zenelaj
2	"Blerje letër A4, letër A3 dhe materiale kancelarie"	Dosje, Stilolapsa, Lapsa, Stilolapsa korrigjimi	500,000.00	360,000.00	MARKETING & DISTRIBUTION
3	"Blerje materiale pastrimi për zyrat, detergjentë të ndryshëm"	Lecke pastrimi fuser, Pelhura pastrimi, Produkte pastrimi, Detergjente	100,000.00	99,445.00	Pastrime Silvio
4	"Blerje Naftë (Gazoil D1)"	Naftë, Karburant diesel	500,000.00	498,666.00	"GEGA CENTER GKG"
5	"Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike"	Bateri, Pjesë dhe pajisje për automjetet dhe motorët e tyre, 6Frena dhe pjesë të fr7enave	500,000.00	464,000.00	Olsi Motors Motors
6	"Blerje siguracioni TPL për automjetet e ASHSH-in"	Sherbime per siguracion e detyrueshem per automjetet	50,000.00	46,000.00	Atlantik - Shoqeri Sigurimesh
7	"Shërbime për mirëmbajtjen e makinerisë fotokopjuese"	Shërbime të ndryshme për riparim dhe mirëmbajtje	100,000.00	70,000.00	EURO INFORM
8	Blerje bileta transporti ajror	Bileta transporti	600,000.00	189,000.00	AMADEUS TRAËELL AND TOURS
				124,110.00	AMADEUS TRAËELL AND TOURS
				165,536.00	ARLO Travel-Blu Tour Operator
9	Blerje e programeve softëare AutoCad 2023 dhe Civil 3D 2023	Konfigurime kompjuteri, Paketa softëare dhe sisteme informacioni	521,000.00	423,276.00	INFOSOFT SYSTEMS
10	Blerje tonera per printera dhe fotokopje	Toner per printer lazer /makina fax , Toner per makinat fotokopjuese	500,000.00	247,500.00	InfoSoft Office
11	Lyerje e ambjenteve te ASHSH	Lyerje, Shërbime lyerjeje	250,000.00	125,500.00	CONSTRUCTION ALBANIA ALBANIA
12	Riparim dhe Mirembajtje automjetesh	Automjete, Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash	100,000.00	79,166.66	ANDI HAMO

Tabela 4. Tabela Përmbledhëse e procedurave blerje me vlerë të vogël, për vitin 2024.

Nr.	Objekti i Prokurimit	Kodet CPV	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues
1	"Blerje pjesë këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike per automjetet ne perdorim te ASHSH"	Lubrifikantet, Bateri, Goma për automjete të lehta, Goma për makina motorike, Filtra të naftës, benzinës ??dhe ajrit , Filtra vaji, Filtra nafte	500,000.00	437,000.00	Blerim Ajdinaj
2	"Blerje e sistemit te kontrollit te hyrje/ daljeve per punonjesit e ASHSH-se"	Karta hyrjeje	100,000.00	100,000.00	Denis Mana
3	Blerje letër A4, A3 dhe materjale kancelarie	Dosje, Stilolapsa, Lapsa, Letër fotokopjuese	250,000.00	139,000.00	InfoSoft Office
4	Blerje materjale pastrimi për zyra, detergjente te ndryshëm	Lecke pastrimi fuser, Fshesa, furça dhe artikuj të tjerë te ndryshëm, Detergjentë	100,000.00	99,850.00	PL-97 GROUP
5	Blerje naftë (Gazoil D1)	Naftë, Karburant diesel	600,000.00	595,333.00	"GEGA CENTER GKG"
6	Blerje siguracioni TPL per automjetet e ASHSH-se	Sherbime per siguracion e detyrueshem per automjetet	50,000.00	47,000.00	Atlantik - Shoqeri Sigurimesh
7	Blerje tonera për printera dhe fotokopje	Toner per printer lazer /makina fax	400,000.00	150,000.00	InfoSoft Office

8	Rinovim i programeve softeare AutoCad 2024 dhe Civil 3D 2024	Konfigurime kompjuteri, Paketa softeare dhe sisteme informacioni	521,000.00	420,000.00	Next Plus
9	Riparim, mirembajtje dhe servis te automjeteve te ASHSH-se	Sherbime riparimi për automjete	100,000.00	97,000.00	Rovena Mersinaj
10	Sherbim larje të automjeteve të ASHSH-së	Sherbime larje makinash dhe të ngjashme	100,000.00	100,000.00	AMAR 17

Burimi: Agjencia Shtetërore e Shpronësimeve

Aneksi 2.2.

Tabela 1. Tabela Përmbledhëse e dosjeve të shpronësimit të audituara, për periudhën 2021 -2024.

Nr.	Titulli i projektit	VKM	Vlera në lekë	Audituar
1	Rishikim i projektit për segmentin rrugorë të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6	*VKM nr. 662, datë 13.10.2022*	3,158,206,249	K. Gjurgjaj
2	*Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, me vendndodhje në Bashkinë Shkodër*	*VKM nr.83/42, datë 03.03.2025*	402,403,347	K. Gjurgjaj
3	Ndërtim kopshti dhe çerdhe integruar nr. 42, Bashkia Tiranë	VKM nr. 98/3 prot, datë 2.3.2022	*66,620,761.2*	K. Gjurgjaj
4	*Sistemim rrugësh, blloku tek Stadiumi, Bashkia Pogradec*	*VKM nr. 569, datë 04.10.2023*	*245,384.49*	K. Gjurgjaj
5	*Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë-Orikum dhe dy By-pass-ve në Rradhimë Vlorë*	*???????*	99,468,454.41	K. Gjurgjaj
6	Studim projektim i mbikalimit të Fllakës	*??????*	21,005,672	S. Muçaj
7	Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 20.12.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të palujtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza lindore Tiranë, Loti III (Shtesa), i ndryshuar, finalizuar me VKM nr. 867, datë 27.12.2022.	*VKM nr. 867, datë 27.12.2022*	45,651,432	S. Muçaj
8	Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 20.12.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të palujtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza lindore Tiranë, Loti III (Shtesa), i ndryshuar, finalizuar me VKM nr. 510, datë 21.03.2023	*VKM nr. 510, datë 21.03.2023*	18,040,988	S. Muçaj
9	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të pajutshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugorë "Rishikim i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe, Tiranë nga Seshii Shqiponja-Bulevardi i Ri dhe rikualifikim i Unazës Lindore për lotët 4-5-6" dhe "Studim-projektim, rikualifikim i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6" Bashkia Tiranë, finalizuar me VKM nr. 287, datë 17.05.2023 në vlerën 669,827,726.40 lekë	VKM nr. 662 prot., datë 13.10.2022	669,827,726.40	S. Muçaj
10	Projektit të rishikuar për Lotet 4, 5, 6. Unaza Lindore (VKM nr. 607. dt.2.10.2024) ndryshuar,	VKM nr. 607. dt.2.10.2024	51,071,853.42	R. Gjati
11	Projekti i Ndërtimit Unazës Lindore Loti II (status i finalizuar me VKM nr. 65 datë 8.2.2023)	VKM nr. 65, datë 08.02.2023	51,071,853.42	R. Gjati
12	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i aksit rrugor Thumanë – Vorë – Kashar " (finalizuar me VKM Nr. 332., datë 31.05.2023)	VKM nr. 332, datë 31.05.2023	115,359,481.9	R. Gjati
13	Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik "Teda Tiranë" V.K.M nr. 286, datë 17.5.2023	VKM nr. 286, datë 17.05.2023	115,592,960	R. Gjati
14	Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore"		537,441,630	R. Gjati

15	Ndërtimi i Rrugës Shëngjin – Baks - Rrjoll, segmenti nga km + 0.00 deri në km 7 + 310.	VKM nr. 246/2023	14,453,7 06,763	R. Gjati
16	Ndërtimi i Nënstacionit 400 kv Elbasan 3.		36,881,231.58	R. Gjati
17	Unaza Lindore Tiranë, Loti 3	VKM nr. 487, datë 30.07.2021	62,764,102	J. Hysomema
18	Projektimi i "Shkollës së Biçikletave" për grupmoshat 7-10 vjeç, Tiranë"	VKM nr. 510, datë 27.07.2022	321,148,389.1	J. Hysomema
19	Ndërtimi i shkollës 9- vjeçare "Qazim Turdiu"	VKM-në nr. 663, datë 13.10.2022	10,833,624	J. Hysomema
20	Kërkesë për shpronësim, "Ndërtimi i qendrës shëndetësore në lagjen "Gafur Muço".	VKM nr. 218, datë 13.04.2023	2,254,070	J. Hysomema
21	Kërkesë për shpronësim, Unaza Lindore Loti 2, dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit (për disa shtesa në VKM-në nr.65, datë 08.02.2023)"	VKM nr. 66, datë 14.02.2024	1,077,705	J. Hysomema
22	Kërkesë për shpronësim, lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar, Vlorë.	VKM nr. 20, datë 17.01.2024	206,784,215.9	J. Hysomema
23	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 658, datë 08.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Zgjerimi i rrugës së Elbasanit (Fakulteti Filologjik – Unaza e Madhe e Tiranës)	*VKM nr. 279, datë 29.04.2022*	2,025,300	H. Axhushi
24	"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 122, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor 'Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës)'"	*VKM-në nr. 13, datë 18.01.2023*	1,063,927,00 1	H. Axhushi
25	Rrishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga Sheshi Shqiponja – Bulevardi Ri dhe Rikualifikim i Unazës Lindore për lotet 4, 5, 6 (faza 2).	*VKM nr. 896, datë 29.12.2022*	143,632,865.70	H. Axhushi
26	Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë i produkteve ushqimore Tirana Agrikulturë (status i finalizuar).	VKM nr. 504, datë 30.08.2023	3,434,215.68	B. Shehu
27	Projekt Ndërtim i Objektit 6 kate+1 kat parkim nën tokë në truallin që pronësi të Entit të Banesave (status i refuzuar)		1,853,478	B. Shehu
28	Projekt zbatimi për ndërtimin e shëtitores së pluzhit të Durrësit, nga ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës", finalizuar me VKM nr. 508 datë 01.08.2024	VKM nr. 508, datë 01.08.2024	26,298,893	B. Shehu
29	Projekt zgjerimi i Varrezave Publike, qyteti Përmet" finalizuar me VKM nr. 687, datë 06.11.2024	VKM nr. 687, datë 06.11.2024	940,800	B. Shehu
30	Projekt Ndërtimi i kopshtit nr. 37, Tiranë.	VKM nr. 504, datë 30.08.2023	25,247,313	B. Shehu
31	Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare Arbanë", Bashkia Tiranë" finalizuar me VKM nr. 181, datë 27.03.2024 në shumën 423,129.70 lekë	VKM nr. 181, datë 27.03.2024	37,677,789.70	E. Saliu
32	Rishkimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe-Tiranë, Bashkia Tiranë.	VKM nr. 896, datë 16.09.2020	37,677,789.70	E. Saliu
33	Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në me Nr. 795, datë 22.09.2015, Unaza Lindore, Tiranë Loti 2, Viti 2023", Bashkia Tiranë	VKM nr. 726, datë 16.09.2020	15,280,707	E. Saliu
34	Përmirësimi i shtresave rrugore, rruga "Andrea Stathë", Bashkia Korçë.	VKM nr. 758, datë 13.12.2024	1,545,197	E. Saliu